

**DUKURI TË REJA KRIMINALE NË SHOQËRINË  
KOSOVARE: VËSHTRIM ANTROPOLOGJIK DHE  
KRIMINOLOGJIK NË RAJONIN E GJAKOVËS**  
**(1999-2012)**

Bekim Sh. Avdiaj

Dorëzuar:  
Universitetit European të Tiranës  
Shkolla Doktorale

Në përbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Sociale, me profil Sociologji antropologjike, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Aleksandër Dhima

Numri i fjalëve: 68043

Tiranë, 2016

## DEKLARATA E AUTORËSISË

Ky punim publikohet për herë tëparë si punim doktoral, pranë Universitetit European të Tiranës. Asnjë pjesë nuk është përfshirë në punim pa citimet përkatëse, çdo analizë që vjen si rrjedhojë e leximit të autorëve të tjerë sqarohet dhe bëhet me dije.

Ky punim është pronësi intelektuale i autorit.

©Bekim Avdiaj

Tiranë, 2016

## ABSTRAKT

Në kohën e sotme është shumë e kuptueshme se kompleksiteti i shoqërisë dhe ndërlikueshmëria e saj paraqet një prerje të kaluarës, të sotmes dhe së ardhmes. Këtë e forcojnë edhe më tej evoluimet e fuqishme që përjetuan dhe po përjetojnë vendet në tranzicion, me ç'rast shkaktuan ‘tërmete’ në të gjitha sferat shoqërore, duke mos kursyer as vlerat njerëzore. Zhvillimi i shoqërive, sidomos atyre të dala nga sistemet e izoluara, për të mbijetuar zhvillimet globale duhet t'u përgjigjen në kohë dhe të shfaqin fleksibilitet ndaj ndryshimeve që vijnë, si: politike, ekonomike, sociale dhe atyre teknologjike.

Qëllimi i studimit është që të kuptojmë karakteristikat e realitetit në drejtim që po lëvizim si shoqëri. Fillimi i organizimit shoqëror modern në shoqérinë e kësaj treve, individëve dhe grupeve të ndryshme u mundësoi edhe beteja mes vete, me qëllim të përforcimit të pozitave të tyre, jo vetëm materiale por edhe të atyre politike. Këtë e shpreh Fatos Tarifa, që thotë se “sot, në fillim të shek. XXI, popullsia e shumë prej vendeve në zhvillim është politikisht e agravuar dhe aktive, e ndërgjegjësuar si rrallëherë më parë për padrejtësitë ekonomike e sociale dhe, shumë herë, e indinjuar dhe e zemëruar për mungesën e dinjitetit të vet politik e shoqëror” (Tarifa, 2014: 36). Kjo bënë që sot shoqëritë ‘moderne’ në botën bashkëkohore ballafaqohen me shtim gjithnjë e më të madh të aktiviteteve kriminale. Kohëve të fundit, prirjet e zhvillimit të kriminalitetit kanë ndryshuar nga e kaluara, duke marrë përmasa që e tejkalojnë natyrën e traditave kulturore, zakonore dhe trashëgimore që janë hasur tradicionalisht në botën shqiptare, duke u vënë në lidhje me rrjete kriminale të natyrave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Një tablo e tillë pasqyrohet edhe në realitetin shoqëror të rajonit të Gjakovës. Dallimi midis aktiviteteve kriminale nga e kaluara me këto të sotmet është shumë i madh, me theks të veçantë në periudhën e pas Luftës në Kosovë deri në ditët e sotme. Kështu që paraqitet nevoja për një analizë më të thellë rreth trajtimit të këtyre aktiviteteve kriminale, shumë nga të cilat nuk kanë qenë në traditën dhe kulturën shqiptare.

Lindja, zhvillimi dhe përhapja në përmasa të mëdha e këtyre dukurive në rajonin e Gjakovës dhe më gjerë, në tërë Kosovën, kërkon vërtetë një vështrim edhe në aspektin antropologjik-kulturor dhe kriminologjik, me qëllim hulumtimin e lidhjeve dhe arsyeve që përdorin subjektet e aktiviteteve kriminale. Disa nga aktivitetet kriminale nuk kursejnë as edhe përdorimin e dhunës deri në agresivitetin më të lartë. Por, veç anës juridike dhe policore në luftën ndaj kësaj dukurie, jemi të mendimit se *analiza kulturore* e kriminalitetit mund të ndihmojë dukshëm në kuptimin bazik të natyrës së tij në Kosovë dhe, për rrjedhojë, edhe në një luftë ballore më të efektshme ndaj tij. Në anën tjetër, roli i shoqërisë në këtë drejtim është i pashmangshëm, pasi që dihet se “shkaqet e krimtit dhe rrënjet e tij gjenden në vetë natyrën e shoqërisë njerëzore, në ambientin shoqëror dhe në mungesën e kontrollit shoqëror” (Halili, 2008: 96). Kjo na shpie në kërkesën për hulumtimin se nga fryshtëzohen, cilat janë shkaqet dhe arsyet që këto subjekte të zhvillojnë këso aktivitetesh. Madje, ne na duhet të kërkojmë dhe të vlerësojmë gjendjen ekonomike e sociale të rajonit, situatën politike, periudhën e tranzicionit, nëse faktorë të tillë janë ndikues të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në këto dukuri. Metoda e përdorur në këtë punim është ajo sasiore dhe cilësore, ku të dhënat e të anketuarve janë përpunuar përmes programit të SPSS.

## **ABSTRACT**

Nowadays it is quite understandable that the complexity of society and its complication represent a cut of the past, present and future. It gets strengthened even further, especially by the powerful evolutions experienced and still being experienced by the countries in transition, thus caused "earthquakes" in all spheres of society, sparing neither human values. The development of societies, especially those arising from isolated systems, to survive global developments must respond on time and show flexibility to upcoming changes, such as political, economic, social and technological ones.

The purpose of the study is to understand the characteristics of reality in the direction that we are moving as a society. The beginning of modern social organization in the society of this area also enabled the battle among individuals and groups in order to strengthen their positions, not only material but also political ones. This is expressed by Fatos Tarifa, saying that "today, at the beginning of the 21<sup>st</sup> century, the population of many of the emerging countries is politically aggravated and active, and aware like rarely before to economic and social injustices, and many times, indignant and angry about the lack of of its political and social dignity." (Tarifa, 2014: 36). This causes that the today 'modern' societies in the contemporary world are facing increasingly bigger augmentation of criminal activities. Recently, the development trends of crime have changed from the past, taking dimensions which go beyond the nature of cultural traditions, customary and inheritance encountered traditionally in the Albanian world, being put in relation to criminal networks of different type inside and abroad. Such a picture is also reflected in the social reality of Gjakova region. The difference between the criminal activities of the past with those of today is enormous, with particular emphasis on the period after the Kosovo war up to the present day. Hence is a need for a deeper analysis about the treatment of these criminal activities, many of which have not been in the Albanian tradition and culture.

Birth, the development and spread on a large scale of these phenomena in Gjakova region and beyond, throughout Kosovo, really requires a look in anthropological-cultural and criminological terms, with the aim of finding connections and causes using subjects of criminal activities. Some of criminal activities do not save even the use of violence up to a high aggressiveness. But in addition to the legal and police side in fighting this phenomenon, we believe that cultural analysis of crime can greatly assist on understanding its basic nature in Kosovo and, therefore, to be even more effectively on a frontal war against it (crime). On the other hand, the role of society in this direction is inevitable, since it is known that "the causes of crime and its roots are in the nature of human society, in social environment and lack of social control" (Halili, 2008: 96). This leads us to demand for the research about the origin of inspiration, what are the causes and reasons for these entities to develop such activities. Even more, we should seek and evaluate the economic and social situation in the region, the political situation, the period of transition, if such factors are influencing directly or indirectly these occurrences. The method used in this paper is qualitative and quantitative, and data from respondents were processed through the SPSS program.

*Bekimi më i madhi i jetës është dashuria e familjes.  
Gruas sime, Lumnijes dhe fëmijëve, Besnikut, Jetlirës dhe Arlindit.  
Në çastet më stresuese, unë gjeta çlodhje në përqafimet tuaja të ngrohta.*

## FALËNDERIME

Ky punim është produkt i një pune disa vjeçare studimore i realizuar me një përkushtim të lartë, nxitja e të cilët është si rezultat i punës profesionale dhe njohjes në detaje me problematikat e kësaj shoqërie në fushën e sigurisë dhe atë sociale. Mirëpo, realizimi me sukses dhe shtimi i vlerave të kësaj pune është bërë me përkrahjen e pakursyer të disa personave dhe institucioneve, të cilëve shfrytëzoj rastin t'i shpreh mirënjojhen dhe falënderimin tim nga thellësia e zemrës.

Falënderimi i parë shkon për udhëheqësin tim shkencor, të nderuarin prof. dr. Aleksandër Dhima, për përkrahjen dhe mbështetjen e pakursyer si dhe për sugjerimet dhe këshillat e tija të pandërprera e me shumë vlera. Edhe pse largësia gjeografike na ndante me qindra kilometra, përkushtimi dhe profesionalizmi i tij i shkrin ato, duke më qenë afër në çdo kohë dhe situatë. Ndihamë e madhe ishte përvoja e gjatë me studentë dhe përgatitja shkencore në fushën profesionale të tij, gjë që reflektuan edhe në përgatitjen e punimit tim shkencor. Përkundër angazhimeve si pedagog universiteti si dhe shumë angazhimeve të tjera në fushën e tij akademike, gjithmonë me urtësinë e tij më inkurajonte dhe më shtynte përpara. Si rrallë kush ka mundur të kuptojë dhe shfrytëzojë edhe angazhimet nga puna ime profesionale, ku me mjeshtëri ka shfrytëzuar njohuritë dhe faktet që posedoja nga fusha e kriminalitetit, njëkohësisht duke më dhënë edhe hapësirë shkencore për të punuar në nxjerrjen e produktit, por që me mbikëqyrje të pandërprerë.

Një falënderim shkon edhe për prof. dr. Fatos Tarifa, i cili vazhdimisht ka përcjellë punën time dhe përmes sugjerimeve dhe kritikave pozitive më ka inkurajuar për punë edhe më të madhe. Vlerësimet e tij se do të jetë një punim i veçantë në këtë fushë dhe me shumë rëndësi kanë qenë shumë motivuese. Po ashtu, nuk ka munguar asnijëherë gatishmëria e tij për informacionet që i kërkoja, të cilat kishin vlera të paçmueshme për punën time hulumtuese.

Falënderimet më të sinqerta iu takojnë edhe individëve e institucioneve, si në vijim: z. Shpend Maxhuni, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, i cili ka kuptuar qëllimin e punimit dhe më ka dhënë hapësirë në shfrytëzimin e disa të dhënavëve në fushën kriminale në rajonin që kisha për studim; pastaj z. Shemsi Hajrizi, Drejtor i përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe z. Burim Buleshkaj, që më kanë mundësuar çasjen në të gjitha burgjet e Kosovës për të realizuar anketimin me personat e dënuar; kolegët nga stacioni policor i Gjakovës për sigurimin e të dhënavëve; menaxherët e shërbimit korrektues në Pejë, Dubravë dhe Lipjan për mirëkuptimin dhe sigurimin e personave ‘mostër’ me prejardhje të saktë nga rajoni i Gjakovës.

Një falënderim i veçantë shkon për familjen time, të cilët ishin përkrahësit dhe nxitësít më të fuqishëm për punën time studimore. Edhe kur ata kishin nevojë për mua, ditën të më kursejnë e të më kuptojnë, madje edhe atëherë kur ua merrja kohën e tyre. Durimin dhe sakrificat e tyre gjithmonë i shprehnim duke më dhuruar dashuri dhe motiv për punë. I falënderoj nga zemra që edhe kur nuk kam mundur të jem plotësisht në mbështetje të tyre, ata gjetën forcën dhe nuk iu munguan rezultatet në mësime, studime e punë. Përkrahja e tyre nuk ka munguar edhe në sigurimin e literaturës dhe realizimin e anketave në terren. Dashuria e tyre, përkushtimi dhe mbështetja e pakursyer ndaj meje u

bënë motivi kryesor për mua që të arrijë deri në finalizimin me sukses të studimeve doktorale.

Dhe së fundmi, një falënderim më së i veçantë shkon për djalin tim, Besnikun. Edhe pse i ri për nga mosha, doli të jetë i madh në përkrahjen time. Ishte aty ku ishte nevoja, sidomos në sigurimin e konferencave dhe botimeve shkencore. Përkrahja në aspektet teknike të punimit e rregulluan dhe e kompletuan atë sipas kërkjesave të parashtruara. Nuk munguan edhe idetë dhe sugjerimet e tij në këtë drejtim. Në momente më të vështira, sidomos kur kisha punë me statistika, teknologji e ndonjëherë edhe me gjuhën angleze, gjente kohën dhe durimin duke më ndihmuar me shumë modesti. Një kontribut të madh bëri në transkriptimin e shumë prej intervistave, duke më kursyer shumë kohën. Dhe së fundmi, pasurimi i punimit me fjalë e terma gjuhësor shqip e madhështuan dhe e kompletuan edhe në aspektin letrar. Andaj, e falënderoj nga zemra për gjithçka të bërë në përkrahjen time, sepse pa këtë përkrahje do të më duhej ende kohë për të mbaruar këtë punim.

Dy faqe falënderime janë të pakta për të përfshirë të gjithë bashkëpunëtorët, miqtë dhe gjithë ata që u treguan të gatshëm në çdo kohë, duke më ofruar gatishmërinë e tyre, pa të cilën asgjë nuk do të kishte vlerën që ka tani.

FALEMINDERIT NGA ZEMRA!

## Përmbajtja

KAPITULLI I: HYRJE .....	14
KAPITULLI II: ASPEKTE METODOLOGJIKE .....	22
2.1 Natyra e studimit .....	22
2.2 Interesi aktual për temën .....	22
2.3 Formulimi i problemit .....	26
2.4 Pyetja kërkimore dhe hipoteza .....	28
2.5 Metodologjia .....	29
2.6 Metodat.....	30
2.6.1 Hulumtimi në terren.....	30
2.6.2 Popullata dhe mostra e zgjedhur.....	31
2.6.3 Instrumentet e kërkimit parësor .....	36
2.6.4 Hulumtimi i faktorëve kriminologjik, institucional e kulturor përmes pyetësorëve dhe intervistave.....	38
2.6.5 Procedura e mbledhjes së të dhënave dhe sfidat.....	40
2.7 Bashkëpunimi me institucionet parandaluese e korrektuese .....	46
2.8 Vlefshmëria dhe besueshmëria e instrumenteve .....	48
2.9 Qëllimi i studimit.....	49
2.10 Rëndësia e studimit .....	50
2.11 Mundësítë dhe kufizimet .....	52
2.12 Hamendesime .....	54
KAPITULLI III: ANTROPOLOGJIA KULTURORE E KRIMINALE.....	56
3.1 Lindja dhe zhvillimi i antropologjisë kulturore e kriminale si fushë studimi .....	56
3.2 Kultura si dukuri antropologjike e sociologjike .....	62
3.3 Kultura dhe krimi në shoqëri.....	67
3.4 Natyra e prejardhjes së dukurive kriminale dhe kontrolli social .....	71
3.5 Specifikat e lëvizjes demografike.....	74
3.6 Ndikimi i faktorëve socialë; Roli i institacioneve sociale.....	78
3.7. Ndërveprimi i faktorëve institucionalë .....	83
3.8 Format e kriminalitetit dhe reagimi i shoqërisë ndër shekuj .....	86
3.8.1 Mendimet dhe teoritë mbi kriminalitetin .....	90
3.8.2 Shpjegimi i natyrës shumëdimensionale të krimtit .....	93
3.9 Transformimet ekonomike e shoqërore në botën e sotme.....	99
3.10 Evoluimi dhe risitë e shoqërisë dhe kulturës së sotme .....	102

3.11 Dukuri të reja kriminale në kontekstin e zhvillimeve të sotme ekonomike, shoqërore e teknologjike.....	106
<b>KAPITULLI IV: ZHVILLIMET EKONOMIKE, DEMOGRAFIKE E KULTURORE TË SHOQËRISË KOSOVARE DHE PRIRJET E KRIMINALITETIT; RASTI I GJAKOVËS .....</b>	<b>113</b>
4.1 Antropologjia kulturore e shoqërisë kosovare, në veçanti asaj gjakovare .....	113
4.1.1 Gjakova në kontekstin antropologjik-historik .....	121
4.2 Trashëgimia kulturore dhe risitë e jetës shoqërore në Gjakovë .....	128
4.2.1 Jeta kulturore .....	131
4.2.2 Zhvillimi i arsimit .....	135
4.3 ‘Prerje’ antropologjike dhe kriminologjike e popullsisë së Gjakovës me rrithinë .....	139
4.4 Tranzicioni demokratik pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë.....	146
4.4.1 Tranzicioni dhe krimi .....	150
4.4.2 Legjislacioni antikrim .....	155
4.4.3 Siguria shtetërore dhe institucionale ndaj krimtit: parandalimi dhe korrektimi .....	158
4.5 Harta e kriminalitetit në Gjakovë dhe rrithinë .....	165
<b>KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE .....</b>	<b>170</b>
5.1 Statistikat përshkruesse të studimit – Përpunimi statistikor i materialit .....	170
5.2 Gjetjet kryesore të studimit; Komentar i të dhënave .....	190
5.3 Faktorët nxitës .....	234
5.3.1 Hapja e lokaleve të lojërave të fatit, lokaleve të ‘natës’, kazinove .....	234
5.3.2 Legjislativi .....	238
5.3.3 Institucionet e shtetit .....	242
5.3.4 Teknologjia .....	243
5.3.5 Risocializimi .....	244
5.4 Motivi shtytës në dukuritë kriminale.....	246
5.5 Parandalimi.....	248
<b>KAPITULLI VI: PËRFUNDIME, VLERËSIMË DHE REKOMANDIME .....</b>	<b>252</b>
6.1 Implikimet teorike dhe rekomandime për studime të ardhshme në këtë fushë ..	252
6.2 Vlerësimë.....	255
6.3 Rekomandimet për institucionet shtetërore, të sigurisë dhe organizatave shoqërore .....	262
<b>SHËNIME .....</b>	<b>264</b>

Komente të pyetësorëve .....	264
Transkriptë e një interviste (narkoman) .....	265
SHTOJCA .....	268
Shtojca 1. Pyetësori me qytetarë, faqja parë.....	268
Shtojca 1. Pyetësori me qytetarë, faqja e dytë.....	269
Shtojca 1. Pyetësori me qytetarë, faqja e tretë.....	270
Shtojca 2. Pyetësori me të dënuar, faqja e parë.....	271
Shtojca 2. Pyetësori me të dënuar, faqja e dytë .....	272
Shtojca 2. Pyetësori me të dënuar, faqja e tretë.....	273
Shtojca 3. Intervista me qytetarë, faqja e parë.....	274
Shtojca 3. Intervista me qytetarë, faqja e dytë.....	275
Shtojca 4. Intervista me të dënuar, faqja e parë.....	276
Shtojca 4. Intervista me të dënuar, faqja e dytë.....	277
Shtojca 5. Statistikat me qytetarët .....	278
Shtojca 6. Statistikat me personat e dënuar .....	285
Shtojca 7. Korrespondenca me institucionet .....	296
LITERATURA.....	302
Literatura parësore.....	302
Literatura dytësore:.....	307
Burime tjera:.....	310

## **LISTA E DIAGRAIMEVE, TABELAVE DHE HARTAVE**

### **Listë e diagrameve**

DIAGRAMI 1. STRUKTURA NË TOTALIN PREJ 530 PYETËSORËSH .....	31
DIAGRAMI 2. MOSHA - ME QYTETARË .....	170
DIAGRAMI 3. MOSHA - ME TË DËNUAR .....	171
DIAGRAMI 4. GJINIA - ME QYTETARË .....	171
DIAGRAMI 5. GJINIA - ME TË DËNUAR .....	172
DIAGRAMI 6. NIVELI I SHKOLLIMIT - ME QYTETARË .....	172
DIAGRAMI 7. NIVELI I SHKOLLIMIT - ME TË DËNUAR .....	173
DIAGRAMI 8. STATUSI MARTESOR - ME QYTETARË .....	174
DIAGRAMI 9. STATUSI MARTESOR - ME TË DËNUAR .....	174
DIAGRAMI 10. STATUSI FAMILJAR -ME QYTETARË .....	174
DIAGRAMI 11. STATUSI FAMILJAR -ME TË DËNUAR .....	175
DIAGRAMI 12. VENDBANIMI - ME QYTETARË .....	175
DIAGRAMI 13. VENDBANIMI - ME TË DËNUAR .....	176
DIAGRAMI 14. STATUSI I PUNËS - ME QYTETARË .....	177
DIAGRAMI 15. STATUSI I PUNËS - ME TË DËNUAR .....	177
DIAGRAMI 16. GJENDJA EKONOMIKE - ME QYTETARË .....	177
DIAGRAMI 17. GJENDJA EKONOMIKE - ME TË DËNUAR .....	178
DIAGRAMI 18. VIKTIMË E VEPRËS PENALE .....	179
DIAGRAMI 19. DËSHMITAR I VEPRËS PENALE .....	179
DIAGRAMI 20. ANKUES PËR VETRA PENALE .....	179
DIAGRAMI 21. ME BANIM JASHTË KOSOVËS .....	180
DIAGRAMI 22. SHKELJET LIGJORE .....	181
DIAGRAMI 23. ARRESTIMI .....	181
DIAGRAMI 24. SA HERË JANË ARRESTUAR .....	182
DIAGRAMI 25. PERIUDHA E ARRESTIMEVE .....	182
DIAGRAMI 26. TË DËNUAR .....	183
DIAGRAMI 27. SA HERË JANË DËNUAR .....	183
DIAGRAMI 28. PERIUDHA KUR JANË DËNUAR .....	183
DIAGRAMI 29. FAMILJAR TË ARRESTUAR .....	184
DIAGRAMI 30. FAMILJAR TË DËNUAR .....	185
DIAGRAMI 31. NATYRA E VEPRAVE PENALE .....	185
DIAGRAMI 32. TË ARRESTUAR DHE TË DËNUAR NGA SHOQËRIA .....	186
DIAGRAMI 33. SIPAS MOSHËS - QYTETARËT .....	187
DIAGRAMI 34. SIPAS GJINISË – QYTETARËT .....	187
DIAGRAMI 35. SIPAS SHKOLLIMIT - QYTETARËT .....	188
DIAGRAMI 36. SIPAS PROFESIONIT -QYTETARËT .....	188
DIAGRAMI 37. SIPAS MOSHËS – TË DËNUARIT .....	189

DIAGRAMI 38. SIPAS GJINISË - TË DËNUARIT .....	189
DIAGRAMI 39. SIPAS SHKOLLIMIT - TË DËNUARIT .....	190
DIAGRAMI 40. VLERËSIMI I SITUATËS .....	191
DIAGRAMI 41. MËNYRA DHE LLOJI I VEPRAVE PENALE PAS VITIT 1999.....	196
DIAGRAMI 42. VLERËSIMI MBI QENËSİNË E TRENDËVE TË FUNDIT TË KRIMINALITETIT BRENDA TRADITAVE DHE KULTURËS SË KËTIJ RAJONI .....	200
DIAGRAMI 43. NDËRLIDHJA E AKTIVITETEVE KRIMINALE NË RAPORT ME TRADITËN DHE KULTURËN E RAJONIT.....	203
DIAGRAMI 44. AVANCIMET E KRIMINALITETIT.....	217
DIAGRAMI 45. NDIKIMI I MUNGESËS SË INSTITUCIONEVE STABILE GJATË PERIUDHËS SË TRANZICIONIT SI FAKTOR NË SHFAQJEN E DUKURIVE TË REJA KRIMINALE.....	225
DIAGRAMI 46. LOKALET E NATËS, LOJËRAT E FATIT, KAZINOTË – FAKTOR SHTYTËS KRIMINAL.....	235
DIAGRAMI 47. HARMONIZIMI I NORMAVE LIGJORE NË KOSOVËN E PAS LUFTËS ISHTE REAL ME RRETHANAT E KOHËS.....	239
DIAGRAMI 49. MOTIVI SHTYTËS I SHKELJES SË LIGJIT .....	247
DIAGRAMI 48. KUSH DUHET TË MERRET ME PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E DUKURIVE KRIMINAL.....	250

### **Listë e tabelave**

TABELA 1. NUMRI I BANORËVE .....	33
TABELA 2. POPULLSIA SIPAS GRUP MOSHAVE .....	34
TABELA 3. NIVELI ARSIMOR.....	34
TABELA 4. REALIZUESHMËRIA (MOSTRA) NË RAPORT ME POPULLACIONIN .....	35
TABELA 5. NUMRI I RASTEVE SIPAS KLASIFIKIMIT TË VEPRAVE PENALE.....	166
TABELA 6. TABELË STATISTIKORE PËR DISA NGA DUKURITË KRIMINALE TË RAPORTUARA NGA VITI 1999 DERI 2012 SIPAS NDARJES RAJONALE TË GJAKOVËS ME RRETHINË..	169
TABELA 7. STATISTIKAT E VETËVRASJEVE NË VITE .....	203
TABELA 8. STATISTIKAT E RASTEVE ME NARKOTIKË.....	205
TABELA 9. STATISTIKAT E UZURPIMIT TË PRONAVE .....	215
TABELA 10. STATISTIKAT E GRABITJEVE.....	219
TABELA 11. STATISTIKAT E VRASJEVE 1999-2012 .....	221
TABELA 12. RASTET E SHKAKTIMIT TË RREZIKUT TË PËRGJITHSHËM .....	222
TABELA 13. PERSONAT E ZHDKUR .....	229
TABELA 14. DHUNA NË FAMILJE .....	232
TABELA 15. DIVORCET.....	233

## **Lista e hartave**

HARTA 1. NDARJA ADMINISTRATIVE E KOMUNËS SË GJAKOVËS .....	33
HARTA 2. KRIMINALITETI NË ZONAT RURALE .....	168
HARTA 3. HARTA E KRIMINALITETIT NË ZONËN URBANE- GJAKOVË .....	168

## **Listë e shkurtimeve**

OJQ – Organizata jo qeveritare

OSBE – Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara

PK – Policia e Kosovë

KLSP - Komitetet Lokale për Siguri Publike

KFOR – Kosovo Peacekeeping Force

EVSB - Ekipet Vepruese të Sigurisë në Bashkësi

KKSB - Këshillin Komunal për Siguri të Bashkësive

NATO – North Atlantic Treaty Organization

UNMIK – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

VP – Vepra Penale

## KAPITULLI I: HYRJE

Ndryshimet shoqërore nëpër histori janë udhëtari i përjetshëm i qenies njerëzore.

Varësisht rrethanave të kohës, kanë ndodhur edhe zhvillimet shoqërore. Shoqëria njerëzore gjatë zhvillimit të saj historik është sfiduar gjeneratë pas gjenerate. Këto sfida nuk kanë kursyer as mënyrën e jetës. Megjithatë, për një stabilitet shoqëror gjithmonë është vepruar sipas asaj që ka ofruar koha. Sipas M. Krasniqi-t, “mënyra e jetesës dhe e mendimit të njeriut formohet dhe stabilizohet nën ndikimin e kushteve shoqërore dhe ekonomike të periudhës së caktuar” (Krasniqi, 1990: 297).

Të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar edhe në proceset e organizimit shoqëror si dhe në aspektin social modern. Deri vonë pjesa më e madhe e shoqërive organizoheshin bazuar në traditat kulturore të tyre. Prandaj, sipas R. Burkart,

Njeriu nuk mund të mbijetojë vetëm nëse e fiton kulturën, d.m.th. vetëm nëse e përparon dhe e koncepton natyrën dhe e ndryshon atë, si dhe vetëm nëse mungesat dhe specifikat nga bashkëpunimi social i kompenson. Pra, kultura është veprim, përparim njerëzor që bënë ndryshime nga natyra dhe nga rrethi në të cilin jeton njeriu (Burkart, 1998: 15)

Zotërimi i tipareve dhe karakteristikave tradicionale e kulturore të trashëgura del të jetë i shoqëruar dhe ndikuar edhe prej kulturave të tjera. Kështu, përvetësimi i të rejave dhe atyre të vjetra dinë të krijojnë shumë herë edhe pakënaqësi të ndërsjellë. Pra, çdo individë apo grup mund të krijojnë kultura të reja, me qëllim të krijimit të rrethanave më të favorshme për jetën e tyre. Lidhur me këtë kemi shprehjen e M. Weber, sipas të cilit “ngjashmëria dhe ndryshimi i zakoneve dhe traditave pavarësisht nga fakti nëse janë të trashëgura biologjikisht apo janë transmetuar në mënyrë tradicionale që nga fillimi, i

nënshtrohen ndryshimit dhe zhvillimit të tyre nëpërmjet kushteve të ngjashme të jetës shoqërore” (Weber, 2004: 128).

Duke u bazuar se qenia njerëzore është qenie e kulturuar, bën që individi dhe grupi të kenë një vlerësim më real ndaj botës. Andaj, antropologu shqiptar, A. Dhima na jep një shpjegim shumë interesant në lidhje me rëndësinë që ka përshtatja e kulturave kur ka ndryshim në sistemin e organizimit shoqëror, duke shprehur se, “nga shkalla e përafrimit të vlerave kulturore të sistemeve të ndryshme përcaktohet në një masë të madhe ecuria e përshtatjes kulturore të njerëzve, kur ata kalojnë përkohësisht ose përgjithnjë nga mjedisi i njërit sistem kulturor në atë të një tjetri” (Dhima, 2010: 192). Të gjitha këto bëjnë që sot shoqëria të jetë në nivelin e zhvillimeve globale dhe shpesh në një botë virtuale dhe multi-kulturore. Kërkesat që vijnë nga këto reflektive shoqërisë i imponojnë që të sfidohet me një dinamizëm jetësor.

Duke iu referuar këtyre dhe rrethanave të reja të shoqërisë kosovare, ky punim doktoral fokusohet pikërisht te profili i kulturës tradicionale në rajonin e Gjakovës dhe transformimi i saj në atë moderne dhe efektet negative në aspektin e kriminologjisë, që u paraqiten gjatë kësaj periudhe, ku ka për qëllim qartësimin e lidhjeve që ekzistojnë me rastin e ‘prurjeve’ të reja kulturore dhe paraqitjen e dukurive të reja kriminale në këtë rajon. Këto ndryshime janë pjesë pasuese e ndryshimeve edhe në riorganizimin shoqëror, pra nga kalimi i një sistemi të mbyllur socialist në sistemin e hapur demokratik.

Shtysa drejt këtij punimi ndërlidhet me një sërë transformimesh në aspektin social, që janë shumë të rëndësishme për shoqërinë shqiptare kosovare, pikërisht në rajonin e Gjakovës në periudhën 1999-2012. Në ditët e sotme, kur gjithçka shkon drejt

globalizmit, njohuria është bërë thuajse element kyç në kontekstin e zhvillimeve sociale, politike dhe ekonomike. Kështu, kjo ‘shoqëri e njohurive’, sot përballet me sfida në riorganizimin e rendit të ri shoqëror, i cili edhe është objekt i këtij studimi.

I vetëdijshëm për vështirësitë e mëdha dhe pengesat, por edhe i dëshirueshëm të ballafaqohem me sfida të këtij lloj hulumtimi shkencor-profesional, iu qasa një tematike të tillë. Edhe pse i vendosur për trajtimin e këtij punimi shkencor të ndërlikuar dhe specifik e kompleks, jam i vetëdijshëm se studimi i dukurisë në fjalë, sado i themeltë të jetë dhe pavarësisht kohës së punës studimore, nuk do të mund të përfshijë të gjitha dhe se nuk do të jetë i përkryer.

Kalimi në sistemin demokratik solli shumë ndryshime, si në sferën politike, ekonomike, sociale dhe atë teknologjike. Kjo ‘reformë’ shoqërore bëri një evolim shoqëror, sidomos në aspektin social, duke sjellë rrethana thuajse krejtësisht ndryshe. Sidomos kur dihet mirë se tradita në popullin shqiptar i kishte rrënjet e thella në truallin e vet dhe datonte nga kohërat e lashta, duke u trashëguar brez pas brezi dhe se ndryshimi i saj ishte shumë i vogël, ajo si shkas i së kaluarës së saj historike, që iu kishte imponuar të mbyllej në vetvete për kohë të gjata. Kjo mënyrë jetese përputhet me mendimin se: “Se çdo mënyrë jetese është produkt i çdo lloj veprimi apo rrethane që ka ndikuar dhe e ka prekur atë në të kaluarën. Meqenëse çdo popull ka historinë e tij të veçantë, edhe mënyra e tij e jetesës është e papërsëritshme” (Dhima, 2010: 18).

Me ndryshimin e kushteve ekonomike dhe shoqërore, sidomos me zhvillimet e teknologjive të fundit në të gjitha sferat e jetës shoqërore, imponohet që të ndryshon edhe tradita dhe kultura, qoftë në sferën pozitive e po ashtu edhe në atë negative dhe ky do jetë proces i vazhdueshëm. Një ndryshim tjetër i traditës dhe kulturës mund të vjen

edhe nga reagimi i vet shtetit apo edhe shoqërisë, me masa të ndryshme (Krasniqi, 1990). Pikërisht, këto i përjetoi dhe vazhdon t'i përjeton edhe shoqëria kosovare, në mesin e së cilës edhe rajoni i Gjakovës. Fokusi këtu ka të bëjë më atë se historikisht ky rajon ishte i njohur me ruajtjen e vlerave tradicionale e të kulturës, ndër të cilat veçohet nga mos njohja e gjuhës turke në asnjë rrëthanë si dhe mbajtja e besës deri në vdekje. Me ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre traditave vazhdon dhe dallohet pas gjysmës së dytë të shek. XX, duke u bërë vatër e traditës dhe kulturës së shoqërisë shqiptare kosovare. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe ishte rajon me një zhvillim ekonomik të madh. Në anën tjetër, pasojat e luftës së fundit ishin më të mëdhatë dhe që ende vazhdon të vuan në të gjitha fushat. Janë këto që e bëjnë disi të veçantë si shoqëri, por që përmes saj përfaqëson tërë shoqërinë kosovare.

Këto lëvizje reflektuan dukshëm edhe në këtë rajon, qoftë në organizimin shoqëror, qoftë edhe në paraqitjen e fenomeneve kriminale. Ndryshimet në fjalë sollën një perspektivë të re, tani më nuk është ajo shoqëria e mbyllur në rrëthin familjar e fisonor, ku çdo individ duhej të kryente detyrat e ngjashme me të tjera në mënyrë që t'i kontribuonte familjes, fisit dhe shoqërisë.

Bazuar në teorinë e funksionalizmit strukturor të A. Radcliffe-Brown, sipas të cilit shoqëritë njerëzore ngjajnë në organizmat e gjallë, ku organet përmes funksioneve të veta luajnë rol në mbajtjen në jetë të procesit jetësor, kërkohet që ashtu të funksionojnë edhe lidhjet mes individëve dhe grupeve si ‘trup’, me qëllim të mbajtjes së ekuilibrit të shoqërisë. Një ekuilibër të tillë që i duhet shoqërisë e trajton edhe E. Durkheim si solidaritet organik, përmes së cilit mbahen të bashkuar grupet shoqërore, gjegjësisht shoqëria. Kështu që, një ndër indikatorët që ndikon në mbajtjen e bashkuar të grupeve si një ‘trup’ i përbashkët për një stabilitet social shoqëror është edhe niveli i paraqitjes së

faktorëve që mundësojnë kriminalitetin brenda rajonit. Dukuria e kriminalitetit, si dukuri e dëmshme dhe shumë e rrezikshme për shoqërinë dhe e faktorëve tjerë ka qenë në epiqendër të shumë filozofëve dhe shkencëtarëve që nga lashtësia. Lidhur me këtë dukuri dhe shkaqet e paraqitjes së saj fillohet që nga pikëpamjet antike të filozofëve të lashtë grekë, edhe pse ka pasur mendime edhe me herët, për të vazhduar deri në ditët e sotme. Prandaj, deri tani janë paraqitur edhe shumë mendime dhe teori.

Pikërisht duke u bazuar në këto të dhëna teorike, rrethanat ekzistuese nëpër të cilat po kalojnë qytetarët e rajonit të Gjakovës kërkohet që të angazhohen në futjen në funksion të të gjithë individëve, grupeve dhe institucioneve lokale e deri te ato qendrore, duke i kryer secili detyrat dhe obligimet e veta. Kjo do të ndikonte në mbajtjen e stabilitetit social të kësaj shoqërie.

Një nga mendimtarët që shtjellon këtë dukuri ishte edhe Zhan-Zhak Russo, sipas të cilit shkaqet e kriminalitetit dhe mënyrat e pengimit të tij gjenden në kushtet dhe rrethanat shoqërore, ngase, njeriu nuk lind kriminel, por atë e shtyn që të merret me veprime dhe sjellje kriminale shoqëria dhe ambienti shoqëror, kushtet dhe rrethanat sociale e politike (Halili, 2008). Vet riorganizimi i jetës ndryshe nga e kaluara dhe zhvillimi shoqëror edhe në këtë rajon sollën shumë ndryshime. Këto rrethana vlerësohen edhe si faktorë nxitës të kriminalitetit. Bazuar në këtë realitet, sot kemi sjellje dhe veprime kriminale konkrete që janë rezultat i ambientit shoqëror, kushteve dhe rrethanave sociale e politike, si: trafikimi me qenie njerëzore, punësimi në lokale të ndaluara i femrave shqiptare, krimet kibernetike etj. Veprat në fjalë, së paku në traditën e këtij rajoni, nuk kanë ekzistuar në të kaluarën, ndërsa sot janë ndër veprat penale më të shumta dhe që sjellin shumë probleme sociale e shoqërore. Pra, bazuar në normat shoqërore dhe në evidencat e së kaluarës, qytetarët këndej pari nuk ishin përballur me të tilla gjëra.

Reformat e reja shoqërore dhe civilizimi modern krijuan rrethana që individë dhe grupe t'i keqpërdorin këto, sidomos për çështje kriminale.

Lidhur me rendësin e traditave për shoqërinë është shprehur edhe Fatos Tarifa, sipas të cilit as “situata më e favorshme gjeografike dhe ligjet më të mira të mundshme nuk mund ta mbajnë në këmbë një kushtetutë nëse mungojnë traditat, ndërsa këto të fundit mund t'i shndërrojnë edhe rrethanat më të disfavorshme dhe ligjet më të këqija në avantazhe” (Tarifa, 2014: 47).

Duke iu referuar E. Durkheim-it se faktorët e krimít dhe kriminalitetit janë në vet shoqërinë njerëzore dhe atë nga mungesa e kontrollit, kjo bënë që veprimet kriminale shumë herë të jenë ato që trasojnë rrugë të ‘mëdha në shoqëri’, madje duke sjellë shqetësime për tërë shoqërinë. Shumë herë kjo gjendje e mungesës së kontrollit shoqëror ka të bëjë me rrethanat ku ligji nuk funksionon, ku paraqitet një dezorganizim shoqëror dhe mungesë solidariteti e deri te tjetërsimi i njerëzve nga njëri tjetri (Halili, 2008: 96). Kuptohet se kjo situatë paraqet frikë, pasiguri, mbyllje në vetvete të individëve. Kjo gjendje nuk njeh traditën dhe as kulturën e atij mjedisit, pra është edhe një shkas për paraqitjen e dukurive të reja kriminale, duke anashkaluar njëfarë dore edhe ato tradicionale. Kjo bënë që shoqëria të ndodhet në një gjendje shoqërore jo të shëndosh dhe jo normale, pasi që mungojnë proceset e duhura për zhvillimin e saj (Vold, Bernard, Snippes, 1998: 124-126; Halili, 2008: 96).

Referuar në sjelljet dhe veprimet kriminale të reportuara në institucionet e policisë dhe të gjyqësisë nga viti 1999-2012 si dhe në analizën e tyre, rezulton një gjendje e përafërt në aspektin kriminal edhe në rajonin e Gjakovës me rrethinë, ashtu siç e paraqet

Durkheimi me termin ‘*anomie*’<sup>1</sup>. Kjo dëshmohet nga incidentet e raportuara, si mënyra e vrasjeve, grabitjet, rrëmbimi i personave, shtimi i vetëvrasjeve, fajdetë dhe reketimi, dhuna në familje e deri te rastet më moderne, si: përgjimet e paautorizuara, hyrja në sistemet kompjuterike, narkotikët, të cilat janë ekzistuese dhe të faktuara, tregon se vërtetë pas një periudhe të gjatë në ruajtjen e kulturës dhe zakoneve e traditave, koha e re e shtet-ndërtimit demokratik gjatë kësaj periudhe ka pësuar ndryshime edhe në sferën e kriminalitetit.

Studimi dhe trajtimi i natyrës së këtij punimi është i sistemuar në gjashtë kapituj, me hyrjen dhe përfundimet. Sistemimi i mëtejshëm i materialit është bërë nëpër nën kapituj, përmes të cilëve shtjellohen temat dhe problemet e caktuara të kësaj teme.

Kapitulli i parë trajton pjesën hyrëse, duke pasqyruar trendin e zhvillimeve shoqërore dhe ndryshimet që pësohen, me ç'rast paraqiten edhe dukuri tjera kriminale. Konkretnisht rrethanat e reja në ndërtimin e rendit të ri shoqëror përmes fazës tranzitore.

Në kapitullin e dytë, me titull “Përbajtja, qëllimi, metodologja dhe rëndësia e studimit”, paraqitet që nga interesi e formulimi i tematikës së problemit, pastaj metodat dhe metodologjinë e përdorur për realizimin e hulumtimit në terren, si dhe qëllimin dhe rëndësinë e studimit.

Në kapitullin e tretë, të titulluar “Antropologjia kulturore e kriminale”, trajtohet pjesa teorike e studimit. Këtu përfshihet që nga lindja e zhvillimi i antropologjisë kulturore e kriminale, duke specifikuar enkas antropologjinë kulturore e sociologjike dhe kriminalitetin në shoqëri. Pastaj, natyrën e paraqitjes së dukurive kriminale dhe llojet e

---

<sup>1</sup> *Anomi* – gjendje shoqërore e paligjshme, si dezorganizim, kaos, anarki, mungesë solidariteti, tjetërsim të njerëzve nga njëri tjetri

faktorëve, teoritë e mendimet mbi krimin e deri te paraqitja e dukurive të reja kriminale, interferuar transformimeve dhe zhvillimeve shoqërore.

Në kapitullin e katërt, me titull “Gjakova si pasqyrim i zhvillimeve ekonomike, demografike e kulturore të shoqërisë kosovare dhe prirja e kriminalitetit në zonë”, pasqyrohet historiku që nga themelimi i shoqërisë shqiptare, me theks të veçantë asaj kosovare e gjakovare, duke trajtuar evoluimet e kësaj shoqërie deri në ditët e sotme. Këtu vihet në pah periudha e transformimit demokratik të kësaj shoqërie apo transformimi nga tradicionalja në moderne. Kjo periudhë nuk ishte kursyer as nga kriminaliteti, përkundër masave parandaluese nga institucionet e shtetit.

Kapitulli i pestë, i titulluar “Analiza e të dhënave”, trajton mostrën e hulumtimit, duke analizuar ndërlidhjen me rrëthanat reale në këtë trevë si dhe gjetjet kryesore të studimit, që janë nxjerrë nga kjo mostër.

Në kapitullin e gjashtë janë dhënë disa përfundime dhe rekomandime themelore, që janë produkt i nxjerr nga puna studimore. Po ashtu janë dhënë edhe disa propozime të caktuara për bashkëpunim shoqëroro-institucional në sferën e krijimit të një ambienti sa më të sigurtë për qytetarët.

Punimi përmbyllët me bibliografinë e literaturës së shfrytëzuar dhe konsultuar për nevojat e hartimit të këtij studimi.

## **KAPITULLI II: ASPEKTE METODOLOGJIKE**

### **2.1 Natyra e studimit**

Bazuar në të dhënat e shumë hulumtuesve rezulton se jo të gjitha studimet hulumtuese kanë arritur të zbulojnë saktësisht problemin e parashtruar. Pjesa e madhe e studimeve përdorin metoda sasiore dhe mundohen që përmes instrumenteve statistikorë të matin variablat e ndryshëm të asaj fushe që hulumtohet. Por, në shumicën e rasteve do të jetë e pamundur të arrihet në një hulumtim të saktë derisa nuk e kemi edhe një analizë cilësore. Pikërisht, për këtë qëllim në këtë studim do të përfshihet edhe natyra cilësore. Kështu, përmes kërkimit cilësor do të analizohen komponentët e parashtruar në hulumtim.

Në një shoqëri që trendi i zhvillimit është jashtëzakonisht i madh e me shumë ndryshime dhe që ka ndikime të ndërsjella mes individëve e grupeve, qoftë për përshtatje apo si rivalitet, domosdo që duhet shtuar kujdes natyrës së studimit. Andaj, studimi në fjalë do të trajtojë pikërisht daljen nga izolimi konservator tradicional dhe kalimin në shoqëri të hapur demokratike, duke i analizuar hapësirat që krijojen dhe rrrethanat e pasigurisë që vijnë si rezultat i dukurive kriminale.

### **2.2 Interesi aktual për temën**

Në dekadën e fundit të shekullit të kaluar dhe në fillimin e këtij shekulli, historia dhe zhvillimi i shoqërisë shqiptare në Kosovë u përcoll me shumë ndryshime. Kryesisht këto zhvillime dhe ndryshime janë si rezultat luftës së fundit në Kosovë (1998-1999), gjatë së cilës pati zhvendosje masive të popullatës dhe dëme të mëdha materiale e në njerëz. Kurse në anën tjetër, pas përfundimit të luftës, kjo shoqëri filloj një histori të re përmes një organizimi shoqëror bashkëkohor, i bazuar në parimet e demokracisë dhe

lirisë së shprehjes, i filluar në kushte tranzicioni dhe i menaxhuar e qeverisur nga faktori ndërkombëtar, duke dal nga një sistem i gjatë socialist.

Lëvizjet e mëdha dhe të thella, të cilat janë rezultat i sistemit të ri demokratik pas vitit 1999, te ne, përveç anës pozitive, sollën si pasojë edhe përhapjen në masë të shumë ‘plagëve’ sociale si dhe të dukurive të reja kriminale. Pra, si në çdo shoqëri në tranzicion, edhe në Kosovë, dukuria e kriminalitetit është thellësish dramatike dhe nuk mund të lihet jashtë vëmendjes në progresin demokratik të saj. Çlirimi i shoqërisë shqiptare kosovare nga shteti serb si dhe sistemi demokratik shënojnë pikën kulmore të shoqërisë sonë, të pritur me shekuj si dhe hapjen e saj ndaj të gjitha vendeve civilizuese, sidomos atyre perëndimore. Mirëpo, kjo, në këto kushte të hapjes, solli edhe një ambient të përshtatshëm dhe sfidues të shoqërisë, sidomos me paraqitjen e problematikave sociale.

Kohët të fundit, prirjet e zhvillimit të kriminalitetit kanë ndryshuar nga e kaluara, duke marrë përmasa që e tejkalojnë natyrën e kriminalitetit gjatë periudhës së sistemit socialist, me këtë edhe të traditave kulturore, zakonore dhe trashëgimore, që janë hasur tradicionalisht në botën shqiptare, duke u vënë në lidhje me rrjete kriminale të natyrave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Një tablo e tillë pasqyrohet edhe në realitetin shoqëror të shoqërisë gjakovare në tërsëi. Dallimi midis aktiviteteve kriminale nga e kaluara me këto të sotmet është shumë i madh, me theks të veçantë në periudhën e pasluftës në Kosovë deri në ditët e sotme. Me këtë rast paraqitet nevoja për një analizë më të thellë rreth trajtimit të këtyre aktiviteteve kriminale, shumë nga të cilat nuk kanë ekzistuar asnjëherë më parë në traditën dhe kulturën shqiptare.

Duke qenë pjesë e institucionit ekzekutiv që merret me ruajtjen e rendit dhe zbatimin e ligjit, pra, Policisë së Kosovës, përpinqemi të kontribuojmë për krijimin e një ambienti sa më të qetë dhe më të sigurt për të gjithë qytetarët e vendit tonë, në veçanti të popullit të këtij rajoni. Me qëllim që kjo të realizohet, ne analizojmë vazhdimesht ‘prirjet’ e krimit dhe dukuritë negative që po bëhen brengë, duke shqetësuar shoqërinë.

Lindja, zhvillimi dhe përhapja në përmasa të mëdha e këtyre dukurive në rajonin e Gjakovës dhe më gjerë është e frikshme dhe për të arritur në përfundime të sakta, në mënyrë që rezultatet të jenë të dobishme, kërkohet vërtet një vështrim edhe në aspektin e antropologjisë kulturore dhe atë kriminologjik, me qëllim hulumtimin e lidhjeve dhe arsyeve që përdorin subjektet e aktiviteteve kriminale, duke filluar nga rrethi familjar, mjedisi shoqëror e deri te lidhjet e tyre me kontingjentet kriminale të vendeve të tjera. Në bazë të dhënave, del se shumica e këtyre personave, kontingjent i krimit janë moshat e reja, madje edhe nga gjinia femërore, që dita ditës po profesionalizohen në këtë drejtim, ndonëse ka edhe të tillë që u takojnë moshave më të shtyra. Kjo na shpie në kërkesën për hulumtimin se nga fryshtohen, cilat janë shkaqet dhe arsyet e këtyre subjekteve që merren me këso aktivitetesh. Në anën tjetër, na duhet të kërkojmë dhe të vlerësojmë gjendjen sociale të rajonit, situatën politike, periudhën e tranzicionit etj, për të analizuar nëse faktorë të tillë janë ndikues të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në këto dukuri.

Tradita burimore shqiptare, me rrënjet e saj thellë në truallin autokton, e cila daton që në kohët e lashta, si shkak i ruajtjes së sistemit konservator përgjatë historisë, ka pësuar ndryshime gati të padukshme. Por jo edhe sot.

Ndryshimet e fundit sollën një perspektivë të re. Pikërisht kjo perspektivë e re, përvçe prurjeve të reja pozitive, solli edhe gjëra që realisht nuk përkojnë aspak me praktikat dhe traditat shekulllore të kësaj ane.

Përcaktimi i këtij hulumtimi vetëm në rajonin e Gjakovës është bërë për arsyen se:

- ky rajon historikisht është i njohur për ruajtjen e zakoneve, traditave dhe kulturës, duke i përcjellë këto nëpër brezni të ndryshme;
- është i vetmi popull që as për pesë shekuj sundimi të pushtuesve turq nuk mësoi dhe nuk foli gjuhën e tyre;
- është shoqëri e njohur për kulturën e lartë dhe zhvillimin shoqëror që kishte, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, ku edhe shumë qytete të tjera në Kosovë e jashtë saj e morën si shembull shoqërinë e këtij rajoni në këtë drejtim;
- është territor i pastër shqiptar dhe gjendet në zemrën e Dukagjinit, dhe se pjesa veriore e Shqipërisë identifikohet me *Malësinë e Gjakovës*;
- përballoi të gjitha rrebeschët gjatë historisë, ndër to edhe luftën e fundit 1998-1999, duke ruajtur me fanatizëm zakonet dhe traditat shqiptare tradicionale, madje deri në vitet e para pas kësaj periudhe, me ç'rast doli nga izolimi tradicional, dalje e cila në aspektin kulturor po përcillet me mospajtime gjeneratash, ndërsa në anën tjetër edhe me paraqitjen e dukurive të reja sociale dhe kriminale;

- njojja për së afërmë e rrethanave në detaje në aspektin social, ekonomik, politik dhe kriminal në këtë rajon, duke qenë pjesë e sistemit të sigurisë së brendshme të këtij rajoni dhe duke njohur në detaje natyrën e kriminalitetit;
- mundësia e qasjes në institucionet e tjera relevante në luftimin e kriminalitetit, nga ato lokale e deri te ato shtetërore, gjë që nuk mund ta ketë secili.

Pikat e mësipërme janë vetëm disa nga arsyetimet që më mundësojnë një hulumtim konkret dhe real në këtë fushë studimi në nivel shkencor, në mënyrë që përparrë opinionit publik dhe atij të nivelit akademik, të vijmë me një hulumtim cilësor, të besueshëm dhe të detajuar, i cili të mund të përdoret edhe për qëllime të mëtutjeshme në luftimin e dukurive negative, që po i bëjnë dëm kësaj shoqërie.

Pra, këto ngjarje/ dukuri të reja në shoqerinë kosovare/ përkatësisht gjakovare pasqyrohen në riorganizimin e kësaj shoqërie, me ndryshimet më vitale dhe prurjet më të reja gjatë dhe pas shtet ndërtimit, bashkë me sfidat që e kanë përcjellë.

### **2.3 Formulimi i problemit**

Rajoni i Gjakovës ka një sipërfaqe prej 586 km<sup>2</sup> dhe 94.556 banorë<sup>2</sup>. Është urë lidhëse mes qyteteve të Dukagjinit dhe pjesës veriore të Shqipërisë. Është i njohur për traditën shqiptare dhe kulturën e lartë intelektuale. Deri në fund të viteve 1980 ishte superfuqi ekonomike në vend, kurse aktualisht po përjeton një gjendje të rëndë ekonomike e sociale. Posedon shumë objekte të trashëgimisë kulturore dhe dy pika vitale: Liqenin e Radoniqit dhe një aeroport.

---

<sup>2</sup> Enti i Statistikave të Kosovës. Prishtinë, Prill 2014

Qytetarët e rajonit të Gjakovës ndihen të shqetësuar nga gjendja e krijuar sociale e ekonomike si dhe paraqitja e disa aktivitetave kriminale, sidomos atyre që nuk kanë ekzistuar në kulturën dhe traditën shqiptare, si: dhuna në familje, vrasjet me maska, grabitjet e armatosura dhe të maskuara, rrëmbimet, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm, prostitucioni, reketimi, trafikimi i qenieve njerëzore, fenomeni i vetëvrasjeve në rritje, kërkimi i lëmoshës, usurpimet e pronave të huaja, zhdukja e personave (largimi nga familja), etj. Këto, përveç që paraqesin një shqetësim të madh, paraqesin edhe rrezikshmëri të madhe, qoftë për jetën dhe pronën e qytetarit, si dhe për tërë shoqërinë në përgjithësi, duke krijuar edhe paqëndrueshmëri shoqërore. Në anën tjetër, kjo ndikon negativisht edhe te individët dhe kompanitë e huaja që mendojnë të investojnë në ndonjë formë në këtë rajon.

Në anën tjetër, tranzicioni i gjatë që përfjetoi Kosova deri në shpalljen e shtetit si dhe situata jostabile pas shpalljes, mundësoj lëvizje, qoftë kalimthi apo edhe të përhershme, të shumë personave të huaj me të kaluara kriminale, të cilët arritën të gjejnë përkrahje edhe nga individët apo grupet vendore për t'u marrë me aktivitete kriminale. Kthimi nga shtetet e Perëndimit dhe vendeve të tjera i disa individëve të njojur për vepra penale në Kosovë dhe rajonin e Gjakovës, pa përcjellë dosjen kriminale të tyre, u ka krijuar mundësi atyre që të mos mbikëqyren nga organet e rendit.

Duke u mbështetur në këto të dhëna dhe në zhvillimet shoqërore të pasluftës, është shtruar nevoja për një hulumtim të këtyre dukurive. Aq më tepër kur mungojnë përpjekjet për identifikimin e natyrës së prejardhjes së dukurive kriminale dhe natyrës së personalitetit të autorëve të veprave të tillë në aspektin sociologjik; edhe pse lufta kundër tyre po bëhet gjithnjë e më tepër atraktive dhe më e përsosur: thuajse çdo ditë përgjohen, hetohen dhe arrestohen subjekte të tillë, por që nuk po arrihen efektet e

duhura. Këtë e shton edhe ajo se ligjet e zbatueshme në Kosovë, që vlerësohet se nuk pasqyrojnë realitetin ekzistues dhe kanë mangësi, si dhe mosbatimi në kohë i sanksioneve penale paraqesin disa nga faktorët nxitës në inkurajimin e mëtejshëm në aktiviteteve kriminale.

Mbështetur në pohimet e mësipërme, shtrohet nevoja për një analizë shkencore të thelluar të dukurive të kësaj natyre, me qëllim identifikimin e problemit dhe ndërmarrjen e masave për tejkalimin e tij.

#### **2.4 Pyetja kërkimore dhe hipoteza**

Me qëllim të një analize rrëth problematikave të dala gjatë organizimit të ri shoqëror të shoqërisë gjakovare dhe identifikimin e rrethanave që kanë sjellë ndryshime rrënjosore në aspektin social e kulturor duke sjellë edhe dukuri kriminale të reja këndejpari, hulumtimi do të realizohet përmes përgjigjeve që do të dalin nga ngritja e *pyetjeve kërkimore*:

Si ndikoj periudha e tranzicionit dhe e transformimit social-kulturor në rajonin e Gjakovës?

A ka lidhje midis riorganizimit të ri social-kulturor dhe kryerjes së aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës?

Sa përputhen dukuritë e reja kriminale me traditat dhe kulturën shqiptare të këtij rajoni?

Duke iu referuar rrethanave të krijuara me rastin e riorganizimit të ri shoqëror dhe transformimit në shoqëri të hapur, dalim me *hipotezën* se:

*Riorganizimi shoqëror dhe prurjet e reja socio-kulturore kanë sjellë dukuri kriminale që tejkalojnë traditat shqiptare në rajonin e Gjakovës*

## 2.5 Metodologja

Duke iu referuar rrethanave shqetësuese për qytetarët e Gjakovës dhe të rrethinës se saj në aspektin e sigurisë së brendshme, sidomos me rastin e prurjeve të reja kulturore dhe paraqitjes së disa dukurive kriminale, të cilat më parë nuk kanë ekzistuar këndejpari, për një pasqyrim vërtet real është përdorur një metodologji e kombinuar, me karakter *sasior* dhe *cilësor*.

Fillimisht është bërë një analizë e detajuar e aparatit teorik, përmes së cilës është nxjerrë një panoramë e qartë e elementeve thelbësorë që karakterizojnë lidhjet midis elementeve kulturore dhe aktiviteteve kriminale. Pra, është analizuar prejardhja dhe vazhdimësia e traditave dhe kulturës së popullsisë së kësaj ane që nga lashtësia e deri në vitin 1999 dhe peripecitë e përjetuara nga aspekti historiko-antropologjik-kulturor si dhe prurjet e reja kulturore gjatë periudhës 1999-2012.

Më tej është vazhduar me përpilimin e *hartës* së aktiviteteve kriminale, me fokus në dukuritë e reja kriminale. Kjo hartë është përpiluar duke u bazuar në rastet dhe ngjarjet kriminale të raportuara në policinë e Kosovës, përkatësisht në stacionin policor të Gjakovës. Gjatë përpilimit të kësaj harte është shfrytëzuar analiza e ‘dosjeve’, sipas të gjitha llojeve të kriminalitetit që më parë nuk kanë qenë të pranishme, por që ndërlidhen me ndryshimet e reja të shoqërisë së kësaj ane.

### *Modeli teorik dhe literatura ku bazohet*

Në një kontekst të zhvillimeve teorike lidhur me sistemet tradicionale dhe kulturat e shoqërive të ndryshme si dhe ndryshimet në kohë, vjen edhe ky studim, i cili duke u mbështetur në literaturën bashkëkohore në fushat ndërdisiplinore të antropologjisë kulturore dhe kriminologjisë ka për synim të analizojë rrethanat gjatë riorganizimit

shoqëror dhe transformimeve që ndodhin, me qëllim të mbulimit të hapësirave dhe pengimit të shfaqjes së dukurive kriminale. Pra, të shërbejë si një metodologji për hulumtimin e praktikave e procedurave të funksionimit të sigurisë në shoqëri dhe atë duke u nisur nga vet shoqëria. Në këtë koncept do të trajtohet shoqëria kosovare, me theks të veçantë ajo Gjakovare, pasi që në këtë pikëpamje, përbën një ‘risi’ duke u përqendruar në kuptimin e gërshtimit të modeleve klasike me prirjet e reja lokale, ku interferojnë tipare të traditës me tipare të huazuara nga realiteti/praktika kriminologjike e vendeve të përparuara evropiane. Kjo gjendje e fakteve na ka motivuar të marrim për bazë nga njëra anë studimet që bëjnë fjalë për traditën e ligjit, për të Drejtën Kanunore dhe ndryshimet bashkëkohore në kulturën shqiptare (në kuptimin më të gjerë të fjalës) dhe, nga ana tjetër, të dhënrat e specialistëve vendas lidhur me trajtimin shkencor të dukurive kriminologjike dhe mënyrat e parandalimit të tyre.

## 2.6 Metodat

Përzgjedhja e metodave për realizimin e këtij studimi janë bazuar dhe përshtatur sipas natyrës së hulumtimit.

### 2.6.1 Hulumtimi në terren


Realizimi i hulumtimit në terren është realizuar nga qershorit 2014 dhe ka zgjatur deri në tetor 2014. Fillmisht ka nisur me realizimin e pyetësorëve dhe intervistave me qytetarë, duke vizituar institucionet lokale, pastaj ekspertë të fushave sociale dhe qytetarë të ndryshëm. Një pjesë janë realizuar nëpër institucione, si: komunë, shkolla, zyre, muze, organizata joqeveritare, një pjesë nëpër lokale dhe një pjesë nëpër shtëpitë e qytetarëve. Realizimi me personat e dënuar është kryer nëpër ambientet e qendrave të korrektimit nëpër tërë Kosovën. Një pjesë e tjetër e të dënuarve, janë realizuar nëpër ambiente te lokaleve në qytet, të cilët janë kontaktuar përmes telefonit.

## 2.6.2 Popullata dhe mostra e zgjedhur

Për hulumtimin është përzgjedhur popullata vetëm nga Gjakova dhe rajonit të saj. Për realizimin e hulumtimit në terren dhe me synimin që ai të jetë sa më real, jam përcaktuar që në studim të përfshihen të gjitha shtresat dhe kategoritë e popullatës së kësaj ane. Duke u bazuar në natyrën e trajtimit të hulumtimit si mostër kam përdorur dy kategori qytetarësh: qytetarët e lirë dhe qytetarët e dënuar për veprat kriminale.

Përcaktimi i qytetarëve të lirë është bërë me disa kritere. Me qëllim që të kemi një hulumtim konkret dhe me sa më shumë dëshmi faktike rrëth këtij studimi, gjatë mbledhjes së të dhënave për mostër janë përzgjedhur nga ata që mund të ndjenin dhe vlerësonin ndryshimet shoqërore, sidomos nga aspekti tradicional e kulturor, si dhe efektet sociale e kriminale. Në mostër janë përfshirë nga qytetarët e rëndomtë deri te intelektualët, qytetarë nga të gjitha institucionet relevante të shoqërisë gjakovare si dhe ata nga organizata qeveritare dhe joqeveritare. Po ashtu janë përfshirë edhe qytetarë nga institucione profesionale nga fusha e sigurisë, ligjit, shërbimeve mjekësore dhe nga qendra për punë sociale, sociologë e psikologë, prijës të komuniteteve fetare si dhe qytetarë odash. Të gjitha këta janë përzgjedhur me qëllim që të kemi një mostër gjithëpërfshirëse në aspektin kriminologjik, institucional, social dhe kulturor (diagrami 1).

Diagrami 1. Struktura në totalin prej 530 pyetësorësh



Gjatë mbledhjes së të dhënave përmes pyetësorëve dhe intervistave me personat e dënuar, si mostër janë përzgjedhur vetëm ata që ishin në vuajtje të dënimit apo që kishin vuajtur dënimin, të gjithë nga treva e Gjakovës. Fillimi është janë analizuar thuajse të gjithë personat e identifikuar si shkelës të normave ligjore, me theks të veçantë ata që janë të përfshirë në dukuri të reja kriminale, sidomos në të tilla që nuk kanë qenë në kulturën dhe traditën e kësaj treve. Për këtë mostër janë nxjerrë të dënuarit nga të dy gjinitë si dhe ata që janë nën moshën madhore, pra nën tetëmbëdhjetë vjeç. Ka nga ata që vinin me të kaluar kriminale edhe nga jashtë Kosovës, pra të kthyer nga shtetet e Evropës Perëndimore apo nga vende të tjera.

Pra, mostra e përzgjedhur i takon të gjitha shtresave të kësaj shoqërie, duke marrë drejtpërdrejt vlerësimet dhe opinionet nga autorët e krimit, viktimat, dëshmitarët dhe të tjerë subjekte, lidhur me qëndrimin rreth dukurive të reja kriminale në veteve dhe duke përdorur elemente krahasues kulturorë që bien në sy në shoqërinë e sotme. E veçanta e tërë kësaj është se në hulumtim janë përfshirë të gjitha zonat e këtij rajoni, si ato rurale ashtu edhe ato që lidhen me nën-ndarjet administrative të qytetit (harta 1).

Harta 1. Ndarja administrative e komunës së Gjakovës



Të gjitha këto janë realizuar përmes pyetësorëve dhe intervistave të ndara veçmas për të dy kategoritë. Po ashtu, lidhur me përzgjedjen e mostrës dhe numrin e tyre janë marrë parasysh edhe disa karakteristika të kësaj treve, si: numri i përgjithshëm i banorëve, popullsia sipas moshave dhe nivelit arsimor, të dhëna që janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Numri i banorëve

Gjinia	Numri	Përqindja
Meshkuj	47226	49.95%
Femra	47330	50.05%
Total	94556	100.00%

*Tabela 2. Popullsia sipas grup moshave*

Grupmosha	Numri i popullsisë	Përqindja
0-9 vjeç	15426	16.31%
10-19 vjeç	20327	21.51%
20-29vjeç	16079	16.97%
30-39vjeç	12940	13.69%
40-49vjeç	11288	11.95%
50-59vjeç	8426	8.91%
60-69vjeç	5548	5.88%
70-79vjeç	3417	3.61%
80+vjeç	1105	1.17%
Gjithsej	94556	100.00%

*Tabela 3. Niveli arsimor*

Niveli arsimor		Numri	Përqindja
Nuk ka arsim formal	Din shkrim-lexim	4435	5.60%
	Nuk din shkrim-lexim	3485	4.40%
Fillor	4 klasë (sistemi i vjetër)	4953	6.26%
	5 klasë (sistemi i ri)	8325	10.52%
I mesëm i ulët	8 klasë (sistemi i vjetër)	20271	25.63%
	9 klasë (sistemi i ri)	9338	11.80%
I mesëm i lartë	12 klasë (sistemi i vjetër)	15281	19.31%
	13 klasë (sistemi i ri)	6540	8.26%
Shkolla e lartë		2237	2.83%
Fakulteti (Bachelor)		3820	4.83%
Pasunivesitar (Master)		407	0.51%
Doktoraturë		38	0.05%
Gjithsej		79130	100.00%

Nga kjo vihet në dukje se hulumtimi studimor ka përfshirë dy kategori: në njëren anë janë qytetarët e të gjitha kategorive që kanë përjetuar dhe janë ballafaquar me trendët e reja dhe mjaft shqetësuese në sferën e traditës e kulturës si dhe në fushën e kriminalitetit, kurse në anën tjetër janë pikërisht kategoria e cila ka ‘përqafuar’ kulturat moderne dhe është përgjegjëse për shkeljet e normave dhe paraqitjen e këtij trendi kriminal. Për këtë qëllim janë planifikuar të plotësohen 550 pyetësorë me qytetarët dhe 80 pyetësorë me personat e dënuar. Ky numër është planifikuar bazuar në numrin e popullsisë së kësaj treve, ku i bie se për çdo i 108-i qytetar e ka plotësuar pyetësorin dhe çdo i 244-i person i dënuar ka plotësuar pyetësorin, bazuar në numrin total të rasteve të raportuara në policinë e Gjakovës. Në këto shifra përfshihen edhe intervistat (15 intervista me qytetarët dhe 20 me të dënuarit). Kështu që, realizueshmëria e pyetësorit me qytetarë është 530 nga 550, pra 96.36%, dhe atij me të dënuarit është 75 nga 80, apo 93.75%.

*Tabela 4. Realizueshmëria (mostra) në raport me populacionin*

Të intervistuar/pyetur	Bazuar në:	Sasia	Mostra	Të realizuar:	Në përqindje (të realizuar)
Qytetarët	Numrin total të popullsisë (20+) <sup>3</sup>	58803	565	545	0.93%
Të dënuarit	Numrin total të rasteve penale	23154	100	95	0.41%

<sup>3</sup> Nga popullsia prej 94556 banorësh, mostra është bazuar në banorët që i takojnë grup moshës mbi 20 vjet

### **2.6.3 Instrumentet e kërkimit parësor**

Metodat tipike për mbledhjen e materialit, në rastin tonë, janë: vëzhgime të drejtpërdrejta, intervista, dokumente dhe materiale audio-pamore (Creswell, 2008). Opinion i disa autorëve se *qasja cilësore* dhe ajo *sasiore* janë të kundërtë me njëratjetrën, në rastin tonë duket se nuk qëndron. Edhe autorë të tjerë, ndër ta, Maxwell, vlerësojnë se këto *qasje* nuk duhen konsideruar si ‘pole’ të kundërtë apo të ndryshme (Maxwell, 2005). Duke iu referuar kësaj situate dhe me qëllim të rritjes së besueshmërisë së të dhënavë, paraqitet nevoja e përdorimit të disa metodave për mbledhjen e të dhënavë. Andaj, si instrumente shtesë të përdorura për kërkim parësor janë: pyetësori i strukturuar, intervistat gjysmë të strukturuara dhe analiza e dosjeve të dokumentacionit. Kështu që specifikat e këtyre instrumenteve kërkimore si dhe strategjitet e ndjekura për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre do të shtjellohen në çështjet përkatëse të këtij kapitulli.

Autori Bickman vlerëson se *para-strukturimi* është një nga çështjet më të rëndësishme në projektimin e një studimi cilësor (Leonard, 2008). Kjo mënyrë e qasjes mundëson krahasimin e të dhënavë të marra nga subjekte të ndryshme dhe njëkohësisht arsyet për shpjegimin e dallimeve. Në anën tjeter, *qasja e pastrukturuar* krijon mundësinë e marrjes së një baze të gjerë informacioni dhe eventualisht të ndryshme për subjekte të ndryshme. Pikërisht Sayer i klasifikon këto qasje si *sintetike* dhe *analitike* (Andrew, 1992). Sipas Miles dhe Huberman, *kërkimi i pa strukturuar* apo *analistik* kërkon shumë kohë dhe është më i përshtatshëm për dukuri komplekse të pastudiuarë më parë dhe, nga ana tjeter, *para-strukturimi* shërben për analizë paraprake, pakëson sasinë e informacionit të mbledhur si dhe thjeshton përpunimin e të dhënavë (Matthew & Huberman, 1994).

Duke iu referuar këtyre principeve, rezulton se edhe *para-strukturimi* i këtij kërkimi parësor është realizuar përmes zhvillimit të një pyetësori paraprak me subjektet e përfshirë në studim. “Vëzhgimi përmes një pyetësori ofron një përshkrim sasior apo numerik të prirjeve, qëndrimeve apo opinioneve të popullatës duke studiuar një mostër, nga analiza e rezultateve të së cilës mund të gjyket mbi popullatën” (Creswell, 2008: 145). Po ashtu, Yin në kuadër të kërkimeve cilësore, e konsideron *pyetësorin* si variantin më të strukturuar të *intervistës*, i cili mund të përdoret apo sugjerohet si instrument plotësues për mbledhjen e informacionit dhe përpunimin bashkë me informacionet e mbledhura përmes *intervistave të drejtpërdrejta* (Yin, 2009).

*Pyetësori* i përdorur në këtë studim i takon dy modeleve: njëri i përket kategorisë së qytetarëve të të gjitha shtresave dhe tjetri është krijuar veçmas për qytetarët e dënuar për shkeljet e ligjit. Pyetësori<sup>4</sup> për qytetarë përbëhet prej katër seksioneve të pyetjeve. Në seksionin e parë përmblidhen të dhënat personale të përgjithshme për subjektin, në të dytin të dhënat lidhur me pozicionin e subjektit në raport me veprat penale, i treti dhe i katërti të dhënat mbi vlerësimin e traditës, kulturës dhe të kriminalitetit. Ndërsa pyetësori për subjektet e dënuar për vepra penale përbëhet po ashtu prej katër seksioneve me pyetje e disa nënpyetjeve: në seksionin e parë përmblidhen të dhënat personale të përgjithshme për subjektin, në të dytin të dhënat lidhur me të kaluarën e tij kriminale dhe të kaluarën kriminale të familjes e shoqërisë, i treti dhe i katërti të dhënat mbi motivin e kryerjes së veprave penale dhe vlerësimin e traditës dhe kulturës.

Pyetjet në të dy pyetësorët iu takojnë disa kategorive:

- (i) pyetje të mbyllura

---

<sup>4</sup> Pyetësorët e plotë gjenden në shtojcën 1 dhe 2 në fund të punimit

- (ii) pyetje të mbyllura pa rend zgjidhjeje, ku të intervistuarve u kërkohet të zgjedhin një prej alternativave
- (iii) pyetje pjesërisht të mbyllura, ku së paku një ndër alternativat është “tjetër”
- (iv) pyetje të hapura ku kërkohet koment shtesë

Instrument tjetër i përdorur për mbledhjen e informacionit është *intervista gjysmë e strukturuar*, që përbëhet nga pyetje të hapura, me ç'rast i intervistuari pyetet për fakte lidhur me çështjen që përbën objekt studimi si dhe me opinionet përkatëse. Për një hulumtim më real janë përdorur dy lloje të intervistave, njëra për qytetarët dhe tjetra për subjektet e dënuar. *Intervistat<sup>5</sup> gjysmë të strukturuara* përbajnë pyetje të mbyllura dhe të hapura.

Si instrument i tretë i përdorur për mbledhjen e të dhënave është *dokumentacioni*, i cili sugjerohet për kërkime cilësore. Konkretisht, *dokumentacioni* është siguruar nga organizata policore lidhur me rastet kriminale të raportuara.

#### **2.6.4 Hulumtimi i faktorëve kriminologjik, institucional e kulturor përmes pyetësorëve dhe intervistave**

##### *Pyetësorët dhe intervistat në aspektin kriminologjik*

Me qëllim të një hulumtimi sa më të saktë dhe të bazuar në rrethanat reale të përditshmërisë rrëth dukurive kriminale, me theks të veçantë të dukurive që më parë nuk kanë qenë prezente në shoqërinë e kësaj treve, është bërë përzgjedhja e mostrës për studim dhe përbledhja e teorike e trajtesës. Duke iu referuar aspektit kriminologjik, janë marrë parasysh dy këndvështrime: këndvështrimi i qytetarëve dhe këndvështrimi i

---

<sup>5</sup> Format e intervistave gjenden në shtojcën 3 dhe 4 në fund të punimit

subjekteve të veprave penale lidhur me dukuritë kriminale. Pra, si mendohen dhe vlerësohen aktivitetet kriminale nga ana e qytetarëve, duke përfshirë edhe viktimat e rasteve të tilla dhe dëshmitarët që kanë pasur rastin të ballafaqohen drejtpërdrejt me aktivitete të tilla si dhe cilat janë motivet dhe rrëthanat që diktojnë dhe nxisin këto dukuri; po ashtu, edhe nga vet subjektet e implikuar në dukuri kriminale janë mendime dhe vlerësimë lidhur me motivet dhe rrëthanat që i shpijnë ata në ato aktiviteteve.

Në anën tjeter, formulimi i pyetësorëve dhe intervistave është dizajnuar në mënyrë të thjeshtë dhe me kërkesat konkrete për këtë trajtesë. Përmes tyre kërkohet qartë të nxjerrët në pah çështja se cilët janë faktorët dhe rrëthanat që krijojnë kushte dhe mundësojnë paraqitjen e aktiviteteve kriminale.

#### *Pyetësorët dhe intervistat në aspektin institucional*

Për një trajtesë edhe më të kompletuar, e cila përveç akterëve të përfshirë në ndonjë mënyrë në aktivitete kriminale, apo thjesht edhe vetëm që të shprehim mendimin e tyre, pyetësorët dhe intervistat janë trajtuar dhe kanë marrë vlerësimet edhe nga ana e disa institucioneve në nivel komunal, përmes drejtuesve të këtyre institucioneve. Kështu që në këta pyetësor dhe intervista janë përfshirë edhe zyrtarë nga Kuvendi Komunal, drejtues të drejtorive të ndryshme komunale, drejtues të reparteve për trajtimin dhe rehabilitimin e personave të përfshirë në dukuritë e reja kriminale, qoftë nga spitali rajonal, qoftë nga organizata të ndryshme joqeveritare, pastaj qendra për punë sociale, pedagogë, psikologë e sociologë dhe ekspertë të kësaj fushe. Po ashtu, këtu nuk janë kursyer as edhe ekspertët e fushës së sigurisë, si zyrtarë dhe eprorë policor, prokurorë dhe përfaqësues të këshillave komunale të sigurisë në bashkësi. Këta kanë dhënë vlerësimet e tyre bazuar në lëmin e punës profesionale në raport me dukuritë kriminale në këtë anë.

### *Pyetësorët dhe intervista në aspektin social-kulturor*

Lidhur me natyrën e hulumtimit janë përfshirë edhe zyrtar, intelektual dhe persona që kanë për profesion lëmin e kulturës dhe atë sociale. Përmes pyetësorit dhe zhvillimit të intervistave, dukuritë kriminale, veçmas këto të rejat, janë trajtuar edhe nga aspekti i tyre profesional. I tërë ky proces është mbështetur në atë se si shihet nga këndvështrimi i tyre, duke marrë parasysh zhvillimet e kësaj shoqërie në raport me trendët e fundit të globalizimit në të gjithë stadet e jetës. Kjo është trajtuar edhe duke bërë krahasimet e zakoneve dhe traditave kulturore me të cilat njihet kjo trevë duke qenë shembull i mirë për të gjithë shoqërinë shqiptare, jo vetëm në Kosovë.

Mendime dhe vlerësime janë marrë edhe nga prijës të religjioneve ekzistuese në këtë anë, të cilët gjatë historisë kanë pasur rol kyç në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Përmes mostrës së përgjedhur jemi munduar të sjellim mendimet e tyre edhe nga aspekti social-kulturor, pasi që këndvështrimi i tyre në këtë drejtim mund të kontribuojë jashtëzakonisht shumë. Edhe përbajtja e pyetësorëve, sidomos e intervistave, është përpjekur që këto zhvillime dhe ndryshime në aspektin e traditave dhe kulturës dhe transferimit në ato moderne, t'i ‘godet’ në suaza profesionale, derisa njojuritë e tyre profesionale dhe vlerësimet e nxjerra nga ata, mund të sjellin një analizë më të veçantë dhe së bashku edhe me analizat tjera të dalë një analizë më e përgjithësuar dhe më e kompletuar.

#### **2.6.5 Procedura e mbledhjes së të dhënave dhe sfidat**

Gjatë hulumtimit, më është dashur të ndeshem me disa procedura, pavarësisht se ato, në disa raste, ishin mjaft sfiduese. Ndër procedurat që duhen respektuar ishte marja e aprovimit për sigurimin dhe qasjen në statistikat dhe të dhënat kriminale të reportuara

në Policinë e Kosovës, gjegjësisht në stacionin policor të Gjakovës. Po ashtu sfidues gjatë trajtimit të këtyre të dhënave ishte analizimi i tyre, për të nxjerrë në pah dukuritë e reja kriminale që më parë nuk kishin qenë evidente. Kjo ndodhë sepse në regjistrat e policisë ishin të regjistruara të gjitha rastet e raportuara që ndiqen sipas detyrës zyrtare. Një vështirësi tjetër gjatë këtij trajtimi ishte se regjistrimi i rasteve kriminale në fillimin e punës së policisë së UNMIK-ut nuk ishte i ruajtur dhe i përcjellë në bazën e të dhënave; fjala është për dy vitet e para të punës së tyre, pra të dhënrat për vitin 1999 dhe 2000, kështu që nga statistikat, që ishin pjesë e hulumtimit, nuk ishte e mundur të sigurohen të dhënrat e sakta.

Gjatë analizimit të të dhënave, sfidues ishte identifikimi i vendngjarjeve ku kishin ndodhur aktivitetet kriminale, me qëllim të krijimit të hartës kriminale si dhe analiza për sigurimin e aktiviteteve të reja kriminale. Këtë e rëndonte edhe më tej çështja e ndryshimit të ligjeve që ishin përdorur nga viti 1999 deri në vitin 2012, ku - përvèç ndryshimeve në klasifikimin e veprave - kishte edhe shtim të veprave të reja që më parë nuk kishin qenë të kodifikuara. Këtu hyn edhe trajtimi i një vepre penale, sepse mënyra e kryerjes së saj përfshinte forma të ndryshme, si p.sh.: vepra penale “shkaktim i rrezikut të përgjithshëm” përfshinte nga të shtënët me armë në vendet publike, sidomos gjatë ahengjeve, që ishte kinse si praktikë e traditës, e deri te sulmi me mjete eksplozive në objektet e banimit apo automjete, ku, përvèç cakut të tyre, numri i viktimave të tjera të pafajshme ishte i madh.

Trajtimi me vërtetësi i veprave të ndryshme kriminale është realizuar falë shumë analizave, njohurive profesionale dhe hulumtimeve në terren. Andaj, statistikat e nxjerra do të jenë vetëm mbështetëse dhe plotësuese për analizën e dukurive kriminale ekzistuese në këtë rajon, sepse bazuar vetëm në të lartcekurat, nuk mund të sigurohen

statistika të sakta për natyrën kriminale që kërcohet në hulumtim, kuptohet përvëç rasteve kriminale të përgjithshme.

Në anën tjetër, ballafaqimi me procedurat gjatë kontaktimit me personat e dënuar kishte sfidat e veta. Pas aprovimit nga drejtuesit e Shërbimit Korrektues të Kosovës, sfidë paraqiste sigurimi i subjekteve të dënuar vetëm nga Gjakova me rrëthinë. Këtë vështirësi e rëndon më tepër fakti që si mostër ishin posaçërisht të dënuarit për dukuritë e reja kriminale. Kulmi i kësaj arrinte me faktin se personat e dënuar më njihnin dhe se mund të refuzonin një bashkëpunim të tillë, sidomos për intervistik. Tjetër sfidë ishte edhe intervistik i të miturve si dhe të dënuarve nga gjinia femërore.

Dohen theksuar këtu edhe procedurat që është dashur të respektohen për të arritur deri te personat e dënuar, ku vërtet duhej kaluar nëpër shumë hallka, nga kontrolli fizik i imi dhe i dokumentacionit e deri te ndalimi i mjeteve për incizim zanor. Shkrimi me dorë gjatë intervistave ishte i loddhëm për mua dhe për të intervistuarin, ku shumë herë duhej kthyer prapa dhe duheshin përsëritur rrëfimet, për t'u siguruar mbi vërtetësinë e asaj që deklaronte i intervistuari. Aq më tepër që, në disa raste, kisha të bëja me disa persona të një niveli më të ulët të zhvillimit intelektual; madje, shumë herë është dashur të kaloj në komunikimin më ‘popullor’ të mundshëm që të kuptoheshim, çka s’kishte të bënte me termat që i takojnë një hulumtimi të karakterit shkencor. Pra, në disa raste është dashur të përdoret ‘zhargon’ shumë i ulët, për të mundur të nxjerrën të informacionet e kërkuar. Janë evidente që në disa raste as përdorimi i këtij fjalori nuk ka ndihmuar dhe se kanë dështuar pyetësori e intervista. Ka ndodhur që edhe pas një ore komunikimi për t’ia sqaruar arsyen e këtij hulumtimi, ka dështuar tërësisht. Po ashtu, janë momente kur ‘nuk’ i kujtohej asgjë nga shkelja e normave tradicionale e ligjore. Kështu që më është paraqitur edhe një sfidë tjetër, ku për shkak të mungesës së

komunikimit për arsyet e lartpërmendura, jam detyruar të zëvendësoj atë subjekt me një tjetër më të përshtatshëm, çka duhej llogaritur në shpenzimin e kohës dhe energjisë për të arritur të njëjtin rezultat me dy elemente, ku shumë më mirë do të arriheshin dy rezultate. Si përparësi kryesore gjatë gjithë kohës ka qenë realizimi i *intervistës gjysmë të strukturuar*, çka më mundësonte të evidentoj gjithçka që kishte të bënte me hulumtimin.

Kështu që mbledhja e të dhënave është bërë drejtpërdrejt nga mostra e përzgjedhur pikërisht për natyrën e këtij hulumtimi, nga persona që janë në rrjedhat e prirjeve të zhvillimit të shoqërisë gjakovare. Në anën tjetër, opinioni i marrë nga autorët e krimit dhe, në shumicën e rasteve, nga vendi ku ata ishin duke vuajtur dënimin si dhe nga disa të dënuar edhe jashtë Kosovës, nëpër vende të ndryshme të Evropës, të cilët përvojën kriminale të fituar në ato vende e kishin transferuar këtu.

Të gjitha këto janë realizuar përmes pyetësorëve, intervistave dhe dokumenteve. Procedura e ndjekur ka qenë si më poshtë:

- a) *Realizimi i pyetësorit.* Së pari, personat përgjegjës si subjekt studimi janë përzgjedhur bazuar në qëllimin e studimit. Pyetësori është formuluar enkas për kategorinë e qytetarëve dhe veçmas për personat e dënuar. Plotësimi i tyre është realizuar drejtpërdrejt, ndërsa nëpër institucionë përmes shefave të tyre.
- b) *Intervistimi.* Fillimisht është përcaktuar mostra, duke marrë parasysh mbulimin e të gjithë zonës si dhe përfshirjen e të gjitha kategorive. Edhe kjo është ndarë enkas për qytetarë dhe për subjektet e dënuara. Pjesa më e madhe e intervistave është realizuar nëpër vendet e tyre të punës dhe në ‘*odat*<sup>6</sup>’ familjare, ndërsa një

---

<sup>6</sup> *Dhomat:* këtu ka të bëjë me dhomat ku zakonisht qëndrojnë gjinia mashkulllore e ndarë nga ajo femërore

numër i vogël në kthinat e lokaleve publike. Secili person i interviewuar është kontaktuar më parë përmes telefonit apo ndonjë forme tjeter kontakti; caktimi i vendit dhe kohës ka qenë sipas propozimit të tyre. Me personat e dënuar, interviewat janë marrë në shumicën e rasteve nëpër vendet ku ata vuanin dënimin dhe një pjesë e vogël nëpër mjedise të rezervuara.

Të gjitha interviewat me qytetarë janë marrë me diktafon, ndërsa ato nëpër shërbimet korrektuese vetëm me shkrim. Për të gjitha interviewat janë mbajtur shënime, të cilat janë pjesë bazike e të dhënave të studimit.

E gjithë kjo kohë në terren është përcjellë edhe me sfida e peripeci të ndryshme. Vet natyra e përzgjedhur në grumbullimin e të dhënave nga subjektet e dënuar nëpër vende ku ata vuanin dënimet, domosdo që përbënte peripeci. Fillonte me ata që veç kishin mbaruar vuajtjen e dënimit dhe se duheshin kontaktuar me telefon shumë herë për të ndarë kohën dhe vendin ku mund të takoheshim. Shumë herë atyre u ‘dilte një punë’ dhe nuk i përbaheshin kohës.

Në anën tjetër, ata që ishin në vuajtje të dënimit, ishin të shpërndarë nëpër vende të ndryshme, bazuar edhe nga mosha e gjinia si dhe nga politikat strategjike të Shërbimit Korrektues të Kosovës. Kështu që është dashur të vizitoj disa qendra të tillë, si: në qendrën e paraburgimit në Pejë, burgun e Dubravës, burgun në Lipjan (për femra dhe të mitur). Për të pasur çasje me të dënuarit, për arsyet e natyrës dhe rrethanave që ka ky institucion i ndjeshëm, është dashur të bëhet kërkesa me shkrim për të marrë autorizimin. Këtë autorizim është dashur të prezantoj në secilin vend ‘vizitor’, në mënyrë që të komunikoj me drejtuesit e institucioneve përkatëse. Edhe ata kishin procedurat e veta që duhej të respektoja. Ka pasur raste kur të dënuarit kishin kohën e

lirë të ‘shëtitjes’ apo të angazhimeve të tjera dhe që duhej të ndërprerja punën me ta, për të vazhduar ditën tjetër. Gjatë tërë kohës duhej të kisha edhe shoqërues nga secila qendër. Drejtuesit e qendrës siguronin zakonisht punëtorët social të qendrës. Më e veçantë ishte në burgun ku mbaheshin femrat dhe të miturit. Pjesa më e madhe e kanë mirëpritur dhe pa hezitim kanë bashkëpunuar madje disa edhe me entuziazëm.

Shumë nga mostrat pas përfundimit të bashkëpunimit në hulumtim e kanë vlerësuar shumë lartë studimin. Sipas tyre, kjo ua kthente besimin se edhe këta janë të rëndësishëm ende për shoqërinë dhe se nuk janë të humbur. Kishte nga ata që mendonin se ‘vizita’ të tilla duheshin bërë shumë më shpesh, së paku të shpreheshin më lirë. Në burgun e Dubravës kishte shumë ankesa për shkak të politikave që kishin sidomos gjatë fazës së parë të sistemimit. Njëri nga ata shprehet: “kemi nevojë për vizita të tilla, që të tregojmë se disa gjëra duhet ndryshuar këtu. Edhe pse kemi personel që përkujdeset për ne, shumë herë nuk kryejnë detyrën si duhet. Kemi raste kur ‘kolegët’ tentojnë të vetëvriten apo edhe janë vetëvrarë vetëm pse kanë rënë në depresion dhe nuk është marrë askush me të”.

Vlen të theksohet takimi me të dënuarit në burgun e Dubravës. Kërkova që të takohem në ‘shkollën’ ku ata mbajnë orë edukative ‘të zanateve’. Kur me punëtorin social hynim në klasat ku ishin ata dhe si më prezantonte si student doktorant, të gjithë i thonin “e njohim ne, ky është komandanti jonë, komandanti i policisë në Gjakovë dhe për ne edhe tani është komandant, e njohim mirë ne dhe krejt çka i duhet ne do i japim, sepse gjithmonë ka bërë një punë të madhe e të mirë për Gjakovën dhe ndaj neve ka pasur sjellje korrekte e burrërore”. Vërtet ishin momente emocionuese të dëgjoje ato fjalë nga njerëzit që përmes procedurave tona ishin në vuajtje të dënimit me vite aty. Kishte që ishin dënuar me tridhjetë vite dhe prej tetë vitesh gjendeshin aty.

Një tjetër që më ka bërë përshtypje gjatë hulumtimit në terren ishte edhe intervista në burgun e Lipjanit. Aty derisa bëja intervistat me disa nga të dënuarat në prezencën e ndonjërit nga punëtorët social, zakonisht ishin femra edhe ato, disa nga atë intervistuarat kur u parashtroja ndonjë nga pyetjet, më bënte me shenjë trupore se përgjigjen e merr vetëm me shkrim. Kështu që disa mendimin e tyre e shkruanin me shkrim. Në anën tjetër, një nga të miturit, pas prezantimit tim në cilësinë e studentit të UET dhe si ligjërues, më vështronë pa ndërprerë dhe kohë pas kohe thoshte “të kam parë unë ty diku, je si fytyrë e njobur përmua”. Duke e njobur karakterin e tij dhe natyrën e aktivitetit kriminal që unë e dija, sinqerisht është i vetmi rast që nuk i kam treguar se nga më njeh ai, por i kam thënë se mund të më ketë parë në televizion diku, gjë që ai nuk ka kuptuar se edhe në TV kisha qenë pjesë e profesionit.

Nuk janë përjashtuar edhe rastet që disa nga të dënuarit kanë shprehur dyshim përmes dhënës intervistë. Në njëren anë kishin frikë se çfarë mund t'i ndodhë dhe në disa raste ata që më njihnin përmes nga puna që bëj në polici, dyshonin se mos unë do t'i përdorja ato shënime përmes polici. Kjo më është paraqitur te intervistat me ata që kishin mbaruar dënimin. Bile disa kanë hezituar që intervistën ta jepnin përmes incizimit, por vetëm duke mbajtur shënime. Po ashtu, gjatë sigurimit të këtyre të dhënave kishte edhe ndonjë rast ku të dhënat ishin kontradiktore, derisa kuptoheshim drejt. Këto kanë qenë raste të pakta. Përfundimisht, të gjithë të intervistuarit kanë pranuar bashkëpunimin vetëm kur janë siguruar se ato janë anonime.

## **2.7 Bashkëpunimi me institucionet parandaluese e korrekta**

Përmes realizimit e hulumtimit në terren, sidomos me shfrytëzimin e të dhënave të aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës përpilimin e hartës së kriminalitetit si dhe me personat e dënuar ka qenë i domosdoshëm dhe i pashmangshëm bashkëpunimi e

institucionet gjegjëse. Kështu që është dashur të bashkëpunoj me institucionin e Policisë së Kosovës dhe Shërbimin Korrektues të Kosovës, Kuvendin Komunal të Gjakovës, arkivin dhe muzeun e qytetit, ku disa prej tyre është dashur t'iu drejtohem edhe me kërkesa me shkrim për t'më mundësuar qasjen në të dhënrat e nevojshme për hulumtim

Fillimisht për të pasur një pasqyrë reale lidhur me natyrën e aktiviteteve kriminale në Gjakovë dhe rrëthinën e saj, është dashur të nxjerrën të dhënrat nga policia e Kosovës, pikërisht nga stacioni policor i Gjakovës, që mbulon këtë pjesë dhe është përgjegjës për sigurinë. Për të pasur qasje në rastet e raportuara është dashur t'i drejtohem me kërkesë të veçantë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës<sup>7</sup>, e cila edhe është aprovuar, gjë që më ka mundësuar qasje në të dhënrat e raportuara, të cilat më është dashur t'i analizoj dhe t'i përzgjedh ato që ndërlidhen me punën hulumtuese.

Në anën tjetër, me qëllim të marrjes së opinioneve edhe nga vet autorët e aktiviteteve kriminale e që gjenden në vuajtje të dënimit, më është dashur të kontaktoj edhe me stafin e lartë të Shërbimit Korrektues të Kosovës<sup>8</sup> dhe t'iu drejtohem me kërkesën për të më mundësuar realizimin e pyetësorëve dhe të intervistave. Edhe pas aprovimit<sup>9</sup> të kërkesës sime, më është dashur që të vazhdoj me bashkëpunimin edhe me zyrtarët korrektues dhe stafin e tyre në burgun e Dubravës, qendrën e paraburgimit në Pejë si dhe me ata në burgun e Lipjanit.

Po ashtu, me kërkesë më është dashur t'i drejtohem edhe zyrtarëve komunal<sup>10</sup> në Gjakovë për të marrë shënimë lidhur më ekzistimin e lokaleve të natës dhe të lojërave të

---

<sup>7</sup> Kërkesa e plotë gjendet në shtojcën 5 në fund të punimit

<sup>8</sup> Kërkesa e plotë gjendet në shtojcën 6 në fund të punimit

<sup>9</sup> Kërkesa e plotë gjendet në shtojcën 7 në fund të punimit

<sup>10</sup> Përgjigja në fjalë është marrë përmes postës elektronike

fatit. Për të siguruar edhe më shumë të dhëna nga ana antropologjiko-historike kam bashkëpunuar edhe me arkivin dhe muzeun e qytetit të Gjakovës.

Dhe së fundmi, për të qenë edhe më komplet ky hulumtim, sidomos nga mendime dhe opinione të të gjitha fushave, shtresave dhe profesioneve, janë kontaktuar edhe njësi nga shërbime shëndetësore, institucionale shkollore, institucionale fetare si dhe organizata joqeveritare që veprojnë në këtë zonë.

## **2.8 Vlefshmëria dhe besueshmëria e instrumenteve**

Me qëllim të rritjes së besueshmërisë së hulumtimit, për realizimin e këtij studimi janë përdorur tri parimet e mbledhjes së të dhënave në kërkime cilësore (Yin, 2009). Fillimisht janë përdorur tri metodat për mbledhjen e informacioneve (pyetësorët, intervistat dhe dokumentacioni), gjë që mundëson përforcimin e vërtetësisë së të dhënave të marra si dhe nxjerr në pah gabimet e mundshme të secilës. Të dhënat e marra nëpërmjet pyetësorit janë konfirmuar përmes *intervistës gjysmë të strukturuar* pasuese si dhe *dokumentacionit* të siguruar nga organi për siguri të brendshme. Gjithashtu janë konsultuar edhe dosjet e subjekteve të dënuar, lidhur me korrektësinë e tyre.

*Së dyti*, është krijuar një bazë e të dhënave për studim. Të dhënat e pyetësorëve, të vërtetuara dhe të plotësuara me informacionet e marra nga intervistat dhe dokumentacionet, janë vendosur në tabela-bazë të dhënash. Kjo teknikë, sipas Yin, rrit besueshmërinë e informacionit. Janë ruajtur gjithashtu të gjithë pyetësorët dhe dokumentacioni plotësues si dhe shënimet e mbajtura gjatë intervistimit, qoftë ato elektronike, apo të marra me shkrim. Kjo bazë të dhënash ka lehtësuar përpunimin dhe nxjerrjen e rezultateve (Yin, 2009).

*Së treti*, gjatë punimit janë përdorur edhe *dëshmitë*, si një instrument tjeter i rritjes së besueshmërisë, përmes përdorimit të citimeve dhe shembujve të veçantë gjatë analizës. Puna me palët, si subjekte të studimit, ka qenë e njëjtë dhe ka përkuar me periudhën e marrjes së të dhënave. Të dhënat e kontrolluara dhe të verifikuara për të gjitha subjektet e përfshira në studim janë trajtuar në pajtim me njëra-tjetrën dhe me protokollin e studimit, i cili është i bashkërenduar me pyetjet e kërkimit.

Një element tjeter është statistika e siguruar nga organet e rendit, të cilat dëshmojnë dhe ndërlidhin natyrën e rasteve me zonat konkrete, e cila pasohet edhe më dëshmimin e personave të përzgjedhur për mostër të hulumtimit.

Gjithashtu, në nivel të instrumenteve të kërkimit është siguruar vlefshmëria ‘ballë për ballë’ e pyetësorit, si dhe marrja personale me intervista, ku thua jse të gjithë të përzgjedhur ishin shumë transparent gjatë bashkëbisedimit.

## 2.9 Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij studimi shkencor është që duke u mbështetur në literaturën bashkëkohore në fushën ndërdisiplinore të trajtimit të një gërshetimi të antropologjisë kulturore dhe kriminologjisë, si dhe nga praktikat e aplikuara të ndërtohet një model i bazuar shkencor për një ‘kontroll social’ të kontrolluar në çdo kohë dhe pavarësisht rrithanave që mund të paraqiten. Pra, që krahas zhvillimit dhe civilizimit shoqëror, të ndërmerrjen edhe veprime konkrete për eliminimin e faktorëve nxitës kriminal të bazuara nga fusha e shkencës.

Fokusi i studimit do të jetë në identifikimin dhe analizën shkencore të prejardhjes së këtyre dukurive, vështruar nga aspekti antropologjik mbi elementët kulturorë, ndërmarrjen e masave parandaluese dhe rritjen e ndjeshmërisë së shoqërisë në luftimin e

kësaj dukurie, në veçanti rritjen e vetëdijes mes grup-moshave të reja, të cilat edhe janë subjekt kryesor i këtyre veprimtarive kriminale bashkëkohore. Duke iu referuar gjetjeve faktike do të nxjerrën përfundimet mbi veprimet që kërkohet të ndërmerrën në këtë drejtim. Në anën tjetër, si qëllim shtytës drejt këtij studimi është edhe arsyja se përmes këtij vështrimi do të hulumtojmë lidhjet kulturore, traditat dhe zakonet e subjekteve të veprave penale, duke filluar nga familja e deri te rrëthi i tyre shoqëror si dhe ato që i lidhin edhe me tjerët jashtë vendit.

*Qëllimi parësor* i këtij hulumtimi shkencor qëndron në identifikimin e lidhjes midis elementeve kulturore dhe krimeve të kryera. *Qëllimi dytësor* është trajtimi i aspektit kriminologjik, duke filluar nga parandalimi i tij dhe roli i shoqërisë dhe institucioneve në luftimin e tij. Përmes këtij studimi do të arrihet në konstatimin e përgjigjeve për pyetjet dhe hipotezat e ngritura sa i përket temës së parashtuar. Së këndejmi do të ndalemi në të drejtën zakonore shqiptare, në natyrën e veprave penale të kësaj pjese nga aspekti kriminologjik dhe ai social, si dhe në kulturën dhe qytetërimin që kishte dhe ka sot kjo anë. E gjithë kjo do të lidhet me gjendjen në fushën kriminale në kohën e pasluftës në Gjakovë me rrëthiminë.

## 2.10 Rëndësia e studimit

Rezultatet e këtij studimi përbëjnë një kontribut shkencor në aspektin teorik dhe praktik. Lidhur me këtë, ‘modeli i reagimit shoqëror’, i ndërtuar për identifikimin dhe parandalimin e aktiviteteve kriminale nga vet shoqëria, dhe jo vetëm nga instrumentet gjegjëse, përbën një kontribut jo vetëm në drejtim të metodologjisë së vlerësimit të këtij funksioni, por edhe të funksioneve tjera në sistemin e bashkërendimit dhe koordinimit për një shoqëri stabile në fushën e sigurisë. Kështu, do të ndërtohet një model, përmes së cilit çështja e krimit dhe kriminalitetit do të fillojë me identifikimin e faktorëve nxitës

të këtyre aktiviteteve, pra, që vet shoqëria të ndërmarrë masat e para në eliminimin e tyre dhe jo të pritet vetëm nga institucionet përgjegjëse. Thua jse pjesa më e madhe deri tani e modeleve të kërkimit shkencor në fushën e sigurisë, sidomos të sigurisë së brendshme, kanë pasur në qendër institucionet shtetërore, sidomos ato të rendit.

Mendoj se studimi paraqet rëndësi të posaçme, jo vetëm për rajonin e Gjakovës, por edhe për tërë Kosovën dhe vende të tjera me rrethana të përafërtë, ngase përmes këtij del një shpjegim i argumentuar lidhur me faktet: pse ka pasur një hop kaq të madh sasior kriminaliteti, cilat janë aktivitetet kriminale që nuk ndërlidhen me traditën dhe kulturën tradicionale, ku janë burimet e këtyre aktiviteteve etj. E gjithë kjo vjen për shkak se pjesa më e madhe e shoqërisë kosovare vazhdon të përballet me aktivitete të përafërtë kriminale. Po ashtu, edhe ato vende ku do të përballen me ndryshimin e organizimit shoqëror nga një sistem i mbyllur në atë demokratik, mund të përfitojnë nga studimi në fjalë.

Të gjitha këto aspekte paraqesin një sfidë personale, sa interesante aq edhe të vështirë për t'u hulumtuar. Këtë sfidë e vështirëson edhe më tepër fakti se studimi do të analizohet vetëm brenda një rajoni me veçoritë dhe specifika e veta. Por, jam i ndërgjegjshëm se ky është i pari studim i këtij lloji në Kosovë dhe, si i tillë, ai mund të nxisë mendimin akademik që edhe në rajone të tjera të vendit të hulumtohen dukuri të tillë, sepse vetëm përmes kësaj mënyre do të përftohet një pasqyrë reale se çfarë duhet të ndërmerr për reduktimin e dukurive të tillë negative për shoqërinë. Pra, përmes këtij punimi, do të përpinqem që sado pak të plotësoj mungesën e hulumtimeve të kësaj natyre në Kosovë. Në këtë këndvështrim, mendoj se punimin tim të doktoratës mund ta shfrytëzojnë të gjithë të interesuarit. Ai do të shërbejë si një pikënisje e mirë për

hulumtime e studime të këtij rrafshi për hulumtuesit e rinj dhe ata që kanë tashmë një përvojë në këtë drejtim.

Rezultatet e studimit përbëjnë gjithashtu një kontribut në pasurimin e literaturës empirike në këtë fushë shumë me rëndësi për shoqërinë. Kërkimi shkencor që trajton ky gërshetim, me fokus në një zonë konkrete të njojur për nga tradita e kultura dhe e bazuar në faktet e vërtetuara, qoftë nga shoqëria, qoftë nga institucionet, si dhe me mostrën e përzgjedhur, që janë të përfshirë konkretisht në këto dukuri, është dëshmi se në këtë aspekt deri tani janë bërë pak studime.

Përfundimet e këtij studimi do të janë me rëndësi, sidomos në aspektin praktik, për shoqërinë gjakovare dhe për vet institucionet që merrem me ruajtjen e rendit dhe sigurinë. Këtyre nuk do iu afrohet vetëm një metodologji e vlerësimit në rrafshin e paraqitjes së aktiviteteve kriminale, por edhe mjete e forma tjera për të identifikuar dhe përcaktuar anët e dobëta dhe faktorët nxitës për këto aktivitete të rrezikshme shoqërore.

Rezultatet e studimit do të nxisin posaçërisht mekanizmat e ruajtjes së rendit për të përshtatur dhe nxjerrë politika strategjike të reja, duke kërkuar bashkëpunim, jo vetëm me organet e legjislativit, por me vet qytetarët dhe organizatat e ndryshme.

## **2.11 Mundësitë dhe kufizimet**

Njohja reale e rrethanave në praktikë me ndodhitë konkrete dhe me natyrën e problematikave të këtij rajoni, duke u bazuar në rastet e raportuara në institucionet e rendit dhe të drejtësisë, është një përparësi dhe mundësi për realizimin e faktuar të këtij studimi.

Përmes këtij punimi do të arrihet të identifikohen arsyet pse ndodhin aktivitetet kriminale, çfarë gërshetimi etno-kulturor kanë personat që i kryejnë ato, çfarë ‘prurjesh’

kanë ata në kuadër komunitar dhe si vlerësohen nga rrethi familjar e ‘fisnor’ përkatës. Kjo do të ndikojë në ngritjen e vetëdijes në shoqëri për parandalimin dhe luftimin e këtyre dukurive. Shpresoj që ky lloj hulumtimi do të nxisë edhe studiues të tjerë të vazhdojnë në trajtimin e këtyre dukurive, ngase tema në fjalë është temë e rrallë në vendin tonë dhe nevojitet të hulumtohet edhe më tej.

Pavarësisht nga vlerat dhe rëndësia që theksuanë më lartë, ky studim shoqërohet edhe me kufizime.

*Së pari*, edhe pse koncepti i studimit është mbështetur mbi bazën e shikimit dhe rishikimit të zgjedhur të literaturës bashkëkohore, prapëserapë studimi është i ndërtuar nga ngjarjet praktike dhe situata reale në këtë rajon. Kështu që, literatura sado e përgjedhur, nuk mund të mbulojë kërkesat e nevojshme, aq më tepër kur kërkohet literaturë nga terreni konkret. Këtë e vështirëson edhe më tej fakti se trajtimi i përket viteve ku studiuesit pak janë marrë më trajtesa të tillë në aspektet shkencore. Gjithashtu, mungesa e studimeve të ngjashme në Kosovë e bën këtë studim me vlera të veçanta, por edhe e kufizon në drejtim të mungesës së bazës së krahasimit.

*Së dyti*, për studim është marrë një pjesë e informacionit nga deklarimet e vet personave që janë marrë me kryerjen e aktiviteteve kriminale dhe një pjesë tjeter nga persona të moshave, gjinive dhe përgatitjeve të ndryshme intelektuale, pastaj nga persona që kanë qenë viktimi e aktiviteteve kriminale si dhe nga profesionist që i trajtojnë disa nga fenomenet kriminale.

Për arsyet e mësipërmë, kam mendimin se ky është një hulumtim shumë kompleks, meqenëse do të merren në konsideratë kategori të ndryshme dhe aktivitete të shumta, të klasifikuara si ‘të rrezikshme’. Nuk përjashtohen edhe hezitimet në dhënien e

intervistave, sigurimi i të dhënave personale të kryesve dhe qasjet në dosjet e individëve që do të hulumtohen, për arsyet e ruajtjes së fshehtësisë zyrtare të kësaj natyre. Për tejkalimin e kësaj, intervistat janë planifikuar të jenë anonime dhe se përmes dosjeve zyrtare janë siguruar të dhënat personale.

*Së treti*, është e pamundur të sigurohen dosjet e personave të kthyer nga shtetet tjera në Kosovë, të cilët edhe atje janë marrë me kriminalitet, pasi që një praktikë e tillë me rastin e kthimit të tyre nuk është bërë.

Kufizimet e tillë janë marrë në konsideratë kur është përcaktuar strategjia e studimit, gjatë analizave të rezultateve dhe dhënieve së konkluzioneve përfundimtare.

## 2.12 Hamendesime

Në këtë studim është supozuar se:

- a. personat e intervistuar janë përgjigjur me sinqeritet lidhur me rrëthanat reale dhe aktuale që janë prezente në shoqërinë e këtij rajoni, me qëllim që në të ardhmen sado pak të reduktohen këto fenomene kriminale
- b. konceptet për të cilat është kërkuar informacion janë të qarta për personat e intervistuar. Sidoqoftë, janë dhënë sqarime për ato koncepte për të cilat besohet se nuk janë përdoruar aq sa duhet
- c. pyetësorët kanë qenë të dizajnuar sipas përzgjedhjes së mostrës, pra sipas kategorisë që ka qenë cak i hulumtimit, dhe më se të qartë rrëth atyre që kërkoreshin. Kjo ka bërë që ata të mos humbasin durimin dhe sinqeritetin
- d. në intervista janë përfshirë edhe ekspertë profesionesh që janë duke u marrë më trajtimin dhe rehabilitimin e personave që janë të përfshirë në aktivitete

kriminale dhe që kanë shfrytëzuar përvojën e krijuar gjatë trajtimeve të mëparshme për të na dhënë informata reale

## **KAPITULLI III: ANTRPOLOGJIA KULTURORE E KRIMINALE**

### **3.1 Lindja dhe zhvillimi i antropologjisë kulturore e kriminale si fushë studimi**

Me lindjen e qenies njerëzore janë krijuar edhe shoqëritë. Këto procese janë përcjellë që nga lashtësia. Fillet e para të jetesës njeriut i ka kaluar në grupe. Vet qenia e tij biologjike dhe organika sociale krijojnë nevojën për bashkëveprim me të tjerët. Këtë fenomen e jep edhe G. Zimel, që thotë se “njeriu bashkohet me të tjerët sepse vëtmia e tij transformohet në bashkëjetësë dhe unifikim me të tjerët” (Zimel, 1969: 155). Kështu që grupimi i tij ishte i bazuar në nevojat e kohës, në bazë të të cilave vini edhe qëllimet, si: grupimi për mbrojtje dhe siguri, për shumim e deri te grupimet për punë, argëtim, kulturë etj. Fillimisht grupimet e para ishin shumë të thjeshta, sepse mënyra e jetesës ishte e tillë që t'i përshtatej atij niveli. Me kalimin e kohës dhe zhvillimet që përcillnin botën njerëzore, edhe grupet pësuan ndryshime rrënjosore, me ç'rast edhe vjen deri te komplikimi i tyre, gjë që imponon edhe një organizim shoqëror më të avancuar. Të gjitha këto fillojnë me organizimin e grupeve shoqërore të quajtura parahistorike. Me kalimin e kohës u bë edhe zhvillimi i këtyre grupeve, të cilat kalojnë si grupe shoqërore deri te krijimi i kombeve. Krahas këtyre zhvillimeve lindi edhe civilizimi dhe emancipimi i tyre.

Secila nga periudhat historike të zhvillimit të grupeve shoqërore është karakterizuar edhe me nivelin e rrethanave ekzistuese që e kanë përcjellë qenien njerëzore. Në varësi të këtyre rrethanave janë imponuar edhe nxjerrjet e normave shoqërore, kështu që secili grup ka krijuar traditat dhe zakonet e veta. Krahas këtyre është zhvilluar edhe niveli i kulturës së grupeve. Kjo ka nisur që nga grupet e para parahistorike për të vazhduar deri te kombet e sotme moderne.

Nga kjo që u tha deri tani, rezulton se zënia fill në formimin e bashkësive- shoqërive me tipare të përbashkëta, daton që nga epoka e *Neo-Eneolitit*, përmes një procesi të ndërlikuar dhe të gjatë evolutiv. Nga ajo kohë e deri në ditët e sotme shoqëria ka pësuar shumë ndryshime, sidomos për nga mënyra e të jetuarit. Këto evoluime vazhdojnë të depërtojnë edhe deri te aspektet më detaje të personalitetit të individit. Kjo është edhe rezultat i një bote krejtësisht tjetër në raport me të kaluarën. Këtë e dëshmon edhe Giddens, sipas të cilët provat mbi ekzistimin e shoqërive datojnë që nga vitit 6000 p.e.s. dhe të cilat janë shumë më ndryshe nga të mëparmet. Ekzistimi i tyre bazohej nga niveli i zhvillimit të qyteteve. Bile, “shumica e shteteve tradicionale ishin perandori që merrnin përmasa të mëdha nëpërmjet pushtimeve dhe bashkimeve me popuj të tjera” (Giddens, 2004: 60). Tani më veç dihet se shteti tradicional ishte i vetmi tip shoqërie në histori para lindjes së industrializimit modern.

Që nga krijimi i shoqërive të para njerëzore, mijëra vite më parë, ato janë përcjellë edhe me elementin përbërës të kulturës, i cili i ka ndjekur nëpër të gjitha fazat e zhvillimit të tyre. Krahas shumë hulumtimeve që i janë bërë dhe i bëhen shoqërisë, nuk kanë munguar edhe studimet dhe hulumtimet e shumta të elementit kulturor që janë trajtuar nga shumë disiplina. Ndonëse njeriu dhe marrëdhëniet në shoqëri datojnë që nga kohët më të hershme historike, ishte shekulli XIX, i cili thuajse solli kulmimin e kësaj trajtese, pasi që veç njihet si koha e shumë ndryshimeve dhe revolucioneve që përjetuan të gjitha shoqëritë njerëzore. Kësaj i kontribuuan edhe zhvillimet e mëdha të shumë disiplinave shkencore.

Duke iu referuar disiplinave të shumta humane e shkencore, na del se kultura është bërë objekt i studimit të tyre. Gjatë qasjeve të ndryshme hulumtuese në këtë drejtim edhe antropologjia, përmes antropologut britanik të shekullit XIX, Edward Tylor, nxjerr

përkuftimin se: “kultura është një tërësi komplekse që përfshin dijen, besimin, artin, ligjet, moralet, zakonet dhe çfarëdo mjeshtërish dhe shprehish të krijuara nga njeriu si anëtar i shoqërisë” (Tylor, 1871: 28). Përkufizim ky disiplinar dhe interdisiplinar mbi kulturën dhe atë se çka është ajo.

Antropologjia si një shkencë për trajtimin e kulturës, e cila që nga themelimi i saj iu është përkushtuar grupeve të ndryshme njerëzore, vazhdon me misionin e saj në këtë fushë me mjaft përgjegjësi. Në këtë drejtim u shqua Lewis Morgan, i cili është ndër antropologët e parë dhe kryesor që kontribuoi në zhvillimin dhe dokumentimin e disiplinës së antropologjisë, përmes hulumtimit të jetës së fiseve indiane në aspektin e kulturës dhe praktikës sociale të tyre. Kontributin e tij në këtë drejtim, A. Canollit e shpreh kështu: “Morgan ishte i qartë në përcaktimin e shkallës evolutive të zhvillimit të shoqërisë në bazë të zbulimeve dhe përdorimeve të teknologjisë dhe rrëthanave materiale” (Canolli, 2009: 131). Me kalimin e kohës, nevoja për studimin e kulturës nëpër shoqëri ishte e domosdoshme. Ishte shek. XX kur në këtë fushë pati arritje të shumta. Andaj, është vlerësuar se “koncepti antropologjik i kulturës ka qenë një nga idetë më të rëndësishme dhe më me ndikim në mendimin e shekullit të njëzetë” (Keesing & Strathern, 2007: 24).

Pikërisht, lidhur me çështjen e trajtimit të kulturës nga aspekti antropologjik, jepen shumë mendime dhe vlerësime nga studiues të shumtë. Një arsyе të plotë e jep edhe Giddens, sipas të cilit “kultura i referohet gjithë mënyrës së jetesës së anëtarëve të një shoqërie” (Giddens, *vep. cit.*: 43). Pavarësisht se kultura si objekt studimi i antropologjisë në aspektin historik është e vonshme, pasi që antropologjia si shkencë në vete është e re, individi si qenie njerëzore që nga lashtësia e deri në ditët e sotme vazhdon të jetë në shoqëri me të tjera, ndërveprim që e realizon përmes kulturës. Sipas

të dhënavë shkencore, dihet se që nga kohët antike njerëzit kanë filluar të organizohen në të gjitha fushat e jetës dhe atë duke ndërvepruar përmes aktiviteteve, qoftë mes vete apo edhe me popuj të tjerë. Pikërisht kjo bën që “antropologjia kulturore shpesh përdoret për të etiketuar një fushë më të ngushtë që lidhet me studimin e zakoneve njerëzore-që do të thotë, studimin krahasimtar të kulturave dhe shoqërise” (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 14).

Një mendim të përafërt e jep edhe Giddens, që thotë se, “kultura përbëhet nga vlerat, të cilave u përbahen anëtarët e një grupei, nga normat që ata respektojnë dhe nga të mirat materiale që krijojnë” (Giddens, *vep. cit.*: 42). Mirëpo, ajo që e dallon zhvillimin e kësaj shkencë sot është se tani bëhen kërkime duke marrë pjesë drejtpërdrejt në jetën e atij individi apo të asaj shoqërie që studiohet.

Duke qenë se njeriu është qenie shoqërore, edhe pse domosdo lidhet edhe me natyrën, ai dallohet nga të gjitha qeniet tjera. Ai, që nga lindja e deri në vdekje, është në kontakt me shoqërinë dhe mjedisin shoqëror. Ajo që e përcjellë dhe e bën të njëjtë apo të dallueshme qenien njerëzore, është pikërisht kultura e tij. Pikërisht përmes kësaj edhe është organizuar jetesa, e cila me kalimin e kohës ka përqafuar hapat e zhvillimit të shoqërisë.

Ka mendime dhe teori të shumta dhe të ndryshme se si është përcjellë e transmetuar procesi i kulturës. Disa teoricienë nga fusha e shkencave sociale vlerësojnë se individi është si ‘letër e bardhë’, apo shprehur në terminologji psikologjike “*tabula rasa*”<sup>11</sup>, sipas ideologut Xhon Loku, ku përmes pendave të ndryshme shkruhet kultura. Sipas A. Canolli-t, “psikologët evolutivë thonë se truri i njeriut është zhvilluar me miliona vite

---

<sup>11</sup> Tabula rasa nga latinishtja në shqip përkthehet si *letër e bardhë*

dhe na ka mundësuar të mbijetojmë në skenën darviniane dhe mu për këtë arsyе truri e përcakton mënyrën e perceptimit dhe të marrjes së kulturës” (Canolli, *vep. cit.*: 164). Po ashtu, edhe sipas R. Keesing & A. Strathern, “Kultura në kuptimin e antropologjisë, .... më saktë, i referohet përvjoes së mësuar, së akumuluar .... i referohet atyre modeleve për sjelljen të transmetuara socialisht dhe karakteristike për një shoqëri të caktuar” (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 25).

Jetesa dhe zhvillimet shoqërore kanë imponuar që shoqëritë njerëzore të marrin dhe japid nga njëra-tjetra përmes marrëdhënieve të ndërtuara gjatë historisë. Kjo vetëm dëshmon ekzistimin e kulturës në secilën shoqëri, e cila ishte si urë lidhëse me të tjerat. Andaj, “kultura e një populli është baza primare për marrëdhëni e shëndetshme ndërkombëtare” (Canolli, *vep. cit.*: 195).

Se kultura është përcjellësi më besnik i qenies njerëzore, është dëshmuar nëpër histori. Pavarësisht ndryshimeve që përjeton shoqëria, qofshin ato të rrethanave të kohës apo edhe në rrethana pushtuese, kultura mbetet pjesë e asaj shoqërie, edhe pse mund të pësojë ndërhyrje nga jashtë. Pra, “Dhuna dhe egërsira i mshehin kulturat nën shkurra të helmuara. Por kultura është dritë që, edhe kur duket e fshehur, nuk asgjësohet dhe shpejt a vonë del dhe vezullon në nji trevë kulture të zhvilluar me fisnikëri të vërtetë” (Falaski-Vlora, 2002: 56). Natyrisht se kultura e një shoqërie, me ngjarjet dhe figurat e saj të mëdha, është e rëndësishme për njerëzit e vet asaj shoqërie. Kështu, “e tëra komplekse që përfshin dijen, besimin, artet, moralet, ligjin, traditën, dhe shumë aftësi dhe zakone të tjera fituar nga njeriu si një anëtar i shoqërisë” (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 25 [Tylor, 1871]). Bazuar në këtë, kultura përfshinë dijen dhe mënyrën e sjelljes sipas zakoneve nga të gjithë anëtarët e së njëjtës shoqëri, duke e përcjellë nëpër gjenerata.

Ashtu siç e ka edhe vet individi apo grupi brenda shoqërisë, të gjithë njerëzit dhe të gjitha shoqëritë kanë historinë e vet. Përmes këtyre historive kulturore ruhet identiteti i grupit dhe shoqërisë. Duke iu referuar këtyre, rezulton se kultura paraqet një rol kyç në qenësimin e shoqërisë si dhe në përcjelljen e trendëve të zhvillimit. Andaj, “kultura përbëhet jo nga ngjarje dhe gjëra që ne mund t’i vëzhgojmë, numërojmë dhe masim: ajo përbëhet nga ide dhe kuptime të përbashkëta” (Keesing & Strathern, *vep.cit.*: 28). Kjo bën që kultura të paraqesë një ‘mekanizëm diturie’, që të kompensohen disa nga mangësitë e instinkteve që i duhen një njeriu për t’u përballur me jetën, ngase dihet se njeriu shkathtësitë për të jetuar i fiton gjatë jetës dhe nuk i trashëgon me lindje, siç e kanë disa qenie të tjera jo njerëzore. Pra, ata shkathtësitë duhet t’i mësojnë nga të tjerët gjatë përvjës jetësore (Raimi, 2009: 135).

Historia kulturore na tregon se njerëzit, përveç që kanë historinë kombëtare, ata mund të kenë edhe historinë kulturore të grupit brenda kombit. Këto janë të rëndësishme dhe ndihmojnë në “zhvillimin e identiteteve të grupeve, historive familjare dhe të jetëve bashkëkohore të anëtarëve që jetojnë në këto kultura të përbashkëta” (Martin & Nakayama, 2010 [2008]: 90). Pikërisht këto edhe janë të ndërlidhura mes vete. Sot jetohet në një botë ku ka lëvizje të shumta më ndryshime të jashtëzakonshme, të cilat na shtyjnë të “rimendojmë betejat dhe identitetet kulturore” (Martin & Nakayama, *po aty*: 90). Me të drejtë Weber thotë se “ne duam të kuptojmë nga njëra anë lidhjet dhe domethënien kulturore të ngjarjeve individuale në shfaqjet e tyre bashkëkohore dhe nga ana tjetër arsyet se pse këto fakte janë historikisht kështu dhe jo ndryshe” (Weber, *vep. cit.*: 38).

Janë pikërisht antropologët ata që merren me trajtimin e kulturës në periudha të caktuara historike. Ndër ta edhe R. Keesing & A. Strathern, që vlerësojnë se:

Antropologët kanë qenë duke folur për dy rende krejtësisht të ndryshme të gjërave kur kanë përdorur termin kulturë- dhe shpesh kanë lëvizur poshtë e lartë ndërmjet dy burimeve të kuptimeve. Së pari, kultura është përdorur për treguar ‘modelet e jetës brenda një komuniteti-aktivitetet që ndodhin rregullisht dhe rregullimet materiale dhe sociale’ karakteristike për një grup të veçantë njerëzish. Në këtë kuptim, kultura i referohet sferës së fenomeneve të vëzhgueshme, të gjërave dhe ngjarjeve ‘atje jashtë’, në botë. Së dyti, kultura është përdorur për të treguar sistemet e organizuara të dijes dhe besimeve, nga ku njerëzit strukturojnë përvojën dhe perceptimet e tyre, formulojnë akte dhe zgjedhin midis alternativave (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 26)

Reth kulturës janë theksuar edhe qëllimet e saj. Sipas autorit Sunaj, duhet nënvizuar qartë se qëllimet kryesore të kulturës janë dy:

Qëllimi i parë ka karakter tradicional, meqë nënkuption kultivimin dhe ruajtjen tradicionale të ashtuquajturit thesar kulturor universal të njerëzimit, gjë që ka vlerë ta paçmuar. Kurse qëllimi i dytë është me karakter progresiv, meqë nënkuption zhvillimin dhe përsosjen e krejt atyre vlerave të ndryshme kulturore, të cilat njeriu vazhdimisht i zbulon gjatë të jetuarit të tij bashkëkohor (Raimi, *vep. cit.*:136)

Bazuar në këtë, të gjitha shoqëritë që do të përballen me këto dy karaktere të kulturës. Domosdo që zhvillimet shoqërore imponojnë një gjë të tillë. Dhe sot, pavarësisht që sado e izoluar ka qenë një shoqëri, këto dy qëllime padyshim që janë në ‘luftë’ mes vete. Reflektim edhe më të theksuar do të jep shoqëritë që përballen me transformime, sidomos ato që dalin nga sistemet e izoluara.

Duke iu referuar të gjitha këtyre, rezulton se çështja e kulturës është trajtuar dhe vazhdon të trajtohet nga shumë autorë. Mirëpo, interpretimi i tyre mund të jetë i ndikuar nga rrethana apo faktorë të ndryshëm.

### **3.2 Kultura si dukuri antropologjike e sociologjike**

Kultura është një prej nocioneve vërtetë kontraverse. Koncepti i saj më gjithëpërfshirës e paraqet atë si tërësi të formave të sjelljes dhe veprimit në të gjitha fushat e jetës njerëzore jo-instiktive, pra të aspektit të saj kreativ e veprues, si në sferën materiale

ashtu edhe në atë shpirtërore. Ajo që njeriun e veçon qartë nga qeniet tjera është lidhja shoqërore. Pikërisht kjo mundëson edhe një përkufizim të shumë anshëm të kulturës.

Rreth nocionit të kulturës janë interesuar shumë shkencëtarë dhe dijetarë të fushave të ndryshme. Sipas M. Pirraku, “në përdorimin teorik e praktik ka kuptim e përbajtje të gjërë dhe mbalon lëmenj të tërë të jetës dhe prodhimit shpirtëror, material e shoqëror të një individi, të një rrethi njerëzish, të një populli, a të një bashkësie njerëzore në përgjithësi në periudha të caktuara historike” (Pirraku, 1989: 23).

Gjatë përditshmërisë, me kulturë mund të nënkuftojmë shumë aspekte të jetës. Për disa nga antropologët kulturor, kjo ka të bëjë me të gjitha tiparet dhe karakteristikat e një shoqërie konkrete. Këtu mund të hyjnë: besimet, sjelljet, idealet, zakonet, vlerat, etj. Kështu që, “manifestimi i kulturës mund të variojë në mënyrë të konsiderueshme nga një vend në tjetrin, por në kuptimin antropologjik asnjë person nuk është “më tepër i kulturuar” apo “më pak i kulturuar” sesa një tjetër” (Memushi, 2000: 19). Kështu, kultura paraqet mënyrën e jetës së një grupei të caktuar.

Lidhur me kulturën nuk kanë reshtur asnjëherë mendime të shumta. Kështu, sipas A. Dhima, që i referohet Gudinafit, pohohet se kultura përcaktohet si “standarde për të vendosur se çfarë është, ç’mund të jetë ..., ç’duhet bërë ... dhe si duhet të veprohet me ‘të’” (Dhima, 2013: 81; Goodinough, 1961: 521-522). Bazuar në atë që individët e mësojnë kulturën, ajo duhet të përfshijë “sisteme të ideve të përbashkëta, sisteme të koncepteve dhe rregullave dhe kuptimeve që qëndrojnë dhe shprehen në mënyrat që jetojnë njerëzit” (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 26). Ndërsa, Bullaç shprehet se “kultura tregon një ngjashmëri me traditat, doket dhe zakonet, sepse, sipas tij, kultura përfaqëson

kallëpet e sjelljes që mësohen në rrëthin shoqëror dhe të cilat përmes së njëjtës rrugë u injektohen brezave të rinj” (Bullaç, 2003: 204).

Po ashtu, rrëth kulturës janë shprehur edhe studiues dhe dijetarë shqiptar. Sipas M. Pirraku, dijetarët tanë të periudhës së pavarësisë kanë konstatuar në mënyrë shumë të përbledhur se “fjala kulturë shenjon të përbledhunit e të gjithë aktivitetit shpirtnuer kolektiv të nji populli si në lamë të ditunis e t’artit, si edhe në pikëpamje të perparimit moral e materijal në jetë shoqnore e individuale të nierit” (Pirraku, *vep. cit.*: 24).

Në anën tjeter, edhe L. Memushit jap këtë mendimin mbi kulturën:

Një kulturë duhet të kënaqë nevojat themelore të njerëzve që jetojnë sipas rregullave të saj, të ketë vazhdimësi e të sigurojë rregull e disiplinë për ta. Duke qenë e tillë, kultura vendoj një balance ndërmjet interesave vetjake dhe nevojave të shoqërisë si një e tërë. Së fundi, një kulturë duhet të ketë aftësinë të ndryshojë, me qëllim që t’i adaptohet çdo rrëthane (Memushi, *vep. cit.*: 285)

Kultura paraqet një sistem mjaft kompleks, ngase është pjesë e pashmangshme e të gjitha shoqërive njerëzore botërore. Edhe pse përdoret nga thuajse çdo njeri, qoftë në të shkruar e në të folur, qoftë në nivele të thjeshta e deri në ato shkencore, nga personalitetë dhe shkencëtar të ndryshëm, madje që merren me trajtimin e së njëjtës, nuk është arritur në gjetjen e një përkufizimi dhe të një koncepti të vetëm të përbashkët. Madje, siç transmetohet, dy antropologë amerikan kanë arritur të konstatojnë 164 përkufizime në lidhje me kulturën, të përaferta apo krejtësisht diametrale mes vete (Bullaç, *vep. cit.*: 201). Sipas sociologëve amerikan Krebber dhe Kluckhon, sot fjala kulturë përdoret në mbi 257 kuptime të ndryshme.

Kultura mësohet, ajo përfshin perceptim, vlera dhe ndjenja, si dhe shprehet si sjellje. Andaj, për këtë edhe është vlerësuar se kjo më shumë mësohet se sa trashëgohet nga aspekti biologjik. Kështu, sipas L. Memushi-t, “kultura përfaqëson një bashkësi

rregullash ose standardesh që veprojnë mbi anëtarët e një shoqërie, të cilat duke u zbatuar nga këta anëtar, prodhojnë sjellje që shkaktojnë një varg ndryshimesh të konsideruara prej tyre të pastra e të pranueshme” (Memushi, *vep. cit.*: 286).

Varësisht nga mënyra e studimit dhe trajtesat që i kanë bërë hulumtuesit, zhvillimi i kulturës dhe tiparet e saj rezultojnë shumë herë me kontradita të shumta. Madje,

ka pasur faktorë objektiv e subjektivë që kanë ushtruar, në këtë ose atë mënyrë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndikim pozitiv mbi zhvillimin e kulturës popullore dhe mbi shkencat që e studiojnë atë; ndërkohë, kanë ekzistuar edhe rrëthana të disfavorshme shoqërore, që kanë ndikuar negativisht (Uçi, 1997: 173)

Por, ajo që është shumë e rëndësishme, është se kultura, përmes vlerave të saj ishte dhe është jo vetëm si trashëgimtare e zakoneve dhe traditave, por edhe baza kryesore e kulturës bashkëkohore, edhe përkundër shumë ndërhyrjeve të shumta politike e ideologjike me qëllim të pengimit të saj. Prandaj, “Çdo kulturë e jeton pranverën, verën, vjeshtën dhe dimrin e vet, apo fëmijërinë, rininë, pjekurinë dhe pleqerinë. Çdo kulturë ka shpirtin e vet specifik. Çdo kulturë ka konceptin e vet për hapësirën.” (Bullaç, *vep. cit.*: 83).

Është e kuptueshme se kultura përbën qenësoren në kuadër të ruajtjes së mirëqenies së atij grupi si dhe ekzistencën e tij, duke realizuar përbushjen e kërkësave dhe nevojave të tyre. Kështu që ‘kultura’ përfshinë ato sjellje që janë mësuar nga të tjerët, qoftë vetëm nga instinkti apo edhe me dëshirë, duke i bërë mostra për të tjerët. Secili grup përban normat e veta kulturore, të cilat i përcjell nëpër gjenerata. Andaj, “çdo përpjekje e njeriut për të përfituar njoburi, për ta pasuar fushëveprimin e vet me dituri, për të arritur deri te njoburi të reja bën pjesë në kulturë” (Bullaç, *vep. cit.*: 206). Këtu rol mund të luajnë edhe rrëthanat historike që i kanë përcjellur grupet. Prandaj, secili grup

shoqëror mban lidhjen direkte varësisht nga lloji i grupit që i takon dhe gjeneza që ka. Këtë e shpreh edhe N. Bardhoshi, sipas të cilit, “kulti i të parëve të përbashkët dhe përdorimi i tij në praktikë është shumëdimensional dhe është ndoshta një prej parimeve kryesore që e mban shoqërinë të lidhur bashkë” (Bardhoshi, 2011: 18-19). Megjithatë, M. Pirraku vlerëson se “konditat në të cilat janë zhvilluar dhe zhvillohen kulturat kombëtare të popujve të ndryshëm kanë qenë dhe janë, pak a shumë, të ndryshme, favorite, të përshtatshme ose fare të ndara, të disfavorshme për zhvillimin e një kulture” (Pirraku, *vep. cit.*: 27).

Duke iu referuar mendimeve dhe vlerësimeve të ndryshme rrëth kulturës, A. Bullaç jep edhe këtë vlerësim:

Lidhshmëria e njeriut me të kaluarën dhe me rrënjet e gjenezës së vet është një prirje natyrore, e cila thellë dhe në përmasa të gjera ndikon në jetën njerëzore/shoqërore. Jeta shoqërore merr nga historia elemente të shumta të njohurive, veprave dhe sjelljeve, tradita të shumta, disa doke, zakone dhe shprehi rrënjesore, i pranon dhe duke i riprodukuar i pasuron ato. Asnjë brez njerëzor nuk mund që brezit të ardhshëm t'ia përcjellë trashëgiminë ashtu siç e ka marrë nga brezi i kaluar, meqë gjithsesi edhe ai i kontribuon apo shton diçka. Kontribuimi në trashëgiminë e lënë nga e kaluara, shtimi asaj disa gjëra të reja ngajeta e kohës përkatëse në të cilën jeton njeriu, krijon kulturën (Bullaç, *vep. cit.*: 222)

Rrëth kulturës antropologjike dhe ‘ecjes’ së saj nëpër histori, e përcjellë me zhvillime të shumta, shihet se ajo është sijeta e popujve, e pafundme, sepse përcillet nëpër gjenerata, duke u transferuar jo vetëm brenda së njëjtë grup apo shoqërie, por edhe prej një shoqërie në tjetrën, deri tek transformimet ndërkontinentale. Është më se e vërtetë që kulturat, sidomos kur janë në interes të shoqërisë, barten lehtë dhe në forma të ndryshme. Ajo kulturë që arrin të dominojë një kohë të tjerat sigurisht që do të bëjë presion mbi ato, duke pretenduar të ua zërë vendin, në mos tërësisht, së paku pjesërisht.

Lidhur me kulturat, rol me rëndësi luan edhe mjedisi natyror, duke u dëshmuar me doket dhe zakonet, me trashëgiminë historike dhe shoqërore. Megjithatë, Giddens

vlerëson se: “Në qoftë se sot një numër i madh shoqërish dhe kulturash tradicionale janë zhdukur, kjo ka ndodhur sepse mënyrat e tyre të jetës ishin ‘inferiore’. Kjo ndodhi sepse ato ishin të paafta t’i rezistonin ndikimit të bashkimit të fuqisë industriale dhe ushtarake që arritën vendet e Perëndimit” (Giddens, *vep. cit.*: 63).

Edhe pse më herët antropologët kanë pretenduar se ekziston dallim mes kulturës dhe shoqërisë, gjatë hulumtimeve moderne rezulton se këto ndërvaren nga njëra-tjetra. Sot argumentohet më së miri se secili grup që arrin të zhvillohet duke ruajtur sistemin e vet organizativ ka të bëjë me shoqerinë. Sipas A. Dhima,

duhet të jetë një grup i dalluar në pikëpamje territoriale, anëtarët e tij të flasin gjuhë të njëjtë dhe të ruajnë ndjesinë e një identiteti të përbashkët, në krahasim me shoqëritë e tjera”, kështu që “sistemi social e kulturor i të cilave dallohet në shumë aspekte nga ai i të ashtuquajturit “prototip (Dhima, 2010: 180)

Andaj, bota moderne sot dikton ndryshime rrënjosore, qoftë në organizimin shoqëror, qoftë në nivelin e kulturës, të cilave domosdo kërkohet t’iu referohemi. Këtë e imponon edhe niveli i zhvillimeve teknologjike, i cili thuajse ka ndryshuar tërësisht mënyrën e jetesës dhe institucioneve sociale, si një karakteristikë e botës bashkëkohore. Se kulturat vazhdimisht zhvillohen dhe devijojnë nga struktura e vet specifike, pra, “është e kuptueshme se asnjë kulturë shekullore nuk mund të ruajë deri në pafund strukturën e vet specifike dhe trashëgiminë e paprishur të së kaluarës (Bullaç, *vep. cit.*: 251).

### **3.3 Kultura dhe krimi në shoqëri**

Kriminaliteti, qoftë si dukuri shoqërore apo edhe individuale, si dhe arsyet e shkaqeve të paraqitjes së tij, është trajtuar nga shumë autorë, madje që nga paraqitja e shoqërisë njerëzore. Shumica e autorëve që janë marrë me trajtimin e kësaj dukurie kriminale theksojnë se ajo është shkencë mbi manifestimin e krimit. Që nga lashtësia ka pasur

tendenca për të treguar dhe shpjeguar arsyen dhe interesin që kanë individët apo grupet për t'u marrë më kime dhe kriminalitet. Por, edhe pse ata pajtohen në përkufizimin e përgjithshëm të dukurisë, mes tyre po ashtu ekzistojnë edhe dallime të shumta.

Marrë parasysh dëmet dhe problematikat që kanë sjellë aktivitetet kriminale, duke futur shqetësim dhe frikë te njerëzit, ka imponuar që shumë prej njerëzve të shprehin interesim rreth kësaj dukurie. Interesimi i opinionit për krimin ka qenë i përhershëm, ngase të gjitha shoqëritë njerëzore janë përballur me këtë dukuri të rrezikshme dhe përherë kanë bërë përpjekje ta pengojnë atë. Kështu që,

Për shkak të natyrës së vet shkatërruese, krimi përherë ka zgjuar frikë, pasiguri dhe tmerr ndër qytetarë, duke shtuar në të njëjtën kohë interesimin për të. Prandaj, në të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore, është shprehur një interesim i veçantë për natyrën, shkakun dhe motivet e krimit si dhe për pasojat shpesh tragjike dhe mënyrën e pengimit dhe dënimit të tij (Halili, 2008: 10)

Aktet kriminale mund të kryhen nga individi apo edhe nga grapi. Çdo individ mund të karakterizohet prej dy palë faktorësh shumë kompleks. Në njëren anë përfshihet aspekti gjenetik, pra ana e brendshme dhe në anën tjetër pjesa e jashtme, e cila përfshinë rezultanten e veprimit të të gjithë faktorëve të mjedisit jetësor. Kjo e bën individin tip *kontrovers*. Bazuar në këtë rezultojnë individ me tipare normale dhe patologjike.

Kështu që, personaliteti i njeriut, përveç sjelljes në suaza të normales, shumë herë di të shfaqë edhe sjellje negative, pra të devijojë. Këtë fenomen e ka trajtuar sociologu Emile Durkheim, që potencon se gjatë jetës shoqërore, krahas sjelljeve normale ekzistojnë edhe ato jonormale, të cilat rrezikojnë ekzistencën sociale. Çdo sjellje që është në kundërshtim me normat, zakonet dhe ligjet e shoqërisë, quhet sjellje devijante. Andaj, me sjellje të tillë kuptojmë cilëndo mënyrë të sjelljes së individit dukshëm më ndryshe nga normat, zakonet dhe ligjet ekzistuese të shoqërisë së caktuar. Kjo ka ekzistuar dhe

do të ekzistojë në të gjitha shoqëritë derisa në to do të ekzistojnë norma dhe ligje dhe reagimi ndaj tyre do ndryshojë nga shoqëria në shoqëri si dhe nga koha në kohë.

Shoqëritë moderne në botën bashkëkohore ballafaqohen me shtim gjithnjë e më të madh të aktiviteteve kriminale, disa prej të cilave nuk kursejnë as edhe përdorimin e dhunës deri në agresivitetin më të lartë. Lidhur më këto dukuri janë marrë edhe shumë autorë, sipas shumicës prej të cilëve kjo është ‘karakteristikë’ e kohës ‘moderne’. Pikërisht këto karakteristika nuk zgjedhin vendin dhe as individin, po në të shumtën e herëve viktimizojnë e terrorizojnë popullsi të pafajshme. Në shumicën e rasteve paraqiten edhe dukuri të reja, që e ‘prekin’ shoqërinë për herë të parë. Madje, disa prej tyre nuk janë as edhe të normuara në ligje, gjë që krijon një amulli tek të gjithë në shoqëri. Kjo shpie edhe deri te ndryshimi i ligjeve dhe kodeve në to. Kështu, “me të drejtë, disa autorë konstatojnë se historia e civilizimit është në të njëjtën kohë edhe histori e krimit, sepse historia njerëzore ka kaluar nëpër ngjarje e kohëra të përcjella me dhunë e krime të llojlojshme” (Halili, 2008: 10).

Lidhur me ndryshimet kulturore që e përcjellin shoqërinë, e që në shumë raste këto ndryshime sjellin edhe dukuri negative dhe janë burim i konflikteve shoqërore e potencojnë edhe autorët Judith dhe Thomas, sipas të cilëve: “Një karakteristikë tjeter kryesore e kulturës është se ajo është dinamike, ose në ndryshim dhe shpesh mund të jetë burim konflikti midis grupeve të ndryshme. Është e rëndësishme të pranojmë se modelet kulturore nuk janë të ngurta dhe homogjene, por dinamike dhe heterogjene” (Judith & Thomas, *vep. cit.*: 52). Kjo tregon se rëndësia e kulturës për jetën e njeriut paraqet çështjen bazë të karaktereve individuale e grupore të shoqërisë dhe një fenomen shumë specifik. Edhe pse është e kuptueshme që kultura ndjek hapat e zhvillimit shoqëror, përcjellja e saj nëpër gjenerata mbulon boshillëkun që mund të krijohet mes

brezave. Në këtë mënyrë realizohen normimet shoqërore duke i plotësuar nevojat e kohës, gjë që vërtetë e bëjnë njeriun të jetë një prej qenieve më të veçanta. Janë pikërisht këto që e baraspeshojnë paraqitjen e konflikteve nga aspekti kulturor si dhe paraqitjet e dukurive të reja negative. Andaj, me të drejtë Giddens shprehet:

Ne mendojmë se zakonet pranohen thjesht sepse e kanë autoritetin e traditës. Përkundrazi, mënyrat tonë të jetesës kërkohet gjithnjë e më shumë të kenë bazë “racionale”. Kjo do të thotë që ato duhet të mbrohen dhe, po të jetë e nevojshme, të ndryshohen në përputhje me faktin nëse ato mund të justifikohen në bazë të argumenteve bindës dhe dëshmive (Giddens, *vep. cit.*: 618)

Shkaktimi i dhunës që ndodh gjatë jetës sociale, në të shumtën e rasteve nuk mund të jetë e kundërtë e kulturës, por është saktësisht produkt i një lloji të caktuar të kulturës. Kjo është dëshmuar edhe nga kultura dhe qytetërimi apo arsimimi dhe edukimi që ishte arritur në shekullin e njëzetë, por që pikërisht gjatë kësaj kohe ndodhi edhe paraqitja e dhunës më të paparë në historinë e njerëzimit. Pra, kjo vjen nga të mësuarit përmes një edukimi dhe socializimi, në veçanti përmes marrëdhënieve të afërta me forcat që menaxhojnë jetën e ndërgjegjshme shoqërore të qenieve njerëzore. Mund të themi se agresioni dhe dhuna janë pjesë e një gare biologjike dhe instiktive e njeriut. Realisht dhuna mund të jetë rezultat i një procesi historik si dhe një ridefinim i kufijve në mes natyrës dhe kulturës. Kështu që, cila është normale dhe cila është devijante apo patologjike, ndryshon në varësi të konteksteve specifike kulturore.

Nëse individët janë të dhunshëm, mendohet se edhe shoqëria dhe kultura nuk janë aq të pafajshme. Dhuna sjell kaos, shpërbërjen e lidhjeve shoqërore dhe kulturore. Efekti i dhunës që ndikon në shoqëri dhe te individi është thyerja e rendit kulturor dhe shpërbërja e formave të saj.

Deri tani janë bërë shumë studime lidhur me shtytjen e individëve në sjellje të tilla, duke i shkelur normat dhe ligjet e asaj shoqërie, ku sipas shpjegimit sociologjik këto devijanca mësohen gjatë jetës në shoqëri. Pra, këtu shkaqet kërkohen jo në individin, por jashtë tij, në rrethinë dhe shoqërinë ku jeton. Një nga lidhjet më të forta të studiuara është lidhja mes sjelljeve kriminale dhe disiplinës së dobët në familje. Shumë studime dëshmojnë se një fëmijë që kalon një fëmijëri jo të mirë, që edukohet në një familje me probleme, kur të rritet, do të posedojë të gjitha premisat e nevojshme për të qenë kriminel. Kjo vërtetohet edhe nga studiuesit amerikan Sadhërlandi dhe Kresei, të cilët kanë vënë në dukje lidhjen mes krimit dhe imoralitetit, alkoolizmit të prindërve, mungesës së njërit prind, mungesës së kontrollit të familjes, mungesës së jetës së gëzuar familjare dhe problemeve ekonomike (Hysi, 2005: 223). Pra, “funksioni edukativ i familjes ka qenë gjithmonë i pranishëm aty, që kur ka lindur familja dhe se do të mbetet në jetën e saj përgjithmonë” (Beqja, 1987: 35). Andaj, me të drejtë akademiku J. Rexhapagiqi thotë se “roli edukativ i familjes nuk zhdukет, e as nuk është për t'u nënçmuar” (Rexhepagiqi, 2008: 75).

### **3.4 Natyra e prejardhjes së dukurive kriminale dhe kontrolli social**

Krimi ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e pandarë e shoqërisë. Bashkë vazhdojnë përjetimin e zhvillimit, duke mos kursyer asgjë. Këtë e shpjegon edhe V. Hysi, që thotë se edhe pse gjendemi në një shoqëri me shumë zhvillime ekonomike e teknologjike me civilizim dhe kulturë të lartë, ende nuk është arritur të shpjegohet pse sjelljet kriminale janë shndërruar në kërcënim serioz për shoqërinë, madje këto zhvillime kanë sjellë edhe forma të reja të krimit (Hysi, *vep. cit.*: 2).

Bazuar në statistikat dhe të dhënrat e kërkimeve empirike kriminologjike dhe nga praktika gjyqësore, del se, si shkak i drejtpërdrejtë i marrjes me veprimtari kriminale të

disa personave, janë sjelljet negative, traumat, konfliktet, përjetimet tragjike dhe të pakëndshme që ata i kanë pasur në këto ambiente. Prandaj, “kriminaliteti si dukuri e dëmshme shoqërore, nuk mund të pengohet me sukses nëse nuk njihen shkaqet dhe kushtet e paraqitjes së tij, sidomos nëse nuk analizohen dhe studiohen faktorët që e kushtëzojnë atë” (Latifi, 2008: 21).

Në përgjithësi shkrimet mbi ‘devijancën dhe përshtatjen’ në sociologji, zakonisht fillojnë me një konceptim të ngushtë për ‘normë’, si diçka që njerëzit thonë se duhet apo nuk duhet bërë. Prandaj, këtë e sqarojnë edhe R. Keesing dhe A. Strathern, që theksojnë se:

Disa norma me të vërtetë publike e të dukshme ndiqen ose shkelen më vetëdije. Por disa ‘rregulla’ të tjera janë të fshehura nën sipërfaqen publike sociale dhe janë zbuluar nga antropologët, duke ndjekur një metodologji për të analizuar të dhënat, të cilat janë ndërtuar mbi rregulla gramatikore. Këto rregulla janë latente në sjelljen tonë, të rrënëjëzuara thellë në zakone dhe në proceset e pavetëdijes mendore. Dhe themeli i jetës tonë të rregullt është pikërisht ndjekja e këtyre rregullave (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 293)

Kjo është vazhdimi që nga shoqëritë e para, edhe pse në atë kohë ekzistonte e drejta e pashkruar, për të vazhduar deri në kohët moderne. Fillimisht normat ishin tipike me rendin shoqëror të kohës, gjë që mundësonte një kontroll të mirëfilltë social. Po ashtu, edhe në kohën e sotme këto norma, edhe pse janë zëvendësuar me ligje, prapë se prapë kanë rëndësi të madhe shoqërore, ngase në një farë forme janë në mbështetje të rregullit që duhet të krijojë shteti. Këtë na paraqet edhe N. Bardhoshi, sipas të cilit:

E drejta e pashkruar në një shoqëri egalitariane ndryshe nga e drejta shtetërore ka një kusht që nuk mund të kapërcejë lehtë. Ajo në tërësinë e saj duhet të jetë në harmoni të plotë me moralin e shoqërisë së cilës i përket. Pra, është vështirë që një normë e së drejtës kanunore të jetë në kundërshti me sistemin e vlerave të shoqërisë. Siç shihet edhe e drejta kanunore ka gjalluar në një mjedis kryesishët rural, duke luajtur rol kyç në kontrollin social si konkurruese e asaj shtetërore dhe duke bashkëvepruar me elemente të tjera kulturore, si religioni dhe morali (Bardhoshi, *vep. cit.*: 53)

Kuptohet se bota moderne në shtetet demokratike mundëson paraqitje të disa nënëkulturave brenda së njëjtës shoqëri. Vet zhvillimet moderne mundësojnë që brenda së njëjtës shoqëri të jenë edhe grupe me tradita dhe kultura tërësisht më ndryshe. Ndaj, derisa për njërin grup disa sjellje mund të jenë të pranueshme, për grupin tjetër ato mund të paraqesin sjellje të papranueshme. Që këto grupe të kenë një sjellje të përafërt kjo realizohet përmes një normimi nga kontrolli social, të aplikuar nga ligjet që dalin nga ata.

Sic dihet shoqëria dhe shteti përmes normimit të disa normave në fusha të caktuara kanë krijuar ligjet dhe kodet penale e të procedurës penale, të cilat janë të obligueshme të respektohen nga secili qytetar, në të kundërtën pasojnë ndëshkimet. Këto norma ligjore mbrojnë shoqërinë nga shkeljet, që nga kundërvajtjet e deri tek krimet. Sipas Giddens, “aty ku ka ligje, ka edhe krimë” (Giddens, *vep. cit.*: 125). Edhe Sally F. Moore vlerësonte se nuk mund të bënte asnjë shoqëri pa ligje. Sidomos me rastin e zhvillimeve moderne, ku bota është bërë e ‘vogël’, sjellë të nevojshme ekzistimin e ligjit, ngase ka gërshtime të kulturave, që edhe mund të jenë në kundërthënie mes vete. Lidhur me këtë, mendimin e mendimin e Malinovski-t, e shpreh N. Bardhoshi kështu: “ligji dallon nga normat tjera jo nga ekzistenca ose jo prej gjykatave, policisë etj, por nga natyra e tij publike, që sjell detyrime të dyanshme për palët” (Bardhoshi, *vep. cit.*: 37).

Qenia njerëzore është qenia me intelektin më të lartë dhe se sjelljet e saj varen nga zakonet, traditat dhe kultura e tyre, që marrin dhe japid nga njëra tjetra, të cilat e bëjnë si qenie sociale. Por, jo gjithmonë këto mund të kalojnë pa probleme. Andaj balanca shoqërore mbahet përmes rendit social të sistemuar përmes ligjeve. Me këtë rast:

Të gjitha shoqëritë kanë mënyrat e tyre për të ushtruar kontrollin social mbi anëtarët e tyre dhe për të shuar konfliktet, në mënyra të ashtuquajtura ligjore ose jo. Të gjitha shoqëritë

janë njësoj të varura në ruajtjen e normave sociale, të cilat mund të janë të sankzionueshme drejtpërdrejt ose në mënyrë më latente (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 305)

Duke iu referuar këtyre shihet se përmes ligjit mbrohet shoqëria dhe sistemi i vlerave të saj. Megjithatë edhe ligji edhe vlerat shoqërore lëvizin dhe ndryshojnë me kalimin e kohës dhe krahas zhvillimeve shoqërore, andaj më qëllim të ‘mbrojtjes së vazhdueshme’ ato përcjellin njëra tjetrën. “Domethënia kulturore e marrëdhënieve ligjore të rregulluara në mënyrë normative, madje edhe e vet normave mund t’i nënshtronhet ndryshimeve thelbësore revolucionare edhe në kushtet e identitetit formal të normave ligjore mbizotëruese” (Weber, *vep. cit.*: 50).

### 3.5 Specifikat e lëvizjes demografike

Secila shoqëri përballet edhe me specifikat demografike, një faktor në vete, me rëndësi të madhe. Vet pozita gjeografike e globit tokësor ka imponuar edhe lëvizjet e shumta demografike të njerëzimit. Këto lëvizje demografike të shoqërive janë përcjellë edhe me gërshtetime të kulturave. Prandaj, “të kufizosh një kulturë nga ana hapësinore dhe demografike është ... problematike ...” (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 34; Schwarts, 1978: 422).

Globi tokësor që nga fillet e para të historisë ka qenë i përfshirë nga konflikte e luftëra të shumta, si dhe nga probleme të ndryshme ekonomiko-sociale. Individë apo edhe grupe të tëra personash janë detyruar të migrojnë në vende të ndryshme, për të qenë më afër mundësive për një jetë më të mirë. Të gjitha këto lëvizje janë shoqëruar edhe me prerjet e normave të sjelljes dhe lloje të ndryshme të kulturave. Lidhur me këtë Giddens shprehet:

Shumë lëvizje sociale janë mjaft të vogla dhe numërojnë ndoshta jo më shumë se disa dhjetëra pjesëtarë; të tjerat mund të përfshijnë mijëra, madje miliona njerëz. Disa lëvizje e

kryejnë veprimtarinë e tyre brenda ligjeve të shoqërisë ose shoqërive ku ekzistojnë, ndërsa tjerat veprojnë si grupe ilegale ose të fshehta (Giddens, *vep. cit.*: 600)

Është e kuptueshme se të gjitha komunitetet që bashkëveprojnë në sfera të ndryshme mund të konsiderohen se përbëjnë një shoqëri. Kështu, “në mënyrë karakteristike, një shoqëri përfshin një sistem social tërësor, anëtarët e të cilit ndajnë midis tyre një gjuhë dhe një traditë kulturore të përbashkët” (Kassing & Strathern, *vep. cit.*: 33). Pavarësisht zhvillimeve bashkëkohore të kohëve të fundit, ku bota thuajse është bërë shumë e vogël në raport me zhvillimet teknologjike dhe njeriu ka qasje në secilin vend dhe pjesë të botës, qoftë me kontakte fizike, qoftë përmes kontakteve nga mjetet elektronike, llojet e kulturave janë ekzistuese. Këto dallime datojnë që nga lashtësia, madje edhe kur ekzistonin grupet e vogla shoqërore, për të vazduar edhe në ditët e sotme. Duke iu referuar këtyre ndryshimeve në kultura Giddens vlerëson se:

Vlerat dhe normat e sjelljes ndryshojnë shumë nga një kulturë në tjetrën, shpesh duke kantrastuar rrënjosisht me atë çka njerëzit e një shoqërie perëndimore e quajnë “normale”. .... . Çdo kulturë përbën modele unike të sjelljes që u duken të huaja njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore (Giddens, *vep. cit.*: 49)

Është më se e kuptueshme se zhvillimet shoqërore, të shtyra edhe nga specifikat demografike, domosdo që ndikojnë edhe në vet kulturën e grupit. Në anën tjetër, kulturat përballen me presion të vazhdueshëm në drejtësim të ndryshimeve, qoftë të kohës apo edhe të rrëthanave. Të gjitha këto me qëllim të imponimit për ndryshime. Sidomos epshet e huaja të shumta për zgjerim në hapësirat e vendeve tjera, bënë që këto historikisht të ballafaqohen me pushtime të shumta dhe atë nga të katër anët e horizontit. Këto ndikuan në zhvillimin e atyre vendeve dhe vështirësuan edhe krijimin e një shoqërie stabile në tërë territorin e vet.

Këto rrethana duhet trajtuar me kujdes me qëllimin më të mirë për zhvillimin e shoqërisë në hap me realitetin, duke qenë korrekt me ato që kërkojen. Shumë drejt e sqaron në shkrimet e saj edhe N. V. Falasku, ku thotë: “Koncepti i univerzalitetit të kulturës nuk është të përvetësohet si tërësi; Mendimet paraprake si dhe fanatizmat shpesh e mjegullojnë mendjen duke na bërë shkurtpamës dhe të njëanshëm” (Falaski-Vlora, *vep. cit.*: 205).

Pjesa më e madhe e vendeve të botës ishte pjesë e kolonizuar e disa vendeve të zhvilluara. Kjo dhe të tjera zhvillime kanë shtyrë popullsitetë e shoqërive të ndryshme të lëvizin nëpër vende tjera jashtë origjinës së tyre. Një lëvizje e tillë demografike nuk kishte kursyer as edhe vendet e Ballkanit. Historikisht dihet se Ballkani, që nga kohët e vjetra e deri në kohët e sotme, është përballur me kriza e luftëra, kryesisht të nxitura në baza nationale. Sipas A. Pipa, dallimet në traditat fetare, zakonet dhe dallimet në gjuhë ishin më të theksuarat, duke pretenduar lakmitë e tyre për pushtet. Andaj, “dallimet etnike dhe kulturore ekzistojnë; ato nuk mund të mohohen”, mirëpo “ka edhe diçka tjetër gjithashtu, që i bashkon këta popuj: një shtresë kulturore e përbashkët, një mbetje se pari bizantine dhe pastaj prej sundimit turk. Dhe poshtë kësaj shtrese gjendet poshtërimi i tërë popullsive që vuajtën nga këto” (Pipa, 2007: 137).

Një mendim të tillë e ka edhe J. Schmitt, që thotë se “historiografitë e ndryshme në Ballkan i shikojnë migrimet më së shumti si pjesë të konflikteve etnike” (Schmitt, 2012: 137). Kjo argumentohet edhe nga ana antropologjike e kulturore, ku thuajse të gjitha kulturat e etnive ballkanike edhe sot trashëgojnë ndërthurje mes vete, duke krijuar një zonë të veçantë të kësaj pjesë të Evropës, fatkeqësisht të njohur për temperamentin dhe mentalitetin konfliktuoz.

Pjesë e këtyre betejave etnike e nacionale ishte edhe shoqëria shqiptare. Betejat dhe ndikimet ishin më të mëdha, sidomos në ndarjen e një pjesë të madhe të territorit, duke mos lënë anash as edhe ndikimet kulturore. E përballur me këto, përfundimisht arriti që të ruaj gjenezën, ndonëse me vonesë, të ndërtojë institucionet e veta dhe të mos asimilohet sikundër edhe shumë popuj të tjerë. Të gjitha këto arriti t'i realizojë përmes ruajtjes së traditave dhe kulturës së përcjellë brez pas brezi, edhe pse vërtet Ballkani ishte bërë zonë e lëvizjeve të shumta nga grupe etnike, me tendenca për të shpallur veten autoktonë. Nga kohët e lashta e deri në vitet e fundit të shek. XX, edhe Kosova ishte në mesin e kësaj hapësire të migrimeve. Kështu, migrimet i kanë shndërruar shqiptarët qysh në mesjetë në një shoqëri trans-territoriale.

Kjo situatë kulture dhe mentaliteti ka reflektuar edhe më tepër kur pas shpalljes së shteteve dhe kombeve, vendimet politike të marra nga superfuqitë krijuan ndarje të kombeve duke krijuar edhe shtete artificiale, nga pasojat e të cilave veç i zhvilluan dy luftëra botërore dhe problemet tjera që ende vijojnë edhe në këtë fillimshekulli. Shoqëritë në botën e sotme dallojnë shumë dhe janë më ndryshe nga ato pararendëse, sidomos nga të ashtuquajturat ‘tradicionale’ që mbizotëruan botën deri rrëth 200 vite më parë. Të gjitha lëvizjet dhe proceset që evoluuan nëpër shoqëri, përveç që ndërhyjnë në kulturë tek njëra-tjetra, ato kanë shkaktuar edhe shkatërrimin e shumë kulturave të tjerave, që nga format më të thjeshta të asimilimit e deri në zhdukjen e plotë të tyre. Shumë nga lëvizjet demografike kanë qenë shkaktar të këtyre ndryshimeve në traditat kulturore. Pavarësisht se qenia njerëzore ka karakteristika të përbashkëta, pjesa më e madhe vjen nga vlerat kulturore dhe tradita e zakonet e shoqërisë, pjesë e së cilës është. Kështu, “traditat kulturore mund të ndryshojnë në idomat dhe metaforat e tyre kur flitet mbi kohën, hapësirën dhe shkakësinë; por përvoja jonë mbi to mund të jetë e strukturuar

thelbësishët nga aparaturat tonë perceptuale, konceptuale” (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 61).

Lidhur specifikat dhe lëvizjet demografike janë marrë e vazhdojnë të merren shumë studiues me qëllim të transmetimit të fenomeneve në shoqëri si dhe të parashikimit për të ardhmen. Për përcjelljen e këtyre ndryshimeve në shoqëri janë shumë të rëndësishme lëvizjet transformuese dhe reformuese, pasi që përmes tyre mund të kontrollohen prurjet e reja në shoqëritë moderne.

### **3.6 Ndikimi i faktorëve socialë; Rol i institucioneve sociale**

Në shoqëritë bashkëkohore veprojnë shumë lloje lëvizjesh sociale. Lëvizja sociale përben një përpjekje kolektive për shtytjen përpara të interesave të përbashkët nëpërmjet bashkëpunimit dhe veprimit jashtë institucioneve të vendosura. Sot përditshmëria jetësore varet dhe ndikohet nga ndryshimet që po përcjellin zhvillimet shoqërore të kohës. Ky dinamizëm ka depërtuar në të gjitha fushat e jetës dhe të organizimit shoqëror. Mirëpo, pavarësisht këtyre ndryshimeve, roli i institucioneve sociale është baza kryesore dhe jetike për njeriun. Janë pikërisht institucionet sociale përmes të cilave organizohet dhe sigurohetjeta nëpër breza si dhe marrëdhëniet shoqërore.

Një ndër institucionet më jetike për qenien njerëzore është *familja*. Rol i saj është i dyfishtë, sepse përmes saj sigurohet vazhdimësia nëpër breza dhe në anën tjetër pikërisht nga këtu merren hapat e parë të shoqërizimit. Gjatë etapave kohore edhe familja përjeton shumë ndryshime, qoftë nga forma dhe funksionet, qoftë nga përbërja dhe organizimi.

Mbështetur në këto procese transformuese, pra në mënyrat se si familja po ndryshon e zhvillohet, sidomos kohëve të fundit, duhet pranuar se ajo është një mjedis i favorshëm

transformimi dhe që ka rol thelbësor në kontributin e zhvillimeve që ndodhin në shoqëri. Kështu, “ndryshimet bashkëkohore janë të pranishme në çdo fushë jetësore, në mënyrën e jetesës dhe të organizimit familjar, ....., në doke e zakone, në jetën shoqërore, ....., si dje ashtu edhe sot” (Statovci, 1990: 21-22). Pra, derisa familja ekziston brenda rrymave të të gjitha shoqërive, ajo nuk mund të qëndrojë e pandryshuar përballë evoluimeve dhe ndryshimeve të tjera që ndodhin. Familja si institucion, si bashkësi shoqërore, si grup mikrosocial, është e ekspozuar ndaj ndikimeve, transformimeve dhe raporteve të ndryshme të shoqërisë globale. Ajo për çdo ditë në vendet e ndryshme të botës, përjeton risi dhe ndikime nga proceset dinamike, ekonomike, politike e sociale. Ndaj, bazuar në të dhënrat e literaturës sociologjike dhe kriminologjike, vërehet se familja patriarchale dalëngadalë po ia lëshon vardin familjes bashkëkohore.

Megjithatë, ky diversitet që krijohet me këtë rast, krijon kushte, mundësi dhe rrethana të favorshme edhe për devijime. Familja, si institucion i veçantë shoqëror, përherë ka pasur dhe ka funksione e detyra të shumëfishta në formimin, edukimin, ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet, e sidomos të fëmijëve dhe të rinjve. Andaj,

kur flitet për ndikimin e familjes dhe raporteve familjare në sjelljet kriminale të fëmijëve dhe të miturve nuk duhet veçuar familjen si të vetmin faktor të sjelljeve delekuente. Kjo për arsy se familja si njësi themelore e shoqërisë por si faktor kriminogen nuk mund të shikohet ndarazi dhe e izoluar nga ndikimi i faktorëve të tjerë në shoqëri (Latifi, 2008: 197)

Funksionet e familjes janë të shumta, ku, sipas autores Afërdita Deva-Zuma & bashkautorëve (Zuma-Deva & etj. 2009: 140), përveç funksionit të riprodhimit, në familje ekzistojnë edhe këto funksione:

- *Funksioni motivues* - të jetë i dashur dhe t'i dojë anëtarët e tjerë

- *Funksioni mbrojtës* - e bën të fuqishëm duke i ofruar mbështetje dhe mbrojtje
- *Funksion social* - të ruaj dhe të përmirësojë pozitën sociale të fëmijës
- *Funksion edukativ/pedagogjik* - nis ngajeta e re dhe zgjatë aq sa edhe ngajeta e njjeriut

Brenda një familjeje, gjithmonë përpinqet të ushtrohet ndikim për një edukatë sa më të lartë, megjithëse duhet pasur kujdes, sidomos ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve, ku nganjëherë iu imponohet të veprojnë kundër vullnetit dhe dëshirave të tyre. Kështu që, “funksioni edukativ i familjes ka qenë gjithmonë i pranishëm aty, që kur ka lindur familja dhe se do të mbetet në jetën e saj përgjithmonë” (Beqja, *vep. cit.*: 35).

**Shkolla** si institucion dhe si faktor mikrosocial ka rëndësi të madhe në formimin dhe ngritjen e gjithanshme të personalitetit të njjeriut (Halili, 2002: 272). Dihet se shkolla, menjëherë pas familjes, është institucioni më i fuqishëm në formimin dhe orientimin e të rinjve. Njerëzit nuk lindin të ditur, por ata mësojnë të sillen përmes një procesi të gjatë të të mësuarit. Arsimimi ka rëndësi jo vetëm për të ardhmen e të rinjve, pozitën sociale të tyre, por ai konsiderohet si mjet i mirë për të larguar të miturit nga rruga e krimtit. Lidhja mes arsimit dhe krimtit është një lidhje e studiuar prej kohësh. Shumë kriminologë kanë vënë re lidhjet mes nivelit të ulët arsimor dhe kriminalitetit. Edhe statistikat rrëth krimtit tradicional tregojnë një lidhje negative ndërmjet krimtit dhe shkallës së arsimimit. Në të gjitha vendet, të zhvilluara ose jo, është konstatuar se përfshirja në krim e njerëzve të arsimuar është në nivele më të ulëta se e atyre pa arsim apo me arsim të ulët. Mirëpo, kohët e fundit vihet re një rritje e numrit të personave me arsim të lartë në kriminalitet, kryesisht në atë të organizuar.

Sot shkolla mund të llogaritet si një institucion me një forcë shumë të madhe me ndikim, qoftë në edukim dhe kulturë, qoftë në zhvillimi e tërësishëm të jetës së njeriut dhe atë falë kontakteve që ka nga moshat e reja e deri në moshën e pjekurisë. Vetë atmosfera e krijuar në shkollë, përmes së cilës rrezatohet intelektualiteti, respekti ndaj shokëve e shoqeve, ndaj mësimdhënësit dhe stafit të shkollës, ndaj dijes dhe perspektivës së njeriut të shkolluar, shkëmbimi i debateve për tema brenda shkollës e deri te ato personale, prezenca e librit dhe e revistave të tjera, kyçja në internet për qëllime të shëndosha dhe përfundimisht dashurinë për ngritje intelektuale, duke i kuptuar anët pozitive dhe ato negative që sfidohen gjatë jetës në shoqëri, do të jetë shtytës për zhvillimin personal të fëmijës.

Duke iu referuar A. Deva-Zuma & bashkautorëve, rezulton se:

shkolla me klimë pozitive sociale të jetës, me kushtet dhe rrethanat e punës së klasës, njëkohësisht zhvillimi i ndjenjës së kolektivitetit, si ajo e përkatësisë, e besnikërisë, respektit, sakrificës etj., respektimi i rendit dhe rregullave ne shkollë, .... aftësimi për vendimmarje individuale dhe kolektive, angazhimi për të merituar dhe ruajtur vendin në grupin social shkollor, për t'i respektuar dhe përmirësuar normat morale, ....” (Zuma- Deva & etj. vep. cit.: 89-90)

Andaj, për këtë arsyen vlerësohet se shkolla konsiderohet si një nga faktorët më me rëndësi lidhur me socializimin e mirëfilltë.

**Mjedisi**- pas familjes dhe shkollës, njeriu, një kohë të gjatë të jetës e kalon në një mjedis shoqëror, në një lagje apo rrugë të caktuar. Në këtë ambient ai ndërton raporte të llojllojshme me fqinjë, me të afërm dhe me persona e individë të ndryshëm. Në pjesën më të madhe, këto kontakte janë të rëndomta, të përditshme e normale dhe paraqesin një gjendje të një komunikimi të zakonshëm të njerëzve. Mirëpo në jetën e përditshme, sidomos në qendra të mëdha, këto kontakte mund të jenë me persona të llojllojshëm dhe grupe të ndryshme, të cilët mund të jenë të prirur për sjellje kriminale e delikuente

(Halili, 2002: 275). Literatura kriminologjike flet për ndikim të madh në sjelljet devijante nga ana e mjedisit të caktuar shoqëror.

Që nga shek. XIX kriminologja ka bërë objekt studimi të saj lidhjet ndërmjet faktorëve të ndryshëm të mjedisit fizik dhe kriminalitetit (Hysi, *vep. cit.*: 211). Studimet e kryera kanë treguar se ekziston një lidhje mes mjedisit fizik dhe kriminalitetit, por që është e tërthortë. Nga kjo që u konstatua deri tani mund të konkludohet se mjedisi i caktuar shoqëror, rruga, lagja, faktorët mikrosocialë, si mund të ndikojnë në paraqitjen e disa sjelljeve delikuente dhe kriminale, mirëpo, këtu duhet të bëhet një ndarje e qartë në mes të ambientit të rrugës, lagjes, si faktorë që u kontribuojnë sjelljeve të caktuara kriminale dhe rr Ethanave kushteve tjera objektive dhe subjektive që ndërlidhen me këta faktorë.

**Media** - zhvillimi i teknologjisë ka anën e vet pozitive, gjithmonë kur ai nga të rinjtë shfrytëzohet për gjëra përfitimi nga cilado sferë e zhvillimit dhe emancipimit, ngritjes edukative e profesionale e deri te hulumtimet shkencore dhe njohja me botën. Përmes këtij zhvillimi të teknologjisë, sot bota është shumë e vogël. Kjo lidhje është në qendër të diskutimeve të kriminologëve dhe të sociologëve. Pjesa më e madhe e tyre pranojnë ekzistencën e një lidhjeje të medias me sjelljet devijante, ndërsa disa studiues të tjerë dhe një pjesë e punonjësve të medias e kundërshtojnë atë. Nuk është fjala vetëm për median elektronike, por edhe për atë të shkruar.

“Nga ana tjetër, nëse u referohemi statistikave rreth krimtit, shumë studime kanë treguar se media elektronike po shfrytëzohet për të realizuar forma të ndryshme të krimtit” (Hysi, *vep. cit.*: 227). Kjo dëshmohet me hapësirën për hapjen e faqeve për pornografi, për tregun e seksit, për të shfaqur dhunë ndaj tjerëve, për aktivitete në lidhje me

terrorizmin, për thirrje e organizime të aktiviteteve kriminale, për propaganda në interes të grupeve të ndryshme, etj.

Ndër akterët mediatik që ndikojnë te moshat e reja janë televizioni, interneti, lojërat e ndryshme kompjuterike, sateliti, videot dhe forma të tjera të teknologjisë moderne, ku fëmijët, që nga mosha kur fillojnë të marrin veten, do të përballen së paku me ndonjëren prej tyre, qoftë duke iu ofruar nga prindërit apo edhe duke i përzgjedhur vetë. Sidomos në kohën e globalizmit, në vende të pazhvilluara dhe në ato në zhvillim, mediat shumë herë transmetojnë programe të pakontrolluara, që janë larg realitetit kulturor të shoqërisë dhe normave e ligjeve të saj. Programet edukative, arsimore, kulturore e shkencore, shumë më të rëndësishme për formimin intelektual të moshave të reja, të domosdoshme për të qenë të pranishme në transmetimet mediatike, mungojnë në masë të madhe.

Andaj, derisa media shërben si pjesë edukative për të rinjtë, përmes saj kërkohet të plasohen gjëra që do ndihmojnë në avancimin e të rinjve dhe përgatitjen e tyre për pjesëmarrje aktive në shoqëri dhe zhvillimin e saj. Në të kundërtën, kjo do të jetë një bazë shumë e fortë për krijimin e sjelljeve devijante tek të miturit, madje jo vetëm në thyerjen e normave shoqërore, por dhe në shkeljet ligjore deri te krimet më të rënda. Që të mos vihet deri te këto sjellje devijante, nuk guxon të mungojë kujdesi familjar përfëmijët dhe të miturit e deri te kontrolli i shtetit.

### **3.7. Ndërveprimi i faktorëve institucionalë**

Rendet e reja shoqërore që po zhvillohen kohëve të fundit, sidomos në vendet tranzitore, synojnë krijimin e shoqërive moderne demokratike, duke sjellë riorganizim shoqëror. Andaj,

është e rëndësishme të theksohet se çdo shtet i organizuar formëson dhe zhvillon një sërë politikash, si: ekonomike, të jashtme, të mbrojtjes, sociale, shëndetësore, ekologjike, energetike, kulturore, arsimore etj. Të gjitha këto kanë ndikimin e tyre përkatës në gjendjen e sigurisë (Masllesha, 2006: 4)

Për realizimin e këtyre politikave është i pashmangshëm bashkëpunimi i faktorëve të të gjitha institucioneve, të cilat bashkë me strategjinë duhet të përshtaten me nivelin e sfidave dhe kërkesave të civilizimit bashkëkohor dhe rrethanat reale ekzistuese.

Të gjitha avancimet e kohës kërkojnë koordinim të të gjithë faktorëve institucional, sidomos në politikat e sigurisë, pasi që siguria mbetet bazë për zhvillimin e të gjitha politikave tjera për zhvillimet e jetës shoqërore. Janë pikërisht zhvillimet globale që R. Masllesha rreth fushës së sigurisë vlerëson me sa vijon:

Lëkundjet e mëdha në marrëdhënet midis shteteve dhe organizimet transnacionale gjithnjë e më të pranishme në hapësira të ndryshme, konfliktet ndërkombëtare si edhe vështirësitë e mëdha në parandalimin dhe menaxhimin e krizave të ndryshme, kërkojnë nga organet përkatëse të sigurisë që, në bazë të objektivave të sigurisë globale, të ndërmarrin masat dhe aktivitetet më efikase, të cilat përdoren në mënyrë të törësishme e të gërshetuar luftojnë kërkesat dhe interesat individuale, grupore e të tjera të vihen në shërbim të përbashkëta që kanë rëndësi vendimtare për sigurinë nacionale (Masllesha, *vep. cit.*: 4)

Ndryshimet globale në shoqëri, posaçërisht në aspektin e teknologjisë, kanë sjellë pasiguri që nga niveli lokal e deri te konfliktet me përmasa ndërkombëtare. Kjo pasiguri cenon të drejtat më të thjeshta të individit e deri tekjeta dhe prona e tyre. E gjithë kjo vjen nga disa faktorë që mund të shkaktojnë këtë paqëndrueshmëri. Sipas B. Gashi dhe B. Avdiaj, në botën bashkëkohore siguria e brendshme nuk është vetëm përgjegjësi dhe nuk mund të arrihet vetëm nga organet kompetente, por duhet të angazhohen edhe institucionë dhe organizata tjera si dhe vet qytetarët (Gashi & Avdiaj, 2012: 93).

Secili vend duhet të hartojë strategjinë e përgjithshme rrith sigurisë shoqërore. Strategjia duhet të përfshijë të gjithë faktorët institucional, duke filluar nga niveli

qeveritar e deri te niveli lokal. Në këtë strategji, patjetër që pjesëmarrës me rol tejet të rëndësishëm janë edhe organizimet në formë të klubeve, grupeve shoqërore, organizataave rimore, atyre joqeveritare, rrjeteve e deri tek individët. Andaj, “faktori vendimtar në shkatërrimin dhe eliminimin e të gjitha burimeve të pasigurisë është reaksiuni i shoqërisë në tërësi dhe jo vetëm i organeve shtetërore që merren më këtë problematikë” (Masllesha, *vep. cit.*: 7). Kështu që pasigurinë duhet trajtuar në aspektin shoqëror dhe jo vetëm në atë juridik.

Me qëllim të realizimit të kësaj strategjie, secili vend duhet të koordinojë aktivitetet duke nisur nga qeveria, përmes ministrive, duke zbritur nivelin në atë të rajonit e deri në lokal. Një nga ministritë përgjegjëse në këtë drejtim mbetet Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të së cilës vepron edhe organizimi i policisë së shtetit. Detyrat e saj, ndër tjera, janë ruajtja e jetës dhe pronës si dhe garantimi i ushtrimit të të drejtave dhe lirive të qytetarëve. Për një funksionim të mirëfilltë në këtë drejtim dhe realizimin e tërësishëm të qëllimeve dhe detyrave, institucioni i policisë, domosdø duhet të koordinojë aktivitetin e vet edhe me institucione tjera. Ndër më të rëndësishmet mbetet institacioni i drejtësisë, i cili ka rol kyç në fushën e sigurisë. Kjo vazhdon edhe me institucionet e nivelit lokal të emëruara nga komunat. Arsyen e kësaj e paraqet edhe R. Masllesha, që thotë se:

Është plotësish e qartë se kundërvënia kriminalitetit, sidomos ajo preventive, duhet të ketë themel të konceptit programor faktin se kriminaliteti nuk mund të vështrohet edhe më tutje si problem që ka të bëjë me sjelljen e individit apo të grupit kriminal, por si problem që ka të bëjë me shoqërinë globale. Sot është gjithnjë e më i pranueshëm koncepti mbi kriminalizimin e shoqërisë. Ky nuk është rezultat i ndonjë qasje të re teorike ose ndonjë koncepti të ri kriminalistiko-politik, por pasojë e faktit real se kriminaliteti po përfshin pothuaj të gjitha fushat e jetës, përkatësisht shoqërinë në tërësi (Masllesha, *vep. cit.*: 28)

Përfundimisht, do mbetet si proces i domosdoshëm koordinimit të faktorëve institucional nga niveli lokal e deri në nivel vendi, për përcjelljen e zhvillimeve të shoqërisë pa e cenuar sigurinë e tyre.

### **3.8 Format e kriminalitetit dhe reagimi i shoqërisë ndër shekuj**

Krimi dhe kriminaliteti paraqesin veprime dhe dukuri negative të dëmshme e shumë të rrezikshme për shoqérinë. Prania e tyre ka reflektuar në të gjitha shoqëritë e kohës nëpër histori. Mënyra dhe forma e paraqitjes së tyre ishin pjesë e diktimeve dhe rrethanave të kohës. Kështu që, shoqëria njerëzore, që nga lindja e saj, është përballur dhe vazhdon të sfidohet nga aktivitetet kriminale. Pra, që nga periudha e shoqërisë së parë njerëzore, që karakterizohet si shoqëri pa klasa, e shfaqur me formimin e njeriut, e cila zgjat deri me paraqitjen e shteteve të para, kanë filluar të ndodhnin eksese që i cenonin rregullat e jetës shoqërore të bazuara në të drejtën zakonore.

Ky ‘shoqërues’ i qenies njerëzore ka vazhduar rrugëtimin e tij të pandërprerë, duke u rritur e zhvilluar bashkë me shoqërinë njerëzore. Nuk mund të gjendet etapë apo periudhë historike pa këto veprime dhe dukuri. E njëjta vazhdon edhe në ditët e sotme, në të gjitha sistemet e organizimeve shoqërore, bile me një rrezikshmëri të madhe, që nuk ka ekzistuar deri me tani. Krimi dhe kriminaliteti, si përcjellës ‘besnik’ i njeriut paraqesin një dukuri shumë komplekse.

Me qëllim të mbrojtjes nga kjo dukuri, është dashur të reagohet ndaj personave që i kryenin ato. Edhe mënyra e reagimit ka qenë bazuar në zhvillimet shoqërore. Që nga kohërat më të lashta, individët apo grupet shoqërore janë angazhuar për mbrojtjen dhe pengimin e kriminalitetit dhe sjelljeve të tjera që paraqitnin rrezik për shoqërinë. Fillimisht këtë reagim e ushtronte familja apo fisi me qëllim të mbrojtjes. Ky reagim ka

pasur karakter të mbrojtjes shoqërore, sepse me këtë është siguruar ekzistенca e bashkësisë në tërësi. Me zhvillimin e shoqërisë, zhvillohen edhe aktivitetet që cenojnë normat juridike dhe shoqërore, prishin rendin dhe qetësinë e deri te ato që paraqesin rrezik për jetën dhe për pronën. Pikërisht këto kanë shtyrë në reagim për t'u vetëmbrojtur nga sjellje e veprime të tillë. Kështu që, “nëpërmes reagimeve të tillë, shoqëria, grupi, klani dhe familja, ka synuar të mbrohet nga sulmet e tillë dhe të pengojë aktivitetin e rrezikshëm për interesat e tyre” (Halili, 2009: 29).

Fenomeni i kriminalitetit është një çështje që ka provokuar dhe që i ka shtyrë shumë studiues të merren me të, derisa “është dukuri negative konstante e cila e ka përcjellur shoqërinë njerëzore që nga bashkësia e parë primitive deri në ditët e sotme” (Hajdari, 2004: 189). Duke qenë se kjo dukuri daton nga lashtësia dhe në përcjellje të pandërprerë është shoqëruar me krimin edhe shpjegimet e para lidhur me këtë kanë qenë shumë të mangëta dhe të pakompletuara. Sipas R. Halilit, ato paraqiteshin përmes disa punimeve jo të kompletuara, pra që ishin të ndara dhe copëtuara, ku ishin dalluar autorët gjermanë dhe austriakë (Halili, 1995: 71; Hajdari, 2004: 79). Kjo ka shtyrë që gjithmonë të punohet në gjetjen e shkaktarëve dhe luftimin e tyre.

Dukuria negative e kriminalitetit ka qenë dhe vazhdon të jetë aktuale edhe sot e kësaj dite. Lidhur me këtë vazhdojnë edhe analizat dhe studimet e shumta, sidomos nga fusha penale dhe ajo kriminologjike. Gjatë trajtesave të shumta në këtë drejtim, janë përfituar edhe terminologji të ndryshme në aspektin juridik. Bazuar në gjuhët anglo-saksone reflekton si kriminalitet ‘violent’, në ato franceze si krim i dhunës, e tek ato gjermane si delikt agresioni (Kuliqi, 2003).

Ajo që mbetet e rëndësishme është se trendi i krimit dhe kriminalitetit janë në rritje thuaçse në të gjitha shoqëritë e botës. Përkundër përpjekjeve të shumta që po bëhen nga ekspertët dhe shkencat e ndryshme të kësaj fushe lidhur me gjetjen e shkaçeve dhe masat e nevojshme për ta zbutur sado pak këtë, kjo ka mbetur vetëm një tentim me shpresë që të realizohet. Sidomos kohëve të fundit të këtij fillim shekulli, prirja e krimeve ka sjellë shumë forma të reja dhe të rrezikshme për njerëzimin. Këto forma dalin të jenë vdekjeprurëse, sepse vet teknologja që përdoret nga akterët e krimeve është shumë e sofistikuar dhe përfshinë përmasa shkatërruese, qoftë ndaj pronës, qoftë në jetën e njerëzve, duke shkaktuar viktima të panumërtë. Kjo nuk e përjashton nivelin e krimit në mënyrë barbare që ka ekzistuar që nga lashtësia, por në botën bashkëkohore përmasat e viktimave janë marramendëse.

Sa është krimi aktual dhe me pasoja të shumta e dëshmojnë edhe mjetet e informacioneve të ndryshme, qoftë në të shkruar, qoftë ato audio-vizuele. Thuaçse nuk ka emision të informacionit që nuk paraqet lajme për ndonjë krim që ka ndodhur, duke përfshirë krimet e nivelit lokal e deri te ato ndërkombëtare, nga krimet më të ‘lehta’ e deri te ato terroriste. Këtë V. Hysi e shpreh kështu:

Mjafton të sjellim në vëmendjen tonë informacionet që përcjellin emisionet e lajmeve apo faqet e gazetave për ngjarje të ndryshme, si: vjedhje, vrasje, droga trafikime të njerëzve, njerëz që ndihen të frikësuar nga krimi, aksione të policisë etj. Shoqëria e sotme është e mbushur edhe ngjarje tjera shumë të dhimbshme dhe me pasoja të rënda ..... Aktet terroristë dhe luftërat shkaktojnë viktima të pafajshme në radhët e njerëzve. Të gjitha këto, pavarësisht se ku ndodhin dhe kush është autor, kanë të përbashkët atë që quhet krim apo akt kriminal (Hysi, *vep. cit.: 1*).

Vërtetë këto e kanë sjellë në sfidë shoqërinë njerëzore, duke krijuar frikë dhe pasiguri për secilin njeri. Krimi është dukuri e dëmshme që rrezikon e dëmon ton vlerat shoqërore e individuale, “dhe të bashkësisë, e kësisoj rrezikon edhe rregullimin juridik të përcaktuar me kushtetutë” (Sahiti, 1996: 37).

Nëpërmjet hulumtimeve, studimeve dhe analizave e shpjegimeve etiologjike bëhen përpjekje të nxirren përfundime dhe të gjenden faktorët themelorë të cilët ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit, si dhe të gjenden zgjidhjet adekuate të mjeteve dhe metodave për luftimin dhe pengimin e tij (Hysi, *vep. cit.*: 76). Në botën e sotme krimi dhe kriminaliteti nuk mund të ndërlidhen me sjelljen e individit apo të grüpuit kriminal të izoluar në një vend apo shoqëri, por si një problem shumë shqetësues që ka të bëjë me shoqërinë globale. Rrethanat reale dhe përfshirja thuajse në të çdo pore të jetës nga kriminaliteti, të shpijnë në konceptin mbi ‘kriminalizimin’ e shoqërisë. Kështu që, kjo problematikë e tejkalon problemin juridik, pasi që veç e ka ngulfatur tërë shoqërinë, duke mos kursyer as edhe rrethin e afërm familjar.

Nga kohët më të vjetra shoqëria është mbrojtur nga kriminaliteti me aprovimin e ligjeve shtypëse. Format e reagimit që nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme kanë shkuar duke u zhvilluar dhe përsosur në favor të çështjes humane. Në këtë drejtim sot kemi transformime rrënjosore. Lidhur me këtë janë shprehur edhe autorët Korajlic dhe Muharremi, sipas të cilëve:

Me qëllim që të sigurohet mbrojtje efikase e vlerave themelore të rëndësishme për ekzistencën e bashkësisë shoqërore, në secilën shoqëri shfrytëzohen forma dhe mekanizma të shumta të reagimit në sjelljet e papranueshme. Shoqëritë bashkëkohore karakterizohen me reagimet e shumëllojshme, formale në aktivitetet e rezikshme shoqërore. Ato në mes tjerash përfshijnë rregullativën precize ligjore me të cilën përcaktohet vëllimi i zonës dhe ashpërsia e reagimit dënuar në aktivitetet e papranueshme shoqërore (Korajlic & Muharremi 2009: 17)

Pikërisht në këtë drejtim, vëmendje e veçantë i është kushtuar familjes. Sipas N. Bardhoshit, disa nga arsyet janë:

Së pari, sepse vet banorët që kemi studiuar e vendosin familjen si institucionin më të rëndësishëm social. Së dyti, familja është mjedisi social ku njeriu lind dhe në të cilin “mëson kulturën”. Së treti, në kuadrin e “mësimit të kulturës” në familje njeriu mëson atë se çfarë është e drejtë dhe e padrejtë. Së katërti, prej strukturës së familjes përcaktohet

përcjellja ose jo e një tradite të caktuar dhe se si negociohen dijet e reja, përfshi ato mbi pronën, ligjin, moralin, religionin, shtetin e me radhë (Bardhoshi, *vep. cit.*: 19)

### 3.8.1 Mendimet dhe teoritë mbi kriminalitetin

Dukuria e kriminalitetit ka rrënë që në lashtësi, duke e përcjellë shoqërinë njerëzore pandërprerë. Kriminaliteti, si dukuri e dëmshme dhe e rrezikshme për shoqërinë, ka qenë në qendër të vëmendjes së shumë filozofëve dhe shkencëtarëve prej kohësh. Lidur me këtë dukuri dhe shkaqet e paraqitjes së tij, fillohet që nga pikëpamjet antike të filozofëve të lashtë grekë (Halili, 2002: 69), edhe pse ka pasur mendime edhe me herët, për të vazhduar deri në ditët e sotme. Lidur me kriminalitetin janë dhënë mendime dhe teori të shumta dhe të ndryshme nga studiues me nam që nga koha antike, të cilat vazhdojnë deri në ditët e sotme. Studiuesit e ndryshëm kanë dhënë edhe përkufizime nga më të ndryshmet, deri tek ato të përafërtat. Këtë e thotë edhe I. Salihu, sipas të cilës “edhe pse ata pajtohen në përkufizimin e përgjithshëm të fenomenologjisë, midis tyre ekzistojnë disa dallime” (Salihu, 1985: 125).

Për kriminalitetin janë dhënë mendime dhe ide që nga koha antike. Platoni vlerëson se ndikimi i instinktit dhe shpirtit të sëmurë sjellin emocione dhe epshe të fuqishme të individët e caktuar, të cilët kryejnë krime. Bazuar në këtë, ky shkon aq larg, sa një parandalim i dukurive kriminale mund të bëhet vetëm nëse do të depërtohet përmes anës së brendshme psikologjike, dhe si ndihmesë i vlerëson edhe disa nga faktorët e jashtëm. Lidur me angazhimin e tij në këtë fushë, ka arritur të nxjerrë edhe librin “Ligjet”, përmes së cilës kërkohet që me rastin e dënimive të merren parasysh të gjitha rrethanat në të cilat ka qenë autori në kohën e kryerjes së veprës. Më këtë edhe fillohet që krimi të trajtohet si veprintari individuale. Po ashtu, edhe Aristoteli e ka trajtuar krimin, duke vlerësuar se në këtë drejtim luan rol edhe vet mënyra e organizimit të shoqërisë.

Lidhur me kriminalitetin, ndër shumë studiues, vlerësimet e veta kanë dhënë edhe J. Pinatel, sipas të cilit fenomenologja kriminale studion format e jashtme të sjelljes kriminale dhe mënyrën e jetës së delikuentëve (Pinatel, 1979: 9-10; Halili, 2008: 115). Ndërsa, autori Milutinoviq vlerëson se fenomenologjia, ndër tjera, duhet të merret edhe me përshkrimin e mënyrës së kryerjes së krimeve të ndryshme, me studimin dhe njohjen e personalitetit dhe të jetës si dhe me tipologjinë dhe klasifikimin e kriminelëve (Milutinoviq, 1982: 193; Halili, 2008: 115).

Bazuar në mendimet dhe literaturën kriminologjike, shumë kohë ka qëndruar mendimi se me kriminalitet merren vetëm shtresat e paqëndrueshme dhe me gjendje jo të mirë ekonomike. Mirëpo kjo teori hidhet poshtë, sepse kohëve të fundit në kriminalitet janë të përfshirë edhe individë nga shtresat më të larta shoqërore dhe me kushte të mira ekonomike. Sot kriminaliteti nuk njeh kufij as në gjini, as në mosha dhe as në ndarjet klasore të shoqërisë. Megjithatë, llojet e krimít dallojnë, dhe atë pikërisht nga mosha, gjinia, shtresa dhe personaliteti.

Mendimet dhe teoritë lidhur me luftimin dhe parandalimin e krimít kanë ‘lëvizur’ përgjatë zhvillimeve shoqërore nëpër histori. Sipas teorisë antropologjike, paraqitja e krimít ndërlidhet me pjesën anatomike e biologjike. Ndërsa ta është i njohur edhe Qesaro Lambrozo, sipas të cilit kriminelët ‘lindin’, duke u munduar t’i shpjegojë përmes disa karakteristikave. Lambrozo, njihet për ndarjen e tipave të kriminelëve të lindur, që sipas tij janë: “kriminelë të lindur, të sëmurë në pikëpamje shpirtërore, nga pasionet, të shprehive dhe të rastit” (Halili, 2008: 78). Ndërsa nxënësi i Lambrozos, Enriko Feri, mendon se kriminaliteti vjen si shkak i disa faktorëve, ndër të cilët: antropologjik, social dhe fizik. Kështu që, kryesisht veprimet kriminale rezultojnë nga ndikimet antropologjike e sociale (Shepareviq, 1982: 27-28). Një nga mendimtarët që shtjelloi

këtë dukuri ishte edhe Zhan Zhak Russo, i cili thekson se “shkaqet e kriminalitetit dhe mënyrat e pengimit të tij gjenden në kushtet dhe rrethanat shoqërore të kryesve te veprave penale”. Sipas tij, “njjeriu nuk lind i tillë, atë e shtyn që të merret me veprime dhe sjellje kriminale shoqëria dhe ambienti shoqëror, kushtet dhe rrethanat sociale e politike” (Halili, 2002: 74).

Nga ana tjetër, duke u bazuar në mendimet e kohërave të ndryshme, vijmë në përfundime se teoritë sociologjike nuk janë unike. R. Halili vlerëson se “karakteristikë e përbashkët e të gjitha këtyre pikëpamjeve dhe mendimeve, është fakti se këto në qendër të vëmendjes e vejnë përcaktimin shoqëror e social të sjelljes kriminale” (Halili, 2008: 94). Kështu, Gabriel Tad, i njohur për kundërshtimin e teorisë së Lambrozos, jep pikëpamjen e tij për kriminalitetin, duke thënë se shkaku kryesor i paraqitjes së tij janë “rrethanat sociale dhe problemet e adaptimit në kushtet ekzistuese të jetës”, ku thekson “procesin e imitimit dhe mësimit të sjelljeve dhe veprimeve kriminale” (Halili, 2008: 95). Prandaj, ata shumë herë në shoqëri luajnë rolin e “shembujve, modeleve, idhujve, idoleve, rasteve, ngjarjeve dhe dukurive që ndodhin dhe të cilat në raste të caktuara lënë përshtypje të thella te delikuentë të caktuar” (Halili, 2008: 95; Schwind, 94-95).

Krahas zhvillimeve shoqërore dalin edhe teori të reja sociologjike lidhur me trajtimin e shkaqeve të kriminalitetit. Ndër to duhet veçuar ato amerikane, të cilat jasin pikëpamjet e tyre rrëth arsyeve të paraqitjes së kriminalitetit si dhe masave që duhet ndërmarrë për të parandaluar atë. Sipas këtyre, janë të shumta arsyet që shkaktojnë dukuritë kriminale në shoqëri, si: a) ndarja e grupeve, qoftë religjioze, kulturore, etnike, politike etj; b) çrrëgullimi i rendit shoqëror – kur në një shoqëri nuk funksionojnë segmentet e duhura jetësore e deri te gjendja e anomisë. Prandaj, “secila prej teorive që kemi parë

kontribuon në kuptimin ose të disa aspekteve ose të disa llojeve të krimít” (Giddens, *vep. cit.*: 137).

Edhe sipas A. Hajdari, “zbulimi, luftimi dhe evitimi i kriminalitetit, si një dukuri e dëmshme shoqërore, nuk mund të realizohet me sukses pa njohjen e shkaqeve dhe kushteve që e determinojnë paraqitjen e tij” (Hajdari, 2004: 158). Prandaj, një ndër masat kryesore pér luftimin e dukurive kriminale është identifikimi i faktorëve që nxitin individët në kriminalitet. Këtë e paraqet edhe Kupçeviq-Mlađenoviq R., sipas të cilit

nëpërmjet hulumtimeve, studimeve dhe analizave e shpjegimeve etiologjike mund të nxirren konkludime dhe të gjenden faktorët themelorë të cilët ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit, si dhe të gjenden zgjidhjet adekuate të mjeteve dhe metodave pér luftimin dhe pengimin e tij (Kupçeviq-Mlađenoviq, 1975: 121-122)

Çështjen e identifikimit dhe të parandalimit e trajton edhe Vesel Latifit, sipas të cilit “sistemi i parandalimit shoqëror duhet të ketë mbështetje shkencore dhe duhet të fillojë nga analizat shkencore dhe nga përpunimi i masave pér sendërtimin e determinantave sociale të dukurive antishoqërore e sidomos të sjelljeve të inkriminuara” (Latifi, 2008: 179).

### **3.8.2 Shpjegimi i natyrës shumëdimensionale të krimít**

Në ditët e sotme trendi i zhvillimeve shoqërore vetëm sa e ka shtuar ndërlikueshmërinë. Sidomos kur këto paraqesin gërshetimin e së kaluarës, së sotmes dhe së ardhmes. Ky kompleksitet shtohet edhe më shumë kur dihet se zhvillimet e fundit botën e kanë afruar si një ‘fshat global’ dhe ku arsyet pér ndërtimin e raporteve shoqërore anë e kënd botës me qëllim të plotësimit të nevojave jetësore janë të domosdoshme. Domosdo që kjo lidhje do të krijojë marrëdhëni shoqërore dhe se në një apo mënyrë tjetër, drejtpërdrejt

apo indirekt do të ketë ndikim duke filluar nga individi, grupi dhe deri te shoqëria në tërësi.

Këtë e forcojnë edhe më tej, sidomos evoluimet e fuqishme që përjetuan dhe po përjetojnë vendet në tranzicion, me ç'rast shkaktuan ‘tërmete’ në të gjitha sferat shoqërore, duke mos kursyer në asnje rast vlerat njerëzore. Kështu, këto trende të zhvillimit global, përmes disa rasteve devijuese kanë ardhur deri te një gjendje ku mohohen tërësisht të gjitha normat shoqërore ekzistuese, duke kaluar në kulturat tjera, me të vetmin qëllim që të ndryshojnë nga tjerët. Këto shumë herë sjellin konflikte shoqërore, madje deri te krimi dhe dukuritë kriminale. Madje, natyra e këtyre dukurive kriminale në ditët e sotme po sjellë dëme të mëdha në shoqëri, ndoshta edhe duke tejkaluar dëmet e luftërave. Si të tilla mund të vlerësohen narkomania, prostitucioni dhe trafikimi me njerëz, dhuna në familje etj, pasojat e të cilave jo vetëm që reflektojnë brenda familjes por edhe në shoqëri dhe më gjërë.

Që nga krijimi i shoqërisë së parë njerëzore e deri në ditët e sotme, krimi dhe kriminaliteti vazhdojnë ta përcjellin shoqërinë. Sjelljet devijante dhe reagimi ndaj tyre ndryshon nga shoqëria në shoqëri si dhe nga koha në kohë. Deri tani janë bërë shumë studime lidhur me shtytjen e individëve në sjellje të tillë, duke i shkelur normat dhe ligjet e asaj shoqërie, ku sipas shpjegimit sociologjik këto devijanca mësohen gjatë jetës në shoqëri. Kështu, sipas autorëve Keesing dhe Strathern,

në shumë shoqëri, vendi i një njeriu në skemën e gjërave ka qenë strukturuar nga rrethanat e lindjes. Lindja nga prindër të caktuar përcakton anëtarësinë në një grup, të vendos në një rrjet obligimesh dhe bashkëpunimi brenda të cilëve do të jetosh jetën tënde, që nga lindja deri në vdekje (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 174)

Shoqëria njerëzore që nga lindja e saj është përballur dhe vazhdon të sfidohet nga ndryshime, ku shumë herë janë ballafaquar edhe me shkelje të rregullave, normave dhe ligjeve ekzistuese. Pra, që nga periudha e shoqërisë së parë njerëzore kanë filluar të ndodhnin eksese që i cenonin rregullat e jetës shoqërore të bazuara në të drejtën zakonore. Me qëllim të mbrojtjes nga këto aktivitete është dashur të reagohet ndaj personave që i kryenin ato. Këtë reagim e ushtronte familja apo fisi me qëllim të mbrojtjes. Për këtë, fenomeni i kriminalitetit është një çështje që ka provokuar dhe që i ka shtyrë shumë studiues të merren me të, “është dukuri negative konstante e cila e ka përcjellur shoqërinë njerëzore që nga bashkësia e parë primitive deri në ditët e sotme” (Hajdari, 2004: 189). Pra, është dukuri e dëmshme që rrezikon e dëmton vlerat shoqërore e individuale, “dhe të bashkësisë, e kësisoj rrezikon edhe rregullimin juridik të përcaktuar me kushtetutë” (Sahiti, *vep. cit.*: 37).

Madje, sipas V. Hysit, në trendin e këtyre zhvillimeve ekonomiko-shoqërore si dhe rrethanat e krijuara kushdo mund të viktinizohet. Pra,

Me një problematikë të sjelljeve dhe veprimeve kriminale sot secili njeri mund të jetë viktimë në një apo formë tjetër. Pra, krimi nuk njeh ngjyrë, ai godet si njerëzit e shtresave të ulëta, ashtu edhe të larta, si femra edhe meshkujt, pavarësisht nga mosha, pozita sociale, vendbanimi, kombësia etj. Krimi nuk ndodh vetëm mes njerëzve që nuk e duan njëri tjetrin, por edhe mes anëtarëve të familjes, mes gruas dhe burrit, prindit dhe fëmijës, pra mes njerëzve më të dashur që pak më parë ndanin të gjitha së bashku (Hysi, *vep. cit.*: 2)

Në anën tjetër, sipas literaturës kriminologjike vlerësohet se rol të madh në paraqitjen e krimít dhe kriminalitetit luan edhe vet mjedisi shoqëror. Këtu theksohet më shumë roli i faktorëve social në krahasim me ata ekonomikë dhe nënvlefëson aspektet individuale të krimít, veçanërisht personalitetin e autorit të krimít. Kësisoj:

Kriminaliteti, si dukuri e dëmshme dhe e rrezikshme shoqërore, që nga kohërat e lashta ka zgjuar interesim në qarqet e ndryshme shoqërore. Qysh herët janë bërë përpjekje për ta shpjeguar atë, sidomos shkaqet dhe natyrën e tij. Gjithashtu, që nga kohërat më të hershme

janë paraqitur ide dhe mendime për mënyrat e pengimit dhe luftimit të tij në shoqëri të ndryshme (Halili, 2008: 69; Ponti, 33-34)

Fillimisht është pretenduar se krimi ishte i ndikuar nga fuqia mbinatyrore e mbinjerëzore si dhe ndikime tjera që nuk kanë mundur të vërehen nga njeriu. Kjo, sipas R. Halilit, ndërlidhej me nivelin e kulturës dhe zhvillimeve të asaj kohe, andaj edhe shpjegimet rreth krimit nuk kanë qenë gjithmonë të sakta (Halili, 2008: 69). Tashmë dihet se bashkësitë e para ishin primitive dhe se janë mbështetur në normat e pashkruara, por që megjithatë ato janë respektuar nga qytetarët, dhe se për shkelje të tyre edhe janë ndëshkuar.

Ndërsa gjatë mesjetës, në shoqëri ka mbizotëruar feja dhe thuajse të gjitha organizimet jetësore iu kanë përbajtur dogmave fetare. Pra, kjo kohë është e njohur për ndalimin e shfaqjes së interesimeve për hulumtime, ndër të cilat edhe nga aspekti i kriminalitetit. Bashkësitë më primitive me autoritet shtetëror kanë qenë homogjene. Ato mbështeteshin në normat e pashkruara shoqërore, shpeshherë të rrënjosura në vetëdijen e njerëzve, prandaj i respektonin të gjithë pjesëtarët e shoqërisë.

Megjithatë, mendimet mesjetare fillojnë të sulmohen nga filozofët e kohës, duke pretenduar për një reformë në këtë drejtim, me theks të posaçëm në trajtime njerëzore dhe jo barbare. Pikëpamjet e disa filozofëve ishin kontradiktore, edhe pse mendonin për reformime. Disa nga filozofët vlerësonin se individi lind si kriminal, disa mendonin se atë e shtyn shoqëria dhe rrethanat shoqërore në aktivitete kriminale.

Kështu që, duke iu referuar autorëve të kësaj periudhe, ata vënë në pah dhe insistojnë në nevojën për ndryshim, qoftë në hulumtimin e shkaktarëve të paraqitjes së kriminalitetit, qoftë në politikat e ndëshkimit. Nisën edhe botimet e para në këtë drejtim nga shumë

filozofë, thuajse të gjitha me tematikën rreth kriminalitetit dhe ndëshkimeve që duheshin bërë. Sipas Stefën Braun, “autorët e kësaj periudhe, veçmas insistojnë në reformën e sistemit të ndëshkimit dhe në eliminimin e dënimive trupore, dënimive barbare, e sidomos në eliminimin e aplikimit të torturës dhe inkvizicionit” (Halili, 2008: 73; Stephan Brown etj. 212-214).

Zhvillimet e kohës së industrializimit dhe të kohës moderne sjellin shumë ndryshime edhe në sferën e kriminalitetit, duke krijuar një pasiguri shoqërore. Përkundër përparimeve në teknologji, e cila mundësoi tejkalimin e disa rreziqeve të deriatëhershme, tanj paraqiten rreziqe të sotme, pikërisht nga faktori njeri. Një trajtim të kriminalitetit e kishte bërë edhe R. Merton, duke e ndërlidhur me disa sjellje devijuese dhe atë pikërisht përmes konceptit të anomisë së E. Durkheimit. Modifikimin e këtij koncepti e bazon në gjendjen shqetësuese të individëve dhe grupeve, gjë që dominon në sjelljen derisa normat e pranuara nuk përputhen me realitetin shoqëror (Giddens, *vep. cit.*).

Të gjitha këto tregojnë se çështja e kriminalitetit ka qenë temë nga shumë autorë e studiues që nga kohët e hershme, duke u përpjekur për të kuptuar veprimet e tillë. Vet cenimi i të mirave materiale dhe jetësore ka shtyrë në trajtesa të tillë, me qëllim të evitimit të këtyre rreziqeve. Andaj, format e reagimit që nga kohët e lashta e deri në ditët e sotme kanë shkuar duke u zhvilluar dhe përsosur në favor të çështjes humane.

Duke iu referuar studimeve më të fundit nga aspekti i kriminologjisë, si faktorë kriminogenë të shfaqjes së dukurive antisociale dhe kriminale në shoqëri janë ata faktorë që ndikojnë dukshëm në paraqitjen e sjelljeve kriminale, si: grupi i faktorëve ekonomiko-shoqëror, faktorët ideopolitik, mikrogruporë, sociopatologjikë dhe të tjera

(Halili, 2008: 241; Millutiniviq, 375-376). Kështu, sipas literaturës së kriminologjisë, në kuadër të këtyre grupeve hyjnë nën faktorët për secilin nga grupet, ndër të cilët mund të jenë:

- **Faktorët ekonomiko-shoqërorë:** industrializimi, urbanizmi, migrimi i njerëzve dhe kriminaliteti i të huajve, krizat, depresionet ekonomike, varfëria, papunësia, profesioni-mjeshtëria
- **Faktorët ideopolitikë të kriminalitetit:** konfliktet politike, konfliktet, lufta, arsimimi, mjetet e komunikimit publik (mjetet e informimit, mediat e shkruara, televizioni, literatura, filmi), religjioni dhe sektet ekstreme religjoze
- **Faktorët mikrogruporë të kriminalitetit:** familja, shkolla, mjedisë shoqëror
- **Faktorët socio-patologjikë:** prostitucioni, patologjia seksuale, alkoolizmi, narkomania, bixhozi, bredhja dhe lëmosha, vetëvrasjet, hakmarrja dhe gjakmarrja

Megjithatë, nuk duhet përjashtuar as faktorët e brendshëm, si: vitetë dhe baza psikike e personalitetit (karakteri, temperamenti, shprehitë dhe prirjet, inteligjenca, emocionet, motivet), baza biologjike e personalitetit, çrrregullimet mendore.

Përfundimisht mund të vlerësohet se sjelljet devijante dhe kriminaliteti rezultojnë nga kushtet dhe rrethanat dhe në anën tjetër nga shkaqet. Andaj, mund të themi se përvèç të lartcekurave, si faktorë i sjelljeve devijante dhe kriminalitetit në kuadër të mjedisit mund të jenë edhe:

- Pabarazia shoqëroro-ekonomike, urbanizimi dhe mbipopullimi
- Zhvillimi i shpejtë ekonomik/niveli i lartë i papunësisë

- Ndjimi i mjeteve të informimit publik
- Normat shoqërore që përkrahin sjellje të dhunshme
- Hapja e lokaleve me shërbime të pakontrolluara dhe joligjore
- Prania e mjeteve dhe substancave psikotrope dhe armëve
- Politizimi i jetës shoqërore dhe kyçja e të miturve në shërbime të partive politike

### **3.9 Transformimet ekonomike e shoqërore në botën e sotme**

Depërtimi i prirjeve bashkëkohore në të gjitha poret e jetës së njeriut nuk ka kursyer as edhe kulturat e të gjitha shoqërive. Përkundër asaj që shumë shoqëri ishin patriarkale dhe kishin një organizim të mbyllur, zhvillimet e fundit, sidomos në teknologji, ndikuani në ‘hapjen’ e tyre. Pra, mundësimi në qasjet e kulturave tjera, qoftë përmes pajisjeve teknologjike apo edhe me vizita të drejtpërdrejta, domosdo që solli një revolucion të ri. Ky *globalizim* e ka vënë botën bashkëkohore në udhëkryq. Përveç të arriturave të shumta dhe përafrimin e botës njerëzore, njëkohësisht ka sjellë edhe dukuri negative, që veç sfidimit të individit dhe grupeve, po ashtu janë sfiduese edhe për tërë shoqërinë. Madje në disa raste, shoqëria po përballet edhe me situata tepër shqetësuese deri tek ato kritiket.

Këtij trendi të zhvillimeve të sotme shoqërore i paraprinë globalizimi, që nuk po kursen nga kjo ‘goditje’ thuajse asnjë prej qytetërimeve dhe kulturave shoqërore, qoftë në vendet e zhvilluara, ato në zhvillim apo vendet e pazhvilluara. Në aspektin qytetëruesh dhe kulturor, globalizimi ka sjellë diversitet të madh kulturor, duke vënë në luhatje kulturat kombëtare të shoqërive, pa kursyer edhe ato tradicionale të ruajtura me fanatizëm. Përmes këtij diversiteti kulturor, shoqëritë po përballen me ri-identifikimin dhe përqafimin e pjesëve të kulturave nga më të ndryshmet, thuajse nga vendet e mbarë botës.

Duke iu referuar këtyre, me të drejtë vlerësohet se sot të arriturat kulturore të një komuniteti janë të imponuara përmes shtrëngesave të ndryshme në raport me botën reale. Në të kundërtën, komuniteti nuk mund të organizojë jetën sociale në mënyrë që të mund të mbijetojë brenda ekosistemit (Kessing & Strathern, *vep. cit.*). Andaj,

sipas filozofive të historisë, historia përcaktohet nga disa dinamika të zhvillimit; njeriu vetë nuk mund të luftojë kundër këtij “zhvillimi të domosdoshëm/të pashmangshëm”; njeriun nuk e shohin dhe e përkufizojnë si qenie që dallohet/formohet me anë të vullnetit, zgjedhjes së tij të lirë dhe të pavarur, por si fryt të mjedisit shoqëror (Bullaç, *vep. cit.*: 27).

Janë këto trende të zhvillimit global, që ndër tjera kanë sjellë edhe dukuri të sjelljeve që më parë nuk kanë ekzistuar në shoqëri. Madje, përmes disa sjelljeve të tillë shkohet deri rastet ku mohohen tërësisht të gjitha normat shoqërore ekzistuese, duke kaluar në një kulturë tjeter, dhe atë me të vetmin qëllim që të ndryshojnë nga tjerët. Kjo shumë herë sjellë konflikte në familje, mjedis dhe në shoqëri. Këto evoluime dhe përparësitë që sjellin ato i kanë përkrahur edhe shumë studiues dhe mendimtar. Edhe pse në njëfarë mënyre kjo ndikon në asgjësimin e kulturës së mirëfilltë popullore, megjithatë kjo zëvendësohet nga prurjet' e reja të kulturave të ndryshme. Por, në të shumtën e rasteve, këto prurje tejkalojnë rrëthanat reale të shoqërisë. Këtë e thotë edhe A. Dhima, sipas të cilit:

Pushtri i kësaj kulture, që imponohet kudo dhe që nuk është ‘më “kultura reale”, por thjesht një dominim në kulturë, vjen nga fuqia e saj teknike dhe kapaciteti për të prodhuar një seri programesh radiofonike, filma ose romane, morali i të cilave kuptohet shumë lehtë dhe sjellë kënaqësi momentale për shpirtin (Dhima, 2013: 29)

Andaj, patjetër që “të gjitha grupet kulturore ndikohen nga mënyra se si e perceptojnë botën anëtarët e tyre, pra se si ata krijojnë një botëkuptim për ‘të .....’” (Martin & Nakayama, *vep. cit.*: 57).

Të gjitha grupet kulturore vlerësimet për grupet apo shoqëritë e tjera i shprehin duke i bazuar në vlerat që janë të dallueshme dhe i karakterizojnë ato. Pikërisht, “vlerat kulturore janë kritere të përgjithshme, me anë të të cilave ‘anëtarët’ e së njëjtës kulturë përcaktojnë se ç’është e dëshirueshme ose e padëshirueshme, e mirë ose e keqe, e bukur ose e shëmtuar për ‘ta’ (Dhima, 2013: 82; Williams, 1993: 5). Por jo gjithherë këto ndryshime kulturore janë të pranuara mes vete, madje ato shumë herë edhe janë shkaktar të keqkuptimeve e deri te konfliktet. Shumë herë këto përzgjedhje kulturore po përcillen edhe me mospajtime dhe kundërshtime.

Në njëren anë, kjo shumëlojshmëri kulturash ka mundësuar një pasuri shoqërore dhe zhvillim të shoqërisë, ndërsa në anën tjetër, këto prurje të reja dhe përqafimi i tyre, po sjellin edhe rivlerësimin e identitetit kombëtar kulturor. Kjo vjen si rezultat i zbehjes së dallimeve mes kulturave. Andaj, sa më bashkëkohore që bëhen shoqëritë, kjo mundëson një gjë të tillë. Me të drejtë autorit A. Bullaç shprehet se:

Njerëzit të cilët jetojnë në bashkësi, thesarit e vet e përcjellin brez pas brezi. Pasi jeta në bashkësi, jeta shoqërore është një realitet i cili ka ekzistuar gjatë historisë, ta shkëputësh këtë realitet nga rrënjet e veta është e njëjtë sikur të rrënosh ndërtesën e vjetër me vlerë të madhe dhe në vend të saj të ndërtosh një të re (Bullaç, *vep. cit.*: 284-285)

Kështu që, këto ‘modernizime’ janë edhe ekspozues ndaj rreziqeve të tillë. Pikërisht këto rreziqe e përcjellin tërë kohën shoqërinë. Është më së e kuptueshme se kulturat e ndryshme domosdo që kanë ndikime të ndryshme tek individi, sa që mund të ketë ndryshime të mëdha apo edhe të duket si një individ tjetër. Bazuar në këtë, sipas Edmond Dragoti-t, individët që kalojnë në këtë nivel janë të shkëputur nga familja, miqtë dhe kolegët, me ç'rast do të shkëputeshin nga lidhjet sociale, ndërsa ata që arrijnë të ruajnë këtë lidhje sociale varen nga anëtarësia, ku edhe kontribuojnë në mbështetje të vetes dhe komunitetit (Dragoti, 1999: 46). Kjo tregon se qëndrimi i individit varet nga

kultura, nga traditat dhe zakonet, trashëgimia si dhe nga normat sociale të asaj shoqërie.

Lidhur me këtë E. Dragoti vlerëson se:

Interpretimi i ngjashmërise dhe i dallimeve njerëzore sot shikohet nga dy këndvështrime kryesore, në aspektin evolutiv, duke theksuar lidhjen njerëzore dhe të gjakut dhe në aspektin kulturor, ku nënvízohet diversiteti njerëzor. Sidoqoftë, sjellja e njeriut përcaktohet nga ndikimi i dyfishtë kulturor dhe gjenetik (Dragoti, *po aty*: 266)

Andaj, lidhur me rrugëtimin dhe zhvillimin shoqëror përmes rrjedhave të kohës dhe gërshetimeve me kulturat e reja, G. Tushi e vlerëson në këtë mënyrë:

Shoqëria jonë, në rrugën e modernizimit të saj, natyrshëm do të ndeshej edhe me fenomenet tjera sociale, që ishin pasojë e pashmangshme e kalimit të shoqërisë shqiptare nga modeli i mbyllur i shoqërisë totalitare, në modelin e “shoqërisë së hapur”, demokratike. Në këtë proces kalimi, sfera e transformimit social të koncepteve, tabuve, gjykimeve dhe paragjykimeve të së kaluarës ka qenë dhe vazhdon të mbetet më e vështirë, sepse, siç dihet, ndryshimet sociale, për shkak të inercisë specifike dhe thelbët të qëndrueshëm konservator, janë më të vështira për të ndryshuar me ritmin e duhur. Madje, përvuja jonë ka treguar se shpesh edhe kur ato ndodhin krijojnë një “vakum social” (Tushi, 2006: 12)

### 3.10 Evoluimi dhe risitë e shoqërisë dhe kulturës së sotme

Të gjithë njerëzit në parim kanë tipare të përafërtë shoqërore dhe ajo që i dallon është tradita dhe kultura e tyre. Këto përcillen dhe ndikohen varësisht nga zhvillimet e shoqërisë. Zhvillimet e fundit shoqërore, të ndikuara edhe nga teknologjite e kohës së fundit e kanë globalizuar botën, duke dhënë mundësi qasjeje në të gjitha vendet e tyre. Kjo qasje është lehtësuar përmes mënyrës së udhëtimeve apo edhe është mundësuar edhe nga larg, kuptohet përmes teknologjisë. Përmes tyre, individi domosdo që do ‘ndikohet’ nga qasjet e tillë dhe këto do reflektojnë përmes tij edhe në shoqëri.

Bashkëkohorja solli risi, të cilat nga masa e madhe e shoqërisë së kësaj treve u përqafuan pa hezitime. Sigurisht se kjo nuk kaloi pa sfida, pasi që gjatë kësaj kohe u zbeh apo edhe po humbet ngadalë tradita dhe kultura shekullore, madje duke u zëvendësuar me ‘kultura të përziera’. Reflektimi i këtyre krijoi lëkundje dhe solli një

krizë të shoqërisë. Po ashtu, përveç efekteve pozitive, u shfaqën edhe dukuri shqetësuese, që më parë nuk kishin qenë prezente. Lidhur me këtë G. Tushi vlerëson se:

Përbysja e koncepteve të së kaluarës sonë sociale totalitare, kolektiviste të tipologjisë së “shoqërisë holiste”, zëvendësimi i tyre me parimet e një shoqërie të re, të hapur dhe demokratike, u shoqërua me trauma sociale, paqartësi teorike, përfytyrime sociale fantazmagorike për shoqërinë e re dhe epërsitë e hipertrofizuar sociale të saj. U përbys përfytyrimi i shoqërisë së vjetër kolektiviste, i shoqërisë së kazermës, që funksiononte mbi themellet e katmanëve të vjetër politikë, moralë dhe socialë. Në skenë u shfaq një model i ri social, i cili u vendos në qendër, në piedestal të saj “njeriun e lirë”, por edhe të vtmuan, të guximshëm, që mund të arrijë gjithçka, por dhe që mund të humbas çdo gjë nga identiteti i vjetër social, individin e lirë nga paragjykimet, por të mbuluar nga iluzionet, individin pragmatist, por të rrezikuar nga valët e rrezikshme të tjetërsimit, njeriun e lirë nga “prangat” sociale, por edhe të vtmuan dhe ndonjëherë edhe të braktisur në momente të pafavorshme të jetës, kur ai ka nevojë për mbështetje sociale (Tushi, *vep. cit.*: 12)

... me ç'rast këto krijojnë edhe një destabilitet shoqëror.

Duke qenë se gjatë gjithë jetës individi dhe shoqëria iu përbahen traditave dhe zakoneve kulturore që i trashëgojnë nga gjeneratat e mëparme, shoqëritë mes vete dallohen nga një numër i madh e llojeve të kulturave. Janë pikërisht zakonet dhe kulturat ato që bëjnë dallimet në vlerat mes tyre. Në kohët moderne “shoqëria jonë është në ndryshim të shpejtë dhe si rrjedhojë ajo po humbet ciklin e të dhënit dhe të kthimit, i cili sigurohet nga cikli i jetës dhe që shpeshherë gjendet në sistemin moral të disa njerëzve” (Kassing & Strathern, *vep. cit.*: 294). Kjo argumentohet me ndryshimet që po përjetojnë disa shoqëri, sidomos ato tradicionale, ku lindjet e fëmijëve në numër të shumtë i bënin me qëllim të krijimit të fuqisë punëtore në familje, ndërsa në ditët e sotme ata janë të kursyer nga kjo praktikë. Sipas mendimit të autorit Giddens, “shoqëritë që ekzistojnë në botën e sotme janë të gjitha të ndryshme nga llojet tradicionale të rendit social që sundoi botën për mijëra vjet deri në 200 vjet më parë. Eksplorimet që ndërmorën udhëtarët perëndimor nëpër botë sollën proceset e ndryshimit që shkatërruan shumë kultura paramoderne” (Giddens, *vep. cit.*: 66).

Lidhur me evoluimet kulturore, autorët L. Coser dhe L. Ridener vlerësojnë se:

Ndërsa sistemet kulturore arrijnë zenithin e lulëzimit të plotë të tyre, ato ‘bëhen gjithmonë e më pak të afta për të shërbërë si instrument përshtatjeje, si përvojë për përbushjen reale të kërkësave të mbartësve të tyre dhe si themel për jetën e tyre shoqërore dhe kulturore’. Në këtë pikë, një sistemi kulturor duke shkuar në caqet e premisave të cilat e krijuan, e kalon kufirin, prish përpjesëtimet e së vërtetës, që dikur mishëronte, nëpërmjet egzagjerimit të njëanshëm dhe përgatit kalimin e saj, duke i dhënë jetë, kështu një sistem të ri kulturor (Coser & Ridener, 2005: 279)

Është më se e kuptueshme se me evoluime ndryshojnë edhe vlerat kulturore, pavarësisht se ato ekzistueset kanë mbajtur rregullin jetësor dhe organizimin shoqëror. Të një mendimi janë edhe Sorokini dhe Hegeli, që vlerësojnë se përmes këtyre ndryshimeve fillohet me diçka të re, e që njëkohësisht shpërbëhet e vjetra (Coser & Ridener, *vep. cit.*: 279).

Në të shumtën e rasteve, këto ndryshime janë shumë të mëdha, pavarësisht se ato janë përcjellur nëpër gjenerata. Në disa raste evoluimi mund të tejkalojë të gjitha nivelet e zakoneve, traditave dhe të kulturave ekzistuese. Zakonisht, prurjet e tilla më të shpeshta ndahan mes komuniteteve që iu imponohet dhunshëm të bashkëjetojnë apo edhe në rastet kur ata i ndërlidhin interesat e drejtpërdrejta apo të tërthorta. Kjo është një vijimësi që nga lindja e njeriut dhe krijimi i shoqërisë së parë njerëzore. Këto procese të evoluimeve shoqërore i kishte ndier edhe Herakliti në kohën e tij, në bazë të të cilave kemi edhe sot motot e njoitura filozofike ‘panta rhei’ - *çdo gjë rrjedhë*, çdo gjë ndryshon dhe ‘në një lum s’mund të hyjmë dy herë’ (Raimi, *vep. cit.*: 252).

Gjatë këtyre lëvizjeve është e kuptueshme se derisa në njëren anë kulturat e një shoqërie zbehen, në anën tjeter, ato të shoqërisë tjetër fuqizohen. Kështu që:

Lëvizjet kulturore që na mundësojnë këtë zhvendosje fuqizojnë identitetë të tjera kulturore dhe mundësojnë rishkrimin e historisë së asaj shoqërie. Ato ndihmojnë të rimendojmë identitetin kulturor dominues. Kultura negacion marrëdhënien e saj me të shkuarën dhe

mënyrën se si e shohin marrëdhënien e kombeve dhe kulturave të tjera me të kaluarat e tyre  
(Martin & Nakayama, *vep. cit.*: 91)

Megjithatë, kultura paraqet të veçantën e qenies njerëzore në raport me ambientin ku jeton. Pikërisht kjo edhe përbën tiparin dhe karakterin dallues të secilit individ të përcjellur nëpër kohë. Pra, “karakteri krijues dhe simbolika” (Dhima, 2013: 127) janë ata që mundësojnë këtë. Edhe sipas Sahlins-it, njeriu përmes simbolikës e koncepton botën (Sahlins, 1976).

Duke iu referuar veprës së Kantit “Ide për Historinë Universale me një Synim Kozmopolit” (1784), “të gjitha përparimet në kulturë, nëpërmjet së cilës njeriu bëhet më i ditur, synojnë që njojuritë dhe shkathtësitë e fituara në jetën e përditshme të bëhen të zbatueshme, sepse njeriu është qëllimi i vetëm dhe i fundit i shoqërisë njerëzore” (Dhima, 2013:41; Kant, 1991 [1784]:41). Sot një numër në rritje njerëzish, nuk kanë identitetë të qarta raciale, etnike ose kombëtare. Këta janë njerëz që jetojnë

në kufij” midis grupeve të ndryshme kulturore. Ndërsa mund të ndihen të ndarë midis traditave të ndryshme kulturore, ata gjithashtu mund të zhvillojnë një identitet multikulturor – një identitet që tejkalon një kulturë të caktuar - dhe ndihen komodë në kultura të ndryshme (Martin & Nakayama, *vep. cit.*: 134)

Gjatë evolucionit kulturor të ditëve të sotme thuajse në të gjitha grupet dhe shoqëritë njerëzore ka edhe shumë prurje të reja nga kultura të ndryshme. Sidomos në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim, kultura tradicionale është zbehur shumë dhe vendin e saj po e zë modernja. Realiteti në terren dëshmon se gjithnjë e më shumë po shkohet drejt një kulture universale. Kjo nuk po kurson as grupet e vogla shoqërore, as ato të mëdhatë, bile po shkon edhe deri te ato ndëretnike e fetare. Kjo lloj kulture universale ka depërtuar thellë tek të gjitha grupet. Nëse marrim aspektin tradicional të kulturës së trashëguar lidhur me punët në bujqësi, blegtori, etj., teknologjia thuajse është e njëjtë

kudo dhe njëjtë punohet; nëse shikohet çështja e sjelljeve individuale të vizitorëve nëpër vende të ndryshme, secili nga ata do të përpinqet të sillet sipas traditës së atij vendi ku është, etj. Këto evoluime dhe të ‘arritura’ G. Tushi i paraqet në këtë mënyrë:

Hapësira e zgjeruar e lirisë së individit dhe e pavarësisë gjithnjë e më të gjërë nga rregulla e detyrime sociale e morale kolektive, të pranueshme e konsensuale po shoqërohet me shfaqjen e fenomeneve të reja, të panjohura më parë (Tushi, *vep. cit.*: 17-18)

Historia njerëzore është përcjellur më ndryshime të pandërprera, por nganjëherë edhe me evoluime, të cilat shumë herë kanë krijuar rrethana të paqëndrueshme shoqërore. Një prej shoqërive që është përballur me këto ndryshime, sidomos me evoluime është edhe shoqëria shqiptare. Pra, këtë evoluim dhe periudhën e tranzicionit G. Tushi e përshkruan kështu:

Ndërkaq, shoqëria shqiptare, në këtë periudhë tranzicioni, ka pasur problemet e saj, që janë të lidhura me një proces të komplikuar të “rivlerësimit të vlerave”, pa ta cilat është e pamundur të funksionojë shoqëria, sado moderne të jetë ajo. Nuk mund të funksionojë një shoqëri moderne, politikisht dhe ekonomikisht, mbi principe të vjetra morale dhe sociale. Në këtë kontekst, shoqëria jonë është duke përjetuar një tjetër “krizë identiteti”, që ka të bëjë me ridimensionin e vlerave morale dhe institucioneve sociale tradicionale. Këto ndryshime kanë prekur konceptet morale, vlerat dhe institucionet e “sigurisë morale” tradicionale të shoqërisë, si: “shoqëria, feja, familja, martesa, individi, komuniteti, etj. (Tushi, *vep. cit.*: 13)

### **3.11 Dukuri të reja kriminale në kontekstin e zhvillimeve të sotme ekonomike, shoqërore e teknologjike**

Krahasuar me të kaluarën jo edhe të largët, jeta dhe mënyra e jetesës së njeriut ka pësuar shumë ndryshime. Këto ndryshime kanë depërtuar deri në imtësitë më të thella përmes transformimeve rrënjosore. Njerëzimi po përballet thuajse me një jetë tërësisht më ndryshe prej periudhave të mëhershme dhe brezave të mëparshëm. Në njëren anë, mënyra e jetës ka shkuar aq larg nga e kaluara sa një pjesë e njerëzimit ka arritur standardin më të lartë të kushteve. Edhe pse një pjesë ende përballet me kushte jo të

mira jetësore, po megjithatë jo si para dy shekujve. Në anën tjetër, këto ndryshime kanë depërtuar edhe në pjesën e brendshme, duke ndërhyrë aq thellë edhe në rrëthim e ngushtë familjar. Vet zhvillimet dhe rrëthanat dinamike të kohës sollën atë që ndoshta për gjeneratat e kaluara as me imaginatë nuk e kishin menduar.

Të gjitha këto e krijojnë një botë shumë interesante dhe shumë komplekse, një botë shumë të avancuar dhe përparimtare dhe një botë të shqetësuar dhe të frikshme njëkohësisht. Pjesa e madhe e shoqërise njerëzore më nuk e kanë atë frikën nga natyra si në të kaluarën dhe nuk presin vetëm gjërat që ua sjell ajo. Kanë shkuar aq larg, sa që thuajse natyra i frikësitet njeriut. Vet zhvillimi i teknologjisë ka bërë që njeriu të futet thellë në zemrën e natyrës dhe të nxjerrë të mirat materiale edhe nga thellësitë e nëntokës e të ngjitet deri lart në kozmos për të hulumtuar edhe gjithësinë. Të gjitha këto janë rezultat i proceseve shoqërore. Pikërisht këto procese civilizuese kanë imponuar edhe rregullat sociale. Andaj, “njerëzit dhe specie të ndryshme kafshësh mësojnë në mënyrë “situative” të modifikojnë sjelljet e tyre në rrëthana të ndryshme” (Dhima, 2013: 139). Sot nuk është ai njeriu që jeton në shpella dhe që ndez zjarrin me fërkim, por që jeton në pallate qindra katërshe dhe që ndez anije kozmike për të pushtuar gjithësinë apo nëndetëse për të hulumtuar jetën nën detëra e oqeane. Kështu, “përderisa mjedisi kulturor në të cilin lindim dhe rritemi ndikon në sjelljen tonë mund të duket sikur ne jemi pa asnjë individualitet ose vullnet të lirë” (Giddens, *vep. cit.*: 94). Sipas Schwarts, vet proceset shoqërore bëjnë që:

Shpërndarja e një kulture ndërmjet anëtarëve të një shoqërie, kapërcen kufijtë e individit në kapacitetin magazinues, krijimin dhe përdorimin e masës kulturore. Një model shpërndarës i kulturave duhet t'i marrë parasysh të dyja: diversitetin dhe të zakonshmen. Është diversiteti që e rrit kapacitetin shpikës të kulturës, por është e zakonshmja ajo që është përgjegjëse për një farë shkalle komunikueshmërie dhe koordinimi (Schwartz 1978: 423; Kassing & Strathern, *vep. cit.*: 30)

Profesori Dhima shkon edhe më larg, duke potencuar se te shumica e shoqërive të zhvilluara, moshat e reja vlerësojnë se shumë pak kanë gjëra të përbashkëta me prindërit e tyre dhe në anën tjetër prindërit nuk pajtohen me sjelljet e brezit të ri. Por, “megjithatë, ‘çarjet’ kulturore midis brezave në një shoqëri të caktuar- edhe kur bien në sy – janë më të parëndësishme në krahasim me ato që vërehen midis sistemeve sociale e kulturore të popujve të ndryshëm” (Dhima, 2013: 140-141).

Proceset e sotme shoqërore dhe ndryshimet sociale sot e bëjnë botën pjesë të progreseve dhe në anën tjetër edhe pjesë të rrezikut. Nga pjesa e progreseve rezulton me avantazhet dhe premisat për një të ardhme më të mirë për të gjitha shoqëritë. Po në anën tjetër, shoqëria njerëzore është e shqetësuar nga kanosja e rreziqeve të shumta që vijnë nga faktori njeri dhe të arriturat moderne teknologjike (Giddens, *vep. cit.*).

Prandaj edhe ky fillimshekulli ka nisur me një shtim edhe më të madh të rreziqeve për jetën njerëzore. Tani më nuk kemi vetëm rrezikun natyrë, por edhe nga vet zhvillimet e shoqërisë. Sot, “zhvillimi, modernizimi, cilësia në rritje e kulturës së jetës po përballen me disa rreziqe eminente natyrore e sociale, të cilat kanë vënë në mendim të plotë shoqërinë, politikën, shtetin dhe çdo gjë” (Tushi, *vep. cit.*: 379).

Të gjitha ndryshimet në kulturat shoqërore dhe “duke bërë dallimin ndërmjet një sistemi kulturor dhe një realiteti social të ndryshuar, ku sistemi i vjetër nuk është i përshtatshëm, Geertz jep një kontribut të madh në teorinë e ndryshimit dhe e vendos shkollën amerikane të antropologjisë në drejtimin e duhur për t'u shkëputur nga teoria e vjetërsuar e akulturimit” (Kessing & Strathern, *vep. cit.*: 363). Edhe profesori Dhima vlerëson se ndryshimet na sjellin në qëndrime se “kultura nuk është as natyrore, as artificiale. Ajo nuk buron as nga gjenetika, as nga mendimi racional, sepse përbëhet nga

rregulla të të sjellurit që nuk janë të shpikura dhe, përgjithësisht, funksioni i tyre nuk kuptohet prej njerëzve që i zbatojnë” (Dhima, 2013: 158).

Të gjitha këto ndryshime kanë ndikuar edhe në proceset e organizimit shoqëror si dhe në aspektin social modern. Deri vonë pjesa më e madhe e shoqërive organizoheshin bazuar në traditat kulturore të tyre. Derisa familja ishte institucioni bazë dhe jetik për grupin dhe shoqërinë, zhvillimet e reja kulturore kanë sjellë reforma. Këto reforma ndikuan që tani shumë pak të kemi familje të fuqishme dhe të mëdha me disa gjenerata. Kjo vjen për shkak se në botën bashkëkohore fuqia punëtore po zëvendësohet me mjetet teknologjike. Tani respektohet ‘kthimi i borxhit’ në gjenerata, pasi që të moshuarit dërgohen nëpër ‘shtëpi të pleqve’ deri në vdekje. Pra, nuk është më ai organizimi social për përkujdesje humanitare, morale e njerëzore, por tani në radhë të parë vijnë interesat private.

Sipas një numri të madh të sociologëve mendohet se të gjitha ndryshimet në shoqëri vijnë si rezultat i këtyre faktorëve dhe shkaqeve: puna dhe ndarja shoqërore e punës, kontradiktat mes forcave prodhuese dhe marrëdhënieve në prodhim, zbulimet gjeniale, revolucioni shkencoro-teknologjik, faktorët gjeografik, faktorët demografik dhe organizimi politik (Raimi, *vep. cit.*).

Trendi i zhvillimit dhe ndryshimet në shoqëritë e sotme mund të ishin të pa imagjinueshme para dy shekujve, por sot të gjithë pajtohen me këtë lëvizje marramendëse. Këto ndryshime ndikuan edhe në mënyrën e të jetuarit, ndërsa ‘lëvizjet e shpejta’ ndikuan në dinamikën e jetës. Kështu që, kjo sjellë edhe ndryshime në të gjitha proceset jetësore. Sipas mendimit të vjetër ‘gjithçka ndryshon gjatë gjithë kohës’.

Bazuar në përpjekjet lidhur me ndryshimet sociale, rezulton se janë tri ndarje kryesore që shkaktojnë ndryshimet sociale: mjedis fizik, organizimi politik dhe faktorët kulturorë. Megjithatë këta faktorë ndikohen edhe nga disa rrrethana tjera. Vet ecuria jetësore imponon ndryshimin me të kaluarën. Këto ndryshime vijnë, qoftë nga zhvillimet ekonomike, ato politike si dhe nga zhvillimet kulturore (Giddens, *vep. cit.*). Prandaj, kjo është dhe do të vazhdojë të mbetet një vazhdimësi që do të përcjellë shoqërinë njerëzore në çfarëdo faze të zhvillimit nëpër të cilën kalon. Pikërisht përmes këtyre faktorëve dhe zhvillimeve do të organizohen proceset jetësore si dhe do të diktohet ndryshimi social në secilën shoqëri.

Ndryshimet teknologjike të dhjetëvjeçarëve të fundit kanë marrë një rëndësi thelbësore për domethënien e termit “kulturë”. Kjo gjendje e re e ka drejtuar R. Williams të jap një përkufizim të ri përkëtuar koncept me shtrirje të gjerë epistemologjike që pasqyron, ndërtjera, edhe realitetin e ndryshimeve teknologjike e mediatike. Këto ndryshime kanë prekur tashmë çdo qelizë të jetës shoqërore, duke filluar nga jeta familjare që nuk është më e njëjta, me orendi të reja shtëpiake dhe me teknologji nga më të sofistikuarat. Ai nuk harron të përmend faktin se teknologjia e ka robëruar në një farë kuptimi njeriun, e ka viktinizuar atë, duke e transformuar në një qenie që varet nga mënyra e përdorimit të këtyre mjeteve. Por, nga ana tjetër, ai nuk e lë pa përmendur që kjo infrastrukturë e re i jep njeriut disa mundësi që nuk i ka pasur më parë (Dhima, 2013: 83).

Nëse kemi parasysh se mjetet teknike të cilat prodhojnë kulturën masive dhe të cilat imazhin e kësaj kulture mund ta përhapin deri në këndim më të largët të botës, se potencialet informative në të kaluarën nuk kanë qenë efektive si të kohës aktuale, mund të themi se marrëdhëniet dhe ndikimet nënëkulturore janë zhvilluar shumë më ngadalë, duke kaluar përmes një procesi të gjatë me sfida të shumta.

Është e pamohueshme e vërteta se zhvillimet ekonomike dhe teknologjike sot luajnë një rol shumë të rëndësishëm për secilën shoqëri. Kjo reflekton sidomos te shoqëritë në riorganizim, enkas gjatë fazës së tranzicionit. Ndryshimet ekonomike e teknologjike mundësojnë joshjen në shumë dukuri të reja, ndër të cilat edhe ato kriminale. Disa nga individët apo grupet krijojnë pasione për disa nga dukuritë kriminale, si: trafikimi me qenie njerëzore, prostitucioni, mjetet e ndryshme psikotrope. Ndër të tjera, këto sjellin përfitime të shpejta dhe të mëdha. Në anën tjetër, qasjet në programe të ndryshme dhe njohja me kultura dhe civilizime nga më të ndryshme, sjellë edhe dukuritë e tjera në fushën e kriminalitetit, si rezultat i të cilave, dukuri të reja reflektojnë në shoqëri, si: ndërhyrje në rrjete kompjuterike, dhunë në familje, divorce, kërkimi i lëmoshën, liri të shfrenuar seksuale.

Të gjitha këto shpijnë në një pasiguri, nga e cila më pastaj krijohet edhe një krizë dhe hamendje te individë apo grupe të caktuara. Në raste të caktuara edhe nga këto rrethana krijohen dukuri të rrezikshme, si: forma të ndryshme të depresionit, vetëvrasje, agresivitet etj.

Nga kjo mund të shihet qartazi se ndryshimet bashkëkohore dhe prurjet e reja përmes procesit të globalizimit, ndonëse e kanë afruar edhe më njerëzimin, duke e shndërruar botën tonë në miniaturë, prapë se prapë, janë pikërisht këto ndryshime që veçse kanë sjellë dukuri negative në shoqërinë e Gjakovës me rrëthimin, sepse e reja, bashkëkohorja, nuk ka arritur të përshtatet si duhet ndaj prirjeve të hershme tradicionale të kësaj ane. Edhe vetë banorët e këtij rajoni, me pasivitetin në kundërshtimin e këtyre prurjeve negative, madje duke i përqafuar me naivitet dhe entuziazëm, kanë kontribuuar dhe po vazhdojnë të japid një mbështetje të madhe që dukuritë e sipër cekura, në vend që të

reduktohen deri në zhdukje të plotë, vetëm sa të fuqizohen dhe të zënë një vend të rëndësishëm në mendësinë e popullit të kësaj treve, gjë që veçse është në rrugë e sipër.

## **KAPITULLI IV: ZHVILLIMET EKONOMIKE, DEMOGRAFIKE E KULTURORE TË SHOQËRISË KOSOVARE DHE PRIRJET E KRIMINALITETIT; RASTI I GJAKOVËS**

### **4.1 Antropologjia kulturore e shoqërisë kosovare, në veçanti asaj gjakovare**

Sot shkenca ka arritur të dëshmojë se populli shqiptar, duke qenë ndër popujt më të vjetër të Evropës, gjatë zhvillimit nëpër histori ka përjetuar një rrugëtim sfidues me shumë bariera. Me një pozitë gjeografike-strategjike, trevat shqiptare u vunë në udhëkryqin e të gjitha prirjeve që përshkonin zhvillimet shoqërore të kohërave, me ç'rast u bënë edhe shënjestër e interesave politik të vendeve fqinje dhe pushtuesve të shumtë, duke filluar nga Perandoria Romake, Bizantine, dyndjet sllave, Perandoria Osmane e deri te Fuqitë e Mëdha të shekujve të fundit.

Bazuar në arritjet dhe zbulimet shkencore, vërtetohet se shoqëria shqiptare e ditëve tona e ka zanafilën që nga lashtësia. Falë hulumtimeve të studiuesve të ndryshëm, tani e kemi të njojur saktësisht gjenezën e popullit shqiptar dhe rolin e saj nga periudha antike deri më sot. Faktet dëshmojnë vijimësinë e kësaj shoqërie përmes një rrugëtimi shekullor, nga krijimi i familjes ilire dhe bashkimi fisionor i tyre e deri te ndërtimi i shtetit Iliro-Dardan, duke mos lënë anash edhe fatet që e shoqëruan gjatë tërë historisë. Një vlerësim të tillë na e dëshmon edhe Nermin Vlora Falaschi, sipas së cilës “stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm kanë banuar qysh në kohën parahistorike në pjesën më të madhe të botës që njihej aso kohe, me ç'rast kanë zhvilluar një qytetërim shumë të rëndësishëm dhe kanë ngritur vepra me vlera të jashtëzakonshme” (Falaski-Vlora, *vep. cit. :8*).

Të gjitha grupet shoqërore, që nga lashtësia, ndërlidhen drejtpërdrejt me kulturën, duke u bazuar te prejardhja dhe përkatësia e tyre etnike. Kultura ndryshon prej një shoqërie

në tjetrën, ndryshon brendapërbrenda shoqërisë dhe prej një kohe në tjetrën. Praninë e kulturës në shoqërinë e paraardhëse të shqiptarëve e kanë dëshmuar edhe autorët antikë si: Straboni, Herodoti, Tukiditi, Aristoteli, Ptolemeu, Homeri, etj. Tanimë dihet se ilirët kishin qenë një popull i përbërë nga disa *fise*, të cilët ata jetonin në një territor të madh, gati në tërë Gadishullin Ballkanik. Duke pasur një bashkëpunim mes vete dhe me popullsitë përreth, ata ishin *etni* autoktone e homogjene dhe “kishin një traditë dhe një territor në kuptim të gjerë të fjalës dhe kështu i takonin trungut etnik ilir” (Krasniqi, 2002: 11).

Për nivelin e qytetërimit të kësaj popullsie, ndër të parat në Evropë, janë shprehur shumë shkencëtarë. Një prej vlerësimeve të tillë në këtë drejtim na paraqet J. Osmani, i cili shprehet se, “në kohën kur ne ishim fise barbare, ilirët kishin arritur një qytetërim shumë të zhvilluar”, për të vazhduar më tutje duke pohuar se “ata kishin qytete të mëdha, urbanizëm të përparuar, amfiteatro, biblioteka e vepra të shumta të artit” (Osmani, 2010: 13). Sidomos këto kishin përparuar hovshëm që nga mijëvjeçari i dytë p.e.s. duke sjellë një qytetërim autokton original. Për rr Ethanat kulturoro-historike të popullsisë shqiptare është shprehur edhe M. Pirraku, sipas të cilit,

zhvillimi shoqëror e kulturor historik i popullit shqiptar, siç dihet, kaloi të gjitha fazat e zhvillimit të shoqërisë njerëzore dhe, ajo që është më e rëndësishme, sipas albanologëve më të mëdhenj, ky popull është autokton në trollin ballkanik, së paku nga koha historike (Pirraku, *vep. cit.*: 33)

Duke u mbështetur në burimet më të sigurta të dokumenteve të shkruara që paraqiten te autorët antikë, vërtetohet bindshëm vazhdimësia nga periudha antike ilire, e dokeve, zakoneve dhe e traditës autoktone, kompakte natyrore, historike, politike, etnografike, shtetërore, juridike etj. Mirëpo, “kërkimet dhe botimet e mirëfillta rrëth folklorit dhe etnografisë shqiptare zanafillën e tyre e kanë relativisht të vonë, çka është e lidhur

ngushtë me rrethanat nëpër të cilat ka kaluar shoqëria shqiptare dhe ajo para saj” (Xhangolli, 1997: 3). Kjo vonesë vjen si rezultat i zhvillimeve historike nëpër kohë të kësaj shoqërie.

Një nga shumë hulumtimet shkencore ishte edhe studimi antropologjik për shqiptarët, i viti 1877, nga patologu dhe antropologu, Rudolf Virhov, studim që identifikon këta me ilirët (Dhima, 1985: 30-31). Që këtu kishte filluar edhe antropologjia e shqiptarëve dhe, me të dëshmohet se shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve të vjetër. Pra, zhvillimet e shoqërisë shqiptare nëpër të gjitha etapat janë shoqëruar nga kultura e tyre, së paku nga Mesjeta e hershme deri me sot. Është kultura, përmes së cilës paraqitet karakteri shpirtëror e material shoqëror nëpër kohë. Duke përcjellë doket, traditat dhe zakonet, kjo është transmetuar nga gjenerata në gjeneratë.

Periudhat nëpër të cilat kaloi dhe u zhvillua kultura shqiptare ishin të ndërlidhura me rrethanat historike të këtij populli. Peripecitë e kohës patjetër që patën ndikimet e tyre. Në veçanti pushtimet e ndryshme shekullore, patën ndikim të pashmangshëm, të cilat u implikuau edhe në traditën zakonore e kulturore. Shkatërrimet e shumta që iu bënë shumë vendeve e territoreve të kësaj popullsie, qoftë në të mirat materiale ashtu edhe në atë të kulturës, ishin të papërballueshme. Megjithatë, kultura shpirtërore e materiale e paraardhësve të popullit shqiptar, jo vetëm që u mbijetoit këtyre ngjarjeve dramatike, por blatoi edhe bazën për kulturën e mëvonshme shqiptare (Pirraku, *vep. cit.*).

Po ashtu, rreth traditave dhe historisë shqiptare është shprehur edhe albanologu i njohur hungarez, Tallock, sipas të cilit “ku ka një popull tjetër në Ballkan, as ai i Greqisë së re, që të mund të ndjekë historinë e fisit të vet me rend gjenealogjik, qysh prej kohëve më të lashta deri në ditët tona, si populli shqiptar” (Krasniqi, 2002.: 133). Gjatë këtyre

periudhave, iliro-dardanët qëndruan duke ruajtur me krenari origjinën e pastër dhe traditat e lashta iliro-shqiptare. Mbijetesën dhe qëndresën e popullit shqiptar që nga lashtësia, P. Rago e shpreh kështu:

E përshkruar sikur të ishte një Arkadi e mbijetuar dhe e gjithëkohëshme, ajo mendohej se banohej nga njerëz primitiv, të lirë dhe trima, bartës të traditave mijëvjeçare të pandryshueshme të kodifikuara nga Ligji i Maleve, të ndikuar nga një mjedis gjeografik armiqësor dhe nga kushte jetese arkaike, farkëtu e karaktere të njerëzve, zakoneve dhe prirjeve të tyre të lashta (Rago, 2011: 40-41)

Kështu që, përkundër rrebesheve shumë shekullore, të cilat patën edhe pasoja shkatërruese, iliro-dardanët prapëseprapë vazhduan të ruanin etnogjenezën e tyre. Me të drejtë mund të vijmë në përfundim se etnogjeneza e popullit shqiptar fillon që nga periudha primitive e mënyrës së organizimit të jetës në shpella, për të vijuar tutje me zhvillimet e saj deri në ditët e sotme. Andaj, lashtësia iliro dardane është e njohur jo vetëm për Ballkanin e Evropës, por në mbarë rruzullin tokësor. Ata tashmë ekzistonin dhe shtriheshin si etni autoktone dhe homogjene në pjesën më të madhe të Gadishullit Ballkanik.

Me fjalë të tjera, malet dhe njerëzit u paraqitën si një unikum i pandashëm, një bashkësi elementesh që prodhonin kushte jetese afér natyrës, të krijuara qysh nga kohët që nuk mbaheshin mend, që nuk mund të ishin të ndryshme nga karakteret nëpërmjet të cilave shfaqeshin (Rago, *po aty*: 40-41)

Zhvillimet historike diktuan që ky popull të përjetojë shumë lëvizje, sidomos në trungun e vet tokësor, duke iu marrë pjesë-pjesë pronat, herë nga një pushtues e herë nga tjetri. Madje, sipas Nermin Vlora Falaschi-t:

Stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm, kanë banuar qysh në kohën parahistorike në pjesën më të madhe të botës që njihet aso kohe, me ç'rast kanë zhvilluar një qytetërim shumë të rëndësishëm dhe kanë ngritur vepra me vlera të jashtëzakonshme. Fitimet tokësore të popujve shkojnë e vijnë. Fitimet shpirtërore mbesin të vulosura në kohë si dritë e vërtetë që nuk shuhën gjatë shekujve, por bëhen energji, shkencë, dituri (Falaski-Vlora, *vep. cit.*: 8-56)

Bazuar në këto ngjarje historiko-antropologjike, albanologu i njohur Johan Georg von Hahn kishte vlerësuar se, “vendi, në të gjitha kohnat, ka qenë nda në pjesë të veçume që banoheshin prej fisesh të lirë, si në atë kohë kur përmendet për herë të parë në histori, ashtu edhe kur ishte pjesë e nji shteti ma të madh, p.sh. i Perandorisë Romake, Bizantine, Bullgare, Serbe dhe Turke” (Hahn, 1992[1854]: 24). Këtë e shpreh edhe Franc Nopça, me ç’rast thotë:

Si të gjithë popujt e ciklit patriarchal të Gadishullit Ballkanik edhe shqiptarët dallohen për kuptimin moral të quartë, ta palëkundshëm, për moralitetin e tyre gati të rëndë, për mënyrat e prera, shumë herë të egra, të veprimit. Kanë një ndjenjë të fortë për bashkësinë e fisit dhe të familjes dhe, njëkohësisht, tregojnë një shpirt të sakrificës, që nuk zbrapset përpëra asnjë pengese (Nopça, 2013 [1925]: 24)

Hapësira ku shtrihej populli iliro-shqiptar, sidomos në mesjetën e hershme, me traditën dhe kulturën burimore, rrrethohej nga popuj që dyndeshin në këto troje duke u përpjekur të sillnin kulturat e veta dhe të impononin bindjen se kanë qenë të përhershëm në këto treva. Shpërnguljet e reja të shtegtarëve sllavë në Gadishullin Ballkanik në shek. VI-VII dhe zhvillimet e mëtejme gjatë mesjetës ishin rreziku më kërcënues i zhbërjes së etnive dhe kulturave të tërë Ballkanit, mirëpo vet etnogjeneza mirë e izoluar shqiptare, qoftë nga kultura, origjina dhe territori, ishte ajo që i sfidoi kësaj duke i ruajtur të pastra tiparet etnike e kulturore. Ishin pikërisht këto që në forma të ndryshme provuan të çrrënjosin popullin shqiptar, duke filluar nga asimilimi e deri te ç farosja biologjike totale e tij, sidomos kur në territorin e sotëm të Kosovës, në kohën e mesjetës u ndërruan shumë sundimtarë, si: romakët, bizantinët, bullgarët, maqedonasit, serbët dhe turqit, për të vazhduar edhe më pas, pra deri në vitet e fundit të shek. XX. Qëndresa e kulturës dhe e së drejtës zakonore të kësaj popullsie nga A. Buda përshkruhet kështu:

Ishte veprimtaria efektive konstante e shtresave popullore që i dha kulturës mesjetare shqiptare përtej dukjes unitare për të gjitha territoret e Perandorisë Bizantine, ato tipare karakteristike të veçanta që pasqyrojnë bazën specifike etnike dhe traditat e veçanta historike, mbi të cilat u zhvillua kjo kulturë. Kështu pranë së drejtës perandorake bizantine kudo në fuqi, vepronate e drejta zakonore vendëse me tipare karakteristike të një demokracie rurale të një tipi arkaik, normat e së cilës u shërbyen veçanërisht fshatarëve të zonave malore për të mbrojtur të drejtat e tyre kundër lakinive të aristokracisë vendëse dhe kërkeseve fiskale të shtetit (Buda, 2006: 14)

Pjesë e këtij populli dhe të këtij trualli historikisht ishin edhe dardanët dhe Dardania, të cilët gjatë ekzistencës së tyre përfjetuan zhvillimet historike, ashtu si edhe ilirët. Është pikërisht Kosova e sotme ajo e cila i ka rrënjet m'u në Dardaninë antike dhe se populli shqiptar i Kosovës është drejtpërdrejtë pasardhës i dardanëve të vjetër dhe që ekzistojnë me një vazhdimesi të qëndrueshme mbi se100 shekulliore para erës sonë. Lidhur me iliro-dardanët, trojet e tyre dhe trashëgiminë, sidomos të dokeve e zakoneve dhe të traditës e autohtonisë etnike, duke filluar nga autorë antikë e tutje, në mënyrë kronologjike trajtohen burime të faktuara mbi dëshmimin e ekzistencës dhe ecurisë përgjatë periudhave nga Homeri e deri ajo e shek. VII.

Sa herë që kemi të bëjmë me hulumtimin e së kaluarës së largët, pasi që dita ditës zbulohen artefakte të reja, shkenca vazhdimisht vazhdon të nxjerrë në shesh fakte dhe dokumente interesante, të cilat në disa raste i demantojnë këto të deritanishmet. Këtë po e mundësojnë edhe mjetet bashkëkohore të teknologjisë së fundit, të cilat po mundësojnë të shpjegohen përmes metodave më të përparuara.

Janë pikërisht këto metoda që argumentojnë se stërgjyshërit e shqiptarëve të sotëm kanë jetuar në trojet e veta autoktone, pra që para romakëve e grekëve, e të cilët ruajtën dhe përcollën me besnikëri zakonet dhe traditat e veta brez pas brezi. Ata arritën që t'i ruajnë e t'i përcjellin edhe zakonet e përbashkëta me popujt fqinj, madje më me origjinalitet se vet ata. Pra, ishte pikërisht kjo lashtësi dhe hapësirë që iliro-shqiptarëve

ua bëri të mundur të jenë “më të avancuarit nga pikëpamja e zhvillimit shoqëror e kulturor” (Osmani, *vep. cit.*: 13). Duke qenë të pranishme që nga kohët e mugëta e deri në ditët e sotme, doqet dhe zakonet popullore kanë pasur rol të rëndësishëm në procesin e integrimit të kulturës kombëtare shqiptare. Andaj, mund të thuhet se kultura popullore, në kuqtimin e gjerë, “ka qenë mbrojtje e fuqishme gjatë historisë nga asimilimi, shkombëtarizimi dhe zhdukja e plotë e kombit shqiptar nga faqja e dheut” (Pirraku, *vep. cit.*: 115-116).

‘Fatet’ në histori dhe në zhvillim shoqëror shqiptarët dardanë i kishin ndarë nga trungu i vet i gjenezës. Historia e tyre okupuese kishte vazhduar edhe rrëth njëqind vite pas shpalljes së shtetit shqiptar të Shqipërisë, pra edhe përgjatë gjithë shekullit njëzetë. Duke mbrojtur me dinjitet të qenit shqiptar, këta nuk lejuan që këto politika të arrinin qëllimet e tyre shfarosëse. Lidhur me proceset që zhvilloheshin historikisht kundër popullit shqiptar e tregon edhe M. Pirraku, sipas të cilit, “plleshmëria e shëndoshë e nënës shqiptare topiti tehun e proceseve asimiluese dhe të masakrave mbi popullin shqiptar nga të huajt, dhe kështu siguroi jetën biologjike të këtij etnosi dhe të këtij populli” (Pirraku, *po aty*: 162-163).

Kështu që, “duke i pasur rrënjet te vlerat që lidhen ngushtë me mbrojtjen e ruajtjen e klanit dhe të familjes, shqiptarizmi u shfaq si një përpunim modern i nocioneve tradicionale të ngulitura në shekuj dhe i ndryshëm nga ideja e kombit, e cila ishte karakteristike për ato vite” (Rago, *vep. cit.*: 19).

Historia dëshmon forma të ndryshme të organizimit shoqëror, varësisht nga pushtuesit që ndërroheshin, pra nga romakët e deri te sllavët e shek. XX. Pavarësisht këtyre, të

gjitha vendbanimet brenda Kosovës arritën të ndërtojnë dhe ruajnë historinë e vet dhe të tërë Kosovës.

Ajo që e bënte të veçantë tradicionalisht këtë popull, ishte lidhja e tij me familjen dhe vendin e lindjes. “Hallka që i lidhte këto pjesë të kulturës shqiptare në një njësi të kulturës ishte gjuha shqipe, emri kombëtar i popullit dhe emri kombëtar dhe ndërkombëtar i vendit” (Pirraku, *vep. cit.*: 19). Andaj, “udhëtimi nëpër shekuj dhe kohë i kulturës kosovare dëshmon lashtësinë si shoqëri dhe individualitetin si komb” (Gjokutaj, 1987: 21). Realisht, pushtimet shekullore të territoreve të Kosovës imponuan një “izolim gjeografik e social-kulturor”, gjë që mundësoi përballimin e të gjitha joshjeve të huajve (Islami, 1981: 203). Ishte pikërisht ky izolim dhe karakteri i myllur domosdoja për rezistencë ndaj trysnive të huaja si dhe faktori kryesor për përcjelljen e traditave të pastra. Kështu, “në rrethana të tillë kultura popullore shqiptare mbetej bartësja kryesore dhe thuajse e vetme e traditave etnike, tradita që shquhen për qëndrueshmëri të madhe, ndaj jetojnë gjatë dhe rastis të ruhen si elementë arkaik edhe pasi ndryshojnë kushtet që i kanë lindur” (Gjokutaj, *vep. cit.*: 22-23).

Vështruar në planin antropologjik social, ky proces shumëformësh përcillet më fort si reagim vetëmbrojtës i një etnosi të vogël kulturor për mbijetesë, pra si një zgjidhje pragmatike ndaj rrezikut të zhbërjes të tij të plotë. Këtë e përforcon edhe B. Demiraj, sipas të cilit:

Pa dashur të ndalemi më hollësisht te ky problem në planin antropologjik social dhe duke u përqendruar në situatën sociale-kulturore që na paraqitet në fund të shekullit XVII dhe në fillim të shek. XVIII, mendojmë se aktivizimi dhe përgjithësimi i etnosit shqiptar është pikërisht veshja gjuhësore e reaksioneve sociale në varg që u zhvilluan brenda strukturës shumëplanëshe të etnosit kulturor-shqiptar gjatë kësaj periudhe (Demiraj, 2014: 126)

Pavarësisht të gjitha këtyre trysnive e presioneve të të gjitha kohërave nëpër histori, jo vetëm që u mbijetoit këtyre, por:

mbi sistemin e argumenteve që dëshmonin prejardhjen, sistemin e vlerave sociale, gjuhën, historinë e gjeografinë dhe tiparet karakteristike antropologjike e psikologjike të shqiptarëve u vërtetua qenia, identiteti dhe integriteti i shqiptarëve, sikurse edhe e drejta e tyre për të pasur njësinë e vet politike dhe administrative-shtetërore (Nushi, 2011: 28)

Një ndër vendbanimet e hershme dhe me një histori krenare, dëshmuar nëpër kohët e ndryshme të historisë, që nga kohë të mugëta, është edhe Gjakova dhe rrëthina e saj. Edhe pse zhvillimet gjatë historisë ndikuan dukshëm edhe në çështjen e paraardhësve të popullit shqiptar, e po ashtu edhe në atë të Gjakovës me rrëthinë, prapëseprapë kjo popullsi arriti të ruajë prejardhjen e vet në çdo pikëpamje, por në veçanti në pikëpamje kulturore e shoqërore.

#### **4.1.1 Gjakova në kontekstin antropologjik-historik**

Artefaktet e ndryshme dokumentuese janë dëshmia më e mirë që tregon autoktoninë e popullsisë shqiptare të Gjakovës me rrëthinë si vazhdimësi nga gjeneza iliro-dardane dhe atë duke përfshirë të gjitha proceset që e përcollën nëpër kohët e historisë. Duke iu falenderuar pozitës së përshtatshme gjeostrategjike dhe të mirave materiale natyrore, Gjakova si vendbanim, kishte kushtet e duhura për zhvillimin e jetës njerëzore që nga kohët e lashta, duke u dokumentuar si vendbanim që nga parahistoria. Argumentimin e japid edhe sot gjetjet e artefakteve të reja në hapësirat e kësaj zone, gjetje të cilat datojnë që nga koha e iliro-dardanëve që kishin jetuar në këto treva. Një argumentim i tillë vjen edhe nga autorja E. Shukriu, që shkruan:

Antrupologjia dhe historia e popullit shqiptar të Gjakovës, si popull autokton dhe pasardhës i ilirëve, paraqet histori në vete, e cila përveç se është shumë e zëshme, jo vetëm për vete, por edhe për popujt tjerë të Ballkanit dhe Evropës, është edhe shumë e lavdishme. Këtë e përforcojnë edhe të gjeturat arkeologjike, përmes së cilave dëshmohen “për një jetë të lulëzuar në këtë rajon që nga parahistoria deri në mesjetë (Shukriu, 2002: 45)

Lashtësia e popullimit të këtyre trevave dhe pjesë të traditave e të kulturës dëshmohen edhe nga toponimet, që sipas S. Ukës, “Gjakova me rrëthinë qenë treva të populluara

qysh në kohët e vjetra, dhe se toponimet e fshatrave të tanishme, tok me Gjakovën, përmenden tek në mesjetën e zhvilluar” (Uka, 2002: 196).

Që nga lashtësia kjo trevë përshkohej nga rruga *Via de Zenta*, e cila në fakt ishte një nga rrugët kryesore të Ballkanit. Rruga në fjalë fillonte nga Shëngjini në Detin Adriatik, për të vazhduar përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në drejtim të Prizrenit dhe vijonte më tej në lindje nëpërmjet Kosovës, Nishit dhe Sofjes që të përfundonte në Konstandinopojë (Stambolli i sotëm). Madje, sipas J. Bajraktari-t:

Një pjesë e rrugës *Via de Zenta* kalonte nëpër territorin e Gjakovës dhe te Vau i Spasit merrte dy drejtime: njëri shkonte për Prizren, kurse tjetri nëpër luginën e Krumës vazhdonte përkrah degës së djathtë të Drinit nëpër katundin Letaj, në Qafën e Prushit, në Gjakovë, e, që këndej vijonte për Prishtinë në lindje, si dhe në Pejë në veri (Bajraktari, 1998: 13-14)

Shikuar nga aspekti gjeografik, qyteti i Gjakovës i takon pjesës jugperëndimore të fushëgropës së Rrafshit të Dukagjinit. E gjendur në kryqëzimin e rrugës së rëndësishme transversale *Via de Zenta*, ose të Zetës (Shkodër-Kosovë), Gjakova shtrihet në bregun e majtë të lumit Erenik duke përfshirë edhe dy anët e përroit Krena dhe në lindje të pllajës së Çabratit.

Duke iu referuar pozitës gjeografike, të mirave natyrore, që në një anë e përbëhen nga miniera e pasur e Devës dhe në anën tjetër rrafshina e plleshme e përshkruar nga dy lumenj: Drini në lindje, i cili ka rëndësi të madhe meqë lidh Adriatikun me Ballkanin qendror, dhe Ereniku në perëndim e jug, si dhe të strukturës së terrenit të kësaj treve, pavarësisht zhvillimeve historike e shoqërore, kishin mundësuar kushte të përshtatshme jetese gjatë periudhave të ndryshme. Lidhur me përbashken e këtyre zhvillimeve dhe ruajtjen e gjenezës së vet, studiuai J. Bajraktari, jep këtë vlerësim:

Burimet dokumentare me prejardhje të ndryshme dëshmojnë për vazhdimësinë e popullsisë autoktone shqiptare në trevën e Gjakovës nga koha e iliro-dardanëve e deri në shekullin XX

dhe tutje. Ky përfundim nuk i përjashton as ndryshimet që kanë ndodhur gjatë shekujve për shkak të proceseve migruese, të lidhura me faktorët politikë, pushtimet e huaja, me ata ekonomikë, socialë, etj. Këta faktorë kanë sjellë si rezultat edhe praninë e elementëve të etnive të tjera në këtë krajinë, si dhe ndarjen e popullsisë së saj në besime të ndryshme, në myslimanë, katolikë, e pjesërisht ortodoksë. Por, edhe në këto rrethana shqiptarët mbetën popullsia zotëruese në trevën e Gjakovës, që dallohet për homogenitetin e saj etnik (Bajraktari, *po aty*: 34)

Përkundër këtyre gjetjeve, të cilat dëshmojnë gjurmët e kulturës materiale nga koha antike, e që u takojnë paraardhësve të popullsisë së sotme shqiptare të kësaj treve, mungojnë gjurmimet arkeologjike. Mirëpo, bazuar në artefaktet e sotme kemi mjaft indikacione e dëshmi të kulturës materiale se në qytetin e Gjakovës dhe në rrëthinën e saj është jetuar edhe gjatë periudhës antike, edhe pse Gjakova nuk përmendet si vendbanim i asaj kohe.

Faktet dhe të dhënat historike dëshmojnë se Gjakova njihet që nga dekada e pestë e shekullit XIV, pra nga viti 1348. Gjatë kësaj kohe, kjo trevë i takonte nahijes së Alltun-ihlisë, me qendër në Junik. Në anën tjetër, bazuar në burimet e kulturës materiale, ndërtimeve arkitekturale monumentale, ajo njihet nga dekada e fundit e shekullit XVI. Për herë të parë, në mesjetë, Gjakova përmendet si fshat, vend tregu më 1485 dhe që “sipas defterit turk të vitit 1485, Gjakova kishte 54 shtëpi që i përgjigjet njehut përkatës të familjeve apo rreth 300 banorëve” (Lleshi, 1987: 40).

Periudhat historike dhe zhvillimet shoqërore domosdo që ishin procese që goditën edhe këtë zonë. Kjo zonë ishte përfshirë nga pushtimi romak, por pas ndarjes së kësaj perandorie, kjo mbeti nën kontrollin e Perandorisë Bizantine. Më vonë, Gjakova me rrëthinë u përfshi nën sundimin bullgar dhe më pas, në mesjetë, nën atë serbo-sllav. Në dokumentacionin e atëhershëm mesjetar, ku ka shumë pak burime historike, kjo zonë përmendej me emrat *Patkovë*, *Rekë* dhe *Alltin*. Format e emërtimit të qytetit pësuan

ndryshime gjatë shekujve. Edhe vendbanimeve iu kishte imponuar të marrin emra sipas pushtuesve, andaj:

Vendbanimet e Gjakovës, si ato të viseve të tjera shqiptare, veçanërisht të Kosovës, mbajnë emra të periudhave të shumta të së kaluarës historike: të kohës së lashtë (antike), të mesjetës së hershme, të mesjetës së vonshme dhe të kohës së re. Perandoritë kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në toponiminë e këtyre viseve, si Perandoria Romake, perandoria Bizantine, shtetet sllave të mesjetës, Perandoria Osmane, shtetet e mëvonshme sllave, veçanërisht mbretëria jugosllave (Osmani, *vep. cit.*: 76)

Lidhur me mënyrën e themelimit të Gjakovës janë dhënë mendime të ndryshme, shumë prej të cilave kanë mungesë në mbështetje të dokumentacionit. Sipas shënimive të deri tanishme, argumentohet se Gjakova deri në vitin 1582 ishte si fshat dhe qendër ‘pazari’, por vet pozita gjeografike dhe rëndësia në aspektin strategjik ishin faktorë që i mundësuan një zhvillim të shpejtë. Kështu, kjo mundësoi që qyteti si qendër urbane të datonte që nga fundi i shek. XVI me vënien e themelove Xhamisë më impozante – të Hadum Agës - më 1001-1003 sipas kalendarit të Hixhrit (viteve 1592-1594). Deri atëherë ekzistonte vendbanimi homonim qëndror fshatar ku mbahej tregu favor i kësaj ane. Mirëpo, “vetëm rrëth një gjysmë shekulli pas ngritjes së Xhamisë së Hadum-agës, Gjakovën e përshkruajnë të huajt si qytet me zjtarë e tregti të spikatur” (Lleshi, *vep. cit.*: 40). Lidhur me Gjakovën dhe themelin e saj, posaçërisht me emrin e saj, është i rëndësishëm edhe versioni popullor. Këtë na paraqet J. Osmani, që thotë:

Sipas traditës popullore, këto objekte të rëndësishme të qytetit janë ndërtuar në fushën e Jak Vulës, e prej këtej është emërtimi i qytetit Jakovë. Rrëth xhamisë së Hadumit është ndërtuar Çarshia e Madhe. Në afërsi të saj janë vendosur shtëpitë e beglerëve. Këta ndërtuan kulla të mëdha në sheshin e quajtur Fusha e Sahatit (Osmani, *vep. cit.*: 147)

Sipas këtyre të dhënavë, duket se Gjakova, pas një zhvillimi të shpejtë në mesin e shek. XVII, arrin të jetë njëri prej qyteteve më të mëdha në Kosovë. Në anën tjetër, bëhet edhe një prej qendrave më të rëndësishme shoqërore, ekonomike, politike dhe strategjike, duke u tërhequr vëmendjen edhe shumë misionarëve e diplomatëve,

klerikëve, udhëpërshkruesve dhe shkencëtarëve të kohës (Bajraktari, *vep. cit.*: 23). Këtë e dëshmojnë edhe shumë nga shkrimet e atyre që kishin pasur rastin të kalojnë nëpër këtë rajon, si:

Arqipeshkvi i Tivarit Gjergj Bardhi në vitin 1637/38, raportin e vet e fillon me Gjakovën, i cili po ashtu dhe gjatë vizitës tjetër në vitin 1641/42 përmend Gjakovën.

Gjeografi turk Haxhi Kallfa (rreth vitit 1635) e përmend Gjakovën- Jakova- qytezë e vogël gjendej ndërmjet Pejës, Vushtrisë, Prishtinës e Prizrenit. Ndërsa për Altun-Ili, shkruan se gjendet: ndërmjet Pejës, Gjakovës, Podlimën. Prefekti i misioneve katolike në Shqipëri, Fra Kerubini, më 27 mars 1638 shkruante veç tjerave: "...Si të kalohet një gjysmë dite prej Gashit, gjendet krahina e Jakovës në një fushë shumë të bukur, ku ka shumë fshatra...." (Osmani, *vep. cit.*: 147)

Dokumentimi historiografik i Gjakovës i ka fillet nga në shek. XVI, gjegjësisht në vitin 1598, kur përmendet për herë të parë në dokumentet e udhëpërshkruesit turk Evlia Çelebia. Ishte pikërisht ky udhëpërshkrues osman, që për herë të parë më 1662 e përmend Gjakovën si qytet. Sipas tij, Gjakova ishte një vendbanim i përparuar, gjakovarët ishin njerëz të mirë dhe të bukur dhe se kishte pasur 2000 shtëpi, dy xhami të bukura, hane të mbuluara me plumb, një hamam dhe 300 dyqane me shumë lloj mjeshtërish (Rizvanolli, 2009b: 9; Haxhibeqiri, 2011: 11).

Gjakova ishte përmendur edhe nga misionarë tjerë të ndryshëm, që kishin kaluar këndeja parë. Kështu, "Misionari i papës, Shtjefën Gaspri, vendos Jakovën me 1671, në rangun e qyteteve kryesore të Kosovës" (Zajmi Sh. & B. 2010: 13). Po ashtu, edhe në disa raporte austriake nga fundi i shek. XVII përmendet Gjakova, e cila vlerësohet se kishte edhe shumë katunde. Disa të dhëna për Gjakovën i dëshmon edhe ky shënim:

Udhëpërshkruesi rus A. Gilferding, i cili, gjatë udhëtimit të tij nëpër Hercegovinë, Bosnjë dhe Kosovë, e vizitoi më 1857 këtë trevë dhe shkruante, se Gjakova ishte qyteti i banuar nga shqiptarët, ku mbizotëronte mënyra fisnore e jetës. Bazën e mënyrës të jetesës së shqiptarëve të këtushëm, sipas tij, e përbënë fisi. Në Gjakovë, sipas tij, elementi shqiptar është më i theksuar se në çdo vend tjetër (Osmani, *vep. cit.*: 150)

Zbulimet arkeologjike në territorin e Gjakovë tregojnë se në këtë hapësirë është i pranishëm procesi i organizuar i jetës urbane qysh në kohërat më të lashta. Kështu, me të gjitha vlerat kulture shqiptare, arkitektura, skulptura, doket dhe zakonet dardane të trashëguara nga antikiteti, koha e Romës, Bizantit, Mesjeta, Osmanët dhe plotësimi me ndërtime të reja, ruajnë një vazhdimësi të theksuar. Përkundër të gjitha këtyre sfidave, Gjakova arriti të ruajë gjuhën, kulturën dhe traditat shqiptare, duke u bërë qyteti me traditën më të hershme letrare dhe kulturore.

Pas shpalljes së pavarësisë së shtetit Shqiptar, Gjakova u pushtua nga serbo-malazezët, të cilët vazhduan me shkatërrime të çdo gjëje, me popullimin e saj me serb e malazez e deri te asimilimi dhe konvertimi i popullatës së kësaj ane. Gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore, Gjakova me rrëthinë ishte nën sundimin e Austro-Hungarisë dhe pas luftës përsëri e ripushtuan serbo-malazezët duke kryer kolonizime thuajse në çdo pjesë të saj. Edhe organizimi i jetës shoqërore në aspektin administrativ dhe atë territorial varej nga sunduesit, me ç'rast kohë pas kohe pësonte ndryshime në bazë të interesave të tyre pushtuese. Këto procese dhe zhvillime ndikuan që në këtë trevë të bëhen disa ndarje administrative. Sipas J. Osmani:

Sa i përketë ndarjes administrative të trevës së Gjakovës, ajo sipas defterit të vitit 1485, ishte qendër pazari, ashtu si katundi Junik. Në atë kohë ishte e përfshirë në ziametin e Deçanit, e jo në atë të Altun-ilisë. Në shek. XV dhe XVI, përkatësisht sipas defterit të Sanxhakut të Shkodrës të vitit 1485 treva e Gjakovës ishte në kuadër të këtij sanxhaku, përkatësisht Nahisë së Altun-Ilisë dhe Demoshtiqit etj. më pastaj Gjakova ishte në kuadër të Sanxhakut të Prizrenit, përkatësisht të Dukagjinit (Osmani, *vep. cit.: 62*)

Derisa në shek. XIX, Gjakova me rrëthinë posedonte një hapësirë territoriale shumë më të madhe se sa sot, pushtimi nga serbo-malazezët në vitin 1913 ia dha edhe formën administrative të sotme. Pas vitit 1963 nuk janë bërë ndryshime territoriale e administrative. Kështu që sot komuna e Gjakovës shtrihet në jugperëndim të Republikës

së Kosovës, me koordinatat  $42.39^{\circ}$  gjerësi gjeografike veriore dhe  $20.43^{\circ}$  gjerësi gjeografike lindore.

Gjakova me rrethinë zë pjesën qendrore të rrafshit të Dukagjinit, përbëhet prej 88 vendbanimeve dhe ka sipërfaqe prej  $587 \text{ km}^2$ , me pjesëmarrje në territorin e Republikës së Kosovës prej 5.38%. Në një pozitë strategjike në mes të Veriut të Shqipërisë dhe qendrës së Kosovës, Gjakova shtrihet në lartësi mbidetare prej 365 metash, kurse në viset malore arrin lartësinë deri në 2305 metra, gjë që na bën të kuptojmë se diferenca e reliefit është mjaft e theksuar. Në bazë të Atllasit të Regjistrimit të Popullsisë së Kosovës, Gjakova me rrethinë ka 94.556 banorë, me dendësi mesatare prej 161.1 banorë për një kilometër katror<sup>12</sup>. Dendësi më të madhe të banorëve për  $\text{km}^2$  e kemi në zonat urbane të qytetit, respektivisht në segmentet që gravitojnë rreth qendrës së qytetit e cila në përbërjen e saj ka shumë ndërtesa të banimit kolektiv, dendësi e cila arrin deri në 1.000 banorë për  $\text{km}^2$ . Nga përbërja etnike, 95% janë shqiptarë.

Periudhat e ndryshme gjatë historisë, popullsinë e kësaj ane e kishin sfiduar mjaft, duke përfshirë këtu shkaqet historike e natyrore, migrimet e shumta dhe epidemitë. Përkundër gjithë këtyre, kjo ka mbijetuar, dhe sot, me 95% të popullsisë shqiptare, Gjakova me rrethinë përbën vendbanimin më homogjen të strukturës kombëtare. Kjo dëshmon se popullsia e kësaj treve është përcjellur me shtim mjaft të madh.

Edhe në Gjakovë, lufta e fundit, përveç viktimave, shkaktoi edhe shumë shkatërrime, gjendje të rëndë ekonomike dhe varfëri, pasojat e të cilave janë të pranishme edhe sot e kësaj dite. Këto detyruan zhvendosjen e shumë familjeve prej një zone në tjetrën, brenda vendit dhe jashtë tij.

---

<sup>12</sup> *Atlati i regjistrimit të popullsisë Kosovë, 2011*

Gjatë periudhës së luftës 1998-1999, forcat ushtarako - policore dhe paramilitare serbe dogjën në qytetin e Gjakovës 1654 shtëpi e 600 lokale afariste si dhe 3500 shtëpi në 84 fshatrat e këtij rajoni (Haxhibeqiri, *vep. cit.*: 13). Rreth 1500 shtëpi janë shkatërruar deri në themel. Prej 84 fshatrave të kësaj komune, 69 syresh janë shkatërruar deri në 90%. Rreth 40.000 qytetarë nga zonat rurale u strehuan në qytetin e Gjakovës. Kjo zhvendosje vazhdon edhe sot, sidomos në drejtim të zonave urbane, gjë që ka vështirësuar edhe më tepër burimet primare për jetë edhe në ato zona. Disa zhvendosje janë bërë e bëhen për shkaqe se lufta iu ka shkatërruar të gjitha, kurse disa për të siguruar punë, pasi nëpër zonat urbane ishin të përqendruar organizata e ndryshme ndërkombëtare.

#### **4. 2 Trashëgimia kulturore dhe risitë e jetës shoqërore në Gjakovë**

Zhvillimet gjatë historisë ndikuan dukshëm edhe në çështjen antropologjike në përgjithësi të paraardhësve të popullit shqiptar, e po ashtu edhe në atë të Gjakovës dhe rrëthinës së saj. Bazuar në dokumentet historike, Gjakova si vendbanim është shumë i hershëm, por si qytet bën pjesë në qytetet më të reja të Kosovës. Është më se e vërtetë se kulturat, sidomos kur janë në interes të shoqërisë, barten lehtë dhe në forma të ndryshme prej një individi a grupei deri te shtetet dhe më gjerë. Kështu që, ajo kulturë që arrin të dominojë një kohë të tjerat, sigurisht do të bëjë presion mbi to, duke pretenduar t'ua zërë vendin, në mos tërësisht, së paku pjesërisht. Andaj, “secili duhet të mbajë parasysh se një kulturë është dinamike dhe gjithmonë në ndryshim, ndërkohë që ushtrohen presione të reja ose të përsëritura mbi të” (Kesing & Andrew, *vep. cit.*: 35).

Zhvillimet historike që karakterizuan Ballkanin, sidomos nga shekujt e parë të erës sonë, sollën depërtimin e kulturës romake në tërë rajonin, e cila bëri shumë presione mbi kulturën ilire dhe kulturat e tjera. Po ashtu, pretendime ndikuese u zhvilluan edhe

me rastin e ndarjes së Perandorisë Romake në Perandorinë e Lindjes dhe të Perëndimit. Më pas vjen depërtimi i bizantinëve në trojet iliro-dardane, ku vendi përfshihet nën ombrellën e kulturës bizantine. Po ashtu, gjatë Mesjetës së hershme, në Ballkan depërtojnë sllavët, vendosja e të cilëve ndryshoi dukshëm hartën etnike të Gadishullit Ballkanik. Megjithatë, gjatë kësaj kohe kemi edhe një lulëzim të kulturës së hershme shqiptare dhe në veçanti të asaj gjakovare. Zhvillimet kulturore vareshin nga shumë faktorë, kështu që, sikur edhe shumë shoqëri të kohës, edhe shoqëria gjakovare pati veçantitë e saj. Prandaj, J. Osmani shprehet:

Pozita e përshtatshme gjeografike, rëndësia strategjike dhe faktorët tjerë bënë të mundur që qyteti të zhvillohet shumë shpejt për një kohë të shkurtër, me një zejtari dhe tregti mjaft të zhvilluar, në lidhje tregtare me Shkodrën, rrafshin e Kosovës, Sanxhakun dhe vendet tjera të Ballkanit. Këto të dhëna dëshmojnë për zgjerimin e qytetit për një kohë të shkurtër, d.m.th. Gjakova në atë kohë ka qenë qytet në kuptimin e vërtetë të fjalës (Osmani, *vep. cit.*: 148)

Pikërisht, kjo mundësoi që Gjakova për një kohë të shkurtër të bëhet qendër me rëndësi të shumëfishta, si: zejtare, tregtare, arsimore, politike, kulturore. Ky zhvillim i shpejtë ishte si rrjedhojë e pozitës së mirë që kishte, qoftë nga ana gjeografike, ashtu edhe nga ajo strategjike, të cilat i mundësuan të krijonte lidhje jo vetëm me vendet përreth, por edhe me ato të Ballkanit dhe të Evropës. Pikërisht, “këto të dhëna dëshmojnë për zgjerimin e qytetit për një kohë të shkurtër, d.m.th. Gjakova në atë kohë ka qenë qytet në kuptimin e vërtetë të fjalës” (Osmani, *po aty*: 148).

Edhe përkundër të gjitha këtyre ndryshimeve, kultura dhe tradita e kësaj ane zhvillohet si kulturë autoktone dhe krahas procesit të Indoevropianizimit. Rrebeshet shekullore, edhe pse gjymtuan shumë nga tradita dhe kultura e kësaj ane, kjo prapë se prapë mbijetoj. Edhe pse nuk kemi dokumente të shkruara, nga zbulimet arkeologjike dhe të tjera, është vërtetuar se ata kanë pasur kulturë të lartë materiale dhe shpirtërore. Kanë

qenë mjeshtër të njohur në përpunimin e metaleve, në ndërtimin e anijeve, në prodhimin e enëve dhe stolive të ndryshme prej qeramike, ndërtimtarë të kështjellave dhe të qyteteve etj. Autorët e ndryshëm të huaj, të cilët janë marrë me studimet albanologjike, sidomos me ato etnologjike, historike e sociologjike, kanë konstatuar edhe nga përvoja e tyre, nga qëndrimet e tyre ndërmjet shqiptarëve, se, në traditën e tyre, vend të parë zënë: besa, mikpritja, burrëria dhe trimëria. Nga tiparet e këtilla kemi edhe këtë fakt:

Besa e fortë i ka bërë njerëzit heronj, por ajo shqiptarëve u ka bërë edhe dëm në raste të caktuara, sepse e mbanin besën edhe nëse e kërkonte armiku i tyre. Kështu ka qenë rasti i gjeneralit turk Ali Pashë Maxharrit, i cili kishte ardhur në Gjakovë me ushtri kundër kryengritësve shqiptarë. Por kur e shesh veten ngushtë, ai kërkon besën nga Abdullah Pashë Dreni i Gjakovës, i cili e strehon bashkë me repartin ushtarak turk në kullat e veta dhe lufton kundër vëllezërve të vet shqiptar për ta shpëtuar armikun e tyre (Krasniqi, 2002: 136)

Rreth vitet të dyzeta të shek. XIX, edhe në Gjakovë filluan të paraqiten elementet e para të marrëdhënieve kapitaliste, duke lënë anash ato feudale të deri atëhershme. Kjo solli edhe kapitullimin e sistemit të esnafave të njohura gjakovare që nga koha e mesjetës, përmes së cilave organizohej zejtaria, si dhe hapjen e tregut mes qyteteve tjera dhe vendeve edhe jashtë Kosovës. Me këtë rast kjo solli edhe një ekonomi më stabile dhe të fortë.

Bazuar në argumente toponimike, Gjakova me rrëthinë na shfaqet me numrin më të madh të vendeve me emërtime të pastra në gjuhën shqipe, duke ruajtur gjurmët e vjetra me prejardhje të lashtë shqiptare. Pikërisht, “nëpërmjet toponimeve të vendbanimeve dëshmohet ruajtja e gjuhës dhe historia e së kaluarës, sepse toponimet janë gjurmë të së kaluarës shpirtërore dhe materiale të popujve” (Osmani, *vep. cit.*: 77).

Me fillimin e bombardimeve nga forcat e NATO-s, me 24 mars 1999, forcat ushtarake e paramilitare serbe dogjën dhe rrënuan pamëshirshëm shumë objekte të rëndësishme, si pjesë e trashëgimisë kulturore e historike të Gjakovës, ndër të cilat edhe xhaminë e

Hadumit me të gjitha objektet përcjellëse, përfshirë mejtepin, bibliotekën e xhamisë me të gjitha librat si dhe kronikën e qytetit të Gjakovës (sixhilin), ku ishin të ruajtura të gjitha ngjarjet e rëndësishme të Gjakovës me rrëthinë që nga themelimi i saj. Po ashtu, ata dogjën dhe shkatërruan edhe Çarshinë e Madhe, teqenë e Bektashinje dhe shumë objekte tjera nga trashëgimia kulturore (Haxhibeqiri, *vep. cit.*: 11). Gjatë kësaj lufte, Gjakova me rrëthinë mbetet si vendi më i shkatërruar nga katrahura serbe, qoftë për nga dëmet materiale, ashtu edhe për shkatërrimet njerëzore. Këto i paraqet edhe autorri J. Osmani, që thekson:

Zjarrit nuk i shpëtuan as objektet me vlera arkitektonike historike të pakontestueshme si: Qarshia e Madhe e qytetit, kullat me arkitekturë originale shqiptare, xhamia e Hadumit, mejtepi, biblioteka e cila ka pasur mbi 2000 libra, prej të cilave 150 kanë qenë originale dhe unikale, kompleksi i Teqesë së Bektashinjëve (Osmani, *vep. cit.*: 54)

Në Gjakovë dhe trevat e saj kanë jetuar dhe jetojnë edhe sot shqiptarët që i takojnë besimeve islam me degët e sunitëve dhe shiitëve dhe të krishterë, të cilët gjithmonë kanë dëshmuar raporte shumë të mira mes vete dhe se janë shembull për të gjitha vendet, qoftë edhe për ato me demokracinë më të zhvilluar.

#### 4.2.1 Jeta kulturore

Giddens mendon se “kultura i referohet gjithë mënyrës së jetesës së anëtarëve të një shoqërie” (Giddens, *vep. cit.*: 43). Ndërsa, zhvillimin e jetës kulturore dhe faktorët ndikues, autorja N. Falaski i paraqet kështu:

Gjithmonë kemi menduar dhe shkruar se kultura i takon tërë njerëzimit, pa marrë parasysh se nëse gjatë kalimit të shekujve ajo ka lulëzuar më shumë në një hapësirë se sa në një tjetër të planetit tonë. Janë faktorët klimatikë, historik, politikë që e ndryshojnë drejtimin e zhvillimit të ngjarjeve sipas ndryshimeve gjeografike ose kozmike, duke e ndryshuar drejtimin e kulturës, ndonjëherë, në mënyrë të furishme, e ndonjëherë gradualisht, me valë, kah rrugët e ndryshme, apo në rrugë të ndryshme (Falaski-Vlora, *vep. cit.*: 205)

Një proces të tillë të zhvillimit dhe ndryshimit të pandërprerë të kulturës, qoftë brenda vetes, qoftë nga ndikimet e jashtme, e ka përcjellë edhe popullin shqiptar dhe paraardhësit e tij. Megjithatë, ky popull u mbijetoi të gjitha presioneve të kohës dhe historisë duke ruajtur etnokulturën e pastër të përcjellë gjeneratë pas gjenerate.

Tradita kulturore e kësaj ane është e ndërlidhur njëjtë me atë shqiptare në përgjithësi, e njohur që nga koha eneolotike dhe e zhvilluar si autoktone. Kjo kulturë rrugëtimin e vet e zhvillon në hapat e ndryshimit të kohërave dhe të përparimit të saj. Iшин këto periudha ku vërtetë kishte lëvizje dhe lulëzime të mëdha në rrafshin kulturor në të gjitha shoqëritë njerëzore, duke qenë të pashmangshme edhe huazimet e ndërsjella. Megjithatë, këmbëngulja dhe vijimësia e qëndrueshme në trevat e veta bëri vetëm formësimin e pandërprerë të kulturës së këtij rajoni, duke qenë autoktone dhe duke arritur shkallën më të lartë të zhvillimit.

Vetë fakti i ekzistimit në trevat e veta dhe ruajtja e kulturës dhe gjuhës janë dëshmi mbi lashtësinë shekullore të kësaj popullsie. Sipas Shevqet Canhasi, burrat e Malësisë së Gjakovës dhe ata të malësive tjera shqiptare nëpër shekuj kishin qëndruar së bashku si vëllezër dhe se falë këtij bashkimi i ruajtën të paprekura gjuhën, zakonet, traditat, veshjen, mënyrën e jetesës, këngët e vallet dhe kulturën në përgjithësi, për të cilat nuk kishin kursyer gjakun dhe jetën. Pra, ishin këto tradita që përballuan rrebeshet shekullore të pushtuesve të ndryshëm (Canhasi, 2004).

Edhe pse dokumentet janë të pakta, së paku deri me tani, për kulturat kjo nuk paraqet ndonjë pengesë, sepse shpesh herë ato nuk janë të shkruara, por ato transmetohen dhe përcillen gojarisht nga gjenerata në gjeneratë brenda grupit të shoqërisë, siç është rasti tipik i kësaj treve. Është e kuptueshme se kultura ndryshon prej një shoqërie në tjetrën,

por ndryshon edhe brendapërbrenda shoqërisë prej në kohe në tjetrën. Megjithatë, treva gjakovare është e njohur për ruajtjen ‘e paprekur’ të traditave dhe kulturës që nga etnogjeneza e vet.

Disa nga karakteristikat e veçanta të ruajtjes dhe përcjelljes së traditave kulturore në këto anë veçohen nga autorë të ndryshëm. Autori M. Rizvanolli, përmend ndër tjetra:

Në shekullin e XVIII në Gjakovë përmendet mjeshtri i famshëm i armëve Tush dyfektxhija, i cili merrej jo vetëm me prodhimin, por edhe me zbukurimin e tyre....., i cili arriti të krijojë “shkollën popullore” të kësaj mjeshtrie. .... Sipas studiuesit bullgar të shekullit XIX, Mihov, edhe Gjakova renditej ndër qendrat më të rëndësishme të prodhimit të armëve të luksit..... Dyfektxhinje të Gjakovës iu kishte dalë zëri për prodhimin e pistoletave “Gjakova”, “vlera e të cilave qendronte veçanërisht në bukurinë e mollëzës së qytës së rrumbullakët apo rruazare” (Rizvanolli, 2009b: 10-11)

Rreth prodhimit të armëve është shprehur edhe autor i J. Bajraktari, që thotë:

Prodhimi i armëve ishte nga degët më të zhvilluara të zejtarisë së Gjakovës. Prodhoheshin sasi të mëdha pistoletash dhe pushkësh të gjata, të cilat shiteshin në të gjitha provincat e Rumelisë. Disa nga këto armë ishin me emër për zbukurimet e tyre dhe shiteshin me çmimë të larta (Bajraktari, *vep. cit.*: 50).

Edhe gazetari anglez Mehju jep panoramë interesante për Gjakovën. Sipas tij, “shqiptarët nuk janë vetëm punëtorë dhe të aftë për punime të ndryshme dore, por vendi ka disa prodhime të rralla, të cilat nuk qëndrojnë aspak prapa prodhimeve artistike të kryeqyteteve tona perëndimore” (Rizvanolli, 2009b: 13).

Në anën tjetër, sipas J. Osmani,

Gjakovën në fillim të shek. XX e pëershkuaran edhe Sami Frashëri në veprën “Qamus-ul alam”, ku ndër tjetra shkruan: banorët e Gjakovës janë të njohur për mikpritje. Merren edhe me tregti dhe zejtari. Janë terzinj të mirë. Ka edhe kazazë të shquar. Regjin lëkurë, prodhojnë këpucë dhe gjësende të tjera. Nga mesi i gjakavarëve ka pasur gjithmonë dijetarë dhe myderrizë të zgjuar (Osmani, *vep. cit.*: 152)

Qytetarët e këtyre trevave ishin të pasionuar edhe për librin. Ata librat i trajtonin me kujdes. Madje, sipas M. Rizvanollit,

një zeje tjetër interesante, karakteristike, si duket, vetëm për Gjakovën, ishte zeja e liberalidhësve, të cilët në dyqanët-punishtet e tyre, merreshin me lidhjen e librave dhe të dorëshkrimeve të ndryshme, me ndreqjen-riparimin e librave të vjetër të dëmtuar nga përdorimi i gjatë apo nga ndonjë dëmtim tjetër (Rizvanolli, 2009b: 18)

Ata me mençuri ditën të shfrytëzojnë edhe pozitën gjeografike të këtij territori, duke e shndërruar në një vend të njojur tregu, që ndikoi edhe në zhvillimin e shpejtë të saj. Kjo e bëri Gjakovën vend të rëndësishëm dhe urë lidhëse jo vetëm mes qyteteve të Kosovës, por edhe më gjërë, ku vendin kryesor e zinte zejtaria.

Ndërtimi apo kultura materiale është karakteristike në këto anë. Këtu bëhet fjalë për një numër të konsiderueshëm të monumenteve të trashëgimisë kulturore që Komuna e Gjakovës disponon. Disa nga aspektet që e veçojnë traditën dhe kulturën e kësaj treve ishin: Ndërtimi i urave mbi lumin “Erenik”, nga esnafët, pra Ura e Terzive më 1730 dhe ajo e Tabakëve më 1790, që ishin objekte të veçanta të asaj kohe; disa nga familjet gjakovare kanë përcjellur nëpër gjenerata zejen e të parëve të tyre, e cila edhe sot ruhet jo vetëm si zeje por edhe për nga mbiemrat e tyre, si: Sahatçija, Furra, Nallbani, Kamishi etj; në mungesë të mjeteve të komunikimit, nëpërmjet kasnecit, përhapesha lajmet në çarshi; në çarshi vendoseshin sullet për të mënjanuar dukuritë negative, aty fillonte procedura e fejesave dhe “ndahej vadja” e martesave. Po ashtu, si vend më neutral, këtu bëhej pajtimi i gjaqeve mes familjeve të ndryshme. Pra, në qytetin e Gjakovës përmes sullevë ishin të ndaluara gjakmarrjet për një kohë shumë të gjatë (Rizvanolli, 2009b: 24-32).

Trendi i zhvillimeve shoqërore përcillej hap pas hapi edhe nga popullata e kësaj ane. Kjo u dha mundësi që ata të kenë qasje dhe të kontribuojnë në të mirë jo vetëm të veten por edhe të tjerëve dhe atë në të gjitha sferat e jetës. Ata u kyçën në politikë, ekonomi, art e kulturë, duke u bërë të rëndësishëm për tërë shoqërinë shqiptare në Kosovë e më gjërë. Në fillim të shek. XX, kjo popullsi përqafoi ndryshimet e fuqishme shoqërore e politike si dhe ato kulturore e arsimore.

#### **4.2.2 Zhvillimi i arsimit**

Duke iu referuar hulumtimeve të deritanishme rezulton se argumentimi i shkrimit të shqipes nuk është edhe shumë i vjetër, krahasuar me vet vjetërsinë e popullit. Kjo dëshmohet me dokumentimet e tij të vonshme. Kështu, sipas M. Tërnava theksohet se:

Në bazë të të arriturave të deritanishme të dijes së historisë dhe të albanologjisë në përgjithësi, dihet se dokumenti i parë që përmend gjuhën shqipe, daton nga gjysma e dytë e shekullit XIII, konkretisht, më 1285. Të dhëna burimore të drejtpërdrejta mbi gjuhën shqipe në truallin e sotëm të Kosovës gjatë shekujve XIV, XV dhe XVI, s'ka, ose edhe ato që ruhen janë tejet fragmentare dhe i kushtohen vetëm ndonjë lokaliteti të caktuar, kështu që nga to nuk mund të nxjerrim njohuri të plota mbi pozitën e gjuhës shqipe në këtë trevë (Tërnava, 1995: 212)

Megjithatë, nga ana tjetër, bazuar në të dhënrat e gjetura përmes toponimeve si dhe udhëpërshkruesve të ndryshëm, dëshmohet se kemi të bëjmë me një popullsi aktive dhe me një gjuhë të gjallë. Shihet se përpjekjet për të ruajtjen e etnisë shqiptare bashkë me traditën, zakonet dhe kulturën nga pushtimet e shumta, dalin të jenë në rend të parë, ndërsa pushtimet kishin arritur të pengonin të shkruarit e saj dhe pikërisht për këtë sot kemi një dokumentim faktik të mëvonshëm. Pra, pavarësisht se ishte folur në gjuhën amtare të kësaj ane, dokumentimi me shkrim mungon dhe për këtë vjen shumë vonë.

Megjithatë, përkundër të gjitha këtyre sfidave, Gjakova kishte arritur të ruajë zakonet, traditat, gjuhën dhe kulturën e vet shqiptare, gjë që e bën edhe sot si vendbanimin me të

hershëm në këtë drejtim. Është më se e kuptueshme se shkrimet fillimisht kishin vlera dhe karaktere fetare. Librat e parë të shkruar gjindeshin në objektet fetare. Sipas M. Rizvanollit:

Gjakova ka një traditë të pasur të arsimit dhe kulturës, traditë, e cila filloj qysh me fillimin e jetës qytetare në te, qysh kur Sylejman Hadum Aga ndërtoi dhe vakëfoi, në vitin 1003 H (1594/1595), pos hanit, hamamit dhe disa dyqaneve, një xhami, një shkollë (mejtep), një bibliotekë dhe një muvakin-hane, një “objekt për matjen e kohës dhe për përcaktimin e kalendarit me ndihmën e kuadranteve astrolabike”. Sipas traditës gjakovare biblioteka e Hadum Agës ishte aq e pasur me libra sa që thuhej se “kush donë me e pa Çaben le ta vizitojë bibliotekën e Hadum agës”. Biblioteka ishe më e madhe se vet xhamia” (Rizvanoli, 2009a.: 11)

Janë këto që kontribuan shumë, ashtu që pikërisht Gjakova të bëhej qendër arsimore. Këtë epitet ia japid edhe themelimi i ‘medresesë së madhe’, rreth viteve 1707 dhe asaj të ‘vogël’, rreth viteve 1815-1816, m’u për shkak të numrit të madh të interesuarve për të ndjekur mësimet në gjuhën shqipe (Rizvanoli, 2009a). Këtu mësohej jo vetëm përfenë, por edhe për çështjen kombëtare, madje në Medresenë e Madhe, mësimet në shqip ishin zhvilluar edhe gjatë kohës së ish-Jugosllavisë, e cila thuajse kishte ndaluar krejt përdorimin e kësaj gjuhe.

Ishin reformat e tanzimatit që mundësuan hapjen e shkollave turke në Gjakovë - shkolla filllore dhe gjimnazet e ulëta, ndërsa më 1851 daton hapja e shkollës shqipe në Gjakovë. “Sipas sallnamesë së vitit 1893 në Gjakovë kishte 15 shkolla filllore me 1101 nxënës dhe një gjimnaz të ulët me 120 nxënës. Me 1900 kanë ekzistuar edhe dy gjimnaze të ulëta” (Rizvanoli, 2009a: 16). Por, shkollat shqipe në Gjakovë i gjemjë edhe më fillim të shek. XX, sidomos pas fitores së Revolucionit Xhonturk.

Hapja e shkollave shqipe dhe interesimi për shkollim dhe edukim i qytetarëve të kësaj ane ishte jashtëzakonisht i madh. Autorët M. Rizvanoli dhe J. Osmani e përshkruajnë kështu këtë arritje kulturore:

Pos mësimit shqip, në fillim të këtij shekulli, në Gjakovë u përhapën edhe librat dhe gazetat shqipe. Në gazeten “Liria” të Selanikut, në një korrespondencë të të 3 dhjetorit 1908 nga Shkupi me titull “Leter pi Kosove”, pos tjerash, lexojmë: “*Ndër të gjitha qytetet e Kosovës ma të kënaqun jemi për Gjakovën për kah ana e shqyptarizmit. Prej kti vendi marrim lajme të mira, ku na diftojn qì nji pjes e madhe e vendalive kanë msue me knu e me shkrue gjuhën e vet. Gjakovasit përpilen për me çil një msonjtore shqqyp, e kemi uzdaj qì ky mendim ka me u pëlqye prej krejt gjytetit ..... Shpnesojm, pra, qì Gjakova ka me ken shembull edhe i tjerave qytete në Gegni e sidomos në Kosovë, ....*” (Rizvanolli, 2009a: 23-24; Osmani, vep. cit.: 153)

Një fakt tjetër në këtë drejtim e paraqet edhe J. Bajraktari, sipas të cilit, në njërin nga artikujt e gazetës “Liria”, nga një mësues i Gjakovës thuhej se “dëshira e mësimit shqip nga dita në ditë po përparon. Numri i atyre që dinin të këndojnë shqip s’ish më tepër se 300 kur sot janë më shumë se 1000 veta që këndojnë dhe shkruajnë gjuhën tanë...” (Bajraktari, vep. cit.: 324-325). Edhe gazeta e Sofjes “Shqypeja e Shqypënis” e 15 korrikut 1909, kishte shkruar për përkushtimin e mësimit të gjuhës shqipe në Gjakovë, sipas së cilës “i madh e i vogël” kanë filluar të mësojnë gjuhën shqipe (Rizvanolli, 2009a).

Gjatë kohës së Luftës së Parë Botërore, edhe përkundër presioneve të kohës nga sllavët, në Gjakovë dhe Kosovë mundësohen disa favore për shkollat shqipe. Gjatë kësaj kohe shkolla e parë shqipe në Gjakovë quhej “Skënderbeg”. Pastaj është themeluar një shkollë e veçantë për vajza. Pastaj, në Gjakovë u hap një kurs për të rriturit që ishin analfabetë, ku më 1918 i vijonin mësimet “150 persona të rritur moshe prej 18-40 vjeçare”. Mësuesit e shkollave shqipe të qytetit të Gjakovës ndihmuani shumë në zgjerimin e rrjetit shkollor nëpër fshatra dhe qendra të tjera të Kosovës (Rizvanolli, 2009a: 30)

Pas mbarimit të luftës së parë botërore me 1918 u mbyllën të gjitha shkollat shqipe në Kosovë dhe atë deri në luftën e dytë botërore. Kështu, pas kapitullimit të Jugosllavisë me 1941, në Gjakovë janë hapur tri shkolla shqipe, në të cilat punonin mësuesit e vjetër

gjakovarë, mësuesit e rindjeve dhe mësues nga Shqipëria. Më 1942 hapet shkolla normale “Gjon N. Kazazi”, godinën e së cilës e ndërtoi vet populli i Gjakovës. Ajo hapi dy paralele kursi përfshirë femra.

Përfundimi i Luftës së Dytë Botërore solli edhe hapjen e Normales së vetme në gjuhën shqipe, e cila shërbeu përfshirë aftësimin e mësuesve. Më 1967 hapet Shkolla e Lartë Pedagogjike, i vetmi institucion i arsimit të lartë në ish-Jugosllavi, ku mësimet zhvilloheshin vetëm në gjuhën amtare shqipe.

Bazuar në këto vërtetohet se Gjakova me rrëthinë gjatë së kaluarës nuk kishte mundur të ndërtonte një traditë të mirëfilltë dhe të njojurë në aspektin e arsimit, por ishte detyruar të improvizojë varësisht nga situatat dhe rrëthanat e krijuara, por që asnjëherë nuk ishte ndaluar së vepruar. Bile shumë herë kishte ngjarë që të rinjtë e kësaj ane të shkolloheshin edhe jashtë Gjakovës apo edhe jashtë Kosovës. Kjo këmbëngulje e tyre përfshin zhvillimin e arsimit bëri që ata shumë shpejt të përparojnë dhe të bëhen një nga qendrat më të njoitura.

Këtë e argumenton edhe ajo se “Gjakova, vërtetë, asnjëherë në historinë e vet 350 vjeçare gjerë në momentin e hapjes së Normales më 1946, nuk pati fatin të ishte seli e ndonjë shkolle të mesme laike të çfarëdo lloji qoftë” (Lleshi, *vep. cit.*: 50). Për të vijuar, “madje as edhe asnjë themelatë tjetër kulturore e superstrukturore” (Lleshi, *po aty*: 52). Pikërisht ishte kjo shkollë që mund të themi se u bë si vatra më e rëndësishme dhe si celulë me ndikim në edukimin e qytetarëve jo vetëm të kësaj treve, por edhe më gjërë. Ishte kjo shkollë, nga gjiri së cilës u formuan personalitetet të dëshmuara në fushën e artit dhe shkencës, jo vetëm në Kosovë, por edhe në nivele ndërkombëtare.

Andaj, edhe pse realisht tradita e arsimit dhe edukimit shqip në Gjakovë është e hershme, peripecitë e kohës dhe apetitet e të huajve ndikuan në krijimin e arsimit stabil dhe me themel dhe atë deri në kohërat e vona.

#### **4.3 ‘Prerje’ antropologjike dhe kriminologjike e popullsisë së Gjakovës me rrethinë**

Përkundër evoluimeve shoqërore, secila shoqëri me fanatizëm mundohet ta ruaj traditën dhe kulturën e vet. Pjesë e këtyre ‘ruajtjeve’ ishte edhe shoqëria shqiptare gjakovare. Bazuar në rrethanat antropologjike dhe historike që përjetoi kjo shoqëri, domosdo që iu imponua të mbahej e ‘mbyllej’ në vetvete. Pikërisht falë një izolimi të tillë shoqëror të tyre, u ruajtën traditat shoqërore e kulturore që nga koha e vjetër. Ky izolim nuk ishte vetëm te populli shqiptar, pasi që “duke u përballur më kërcënime të jashtme, disa popuj e morën dhe e kthyen konservatorizmin tradicional në mburojën e tyre për mbijetesë; ishte një mënyrë për të ruajtur identitetin e tyre kulturor dhe individual” (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 389).

Pra, ishin ato tradita kulturore që organizonin jetën në shoqërinë shqiptare edhe në aspektin social, qoftë edhe atëherë kur mungonte organizimi shtetëror, qoftë edhe pas shtetësisë. E tërë ajo organizohej përmes normave shoqërore të kohës. Disa nga normat e tillë vazhduan edhe pas shpalljes së ligjeve. Në rrethana të caktuara, normat shoqërore në aspektin social, edhe pas marrjes së përgjegjësisë nga ana e shtetit për mirëqenien sociale dhe atë përmes institacioneve, vazhduan në formën morale dhe ishin prezente aty ku ishte nevoja, duke filluar nga individi, familja apo edhe pjesë të shoqërisë. Kjo është dëshmuar gjithmonë përmes humanitetit dhe mikpritjes tradicionale shqiptare dhe atë jo vetëm ndaj njëri tjetrit por edhe ndaj të huajve. Realisht frika nga ‘*koritja*’ dhe ‘*ndëshkimet e rrëthit*’ ishin deri vonë më të ‘*fuqishme*’ se sa dënimet nga ligjet.

Mënyra e organizimit dhe funksionimit të kësaj treve ishte e veçantë. Shumë herë ishte edhe model i organizimeve të jetës shoqërore jo vetëm për shoqërinë shqiptare. *Familja patriarchale* ishte forma që mbizotëronte edhe në Gjakovë, ashtu si edhe në pjesën më të madhe te të gjithë shqiptarët, dhe se ishte e organizuar sipas së drejtës zakonore. Disa kalimtarë që kalonin këndeje parë mahnjeshin me rregullin, kulturën dhe traditat e kësaj ane, që vërtetë ishin tipike tradicionale dhe të kohës. Një vlerësim të përafërt e ka edhe autorë Rago, sipas të cilit:

duke i pasur rrënjet te vlerat që lidhen më ngushtë me mbrojtjen e ruajtjen e klanit dhe të familjes, shqiptarizmi u shfaq si një përpunim modern i nacioneve tradicionale të ngulitura në shekuj dhe i ndryshëm nga ideja e kombit, e cila ishte karakteristike për ato vite (Rago, *vep. cit.*: 19)

Qenia njerëzore në kohët e sotme po përjeton të arriturat më të larta në të gjithë nivelet e jetës. Këto të arritura në njëren anë paraqesin premtimet e mëdha për të ardhmen, duke krijuar mundësi qasjeje dhe komunikimi edhe me vendet më të largëta të planetit, ndërsa në anën tjetër këto paraqesin edhe shqetësimë në fushën e sigurisë, sidomos nga teknologjitet moderne të kohës. Me të drejtë Giddens vlerëson se:

Nuk është vetëm ana e jashtme e jetës sonë që ka ndryshuar. Këto transformime kanë ndryshuar rrënjesisht dhe vazhdojnë të ndryshojnë aspektet më intime dhe personale të jetës së përditshme. Sot bota jonë është rrënjesisht e ndryshme nga ajo e periudhave të mëparshme (Giddens, *vep. cit.*: 25)

Kjo ka ndikuar që edhe shoqëritë e kësaj kohe të dallojnë dukshëm nga shoqëritë tradicionale mijëra vjeçare.

Popullsinë e Gjakovës me rrëthinë e përcollën fate historike gjithmonë në disfavorin e saj. Andaj, zhvillimi i kësaj shoqërie në aspektin etno-kulturor për asnjë moment nuk kaloj pa ndërhyrje nga jashtë. Në dekadën e fundit të shekullit të kaluar dhe në fillimin e këtij shekulli pati një ndryshim jashtëzakonisht të madh. Ky ndryshim vinte si rezultat i

luftës së fundit në Kosovë (1998-1999), me zhvendosje masive të popullatës dhe dëme të mëdha materiale, si dhe fillimit të një historie të re përmes një organizimi shoqëror demokratik, të filluar në kushte tranzicioni dhe të menaxhuar e qeverisur nga faktori ndërkombëtar. Këto periudha kohore kanë ndikuar në të gjitha proceset e organizimit të jetës shoqërore, duke mos kursyer as familjen, shkollën dhe mjedisin jetësor.

Hapja e shoqërisë dhe organizimi modern demokratik ndryshuan mënyrën e jetës, duke e ‘*goditur*’ edhe këtë. Kjo nuk kurseu as edhe pikën më të fortë të kësaj shoqërie, pra në traditën dhe kulturën e kësaj ane. Për këto prurje të reja A. Dhima shprehet:

Falë këtij procesi, nëpërmjet të cilit elementë kulturorë të veçantë ose të gjithë elementet e një sistemi social-kulturor shpërndahen gjografikisht nga njëri vend ose popull në tjetrin, vihen në kontakt të drejtpërdrejtë ose tërthorazi anëtarët e shoqërive të ndryshme, por njëkohësisht shpërndahen edhe disa zakone e besime nga njëra shoqëri në tjetrën, çka sjellë pasojën e rëndësishme që mënyrat e jetës së të dyjave shoqërive të ndërthurura në këtë proces të bëhen gjithnjë e më të ngjashme. Ne dëgjojmë shpesh se, në kohën e sotme, e gjithë bota po modernizohet. Në të vërtetë, popujt po i ngjasojnë njëri-tjetrit më tepër sot se sa para një shekulli” (Dhima, 2013: 141)

Ishin disa faktorë që mundësuan dhe ndikuan në këtë. Së pari, dëbimi me dhunë nga truallet e veta, migrimi nëpër vende të ndryshme të botës dhe kthimi, së dyti organizimi shoqëror në sistemin demokratik i udhëhequr nga një administratë ndërkombëtare, në gjirin e së cilës vinin njerëz nga vende me kultura dhe civilizim të ndryshëm dhe së treti, qasja në teknologjitë e kohës.

Zhvillimet shoqërore të sotme, sidomos në sferën e teknologjisë, kanë ndikuar që bota e madhe dhe e ‘*pa arritshme*’ para pak kohe, sot të bëhet një vend shumë i ‘*vogël*’ dhe i arritshëm. Kjo ndër të tjera ka ndikuar edhe jo vetëm në ‘prerjet socio-kulturore’, por ka sjellë transferime rrënjosore në këtë drejtim. Është më së e kuptueshme se gjërat ndryshojnë me kalimin e kohës, sidomos ato socio-kulturore dhe se sado që kanë reflektuar me kohën, prapëseprapë vetëm mbi to nuk mund të ndërtohet një shoqëri më

e përparuar, aq më tepër kur kemi të bëjmë me organizime moderne të shoqërisë. Lidhur më këtë, kemi edhe vlerësimin e G. Tushit, ku ndër tjera thotë:

Në këtë kontekst, shoqëria jonë është duke përjetuar një tjetër ‘krizë identiteti’, që ka të bëjë me ridimensionin e vlerave morale dhe institucioneve sociale tradicionale. Këto ndryshime kanë prekur konceptet morale, vlerat dhe institucionet e ‘sigurisë morale’ tradicionale të shoqërisë, si: shoqëria, feja, familja, martesa, individi, komuniteti, etj.(Tushi, *vep. cit.*: 13)

Edhe shoqëria jonë po përballet pikërisht me probleme në rrafshin socio-kulturor, që domosdo ndërlidhen me ‘*reformat*’ e organizimit shoqëror. Në njëren anë vijnë barrierat dhe ‘*mospajtimet*’ mes brezave me të ‘*vjetrat*’ dhe me të ‘*rejat*’ dhe në anën tjetër janë kushtet sociale dhe përfitimet nga ‘*bizneset*’ e përfituesve të ndryshëm. Disa nga të rejat që kanë reflektuar në brezat e rinj janë: martesat për dashuri dhe pa ‘*mesit-shkues*’; mënyra e veshjeve ekstravagante nga gjinia femërore te moshat e reja; përdorimi i shtuar i substancave psikotrope nga moshat e reja; trafikimi i qenieve njerëzore dhe punësimet nëpër lokale ‘*nate*’; përdorimi i teknologjive të fundit për kryerjen e veprave të ndryshme penale etj.

Ky trend i zhvillimit dhe modernizimit të kulturës në këtë rajon, përveç gjërave në progresin pozitiv dhe avancimit të shoqërisë, ka sjellë edhe përballje me disa nga ‘*rreziqet*’ permanente që po e përcjellin hap pas hapi, pasojat e të cilave rëndojnë mbi vet individin, familjen, mjedisin dhe shoqërinë në përgjithësi. Këto pasoja janë edhe të kushtueshme, pavarësisht në ‘*kurrizin*’ e cilitdo që janë. Kështu, shoqëria e kësaj ane përmes këtyre ‘*prerjeve*’ kulturore po sfidohet edhe me ‘*lëkundjet*’, si efekte negative. Pra, vërehet se këto ndikojnë në gjendjen sociale dhe që është mjaft shqetësuese, ngase dita ditës po shkohet drejt ‘*përqafimeve*’ të kulturave që nuk janë në hap me realitetin e

shoqërisë sonë. Kjo domosdo që shton edhe pasigurinë. Duke u bazuar në këto, del të jet i drejtë vlerësimi i G. Tushi-t, që thotë:

Shoqëria jonë, tani pas një dekade e gjysmë transformimi të vrullshëm, është bërë “shoqëri cilësisht tjeter”, që nuk ka më “kala sigurie” ku të mbrohet njeriu i dobët. Shoqëria moderne shqiptare nuk e ka më në koncept idenë e vjetër të barazisë, ajo është shoqëri e kompeticionit individual, në të cilin njeriu hyn me forcat e tij për të fituar” (Tushi, *vep. cit.*: 317)

Kështu që çdo ditë po shtohen problemet dhe nevojat sociale, të cilave nuk ka mundësi t’iu përgjigjen në masën e duhur institucionet lokale dhe qendrore të shtetit. Andaj, kjo shoqëri ka ardhur në pikën ku vazhdon me ‘arritjet gjeniale’. Këto ndryshime kanë ndikuar edhe në sferën e ‘ciklit të dhënit dhe të kthimit’, proces të cilin e paraqesin autorët Keesing dhe Strathern, e paraqesin kështu:

Shoqëria jonë është në ndryshim të shpejtë dhe si rrjedhojë ajo po humbet ciklin e të dhënit dhe të kthimit, i cili sigurohet nga cikli i jetës dhe që shpeshherë gjendet në sistemin moral të disa njerëzve; prindërit që kujdesen për fëmijët kur janë të vegjël dhe pa ndihmë mund të kujdesen nga fëmijët kur ata të plaken dhe do të kenë nevojë për ndihmë (Keesing & Strathern, *vep. cit.*: 294)

Në shoqërinë shqiptare gjakovare cikli i të dhënit dhe kthimit ishte në nivelin më të lartë shoqëror. Pavarësisht rrethanave jetësore të individit, qenia e tij në aspektin social nuk ishte e rrezikuar, sepse edhe nëse nuk kishte fëmijë e as familje, për të përkujdeseshin të afërmit tjerë deri në momente të fundit të jetës, madje edhe për ceremoninë mortore. Ndërsa ditët e sotme kanë sjellë rrethana të reja në shoqërinë e këtij rajoni. Tani cikli i kthimit në aspektin social as këtu nuk funksionon, përvèç ndonjë rasti të rrallë nga aspekti moral dhe akoma më rrallë humanitar. Kjo dëshmohet me rastet e shumta sociale në këtë shoqëri, ku ka raste që edhe pse ka kushte të mira familja, madje edhe ajo e ngushta, të moshuarit mbesin të vettuar dhe në mëshirën e fatit. Ndonjëherë ‘cikli’ i kthimit shfrytëzohet për dërgimin e tyre në strehimore. Ky proces i ri social sot

paraqet një zbrazëti të kulturës, andaj këtë e gjejmë edhe te autori Dhima, i cili konstaton se:

“N.q. se ndodhin ndryshime të shpejta ose të paparashikuara në mënyrën e jetesës midis brezave, atëherë mund të krijohet një “bosllëk kulturo”, në kuptimin që brezi i ri nuk pranon ose i refuzon me ndërgjegje disa elemente të kulturës së prindërve të tyre. Në kohën e sotme, në shumicën e shoqërive të zhvilluara përendimore, të rinxjtë mendojnë mjafit shpesh se kanë fare pak gjëra të përbashkëta me prindërit e tyre, por edhe këta të fundit fajesojnë brezin e ri për “standarde të ulëta”, si p.sh. në sferën e moralit seksual. Megjithatë, “çarjet” kulturore midis brezave në një shoqëri të caktuar- edhe kur bien në sy – janë më të parëndësishme në krahasim me ato që vërehen midis sistemeve social-kulturore të popujve të ndryshëm (Dhima, 2013: 140-141)

Pikërisht me këtë ‘bosllëk’ të tillë kulturore sot është duke u përballur edhe kjo shoqëri, kur vërtetë të rinxjtë kanë ‘përqafuar’ shumë nga kulturat globale dhe që sjelljet e tyre në raport me familjen, mjedisin dhe shoqerinë janë jashtë ‘konditave’ tradicionale e kulturore. Veç tjerash, një ‘prurje’ e tillë ka krijuar dis-harmoni jo vetëm në shoqëri por edhe në familje.

Kjo reflekton edhe në statistikat e veprave të raportuara në organet e sigurisë, ku vërtetë rezulton se karshi ‘prurjeve’ të reja kulturore kemi edhe paraqitje të rasteve të reja që më parë nuk kanë qenë prezente në shoqerinë e kësaj ane. Disa nga dukuritë e reja nuk kanë qenë as të kodifikuara në ligje, por janë kodifikuar dhe vazhdojnë të kodifikohen sipas trendit të ri të paraqitjes së dukurive që cenojnë rregullin shoqëror. Edhe ato që kanë ekzistuar në të kaluarën ishin shumë të pakta, ndërsa sot paraqesin një shqetësim serioz për tërë shoqerinë. Kështu që për arritjet e reja kulturore dhe ndryshimet e tyre, Bullaç-i thekson se:

Nga shkaqet kryesore të trazirave shoqërore është edhe e vërteta se duke u kundërshtuar struktura tradicionale, kundërshtohet edhe vetë tradita, gjykojen edhe elemente të shumta kulturore, doke dhe zakone të cilat në vete i përmban tradita. Por, sikur që janë gabim mohimi, refuzimi dhe fajësimi i traditës në tërësi, po aq gabim është edhe pranimi i plotë i saj ashtu siç është; sepse tradita nuk mund që ta formojë veten përmes ligjeve të veta specifike, meqë në formimin e saj rol të rëndësishëm luajnë faktorë të ndryshëm historikë dhe shoqërorë. Mund të thuhet se pa marrë parasysh llojin e traditës, çdo traditë bart në vete gjurmët e së kaluarës, të vendit ku ajo traditë është përhapur (Bullaç, *vep. cit.*: 283-284)

Andaj, këto tende të zhvillimit global, përmes disa rasteve devijuese kanë sjellë deri te një gjendje ku mohohen tërësisht të gjitha normat shoqërore ekzistuese, duke kaluar në një kulturë tjetër, me të vetmin qëllim që të ndryshojnë nga tjerët.

Duke iu referuar rrethanave reale në të cilat zë fill organizimi demokratik i shoqërisë kosovare, në veçanti asaj gjakovare dhe duke pasur parasysh kushtet e vështira, ishte e pashmangshme edhe paraqitja e vështirësive gjatë këtij procesi. Kjo shoqëri gjatë rrugëtit për një ‘*bashkëkohoren*’, pra nga kalimi i modelit të myllur në këtë model të ‘*hapur*’, është shoqëruar nga sfida të ndryshme, sidomos në fushën sociale dhe kulturore. Lidhur me vështirësi të tilla është shprehur edhe G. Tushi, sipas të cilit: “Ndryshimet sociale, për shkak të inercisë specifike dhe thelbët të qëndrueshëm konservator, janë më të vështira për të ndryshuar me ritmin e duhur. Madje, përvoja jonë ka treguar se shpesh edhe kur ato ndodhin krijojnë një ‘vakum social’ ” (Tushi, *vep. cit.: 12*).

Ky riorganizim shoqëror i dha hapësirë dhe liri individit, duke bërë që të ndjehet plotësisht i pavarur dhe i lirë të veprojë. Ai nuk e ka ‘frikën’ nga familja e rrathi, por që vepron sipas tekeve personale, që shumë herë edhe janë të gabuara. Pikërisht, duke iu referuar kësaj lirie kemi edhe këtë vlerësim:

Liria ka koston e vet sociale, ka pasojat dhe deformacionet që vijnë nga ekseset e jetës moderne. Në kohën tonë u zhdukën vërtetë disa plagë socialo-politike të tmerrshme si diktatura, koncepti monist e determinist politik e moral, u zgjeruar koncepti për privacinë e jetës personale, por në të njëjtën kohë u shfaqën dukuri, fenomene e plagë të reja sociale, ta panjohura më parë (Tushi, *po aty: 17-18*)

#### **4.4 Tranzicioni demokratik pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë**

Procesi i tranzacionit demokratik të kësaj shoqërie mundësoj transformimin e funksionimit të sistemit të mbyllur me pikëpamje socialiste e komuniste, në atë të demokracisë plurale dhe të ekonomisë së lirë të tregut, pra sistemit bashkëkohor të kapitalizmit dhe atë përmes proceseve të transformimit rrënjosor të sistemit politik, social dhe ekonomik.

Në kohën e sotme është e kuptueshme që ndërlikueshmëria e shoqërisë paraqet një prerje të së kaluarës, të sotmes dhe së ardhmes. Këtë e përforcojnë edhe më tej, sidomos evoluimet e fuqishme që përjetuan dhe po përjetojnë vendet në tranzicion, me ç'rast shkaktuan ‘*tërmete*’ në të gjitha sferat shoqërore, duke mos kursyer as vlerat njerëzore. Sidomos, “në disa shoqëri tejet të shtresëzuar, ku membranat ndërmjet shtresave janë të holla, lëvizshmëria është shumë e lartë” (Coser & Ridener, *vep. cit.*: 291). Në anën tjeter këtë e përforcon edhe fakti kur dihet se shoqëria përbëhet prej komuniteteve që lidhen ekonomikisht dhe politikisht, të cilat si karakteristikë kanë sistemin social dhe traditën e përbashkët kulturore (Keesing & Strathern, *vep. cit.*).

Kjo ndërlikueshmëri shtohet edhe më shumë kur dihet se zhvillimet e fundit botën e kanë afruar si një ‘*fshat global*’, ku arsyet për ndërtimin e raporteve shoqërore anë e kënd botës, me qëllim të plotësimit të nevojave jetësore, janë të domosdoshme. Domosdo që kjo lidhje do të krijojë marrëdhënie shoqërore dhe se në një apo mënyrë tjeter, drejtpërdrejt apo në mënyrë jodirekte do të ketë ndikim, duke filluar nga individi, grupi dhe deri tek shoqëria si tërsesi. Kështu që, këto sisteme të reja shoqërore janë të ndikuara përmes proceseve ndërvepruese (Coser & Ridener, *vep. cit.*).

Në realitetin e rrethanave tona, si duket tranzicioni doli të jetë një proces tejet i ndërlikuar dhe se progresi e ecuria në kohë ndikohen nga shoqëria e atij vendi si dhe lloji i transformimeve që do të bëhen. Këto procese shumë herë janë përcjellur edhe me natyra tjera jashtë *domenit* të tij. Sidomos problematikat më të mëdha paraqiten atëherë kur gjatë periudhës së tranzacionit, në disa raste institucionet janë të brishta dhe jo stabile.

Periudha e tranzacionit të shoqërisë gjakovare solli ndryshime rrënjosore në të gjitha sferat e organizimit të jetës. Ishte kjo periudha në të cilën pati lëvizjen më të madhe dhe daljen nga ‘*guacka*’ edhe në aspektin e traditës kulturore. Nga këtu u fillua me transformimin e tradicionales dhe përqafimin e bashkëkohores. Këtë e përjetoj dhe po e përjeton edhe sot e kësaj dite Gjakova me rrëthinë, e cila ishte e njobur historikisht për traditën dhe kulturën e lartë.

Derisa edhe shoqëria gjakovare, ashtu si vendet tjera postkomuniste, po kalon një proces tranzicioni të shumëfishtë, si: tranzicion politik nga një parti në disa parti, tranzicion ekonomik nga një ekonomi e planifikuar në ekonominë e tregut të lirë dhe konkurrencës, tranzicion në fushën e sigurisë së vendit në sigurim ndërkombëtar, kjo nuk po e kursen edhe tranzicionin socio-kulturor. Pra, shoqëria gjakovare për herë të parë në historinë e vet po përjeton sistemin demokratik të organizimit. Këtij procesi tranzicioni i parapriu misioni ndërkombëtar i UNMIK-ut, dhe se një konsolidim i tillë ishte jo edhe i lehtë. Arsyja ishte dyfishe: së pari në këtë mision ishin njerëz nga vende të ndryshme të botës dhe në vete kishin kultura e përvoja të ndara, ndërsa e dyta ishte se shoqëria gjakovare përballej me pasojat e mëdha të luftës dhe se për herë të parë përjetonte lirinë e plotë e që i mundësonte të dilte nga ‘konserva’ e myllur shekullore. Kësaj mund t’i shtohen edhe mungesa në traditën politike e demokratike, kushtet e

rënda socio-ekonomike, e që e ‘*keq interpretonin*’ edhe më shumë vendosjen e rendit demokratik. Andaj, njëjtë si edhe shumë vende të tjera të dala nga sistemi soacialist-komunist, kjo shoqëri vazhdon të kalojë një proces tranzisional të shumëfishtë në të gjitha fushat. Mirëpo, “ndërtimi i sistemit të ri nuk mund të ndodhë përpara shkatërrimit të sistemit të vjetër” (Coser & Ridener, *vep. cit.*: 18) dhe përpara se të gjitha rrethanat e rendit të vjetër të jenë shkatëruar. Pra, ardhjet e reja nuk mund të jenë funksionale derisa sistemi në ‘*mbarim*’ të mos lokalizohet dhe zhduket tërësisht.

Ky proces tranzicioni përcillet edhe me shumë sfida. Kështu, “kalimi nga një sistem shoqëror në një tjetër, kurrë nuk mund të jetë i vazhdueshëm dhe i drejtpërdrejtë” (Coser & Ridener, *po aty*: 19). Sidomos kur kjo vjen nga një regjim i gjatë socialist, në të cilin ekzistonte vetëm një parti politike, ku përcillej me një shtypje të identitetit kulturor e kombëtar, në të cilin familja patriarchale dominonte në shoqëri. Të gjitha këto bëjnë që proceset e konsolidimit dhe organizimit demokratik të mos jenë edhe të lehta. Duke pasur parasysh kushtet e vështira, në të cilat filloi demokratizimi në Kosovë, suksesi i tranzacionit del të jetë shumë më i vështirë dhe më i rëndë se sa në çdo vend tjetër ish-komunist. Kjo hyri në rrugën e tranzacionit në një kohë kur nuk kishte ende gjyqësor të pavarur, media të lira dhe grupe e shoqata qytetare të pavarura. Aq më tepër, kur ky proces i ndihmuar dhe i përkrahur nga faktori ndërkombëtar, imponoi që shumë nga gjërat të bëhen me hapa shumë të përshpejtuar. Andaj, këto rrethana gjatë këtyre ‘*lëvizjeve*’ përjetuan një dinamikë zhvillimore dhe shumë herë edhe duke dalur jashtë vetvetes. Se këto ndodhin në situata të tillë e paraqet edhe B. Demiraj, sipas të cilit:

Pa dyshim që në këtë diskurs energji pozitive emeton përsiatja evolucioniste, me vlerë ndërkohë aksiomatike, sipas së cilës lënda e etnosit – si ajo materiale, edhe ajo shpirtërore – përjeton në kohë dhe hapësirë një dinamikë zhvillimi variabël, duke iu nënshtruar në vijimësi shndërrimit, i përfthuar ky qoftë edhe në saje të përballjes me komponente jo anase që e rrethojnë ose janë ulur këmbëkryq, duke ndarë së bashku atë hapësirë jetike kompakte të bashkësisë etnike, në rastin tonë shqiptare (Demiraj, *vep. cit.*: 14)

Fillimi i tranzicioni demokratik shoqërinë gjakovare e gjeti me zonën më të goditur gjatë luftës, me shumë të vrarë e masakruar si dhe me shumë persona të zhdukur, kurse në anën tjetër me një gjendje të rëndë ekonomike e sociale. Pasojat dhe plagët e luftës së fundit ende janë prezente kudo. Bën pjesë në vendet ku masakrat serbo-sllave nuk kursyen moshë as gjini të popullsisë së kësaj ane, ku ende mbetet në pritje të njoftimeve më të reja për bijtë e bijat e saj të zhdukur që nga lufta e fundit. Kjo ka bërë që shumë familje të jenë goditur nga këto plagë, duke lënë shumë fëmijë pa prindër e prindër pa fëmijë. Këto kanë sjellë edhe shumë probleme në aspektin social, qoftë në përkujdesje e edukim, ashtu edhe në atë të ekzistencës për të mbijetuar.

Pasojat e luftës dhe periudha e tranzicionit me zhvillimet e reja e rënduan edhe më tej këtë situatë të kësaj popullsie nga aspekti ekonomik. Në vitet e shtatëdhjeta, sidomos në të tetëdhjetat e shekullit të kaluar kjo zonë ishte e njojur për zhvillimin ekonomik që kishte. Jo vetëm në Dukagjin e Kosovë, por edhe në tërë ish-federatën Jugosllave. Nga ekonomitë që zhvillonin aktivitetet prodhuese, ishin nga më të lehtat e deri tek më të rëndat, prodhimet e të cilave eksportoheshin edhe jashtë federatës Jugosllave. Të punësuarit *gravitonin* nga tërë rajoni i Dukagjinit. Sipas shënimive vlerësohet se kishte rrith dyzëtmijë të punësuar në të gjitha sektorët e prodhimitarive.

Procesi i tranzicionit edhe më tej u përball me një reformë në këtë drejtim. Kështu që, asnë nga ekonomitë e fuqishme dikur, pas luftës nuk rifilloi aktivitetin e vet prodhues. Shumicës prej tyre u duhej vetëm pak riparim dhe se ishin të gatshme për rifillimin e punës. Mirëpo, rrethanat e reja diktuan që këto, jo vetëm që nuk u aktivizuan, por u bënë objekte të shumë veprave kriminale, duke u *demoluar* dhe shkatërruar deri në themel. Të gjithë thuajse ishin të pafuqishëm të ndalnin këtë proces. Të gjitha pjesët e tyre thuajse përfunduan në hekurishtet e vendeve të rajonit. Edhe prona shtetërore e

shumë ndërmarrjeve prodhuese e bujqësore të asaj kohe, nga persona të ‘*fugishëm*’ u zhbë gati tërësisht. Këtyre u ndihmuani edhe reformat në kalimin e pronës shtetërore në atë private përmes procesit të njohur të privatizimit dhe atë përmes institucioneve të reja shtetërore në mënyrë krejtësisht legale. Kjo ndikoi që edhe shumë ish punëtor dhe ekspert të atyre profileve, me shkollimin profesional, të ngelen pa punë, apo të merren me ‘*zeje*’ tjera jashtë profesionit, vetëm sa për të siguruar mbijetesën.

Nga ajo ekonomi e fuqishme, pas luftës dhe gjatë periudhës së tranzicionit u ndërtuan vetëm disa ekonomi të vogla, e thuajse asnjë e mesme, të cilat nuk patën fuqi të punësojnë fuqi punëtore të madhe. Pra, pjesa më e madhe u shndërruan në ekonomi familjare e që pas një kohe shuma nga ato detyroheshin të mbylleshin.

Përfundimisht rezulton se kjo periudhë u përballet me një proces shumë më kompleks se sa vetëm si tranzicion postkomunist dhe se strategjia e tij ka të bëjë me zhvillimin e gjithanshëm të shoqërisë.

#### **4.4.1 Tranzicioni dhe krimi**

Të gjitha periudhat e transformimeve, sidomos gjatë fazës së tranzacioneve, shfrytëzohet edhe nga rryma tjera të brendshme dhe të jashtme për aktivitete kriminale. Zakonisht individët dhe grupet shfrytëzojnë jostabilitetin e institucioneve në themelim e sipër, ku veçanërisht ‘*profesionalistët*’ përfitojnë më së shumti në këto rrëthana dhe kanë një rrjet të gjërë e të shpërndarë nëpër vende përreth. Transformimet shoqërore për një numër të madh të shoqërisë janë të pakuptueshme dhe krejt të reja. Këto prurje të reja, ndër tjera sjellin edhe nevojën për normat e reja të sjelljeve, duke filluar nga individi e deri te institucionet qeverisëse si dhe brenda tyre kanë faktorët që shtyjnë në ndryshim të

sjelljeve. Pikërisht janë këto faza tranzicioni që shumë nga ndryshimet në norma dhe në sjellje imponojnë edhe sjellje devijante e deri në kriminalitet.

Menjëherë pas çlirimit shoqëria kosovare dhe ajo gjakovare u përball me krijimin dhe ndërtimin e së ardhmes. Kjo përbënte një sfidë jashtëzakonisht të madhe. Madje paraqiti vështirësi edhe më të mëdha se sa mendoheshin. Arsyja kishte të bënte me faktin se periudha e transformimeve si proces mori shumë kohë dhe se në vete përfshinte një sistem dhe strukturë të re në fushën ekonomike, politike, ligjore dhe sociale. Këtë tranzicion kjo shoqëri e nisi me një ndërlikueshmëri të theksuar. Fillimisht këtij procesi i printe menaxhimi nga bashkësia ndërkombe, i vendosur menjëherë pas luftës, me qëllim të ndihmonte në sigurimin e jetës dhe të riorganizonte ndërtimin e vendit bashkë me të gjitha institucioneve të reja. Në anën tjetër, përmes këtij tranzicioni duhej të shkatërrrohej e ‘*vjetra*’, që më shekuj ishte përcjellë nëpër breza duke ruajtur traditën dhe kulturën e vet, për të adaptuar të rejat, shumë nga të cilat për herë të parë do të ishin pjesë e kësaj shoqërie.

Rrethanat në të cilat ndodhej Kosova e pasluftës ndikuan që projektimi i këtyre transformimeve të zhvillohet bazuar në qëllimet politike. U fillua me ekonominë, e cila edhe ashtu ishte në gjendje të mjerueshme, duke sjellë shkatërrimin e tërësisë hënë të saj. Kjo përveç se i vështirësoi kushtet e jetës, u bë edhe shkas i krimtit dhe shumë aktivitatave kriminale. Po ashtu edhe sistemi ligjor u reformua tërësisht. Fillimisht u plotësua më ndërhyje dhe atë deri në nxjerrjen e kodeve të reja të përkohshme të Kosovës, në prill të vitit 2004. I njëjtë vazhdoi me ndryshime dhe plotësimë deri në fund të vitit 2012. Normalt e kodifikuara rezultuan të jenë një prerje nga ligjet e vendeve përreth Kosovës. Edhe në aspektin socio-kulturor pati zhvillime të reja. Këto transformime në këtë drejtim ndërhynë në shumë çështje të ndjeshme. Tani më nuk ishte

dora e shtetit që mundësonte arsimim dhe shërim falas. Andaj, duke iu referuar gjithë këtyre transformimeve gjatë kohës së tranzpcionit ishte e pashmangshme që këto të mos shoqërohen edhe me dukuri kriminale. Lidhur me faktorët që ndikojnë në kriminalitet V. Hysi thotë se,

Nëpërmjet hulumtimeve, studimeve dhe analizave e shpjegimeve etiologjike mund të nxirren konkludime dhe të gjenden faktorët themelorë të cilët ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit, si dhe të gjenden zgjidhjet adekuate të mjeteve dhe metodave për luftimin dhe pengimin e tij (Hysi, vep. cit.: 76)

Me transformimin e ri shoqëror, kohëve të fundit, prirjet e zhvillimit të kriminalitetit kanë ndryshuar nga e kaluara, duke marrë përmasa tjera në raport me natyrën e traditave kulturore, zakonore dhe trashëgimore që janë hasur tradicionalisht në këtë anë, si dhe duke u vënë në lidhje me rrijete kriminale të natyrave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Këto ‘lëvizje’ të shoqërisë së kësaj treve, përveç shumë gjërave pozitive që pati fatin t’i ‘huazojnë’, sollën edhe gjëra të reja në aspektin social dhe kriminal. Madje, disa nga sjelljet e ‘reja’ të përqafuara nga ‘kulturat’ dhe ‘civilizimet’ tjera janë mjaft shqetësuese. Po ashtu, shqetësuese mbetet edhe situata e sigurisë, sidomos pas paraqitjes së këtyre dukurive të reja kriminale.

Kështu, si në çdo shoqëri në tranzicion, edhe këtu dukuria e kriminalitetit është thellësisht dramatike dhe nuk mund të lihet jashtë vëmendjes në progresin demokratik të saj. Këto lëvizje dukshëm reflektuan edhe në këtë rajon, qoftë në organizimin shoqëror, qoftë edhe në paraqitjen e dukurive kriminale. Ndryshimet në fjalë sollën një perspektivë të re.

Një nga faktorët që ndikon në mbajtjen e bashkuar të grupeve si një ‘trup’ i përbashkët për një stabilitet shoqëror është edhe niveli i paraqitjes së kriminalitetit brenda rajonit.

Ky mendim ndërlidhet edhe me realitetin aktual në rrethanave e Gjakovës. Bazuar në këtë realitet sot kemi sjellje devijante dhe veprime kriminale konkrete, që janë rezultat i ambientit shoqëror, kushteve dhe rrëthanave ekonomike, sociale e politike, si: veprat penale të uzurpimit të pronës së huaj, trafikimi me qenie njerëzore, punësimi në lokale të ndaluara i femrave shqiptare, etj. Veprat në fjalë sot janë ndër veprat penale më të shumta, të cilat sjellin shumë probleme sociale e shoqërore.

Prandaj, paraqitja e rrëthanave të reja jetësore, përveç gjërave të mira dhe pozitive, solli edhe paraqitjen e dukurive të reja në fushën e kriminalitetit në këtë rrethinë. Ndërsa tjetër, edhe ato që e kishin përcjellë shoqërinë deri më tani, vazhduan prapë, por me modifikime më të përparuara në sferën kriminale. Kështu që, periudha e re e paslufthës, përveç që i shtyu përpara dukuritë e kaluara, ajo solli dukuri kriminale nga më të ndryshmet.

Duke iu referuar këtyre fenomeneve dhe dukurive, mund të themi se sot Gjakova me rrëthinë ballafaqohet me: dukuritë *kriminale tradicionale* të ‘moderuara’ dhe ato *kriminale të reja*.

Brenda këtyre dukurive kriminale veçojmë:

- Vrasja (enigmatike dhe të maskuara)
- Grabitjet dhe vjedhjet grabitqare
- Uzurpimi i paligjshëm i pronës
- Rrëmbimi dhe kidnapimi
- Krimi i organizuar
- Hyrje në sistemet kompjuterike
- Dhuna në familje dhe divorcet

- Veprat penale të narkotikëve
- Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm
- Trafikimi i qenieve njerëzore dhe prostitucioni
- Lojërat e fatit
- Reketimi dhe fajdeja
- Shantazhi
- Vetëvrasjet dhe tentim vetëvrasjet, etj.

Të gjitha këto janë evidente në tërë rajonin e Gjakovës dhe argumentohen përmes regjistrave në organet e rendit dhe në prokurori. Pra, këto i referohen hartës kriminologjike të këtij rajoni. Duke u bazuar në trendin e këtyre krimeve, del se pikërisht këto janë si rezultat i transformimeve të shoqërisë dhe periudhës së tranzicionit, ku institucionet përgjegjëse të sigurisë dhe të tjerat kalonin nëpër proceset e reformimit duke mos pasur stabilitetin e nevojshëm. Në disa raste këto kishin kontribuuar në mënyrë indirekte e në disa edhe direkte. Pastaj, interesat personale ndikuan që të ndërmerren veprime e vendime politike që mundësuan veprimtarinë e aktiviteteve kriminale. Ndër to mund të veçohen: lejimi i hapjes së lokaleve të lojërave të fatit, i lokaleve të natës, punësimi i femrave të huaja në ato lokale, kryerja e shërbimeve në baza partiake dhe me ‘*intervenime*’, pasurimi i shpejtë i individëve në rrëthana të dyshimta, etj.

Në aspektin ekonomik, gjendja e tillë në disa raste shtyri që individë dhe grupe të përvetësojnë pronën e huaj në forma nga më të ndryshmet, kryesisht me anë të vjedhjeve të rënda, usurpimeve të pronave, grabitjeve të armatosura dhe të maskuara, rrëmbime dhe kidnapime, etj. Nga aspekti social reflektuan aktivitete kriminale si: dhuna në familje, vetëvrasjet dhe tentim vetëvrasjet, përdorimi i substancave narkotike,

etj. Këto zhvillime të shoqërisë i përçolli edhe trendi i teknologjisë, duke mundësuar kryerjen e disa krimeve përmes përdorimit m'u të kësaj teknologje, si hyrja ilegale në sistemet kompjuterike e raste të tjera të ngjashme.

Pra, periudha e tranzicionit gjatë këtyre transformimeve të shoqërisë në këtë rajon u përballet dhe vazhdon të përballet me krim dhe aktivitete kriminale. Pjesa më e madhe e këtyre krimeve nuk kishin qenë përcjellës të mëparshëm të kësaj shoqërie, por që janë rezultat pikërisht të këtyre ndryshimeve dhe zhvillimeve shoqërore.

#### **4.4.2 Legjislacioni antikrim**

Në aspektin e legjislacionit, kjo trevë përfshihet në atë ekzistues të Kosovës. Që nga qershori i vitit 1999, kur NATO detyroi forcat serbo-sllave të tërhoqen nga Kosova, ky territor është administruar nga prania ndërkombëtare civile dhe e sigurisë e autorizuar nga Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Administrata civile ndërkombëtare – Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK-u) është drejtuar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara. Tri organizata ndërkombëtare në bashkëveprim operuan në katër shtyllat e strukturës së UNMIK-ut, më konkretisht:

- Shtylla parë – Policia dhe drejtësia, nën mandatin e OKB-së
- Shtylla e dytë – Administrata Civile, nën mandatin e OKB-së
- Shtylla e tretë – Demokratizimi dhe ndërtimi institucional, nën mandatin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe
- Shtylla e katërt – Rindërtimi ekonomik, nën mandatin e Bashkimit Evropian (BE)

Përveç kësaj, për të siguruar një administratë të përkohshme, UNMIK-u është ngarkuar me krijimin e ‘një sistemi gjyqësor të pavarur, të paanshëm dhe multietnik’. Administrata e UNMIK-ut, me të filluar punën e saj, në kuadër të drejtësisë, riktheu në fuqi legjisacionin e Kosovës që kishte qenë deri më 22 mars 1989, të cilin e kishte shfuqizuar shteti i Serbisë, mirëpo duke bërë ndryshime në heqjen e të gjitha ligjeve që kishin karakter diskriminues dhe politik. Kjo u realizua përmes nxjerrjes së rregullores 1999/24-UNMIK ‘*Ligjet jodiskriminuese në Kosovë*’, si dhe rregulloreve tjera të shpallura nga përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to. Pra, sistemi në fjalë përbëhej nga ligji dhe kodi penal i Kosovës, ligji dhe kodi penal i ish-Jugosllavisë, ligji i procedurës penale, i cili gjatë një kohe ka qenë në fuqi në të gjitha ish-republikat jugosllave.

Ky sistem udhëhiqej nga prokurorë dhe gjyqtarë të huaj, që me kalimin e kohës u plotësuan edhe me staf vendor. Për pjesën e madhe të qytetarëve ky legjisacion paraqiste pakënaqësi dhe dyshime. Gjatë kësaj kohe, në Gjakovë funksiononte Gjykata për Kundërvajtje, e cila gjykonte veprat e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 60 ditë. Po ashtu, këtu funksiononte gjykata komunale, për vepra të dënueshme deri në pesë vite, për mosmarrëveshje pronësore të lehta, për çështje të trashëgimisë, marrëdhënie të punës dhe çështje të tjera civile.

U desh të pritej deri në prill të vitit 2004, kur nga misioni ndërkombëtar i UNMIK-ut të hynte në fuqi *Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës dhe Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale të Kosovës*, i cili ishte një model i nxjerrë nga shtetet e rajonit dhe i modifikuar për shoqërinë kosovare. Gjatë kësaj kohe, Gjakova kishte gjykatën komunale dhe prokurorinë komunale, që trajtonin veprat e përgjithshme kriminale po ashtu deri në

pesë vite, ndërsa veprat më të rënda penale procedoheshin në Prokurorinë dhe Gjykatën e Qarkut në Pejë.

Në këtë legjislacion ishin përfshirë edhe disa norma të reja, të sanksionuara sipas klasifikimeve të veprave. Megjithatë, kompletimi i legjislacionit ka vazhduar gjatë tërë kohës dhe atë përmes nxjerrjes së rregulloreve dhe ligjeve të ndryshme. Në të shumtën e rasteve, ky legjislacion nuk ishte në përputhje me realitetin e kësaj shoqërie.

Pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në shkurt 2008, në mbështetje të nenit 65/1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me qëllim të krijimit të kushteve më të favorshme dhe shtimin e efikasitetit të punës së prokurorive dhe gjykatave, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkontinentare, Kuvendi i Kosovës me datën 6 nëntor 2008 miratoi ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit të Përkohshëm të Kosovës, ku në emërtimin e tij hiqet fjala i përkohshëm dhe mbetet vetëm *Kodi Penal i Kosovës* dhe *Kodi i Procedurës Penale të Kosovës*.

Edhe gjatë vitit 2012 është vazhduar me ndryshime në të dy kodet, të cilat ndryshime u finalizuan dhe mundësuan hyrjen në fuqi të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe në Gjakovë funksiononte Gjykata për Kundërvajtje me modifikime të kohëpaskohshme si dhe Gjykata dhe Prokuroria Komunale.

Mbështetur në të gjitha këto ndryshime në kodet e zbatuara në Kosovë si dhe nxjerrjen e ligjeve dhe të rregulloreve gjatë gjithë këtyre periudhave, paraqitet si dëshmi e fuqishme për zhvillimin shoqëror të pëershpejtuar të shoqërisë kosovare në përgjithësi, pjesë e së cilës është edhe ajo gjakovare. Kështu që, janë trendët e zhvillimeve shoqërore që kanë

sjellë ‘prurje’ të reja, të cilat shumë herë bien ndesh me normat shoqërore, gjë që ka imponuar edhe të ketë ndërhyrje në ligje.

Ndërhyrjet e tillë thuajse janë imponuar në të gjitha fushat, prej atyre që kanë ekzistuar dhe që është dashur të modifikohen sipas nevojave të kohës e deri te ato që janë të reja tërësisht. Pra, zhvillimet shoqërore demokratike si dhe zhvillimet teknologjike që mundësuan qasje në zhvillimet dhe kulturat e shoqërive të vendeve thuajse të mbarë botës, sollën prurje të reja jo vetëm në kulturën e kësaj treve, por edhe në aspektin juridik të funksionimit të shtetit.

#### **4.4.3 Siguria shtetërore dhe institucionale ndaj krimtit: parandalimi dhe korrektimi**

Siguria shtetërore dhe parandalimi i krimtit është detyrë e çdo shoqërie demokratike, me qëllim që ketë siguri stabile brenda shoqërisë. Për të realizuar këtë është e nevojshme që krimi në fazën fillore ose para krijimit të tij të parandalohet. Andaj, luftimi parandalues i krimtit është përpjekje për shuarjen që në fazën embrionale të dukurive negative.

Duhet që të bëhen planifikime dhe angazhime nga institucionet publike, në mënyrë që përmes programeve të avancuara të ndërmarrin veprime parandaluese ndaj shfaqjes së kriminalitetit. Institucionet kryesore shtetërore në shtetet demokratike për parandalimin dhe korrektimin e aktiviteteve kriminale janë: policia, prokuroria dhe gjykata, si dhe shërbimi korrektues. Këto edhe në aspektin e punës që bëjnë kanë një ndërlidhje, e cila bazohet duke filluar nga kushtetuta e shtetit e deri te ligjet dhe aktet nënligjore.

Si parandalues i parë në përballje me masat e parandalimit dhe luftimin e krimtit del të jetë policia. Parandalimi i kriminalitetit nga policia fillon që nga vet uniforma e kësaj të

fundit, ku shumë herë mjafton vetëm prezenca e fizike e zyrtarëve policor në lokacione të caktuara. Pastaj vijnë autorizimet ligjore që mund t'i përdorë kur e sheh të nevojshme ndërmarrjen e masave të tillë. Në sistemet demokratike, policia ka ngritur këtë çështje në nivelin më të lartë institucional, duke u integruar në vet shoqërinë dhe institucionet lokale dhe jo e ndarë nga to. Tani, përmes projekteve të përbashkëta me shoqërinë, merr pjesë dhe e zhvillon aktivitetin e vet parandalues duke organizuar trajnime, tryeza dhe seminare të shumta me tematika nga sjelljet devijuese e deri tek aktivitetet kriminale. Kështu, bashkëpunimi i PK-së me institucionet qendrore dhe lokale të qeverisjes së Republikës së Kosovës është i paraparë edhe sipas ligjit të policisë, nen 8, sipas së cilës parashihet një bashkëpunim me të gjitha institucionet që janë përgjegjëse në fushën e sigurisë. “Bashkëpunimi në fjalë rregullohet sipas akteve ligjore të Qeverisë dhe me memorandume të mirëkuptimit, të aprovuara nga Ministri” (Gashi & Avdaj, *vep. cit.*: 100). Kështu, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sjelljeve devijante dhe të kriminalitetit policia bashkëpunon me të gjithë partnerët e vet, si: autoritetet lokale, organizatat civile, komunitetet lokale dhe me organizatat joqeveritare. Andaj,

filozofia e policimit në komunitet në ndërtimin e partneritetit polici-publik është që niveli i pjesëmarjes së komunitetit në forcimin e sigurisë dhe rendit social e në zgjidhjen e krimit të lidhur me komunitetin duhet rritur pasi policia nuk mund ta përbushë këtë detyrë e vetme (OSBE, 2008: 19)

Institucionet gjyqësore, përfshirë prokurorinë dhe gjykatën, luajnë një rol me rëndësi të madhe në parandalimin e sjelljeve devijante dhe të kriminalitetit. Aty ku shoqëria dhe policia nuk kanë pasur suksesin e duhur, kërkohet ndërhyrja e këtyre institucioneve.

Kompetencat ligjore u mundësojnë që për disa raste të lehta e deri të mesme të shkeljeve, që janë për herë të parë, përmes disa masave ndëshkuese të kategorive të lehta të prevënojnë tek kundërvajtësit.

Institucionet korrektuese përfshijnë shërbimin korrektues. Veprimitaria e tyre përfshinë njëkohësisht dy qëllime. Së pari, aty dërgohen të ndëshkuarit për vuajtjen e dënimit dhe së dyti, përmes këtij shërbimi bëhen përpjekje për risocializimin e tyre.

Në ditët e para të çlirimit të Gjakovës dhe rrethinës, përgjegjës për sigurinë në përgjithësi ishin trupat e NATO-s të vendosur në Kosovë, të emëruar KFOR. Kjo zgjati deri me themelimin e policisë së UNMIK-ut, e që më pas u pasuan edhe nga policët kosovar të gjeneratave të para, si dhe të prokurorisë e gjykatave dhe shërbimit korrektues. Me kalimin e kohës, këto institucione u plotësuan dhe u pavarësuan në kryerjen e detyrave dhe obligimeve që kanë në kompetencë. Kështu, duke iu referuar këtyre, në kuadër të sigurisë shtetërore lidhur me parandalimin dhe korrektimin, edhe në rajonin e Gjakovës duket të kemi tri forma: parësor, dytësor dhe tretësor. Faktikisht, format tretësore pjesërisht realizohet (drejtpërdrejt) këtu, por pjesa e madhe kryhet në vendet ku janë të destinuara për vuajtjen e dënimit. Kjo formë e parandalimit përpinqet të funksionojë në zinxhir dhe sa më mirë të realizohet kjo, rezultatet do të jenë më të prekshme në këtë drejtim.

Në anën tjetër, *siguria* dhe *parandalimi* nuk është vetëm përgjegjësi e organeve dhe shërbimeve zyrtare. Është e kuptueshme se kundërvënia ndaj sjelljeve devijuese dhe kriminalitetit, sidomos ajo parandaluese, duhet të ketë themel të konceptit programor faktin se kriminaliteti nuk mund të vështrohet vetëm si problem që ka të bëj me sjelljen e individit apo të grüpuit kriminal, por si problem që ka të bëj me shoqërinë globale. Pra, trajtimi i problemit duhet të jetë jo vetëm si problem juridik por edhe si problem shoqëror.

Në botën bashkëkohore, rolin kyç në parandalimin dhe luftimin e krimit dhe kriminalitetit e mban vet shoqëria dhe organizatat joqeveritare. Rol i shoqërisë fillon që nga familja, mjedis, shkolla, media e organizatat lokale. Vetëm me një organizim të gjithë këtyre mekanizmave do të mund të realizohen synimet për masat e parandalimit, duke i siguruar shoqërisë një ambient të sigurt në fushën e kriminalitetit. Kështu, si faktor kryesor dhe vendimtar në ruajtjen nga aktivitetet kriminale dhe funksionimin e mirëfilltë të shoqërisë është vet reaksi i shoqërisë dhe jo vetëm i institucioneve shtetërore. “Kështu, politika demokratike e sigurisë fiton rëndësi të jashtëzakonshme shoqërore dhe përballon të gjitha sjelljet devijante në shoqëri, sidomos në procesin e organizimit të tërësishëm të shoqërisë në fusha të ndryshme” (Gashi & Avdaj, *vep. cit.*: 93).

Kështu, roli i institucioneve të shoqërisë në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit fillon nga bërthama dhe qeliza e shoqërisë, pra nga familja. Shoqëria që nga lindja e saj është përballur dhe vazhdon të sfidohet nga ndryshime, ku shumë herë janë ballafaqar edhe me shkelje të rregullave, normave dhe ligjeve ekzistuese.

*Familja patriarchale* ishte forma që mbizotëronte edhe në Gjakovë, ashtu si edhe në pjesën më të madhe te të gjithë shqiptarët, dhe se ishte e organizuar sipas së drejtës zakonore. Këtu mbizotëronin tiparet kryesore, si: familja ishte bashkësi njerëzish me lidhje gjaku në vijë mashkulllore apo nga martesa, ku brenda saj jetonin disa breza; kishin një ekonomi të përbashkët; mbizotëronte pushteti i burrave mbi gratë; i zoti i shtëpisë gëzonte pushtetin; kishte solidaritet në organizimin e brendshëm dhe ndarjen e punëve, etj. Në këto familje qëndronte barazia e njerëzve nga gjaku, mikpritja, nderi dhe besa.

Për nga ndërtimi, familja i takonte *familjes së zgjeruar*, ku jetonin bashkë breza të tërë.

Gjithmonë respektohesin zakonet dhe traditat familjare, kështu që secili nga anëtarët i dinte ato që i takonin në çdo kohë. Respekti dhe sjellja e anëtarëve të familjes jo vetëm që kanë qenë obligim i imponuar, por ato ishin bërë edhe traditë dhe pjesë e jetës së rëndomtë të tyre. Andaj, “familja mbetet gjithnjë qeliza më e imët edukative e shoqërisë, shkallë - shkallë mjaft funksione të saj fillon e i merr në dorë shoqëria nëpërmjet institucioneve të specializuara edukative” (Beqja, 1987:36).

Prurjet e proceseve globalizuese kohëve të fundit kanë sjellë një ndryshim shumë të madh në të gjitha sferat e shoqërisë në Kosovë, ndër to edhe në familje. Ndonëse *familja* mbetet simbol vendimtar i vlerave shoqërore, kjo po ballafaqohet kohëve të fundit me një krizë, e cila vjen si rezultat i shtimit të numrit të divorceve, rimartesave, familjeve me një prind, bashkëjetesave, familjeve me dy prindërit në punë, prinderimit nga çifte homoseksuale apo lesbike, e që të gjithë këta faktorë i kontribuojnë shtimit të diversitetit të *familjes*, me ç'rast tejkalojnë vlerat e *familjes tradicionale*. *Diversiteti kulturor* që krijohet me këtë rast krijon kushte, mundësi dhe rrethana të favorshme edhe për *devijime*.

Familja, si institucion i veçantë shoqëror, përherë ka pasur dhe ka funksione e detyra të shumëfishta në formimin, edukimin, ngritjen, zhvillimin dhe afirmimin e anëtarëve të vet, e sidomos të fëmijëve dhe të rinjve. Ajo paraqet fuqinë më të rëndësishme shoqërore për edukimin e drejtë dhe orientimin jetësor. Kësisoj familja manifestohet njëkohësisht edhe si fuqi e madhe në parandalimin e veprave penale (Latifi, 2008).

Shkolla si institucion dhe si “faktor mikrosocial” (Halili, 2008: 272) ka rëndësi të madhe në formimin dhe ngritjen e gjithanshme të personalitetit të njeriut. Dihet se

shkolla, menjëherë pas familjes, është institucioni më i fuqishëm në formimin dhe orientimin e të rinjve. Njerëzit nuk lindin të ditur, por ata mësojnë të sillen përmes një procesi të gjatë të mësuarit. Arsimimi ka rëndësi jo vetëm për të ardhmen e të rinjve, pozitën sociale të tyre, por ai konsiderohet si mjet i mirë për t'i larguar ata nga sjelljet devijante dhe kriminaliteti. Kjo është dëshmuar që prej kohësh, ku sipas shumë kriminologëve pjesa më e madhe e atyre që merren me kriminalitet dhe sjellje devjante i takojnë nivelit të ulët arsimor. Edhe statistikat rrëth krimit tradicional tregojnë një lidhje negative ndërmjet krimit dhe shkallës së ulët të arsimimit, pra me rritjen e njërs variabël, ulet tjetra dhe anasjelltas. Në të gjitha vendet e botës, të zhvilluara ose jo, është konstatuar se përfshirja në krim e njerëzve të arsimuar është në nivele më të ulëta se e atyre pa arsim apo me arsim të ulët.

Sot shkolla mund të llogaritet si një institucion me një forcë shumë të madhe ndikuese, qoftë në edukim dhe kulturë, qoftë në zhvillimi e tërësishëm të jetës së njeriut, duke luajtur rolin e saj edhe në parandalimin e kriminalitetit.

Gjatë gjithë historisë së zhvillimit të shoqërive të ndryshme, sistemeve politike dhe fenomeneve që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me shtetet dhe shoqëritë, rol të rëndësishëm në ndërtimin e tyre kanë luajtur padyshim edhe mediat. Duke qenë përherë në një rivalitet të natyrshëm me pushtetin, mediat ushtrojnë rol të rëndësishëm në identifikimin dhe luftimin e dukurive negative, sikundër edhe në nxitjen dhe zhvillimin e proceseve pozitive në një shoqëri.

Zanafilla e komunikimit masiv fillon qysh në agoria-në e lashtë greke, do të thotë kur filluan edhe qelizat e para të demokracisë së drejtpërdrejtë.

Roli i institucioneve komunale në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit përmes themelimit të disa këshillave del të jetë mjaft pozitive: secila komunë themelon Këshillin Komunal për Siguri të Bashkësive (KKSB) bazuar në nenin 128/4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe duke iu referuar nenit 3/ pika 16 dhe 17, si dhe nenit 7 të Ligjit pér Policinë e Kosovës. Si qëllim kryesor i KKSB-së është që në nivelin lokal-komunal të jetë i informuar lidhur me situatën e sigurisë, duke u njoftuar pér natyrën e krimít e aktivitetet kriminale dhe sjelljet devijante, që pastaj të identifikojë metodat e zhvillimit dhe zbatimit të projekteve efektive si dhe të planeve të veprimit pér shqyrtimin e këtyre çështjeve në nivel lokal, në bashkëpunim të ngushtë me pushtetin komunal, bashkësitë vendore dhe Policinë e Kosovës (Gashi & Avdaj, *vep. cit.*: 115).

KKSB-ja përbënë një ‘trup’ konsultues dhe këshillues pér ndërmarrjen e veprimeve parandaluese ndaj aktiviteteve kriminale, duke përfshirë të gjitha bashkësitë me përfaqësim të barabartë. Udhëhiqet nga kryetari i komunës dhe anëtarët që përfaqësojnë të gjitha komunitetet komunale. Përmes tij paraqiten shqetësimet e shoqërisë, sidomos ato që cenojnë sigurinë e tyre. Pra, është instrument komunal që në bashkëveprim me organet e rendit vepron në parandalimin dhe luftimin e sjelljeve devijante e të kriminalitetit.

Po ashtu, si ekipe që veprojnë në parandalimin dhe luftimin e dukurive kriminale dhe sjelljeve devijante dhe që bashkëpunojnë me organet e rendit dhe qeverisjen komunale janë edhe Komitetet Lokale pér Siguri Publike dhe Ekipet Vepruese të Sigurisë në Bashkësi, përmes së cilave shtrihet aktiviteti parandalues në tërë shoqërinë komunale.

Në raste të caktuara, anëtarët e KKSB-së konsultohen me Komitetet Lokale pér Siguri Publike dhe Ekipet Vepruese të Sigurisë në Bashkësi ose me personat apo grupet tjera,

për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet me synim të zgjedhjes konkrete të problemeve, duke përfshirë edhe ato që lidhen me tensionimet në bashkësi dhe më lirinë e lëvizjes. Kështu që, të gjitha këto përmes angazhimeve në forma të ndryshme, sidomos përmes identifikimit të faktorëve nxitës për aktivitetet kriminale si dhe pjesëmarrjen në fushatat përvetësimi në luftimin e kriminalitetit, kontribuojnë në parandalim.

Në të kundërtën, dështimi i masave parandaluese do të rrezikojë sigurinë e individit dhe të pronës dhe kjo do të ndikojë në destabilitetin e funksionimit të mirëfilltë të organeve lokale e shtetërore si dhe të shoqërisë në përgjithësi. Kështu që mbetet detyrë parësore e institucioneve gjegjëse që të koordinojnë veprimtaritë e veta dhe ato të përgjithshme përmes politikave strategjike mbi masat e parandalimit si dhe ruajtjen e sigurisë për një stabilitet dhe funksionim të duhur të shoqërisë.

#### **4.5 Harta e kriminalitetit në Gjakovë dhe rrëthinë**

Me qëllim që të kemi një pasqyrë reale lidhur me natyrën e dukurive kriminale, sidomos nga ato që paraqiten si risi në këtë trevë, janë nxjerrë të gjitha statistikat e rasteve të raportuara në Policinë e Kosovës, gjegjësisht në stacionin policor të Gjakovës, i cili mbulon tërë zonën e kësaj treve. Këto statistika janë analizuar detajisht dhe nga të gjitha ato, për natyrën e hulumtimit janë marrë vetëm ato që ndërlidhen me natyrën e këtij studimi. Gjatë kësaj analize rezulton se trendët e zhvillimit të shoqërisë gjakovare me rrëthinë dhe paraqitura e dukurive të reja kriminale në këto anë na sjellë në përfundim se kjo shoqëri është ballafaquar me shumë aktivitete kriminale. Mirëpo, si më shqetësuese dalin në pah dukuritë e ‘*vjetra, por të moderuara*’ kriminale dhe me dukuritë e reja kriminale. Natyra e përzgjedhjes së këtyre aktivitetave kriminale është bazuar në llojet e krimeve, të cilat edhe nëse kanë ekzistuar në të kaluarën, tani ato nuk iu përbahen zakoneve siç e parashihë tradita dhe kultura e kësaj ane, por edhe në ato që tani janë

krejt të reja, pra që fare nuk kanë ekzistuar në Gjakovën me rrithinë. Këto përzgjedhje janë dëshmuar edhe nga vet deklarimet e mostrës të përfshirë në studim.

Në anën tjetër, të gjitha këto dukuri kriminale janë analizuar dhe bazuar edhe nga pozita gjeografike e vetë qytetit si dhe zonës rurale të kësaj treve. Bazuar në ndarjen gjeografike, e cila është në përputhje me ndarjen e identifikuar sipas rajoneve të kësaj treve, rezulton se kemi të bëjmë me tri zona rurale dhe me zonën urbane, pra me qytetin e Gjakovës. Kështu që, në hartë janë përfshirë të gjitha rajonet si dhe dukuritë kriminale që kanë ndodhur saktësisht në këto zona, pra për secilin rast kriminal të fushës së studimit, i cili ka ndodhur dhe është raportuar në policinë që mbulon këtë zonë.

Fillimisht këto përzgjedhje janë nxjerrë nga statistikat e rasteve të raportuara në organet e rendit në Gjakovë që nga funksionimi i tyre, pra që nga viti 1999 e deri në vitin 2012. Gjatë raportimit të këtyre nëpër vite, shihet të ketë pasur fillimisht ngritje e rënie të përafërtë të trendit të kriminalitetit deri në vitin 2009 dhe më pas një rënie e tyre pak më e theksuar. Këtë e dëshmojnë statistikat e përgjithshme të rasteve të raportuara, sipas së cilave:

*Tabela 5. Numri i rasteve sipas klasifikimit të veprave penale*


Vepra	Viti													
	1999 <sup>13</sup>	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Vrasje	8	13	10	5	5	1	1	1	6	2	5	6	3	3
Tentim Vrasje		7	11	8	5	19	18	6	11	16	18	15	10	8
Vetvrasje	7	1	7	3	4	4	5	2	6	2	8	6	4	7
Tentim vetvrasje		/	/	1	15	16	30	37	23	30	16	17	19	7

<sup>13</sup> Mungesë të dhënash nga data-baza e policisë


Dhunë familjare			23	28	37	27	67	70	71	34	47	49	54	51
Grabitje&Tentim grabitje		22	24	46	24	23	29	24	23	20	29	30	41	32
Sh.Rr. P		27	15	56	29	14	54	46	20	88	12	43	55	40
Rrëmbim		20	16	9	3	5	2	6	4	5	5	5	3	/
Dhunim& V. kundër integitetit		2	7	4	9	9	10	12	2	4	5	4	7	7
Droga&substanca psikotropë		2	5	30	23	14	32	36	14	29	31	27	33	17
Trafikim me qenie njëzore		1	5	15	/	/	2	/	/	1	/	/	/	/
Persona të humbur		19	17	21	12	17	6	17	15	10	10	11	22	13
Uzurpim i pronës		/	/	8	1	/	7	13	3	7	3	11	9	15
Hyrje në sist. kompjuterike		/	1	/	/	/	/	/	/	/	1	/	/	3
Hetime të vdekjes		/	/	/	/	/	2	2	11	/	14	8	9	15
Numri i përgjithshëm i veprave				2309	2630	1868	2507	2435	2106	2123	1809	1924	1819	1624

Duke marrë për bazë hartën gjeografike të kësaj treve dhe ndarjet sipas rajoneve të banuara e që edhe organet e sigurisë i mbulojnë, kemi nxjerrë saktë hartën e ‘*kriminalitetet*’, në të cilën tregohen saktë llojet më shqetësuese të veprave kriminale dhe statistikat e tyre. Kështu që bazuar në këto, harta e kriminalitetit të Gjakovës me rrëthinë paraqitet në këtë formë:

Harta 2. Kriminaliteti në zonat rurale



Harta 3. Harta e kriminalitetit në zonën urbane- Gjakovë



Duke iu përmbajtur të të njëjtave të dhëna, në formën tabelore do kemi këtë pasqyrim (shih tab. 6):

*Tabela 6. Tabelë statistikore për disa nga dukuritë kriminale të raportuara nga viti 1999 deri 2012 sipas ndarjes rajonale të Gjakovës me rrëthinë*

Veprat	Gjakovë	Rajonini Hasit	Rajoni i Dushkajës	Rajoni i Rekës së keqe	Totali
Vrasje	30	19	8	6	63
Tentim Vrasje	46	14	21	12	93
Vetëvrasje	30	8	12	5	55
Tentim vetëvrasje					181
Dhunë familjare	142	13	22	15	192
Grabitje&Ten. grabitje	136	28	20	24	208
Shkaktim i Rrezikut të Përgjithshëm	53	5	3	12	73
Rrëmbim	43	7	12	14	83
Dhunim &V. P. kundër integritetit	33	3	4	3	43
Substanca narkotike	84	4	5	7	100
Trafikim me qenie njerëzore	16	1	1	6	24
Persona të humbur	125	15	15	17	172
Uzurpim i pronës	13		2	1	16
Hyrje në sist. Kompjuter.	4			1	5

## KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE

### 5.1 Statistikat përshkruese të studimit – Përpunimi statistikor i materialit


*Informacion i përgjithshëm mbi subjektet e caktuara*

Gjatë kërkimit primar, i realizuar për qëllimet e këtij studimi, janë marrë të dhëna të mjaftueshme nga pyetësorët, me një mostër që përfshin 530 qytetarë dhe 75 të dënuar, si dhe intervista me 15 qytetarë dhe 20 me të dënuar. Në mostër janë përfshirë të gjitha kategoritë nga popullsia e rajonit të Gjakovës. Pyetësori ishte standard dhe i ndarë në dy tipa: a) tipi me qytetarë të përzgjedhur dhe b) tipi me personat e dënuar. Edhe intervista ishte nga dy tipa të tilla, por që i takonte llojit të pastrukturuar.


#### Mosha:

Duke u bazuar në trajtesën e studimit, për mostrat e përzgjedhura ishte përcaktuar mosha. Duke iu referuar të dhënavë të nxjerra nga hulumtimi, na rezulton se kemi të bëjmë me një përqindje të kënaqshme të të gjitha kategorive, pra që kanë mundësi të kuptojnë qartë traditat dhe kulturën në të kaluarën dhe sotmen, si dhe paraqitjen e dukurive të reja kriminale; në anën tjeter, kemi përfshirje të të gjitha moshave që kanë qenë subjekt i shkeljeve ligjore.

*Diagrami 2. Mosha - me qytetarë*



*Diagrami 3. Mosha - me të dënuar*




Pra, nga kjo del se kemi një mostër të përfaqësuar mirë nga moshat e përcaktuara, qoftë nga qytetarët, qoftë nga të dënuarit.


#### **Gjinia:**

Derisa këto tradita dhe dukuri kriminale kanë përfshirë pa dallim gjinie qytetarët, në anën tjeter, subjekt i shkeljeve ligjore ishin të dy gjinitë, duke qenë pjesë e drejtpërdrejtë e këtyre zhvillimeve, edhe në pyetësor janë përfshirë të dy gjinitë (shih diagr. 4 dhe 5).

*Diagrami 4. Gjinia - me qytetarë*



*Diagrami 5. Gjinia - me të dënuar*




Nga mostra e studimit del se kemi një përqindje të përafërt gjinore në tipin e pyetësorëve me qytetarë, kurse tek të dënuarit, shihet dominon gjinia mashkulllore. Edhe sipas statistikave të burimeve dytësore, del se shumica e të dënuarve i takojnë gjinisë mashkulllore.


#### **Niveli i shkollimit:**

Duke u nisur nga nxitja që të kemi sa më shumë këndvështrime dhe vlerësimë të mendimeve nga niveli i zhvillimit intelektual, si dhe nga ana tjetër, për nivelin intelektual nga të dënuarit, shihet se kemi të bëjmë me të gjitha kategoritë e shkollimit.

*Diagrami 6. Niveli i shkollimit - me qytetarë*



*Diagrami 7. Niveli i shkollimit - me të dënuar*




Kjo variabël është një tregues se tek tipi me qytetarë dominojnë të anketuarit me shkollim të lartë dhe superior, gjë që mundëson një vlerësim me karakter më të gjerë dhe më analizues të mendimeve më gjithëpërfshirëse dhe më të përafërtë me realitetin. Ndërsa te tipi me të dënuarit, shihet se në kriminalitet janë përfshirë të gjitha nivelet intelektuale, por që dominojnë niveli fillor dhe i mesëm. Zakonisht, nga ata pa shkollim pjesa e madhe vijnë nga komunitetet romë, ashkalinjë dhe egjiptian.


#### **Statusi martesor dhe familjar:**

Duke ditur se gjërat nuk mund të vlerësohen njëjtë si nga ata që zhvillojnë jetë individuale nga ata që zhvillojnë jetë familjare dhe bartin përgjegjësi më të mëdha në shoqëri përmes familjes së ngushtë e deri te rrathi i gjerë. Ndaj, që vlerësimi të nxjerrët i paanshëm, rezulton një përfshirje e personave me statuse si nga ana e martesës si dhe ai familjar (diagr. 8 – 11).


*Diagrami 8. Statusi martesor - me qytetarë*




*Diagrami 9. Statusi martesor - me tè dënuar*



*Diagrami 10. Statusi familjar -me qytetarë*



*Diagrami 11. Statusi familjar -me të dënuar*




Shihet se kemi të bëjmë me mostër që është pjesë e bashkësisë më të gjërë dhe pak i takon individualitetit. Edhe nga mostra me të dënuar kemi të bëjmë me persona që janë kryesisht pjesë e familjes, por që shumica e tyre jetojnë me prindër dhe janë të pamartuar. Shikuar në aspektin social, kjo është edhe kategoria që nuk ka edhe shumë obligime për të tjerët, po është pikërisht kjo kategori që merret më shumë me shoqërinë.


#### Vendbanimi:

Marrë parasysh se zhvillimet shoqërore dhe aktet kriminale kanë përfshirë përafërsisht njëjtë si zonën urbane, ashtu edhe atë rurale, kemi përfshirje në mostër nga të dyja zonat, qoftë me qytetarët, qoftë me qytetarët e dënuarit.

*Diagrami 12. Vendbanimi - me qytetarë*



Diagrami 13. Vendbanimi - me të dënuar




Kjo përfshirje e mostrës rezulton të jetë e përafërt edhe me zonat e banuara, pra, pjesa më e madhe në zonën urbane ku është përqendruar popullsia pas vitit 1999, duke marrë parasysh se gjatë këtyre viteve ka pasur migrime të shumta të brendshme, me ç'rast qyteti është populuar më shumë nga popullata e zonave rurale. Po ashtu edhe personat e dënuar del të jenë më të shumtë nga zona urbane.


#### **Statusi i punës dhe gjendja ekonomike:**

Punësimi krijon dy mundësi: a) duke qenë një gërshetim i zakoneve dhe kulturave dhe b) rregullon edhe gjendjen ekonomike. Vlerësimet nga terreni paraqesin të tri kategoritë (të punësuarit, të papunët dhe pensionistët). Këto vlerësimë jepin mendime më të hapura, sepse mjedisi i punës domosdo që ka dhënë mundësi të gërshetimit të zakoneve dhe kulturave lokale që më parë dhe konceptet e tyre mund të përafrohen më shumë në kuptimin e rrethanave aktuale. Megjithatë, edhe ata që janë të papunë jepin konceptin e tyre ashtu siç e mendojnë. Edhe gjendja ekonomike paraqet një prej faktorëve kyç, sidomos te qytetarët e dënuar lidhur me shkaktarët e përfshirjes në aktivitete kriminale (shih diagr. 14 – 17).


Diagrami 14. Statusi i punës - me qytetarë




Diagrami 15. Statusi i punës - me të dënuar



Diagrami 16. Gjendja ekonomike - me qytetarë



Diagrami 17. Gjendja ekonomike - me të dënuar




Sipas gjetjeve tek qytetarët, pjesa më e madhe e vlerësimeve vjen nga personat e punësuar dhe me një gjendje të mesme dhe të mirë ekonomike, ndërsa tek të dënuarit, vlerësimet vijnë nga statusi i të papunësuarve dhe me një gjendje të dobët dhe e mesme ekonomike. Bazuar në këto, shihet se nga ana e qytetarëve mund të kemi mendime më reale lidhur me vlerësimet e tyre, ndërsa të dënuarit vijnë jo vetëm nga niveli i dobët ekonomik, por edhe nga ai i mesëm dhe i mirë. Kjo na paraqet edhe një karakteristikë interesante mbi nxitjen e individëve e grupeve të ndryshme për t'iu futur rrugës së krimít, ku na del se jo vetëm personat, të cilëve iu imponohet sigurimi i mbijetesës përmes aktivitetave të kriminale, por në kriminalitet, akoma më shumë, nxiten personat vetëm për pasurim më të shpejtë, madje ka të tillë që punët e pista i bëjnë nga pasioni.


#### Qytetarët në raport me aktivitetet kriminale:

Këtu kemi mostër, që veç në ndonjë mënyrë ka qenë i sulmuar nga dukuritë kriminale. Kështu që kemi mendime, jo thjeshtë vetëm si qytetarë, por edhe nga ata që janë të sulmuar në një ose tjetër mënyrë, e që domosdo do të jetë e ndikuar edhe në paraqitjen e përshtypjeve të tyre (diagr. 18 – 20)


Diagrami 18. Viktimë e veprës penale



Diagrami 19. Dëshmitar i veprës penale



Diagrami 20. Ankues për vepra penale




Bazuar në të dhënat e lartcekura shihet se mostra në fjalë përbëhet nga ata që kanë qenë viktimi, ankues dhe dëshmitar të veprave penale dhe nga ana tjetër edhe nga ata që nuk kanë përjetuar asnjëren nga këto. Kjo mundëson që mendimet të jenë nga të gjitha këndvështrimet, e jo vetëm nga një anë.

#### **Vendqëndrim tjetër:**

Duke marrë parasysh se pak pas ndërhyrjes së faktorit ndërkombëtar në Kosovë dhe qeverisjes së tyre gjatë periudhës së tranzicionit të kësaj shoqërie, po edhe pas shpalljes së shtetit të Kosovës, shumë persona nga vende të ndryshme të Evropës, e vende tjera, janë kthyer vullnetarisht apo edhe me dëbim në vendin e tyre, ndër të cilat edhe në Gjakovë, shumë nga personat e dënuar kanë pasur edhe vendqëndrime tjera jashtë Kosovës (diagr. 21).

*Diagrami 21. Me banim jashtë Kosovës*




Nga kjo mostër shihet se ka një numër të madh që kanë jetuar nëpër vende të ndryshme të botës dhe se kanë njojuri mbi shoqëritë e zhvilluara dhe të hapura dhe se kanë pasur të bëjnë me shkelje ligjore në këto vende.

### **Shkeljet ligjore:**

Personat në mostër nga të dënuarit kanë të bëjnë me shkelje ligjore, të cilën gjë e dëshmojnë edhe vet përmes të dhënave në pyetësor (diagr. 22).

*Diagrami 22. Shkeljet ligjore*




Në pjesën e dytë trajtohet rënia ndesh me ligjin dhe arrestimet e dënimet, ku kemi:  
96.0% të tyre pranojnë se kanë rënë ndesh me ligjin


### **Arrestuar:**

Nga këta persona del se përqindja e madhe prej tyre janë arrestuar, arrestime të cilat u takojnë periudhave të paraluftës, të pasluftës dhe të të dyjave (diagr. 23 – 25).


*Diagrami 23. Arrestimi*



Diagrami 24. Sa herë janë arrestuar



Diagrami 25. Periudha e arrestimeve




Këtu shihet se pjesa më e madhe janë delikuent të rinj dhe se një numër është arrestuar disa herë.


#### Të dënuar:

Nga kjo mostër del se thuajse të gjithë kanë qenë edhe të dënuar, dhe jo vetëm njëherë. Gjithashtu periudhat në të cilat ata janë dënuar varojnë nga njëherë deri në disa herë (diagr. 26 – 28).


*Diagrami 26. Të dënuar*



*Diagrami 27. Sa herë janë dënuar*



*Diagrami 28. Periudha kur janë dënuar*




Nga kjo shihet se personat në fjalë kanë një të kaluar kriminale, ku dominon dënimimi me vetëm një herë, por që është i pranishëm dhe shqetësues edhe fakti kur janë edhe me dy, tri e më shumë herë të dënuar. Kjo dëshmon për persona si recidivistë dhe se te ata nuk është arritur risocializimi i duhur. Pasta, dominon periudha e dënlimeve pas luftës 1998-1999, por që ka edhe nga ata që kanë qenë të dënuar edhe para asaj periudhe dhe po ashtu edhe në të dy periudhat. Ajo që bie në sy është se disa kanë shkruar se nuk kanë qenë të arrestuar. Kjo gjë mendohet se vjen nga dy arsyet: së pari disa kanë menduar t'ishmangën realitetit dhe së dyti, ka raste kur ata pas veprës së kryer nuk janë arrestuar, por që vet janë paraqitur në organet e drejtësisë dhe nga aty e kanë marrë masën e dënlimit.


#### **Familjar të arrestuar dhe të dënuar:**

Nga kjo mostër del se personat e dënuar kanë pasur edhe familjar të arrestuar dhe të dënuar (diagr. 29 – 30).

*Diagrami 29. Familjar të arrestuar*



*Diagrami 30. Familjar të dënuar*




Pra, shihet se edhe nga anëtarët e familjes kanë një trashëgimi përcjellëse në shkelje të normave shoqërore. Mirëpo, pjesa më e madhe del të jetë se ata janë edhe të vetmit që kanë kryer aktivitete kriminale.

#### **Dënim i për veprat mbi bazë të periudhave:**

Bazuar në trendin e zhvillimit të shoqërisë dhe dukurive kriminale sipas kësaj kategorie të qytetarëve del se pjesën më të madhe për nga natyra e veprimitarive kriminale janë dukuri që rezultojnë vetëm pas luftës, po që ka raste që edhe nga ato që kanë ekzistuar edhe në të kaluarën (diagr. 31).


*Diagrami 31. Natyra e veprave penale*



### Të arrestuar apo të dënuar nga shoqëria:

Personat e dënuar del të kenë pasur në shoqëri persona të arrestuar dhe të dënuar. Kjo të bënë të mendosh se këta kanë një bashkëpunim të mirë mes vete dhe pjesën edhe të kohës e kalojnë së bashku. Madje, këta të bëjnë të kuptosh se mund të jenë edhe model i njëri tjetrit dhe shtytës në aktivitetet kriminale (diagr. 32).

*Diagrami 32. Të arrestuar dhe të dënuar nga shoqëria*




Duke iu referuar të dhënave personale të dy tipave të studimit vlerësohet se mostra e përzgjedhur ka mjaft njoburi lidhur me trajtimin e traditave dhe të kulturës në të kaluarën dhe evoluimet e sotme kulturore si dhe të paraqitjes së dukurive të reja kriminale. Në anën tjeter, tipi i mostrës me personat e dënuar del të jetë një tip i hapur dhe më se real, duke mos hezituar të tregojnë saktë përfshirjen e tyre në kriminalitet. Këtë e them, pasi që kam njobur për së afërm me pjesën më të madhe të tyre dhe të kaluarën kriminale.

### **Struktura në përqindje e intervistave me qytetarët:**


Duke marrë parasyshë trajtesën e hulumtimit, në mostër janë përfshirë qytetarë mbi moshën 30 vjeç, me qëllim që më saktë të dallojnë të kaluarën dhe të sotmen. Andaj, bazuar në të dhënrat rreth moshës (shih diagr. 33), shihet se kemi një mostër që ka përjetuar dhe njeh mirë zhvillimet nga e kaluara dhe e tanishmja.

*Diagrami 33. Sipas moshës - qytetarët*




Edhe nga ana gjinore janë përfshirë të dy gjinitë, që sipas diagramit kemi këtë përqindje, por që dominon ajo mashkullore:

*Diagrami 34. Sipas gjinisë – qytetarët*




Me qëllim që të kemi vlerësime nga të gjitha nivelet e shkollimit, shihet se edhe këtu janë të përfshira të gjitha, por që dominim shkollimi superior. Ky nivel domosdo që mund të vlerëson më realisht, sepse ka një kënd më të gjerë të procesit të zhvillimeve shoqërore.

*Diagrami 35. Sipas shkollimit - qytetarët*



Derisa zhvillimet shoqërore kanë prekur çdo pore të shoqërisë, nga mostra del të jenë përfshirë thuajse të gjitha kategoritë e qytetarëve. Këtë e shohim edhe nga diagrami 36.


*Diagrami 36. Sipas profesionit - qytetarët*



### **Struktura e intervistave me persona të dënuar:**


Duke iu referuar të përfshirëve në aktivitete kriminale, shihet se kemi të bëjmë me të gjitha moshat, pra edhe nga ajo e mitura. Kjo paraqet një realitet që ndryshimet kanë reflektouar në të gjithë shoqërinë, ku secila moshë shkel normat shoqërore e juridike.

*Diagrami 37. Sipas moshës – të dënuarit*




Lidhu me shkelësit e normave ligjore, shihet se tani kemi edhe nga gjinia femërore:

*Diagrami 38. Sipas gjinisë - të dënuarit*



Duke iu referuar nivelit të shkollimit, personat e dënuar dalin të vijnë nga të gjitha nivelet, por që dominojnë ata me shkollim të mesëm dhe fillor (shih diagr. 39).

Diagrami 39. Sipas shkollimit - të dënuarit



## 5.2 Gjetjet kryesore të studimit; Komentar i të dhënave


Pas trajtimit lidhur me metodat dhe metodologjinë e hulumtimit dhe paraqitjes së instrumentit të hartuar për vlerësimin e elementeve lidhur me zhvillimet në shoqërinë e Gjakovës me rrethinë me rastin e ndryshimit në sistemin organizativ të jetës së pasluftës së vitit 1999, sidomos në pikëpamjet e evoluimit në fushën e kulturës dhe të traditave, e cila njëkohësisht përcillet me zhvillimin e trendëve kriminale përmes paraqitjes së dukurive të reja kriminale, për më konkretisht do i pasqyrojmë përmes rezultateve të studimit.

Rrethanat e reja të krijuara menjëherë pas përfundimit të luftës 1998-1999, sollën ndryshime të mëdha në këtë shoqëri. Përqafimi i sistemit demokratik thuajse bëri një riorganizim krejt tjetër të shoqërisë së kësaj treve. Kjo depërttoi në çdo pore të shoqërisë, sidomos në kulturën dhe traditën. Një zhvillim i tillë mundësoi ‘hapjen’ e shoqërisë. Kjo u bë edhe faktori kryesor që më në fund ‘tradicionalizmi’ t'i lëshojnë vendin

bashkëkohores. Ky riorganizim shoqëror ka ndryshuar të gjitha rrëthanat politike, ekonomike dhe sociale. E gjithë kjo ‘lëvizje’ kishte edhe sfidat e veta të shumta, me ç’rast ky tranzicion u shfrytëzua për aktivitete kriminale, të cilat sollën risi negative, të shëmtuara dhe tejet të rrezikshme në shoqërinë e këtij rajoni.

Kjo ka ndikuar edhe në situatën e sigurisë së qytetarëve të kësaj ane. Andaj, duke iu referuar të anketuarve rrëth vlerësimit të përgjithshëm të situatës së sigurisë se si janë përballuar qytetarët e kësaj treve në fushën e aktiviteteve kriminale gjatë vitit 1999 – 2012, rezulton se kishim të bëjnë me një situatë mjaft shqetësuese për ta. Këtë e argumenton edhe përqindja e madhe nga mostra e hulumtimit, ku rrëth 80% e vlerësojnë një gjë të tillë si shqetësuese (shih diagr. 40).

*Diagrami 40. Vlerësimi i situatës*



Pra, periudha e ndërtimit të një rendi të ri shoqëror, nuk kishte mundur ta ruajë qetësinë individuale, grupore e shoqërore brenda vetes. Rrëthanat e reja të krijuara gjatë kësaj periudhe nuk ishin kursyer as nga incidentet e natyrave kriminale. Kështu, nga të gjeturat tona dëshmohet se në zonat ku banojnë popullata e përfshirë në hulumtim, ku janë të përfshira të gjitha rajonet e kësaj treve, kishin qenë të përballura me mjaft raste shqetësuese kriminale. Edhe të dhënët statistikore dëshmojnë raportimet e rasteve të tilla

tek organet e rendit, duke filluar nga rastet më të lehta e deri te ato më të rënda. Të gjitha këto shqetësime, përveç të marra nga pyetësorët, edhe më qartë janë trajtuar përmes intervistave të drejtpërdrejta me qytetarët nga të gjitha kategoritë e shoqërisë së këtij rajoni.

Duke iu referuar intervistave, në pjesën më të madhe është cekur se gjatë kësaj periudhe gjërat kanë ndryshuar shumë. Riorganizimi shoqëror ka sjellë edhe “fenomenet e reja që kanë lulëzuar në shoqerinë tonë kanë sjellur pasoja të mëdha si në aspektin moral, shoqëror, ekonomik dhe atë social, ku nesër a pasnesër shoqëria do t'i paguajë me çmim relativisht të lartë” (Q-M-3)<sup>14</sup>. Këto i pohon edhe një nga sociologët e intervistuar, sipas të cilit “ka shumë ndryshime, në mesin e të cilave janë paraqitur disa dukuri, të cilat asnjëherë nuk kanë ekzistuar në qytetin e Gjakovës e as në zonat periferike” (Q-S-6)<sup>15</sup>. Njëjtë mendon edhe një nga drejtueset e një OJQ-je që merret me trajtimin e viktimate të dhunës në familje. Ajo pohon se:

Kemi pasur raste edhe me njerëzit që kanë jetuar me social prej 70€, kur posa kanë marrë atë, qoftë ai vet, djali apo nipi, e kanë humbur në bixhoz dhe nga pamundësia për t’i nxjerrë ato, kanë ushtruar dhunë ndaj familjes, duke mos kursyer as prindërit, që për ne ka qenë e paimagjinueshme që fëmija ta rrahë prindin (Q-N-10)<sup>16</sup>

Pohimi në fjalë paraqet qartë prurjet e reja, qoftë në socio-kulturë, qoftë në kriminalitet. Së pari, lokalet e lojërave të fatit nuk kanë qenë prezantë kudo nëpër shoqëri dhe së dyti, respektimi i prindërve dhe më të vjetërve ka qenë obligim moral i secilit e që është respektuar, ndërsa tani kemi të bëjmë jo vetëm me shkelje të traditës kulturore por edhe me veprën kriminale të *dhunës në familje*.

<sup>14</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014

<sup>15</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 31.07.2014

<sup>16</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014

Mostra e përdorur në hulumtim, shqetësimet në këto përmasa, i argumenton edhe me atë se në zonat e tyre të banimit ka pasur paraqitje të dukurive kriminale, me theks të veçantë nga këto ‘moderne’. Njëjtë del të jetë edhe në organet e rendit, ku, bazuar në lokacionet ku kishin ndodhur rastet kriminale, shihet se ato nuk kishin kursyer as zonat rurale dhe as atë urbane. Shqetësuese del të jetë pasiguria e tyre gjatë lëvizjeve vetëm, sidomos gjatë kohës së errësirës. Ata e argumentojnë këtë me faktet se disa prej tyre kishin qenë vet viktimi e akteve kriminale, si e grabitjeve dhe e vjedhjeve grabitqare. Bazuar në deklarimet e tyre shihet se kishte pasur raste kur individë apo grupe kishin vepruar nëpër zona të ndryshme ditën, sidomos gjatë natës, duke shfrytëzuar si cak gjininë femërore, moshat e vjetra, duke u grabitur çantat nga dora, arin nga qafa apo bizhuteritë e tjera nga veshët, në mënyrë tinëzare apo edhe me dhunë, dhe pastaj iknin në drejtime të panjohura. Nuk ishin të rralla edhe rastet kur persona të maskuar dhe të armatosur kishin grabitur në rrugë apo edhe brenda në familje, dhe atë pa kursyer moshën dhe as gjininë.

Respektimi i moshës së vjetër dhe gjinisë femërore ishte kulturë që është respektuar kudo e kurdo, madje edhe në rastet e hakmarrjes dhe gjakmarrjes. Për personat dhe familjet e varfëruara ka mbizotëruar humaniteti shoqëror duke i përkrahur me sigurimin e gjërate të nevojshme për jetesë. Mirëpo, në rrethanat e tanishme nuk ka respekt ndaj askujt, përkundrazi shfrytëzohet paaftësia e tyre për tu vetëmbrojtur apo në mënyrë tinëzare iu merren gjërat personale e familjare me vlerë. Madje kjo shkon aq larg, jo veç shkeljes së traditave, por edhe duke sjellë dukuri të re kriminale të rrezikshme dhe shqetësuese. Duke iu referuar personave që kanë kryer kësot vepra kriminale, shihet se ata i kanë bërë përfitime personale me qellim të realizimit planifikimeve tjera prapë kriminale, si shkuarja nëpër lojëra të fatit, lokale të natës etj.

Se vërtetë janë raste shqetësuese, dalin edhe rastet e pasigurisë së pronave të tyre, të cilat nëse janë lënë pa mbikëqyrje përkohësisht, u janë dëmtuar apo edhe vjedhur. Pikërisht kjo pasiguri dhe ky shqetësim reflekton edhe në numrin e madh të rasteve të denoncuara në organet e rendit, sidomos të vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda, ku nuk janë kursyer pronat pa përkujdesje dhe as ato që ishin të banuara dhe me familjar brenda në kohën e krimtit. Madje, tregohen raste kur autorët e këtyre akteve kriminale kishin sulmuar familjarët që i kishin dëgjuar dhe kishin dalur ta mbrojnë pronën e tyre. Disa pohojnë se kur kanë ardhur nga shtetet e tjera ku jetojnë e punojnë, kanë gjetur të demoluara dhe të vjedhura pronat e tyre. Bazuar në statistikat në fjalë del se gjatë këtyre viteve ishin me qindra raste të vjedhjeve e dëmtimeve të pronave. Lidhur më këtë dukuri, në shumicën e rasteve, nga të intervistuarit thuhet se kur ata kanë pasur raste për të shkuar diku janë detyruar që të gjejnë dikë nga të afërmit e tyre për t'i lënë në shtëpitë e tyre apo edhe kanë paguar persona që të përkujdesen për pronën e tyre.

Me qëllim të krijimit të një sigurie shoqërore, nga qytetarët dhe disa institucione ishte kërkuar prezenca më e madhe e policisë, ku nuk kishin munguar edhe kërkesat zyrtare me shkrim që iu kishin bërë organeve të rendit. Ata edhe në kohën e hulumtimit e shohin të domosdoshme një shtim të një prezence të tillë, sidomos nëpër disa lagje të qytetit dhe në zonat e thella rurale. Madje, kishin edhe kërkesa për ngritjen e nënstacioneve policore në disa qendra më të mëdha rurale.

Duke iu referuar situatës shqetësuese shihet se gjatë kohës së këtij riorganizimi dhe transformimi shoqëror të kësaj treve, është formuar një shoqëri e ndryshueshme nga e kaluara, krahas së cilës janë formuar edhe ‘struktura’ që kanë sjellë dukuri të reja kriminale. Këto dukuri janë paraqitur si rezultat i ndryshimeve të politikave ri-organizuese, ekonomike e sociale.

Në anën tjetër, gjendja aktuale vlerësohet si situatë shqetësuese edhe nga disa prej personave që vet kanë shkelur normat ligjore dhe ato morale të kësaj shoqërie. Këtë e tregon edhe njëri nga të anketuarit, që thotë se “dukuritë e reja kriminale janë shqetësuese për tërë shoqërinë, bile edhe për neve që i kryejmë, e sidomos për rininë, pasi pjesa më e madhe e rinishë e ka prioritet drogën, që po iu duket interesante” (D-1)<sup>17</sup>. Ndërsa sipas të anketuarit tjetër thuhet se, “këto janë më të rrezikshme, sepse vazhdimisht po shkojnë në rritje, pasojat janë të shumta, duke filluar nga vetja, familja, rrithi dhe tërë shoqëria” (D-L-M-1)<sup>18</sup>.

Një vlerësim lidhur me rrezikshmérinë e aktiviteteve kriminale të kësaj kohe e përforcojnë edhe më tej dy të anketuar tjerë, bile duke e treguar arsyen e këtij rreziku, qoftë për ata që i kryejnë, por edhe për shoqërinë, sipas të cilëve:

Dukuritë e reja kriminale janë më të rrezikshme për shoqërinë, sepse ato përfshijnë edhe persona të tjera dhe e shtojnë numrin dhe se vet natyra e tyre është e rrezikshme. Edhe për vet individin si dhe të tjerët. Për individin është e rrezikshme nga vet natyra e veprës dhe rreziqet prej atyre që i dëmon ton dhe në anën tjetër e pret policia dhe burgu. Për shoqërinë është rrezik se është e gatshme t'i dëmon ton viktimat deri me pasojat më të rënda (D-L-M-1)<sup>19</sup>

Ndërsa aktivitetet kriminale të sotme sa janë të rrezikshme për individin, edhe më të rrezikshme janë për shoqërinë. Të rrezikshme për individin janë ngase shumë herë përballesh me rrezik për jetën, e për shoqërinë janë të mëdha si në shërim e po ashtu edhe për motivim për të tjerët (D-P-2)<sup>20</sup>

Duke iu referuar këtyre vlerësimeve si dhe shumë të tjerave të përafërtë, shihet se vërtetë kemi të bëjmë me një situatë shqetësuese, madje në shumë aspekte. Fillimisht në aspektin social dalin dukuri të reja, si konsumimi i substancave narkotike, e që paraqesin problem jo vetëm për individin, por edhe për familjen dhe tërë shoqërinë, në aspektin material dhe në trajtimet mjekësore- rehabilituese si dhe në ato të vuajtjeve të

<sup>17</sup> Intervistë me të dënuar, realizuar në qytet, 01.08.2014

<sup>18</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.


<sup>19</sup> Po aty.

<sup>20</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 22.09.2014.

dënimiveve. Në anën tjetër, gjendja e tyre dhe mënyra e kryerjes paraqet rrezik për vet jetën e tyre si dhe për tjerët që janë cak i tyre. Ajo që i karakterizon rrëthanat në fjalë të kësaj shoqërie është fakti se për këtë ndajnë mendime të përafërtë edhe vet individët që janë marrë me aktivitete kriminale.

Në analizën mbi mënyrën e kryerjes dhe llojin e incidenteve kriminale për periudhën e viteve 1999-2012, kemi vlerësimet e marra nga terreni, sipas të cilave kemi këto përgjigje (shih diagr. 41):

*Diagrami 41. Mënyra dhe lloji i veprave penale pas vitit 1999*



Këtë ndryshim në mënyrat e paraqitjes së aktiviteteve kriminale të argumentuar me të dhënat nga pyetësori, e plotësojnë edhe shumë mendime të marra përmes intervistave. Ata vlerësojnë se për nga natyra e këtyre incidenteve kriminale gjatë kësaj periudhe ka ndryshime të dukshme krahasuar me të kaluarën. Madje disa të intervistuar thonë: “kurrë nuk kemi parë e as dëgjuar të ketë ngjarë një rast i tillë”.

Ndryshimi vjen nga disa arsyet. Së pari ata vlerësojnë se gjatë kësaj kohe janë paraqitur disa dukuri në shumë aspekte, sidomos zbehja dhe humbja e rolit të disa institucioneve,

si ai i familjes, pastaj në fushën e ekonomisë e të biznesit dhe sjelljet e kulturave nga vendet e tjera në këtë drejtim, të cilat shumë herë janë shfrytëzuar nga individë dhe grupe të caktuara për përfitime personale, pa analizuar shkeljet e normave morale e ligjore të shoqërisë. Së dyti, vjen numri gjithnjë më i madh i incidenteve kriminale, të cilat janë ‘risi’ të reja. Së treti, edhe disa nga incidentet kriminale që e kanë përcjellë këtë shoqëri, gjatë kësaj periudhe janë modifikuar, duke sjellur pasoja më të rënda për shoqërinë.

Një ndryshim i tillë vjen me rastin e zbehjes së rolit të familjes, i cili ka ndikuar që disa individë të caktuar, duke mos pasur respektin dhe as frikën e familjes, aktivitetet e tyre i zhvillojnë në të gjitha fushat e jetës së tyre në kundërshtim të plotë me traditat, kulturën dhe normat shoqërore të familjes dhe shoqërisë. Sidomos moshat e reja, “po përqafojnë jetën gjithnjë më të re, që po e quaj pak moderne” (Q-E-1)<sup>21</sup>, kështu që “po largohemi gjithnjë e më shumë nga raportet e mëhershme që kanë qenë brenda një familjeje”<sup>22</sup>. Kështu, ata sollën risi të reja në shumë fusha, si: ekonomi, biznes, e deri te rr Ethanat sociale. Këto mundësuan, që kinse në emër krijimit të një biznesi, ata të sjellin hapjen e lokaleve ku punonin femra nga vende të ndryshme të Evropës dhe vendeve të tjera, veçanërisht me shërbime gjatë orëve të natës; usurpimin e pronave të huaja, kërkimi i lëmoshës nga të gjitha kategoritë e qytetarëve, etj. Të gjitha këto dhe shumë tjera mundësuan edhe paraqitje të reja kriminale. Kjo pasqyrohet kështu:

Ndryshimi i kriminalitetit të sotëm është se në shoqëri më nuk është dominimi i familjes e rrëthit sipas traditës që nuk të kanë lejua me bërrë diçka me “na marrë fytyrën”, e sot janë të lirë dhe nuk respektojnë askënd dhe synojnë të bëjnë qejfe veç për vete. Që të bëjnë këto, ata grabitin, vrasin, merren me droga, me femra të huaja, që më parë nuk i ka lejua shoqëria (Q-D-11)<sup>23</sup>

<sup>21</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 24.06.2015.

<sup>22</sup> Po aty.

<sup>23</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 14.07.2014.

Mendim të përafërt jap edhe një tjetër i anketuar, i cili shprehet kësisoj:

Koha ka sjellë ndryshime të reja. Vjedhjet e rënda, grabitje, droga, prostitucion janë aktivitete që kam pasur rastin vet t'i përjetoj. Në të kaluarën ka qenë regjim tjetër dhe roli i familjes dhe traditat kanë pengu këto gjëra (D-P-2)<sup>24</sup>

Natyra e këtyre incidenteve kriminale është edhe më e frikshme, sepse nuk kurson moshat dhe as gjininë. Tani ka raste kur edhe pse për nga natyra duken të njëjta, realisht janë më të frikshme dhe më të rrezikshme e deri te ato që fare nuk kanë ekzistuar. Pra, del si një mënyrë e re në të shumtën e incidenteve kriminale. Një nga vlerësimet kemi edhe këtë:

Ndryshimi i raporteve shoqërore solli ndryshime edhe në fushën e krimit. Mënyra e kryerjes së veprave penale vetëm se erdhi e ‘moderuar’ nën maska, e pamëshirshme në mënyrën e vet kryesve, metoda kriminale të shumëllojshme, si: grabitja, plaçkitja, droga, prostitucioni, mashtimi etj. (Q-T-2)<sup>25</sup>

Kohëve të fundit shoqëria e kësaj treve është përballur me disa dukuri, të cilat edhe pse ishin prezente në të kaluarën, tani kanë mënyrë dhe formë tjetër. Kjo vjen edhe si rezultat i hapjes së shoqërisë ndaj formave të huaja kulturore, ku për njerëzit që kanë dalë jashtë vendit, disa dukuri kanë qenë aq interesante dhe tejet profitabile po t'i sillnin në Kosovë. Në këtë mënyrë, gjërat negative erdhën dhe u mbollën në shoqërinë e këtij rajoni, duke lëshuar rrënje të forta dhe duke u avancuar vazhdimesh në nivele më të përsosura. Për shkak të kësaj, edhe aktivitetet kriminale kanë marrë dimisione të reja dhe mënyrat e kryerjes së këtyre akteve, po bëhen gjithnjë e më të pamëshirshme.

Kështu që:

Ndërlidhja e aktiviteteve kriminale tash me të kaluarën mendoj se diametralisht janë të kundërtë. Bie fjala, në të kaluarën vrasjet nuk kanë ngjarë të maskuara, sepse motivet kanë qenë ndryshe. P.sh. një vrasje me motiv hakmarrje ose gjakmarrje (pa maska) ka ndryshua nga motivi i vrasjes politike (me maska) dhe mbrojtje tinëzare nga shteti). Ndryshe te

<sup>24</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektaues dhe numri, 22.09.2014

<sup>25</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 10.10.2014.

vjedhjet e rënda, viktimat nuk janë maltretuar (lidhë, rrah etj.), ndërsa pas lufte ndaj viktimës janë bërë shumë të këqija. Kjo do të thotë se ka ndryshuar rrënjesisht metodologjia e kryerjes së krimtit. Mendoj se kjo mënyrë e krimtit është ardhur nga jashtë, sepse nuk ndërlidhet me të kaluarën dhe traditat tona as në këtë aspekt (Q-T-2)<sup>26</sup>

Derisa gjatë kësaj periudhe shihet se kërkesat dhe ‘nevojat’ e individëve dhe grupeve kanë shkuar në nivel shumë më të lartë “jo për bukë, aq sa për luks” (Q-M-3)<sup>27</sup>, kështu që për realizimin e këtyre ata përdorin mënyra dhe aktivitete të ndryshme, shumë herë të ndaluara edhe me ligje, bile edhe deri te ato jo njerëzore. Kjo vërteton se shoqëria e kësaj treve po “përballet me disa dukuri që nuk përputhen aspak me kulturën dhe mentalitetin tonë” (Q-N-10)<sup>28</sup> dhe që vlerësohet se “janë dukuri që kanë ardhur si rezultat i hapjes së Kosovës ndaj kulturave të tjera” (Q-N-10)<sup>29</sup>. Nuk janë të pakta rastet kur individët që merren me kësot aktivitete kanë jetuar disa kohë nëpër vende tjera, ku edhe kanë kryer veprimitari të njëjta, gjë që personalisht pohohet duke treguar se “unë jam vet ndër ta” (D-2)<sup>30</sup>, apo “të gjitha kanë ardhur nga perëndimi” (D-3)<sup>31</sup>.

Duke e ditur se disa prej këtyre aktiviteteve kriminale kanë mundur të kryhen edhe në të kaluarën, jepen mendime e vlerësimë se vet shoqëria nuk i ka pranuar dhe atë përmes normave morale. Ndaj,

është e vërtetë se shoqëria s’i ka lejua, e gjithmonë i ka luftuar. Është dashtë të ruhesh, se nëse do të bëje diçka do të cilësonin si shtëpi e pandershme, e pabesë dhe do të thoshin ‘ruaju filanit’. Pra, kanë qenë më të rënda se sa dënimet që i jep gjykata. Është dashur të ruhesh nga veprat e këqija se të ka dënuar shoqëria, ndërsa sot njerëzit nuk e kanë atë problem (Q-S-4)<sup>32</sup>

<sup>26</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 10.10.2014.

<sup>27</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>28</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>29</sup> Po aty.

<sup>30</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 24.06.2014.

<sup>31</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 26.06.2014.


<sup>32</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 27.07.2014

Përmes këtyre shihet se parandalimi i disa prej aktiviteteve kriminale ishte bërë nga shoqëria, veçanërisht përmes familjes, ku dënim i dhënë në këtë mënyrë i përfshinte të gjithë anëtarët e familjes dhe jo vetëm atë që kryente veprën. Andaj, kjo ishte ndër faktorët kryesor që shumë veprimitari kriminale nuk janë kryer, sepse ishte e rëndësishme të respektohej kultura dhe tradita, dhe se çdo shkelje e tyre mund të dërgonte deri te izolimi nga ai rreth.

Të gjitha këto na japid vlerësimin se vërtet sot jemi duke u përballur me forma e mënyra më të ndryshme të kryerjes së incidenteve kriminale, madje edhe shumë më të frikshme dhe më të rrezikshme. Duket se në mënyrë tejet aktive dhe me plot entuziazëm kemi ‘huazuar’ nga ‘mrekullitë e huaja’, të cilat i kemi adaptuar e përsosur në sistemin e krimit në vendin tonë, duke kaluar nga format më të thjeshta deri tek ato më të padëgjuar.

Derisa ky rajon ishte i dëshmuar për traditën dhe kulturën e lartë dhe të pastër shqiptare, rezulton se trendët e fundit të kriminalitetit tejkalojnë thuajse tërësisht traditat vendëse. Kjo është dëshmuar nga të dhënat e të anketuarve, e paraqitur në diagramin 42.

*Diagrami 42. Vlerësimi mbi qenësinë e trendëve të fundit të kriminalitetit brenda traditave dhe kulturës së këtij rajoni*



Bazuar në të dhënat nga terreni dëshmohen disa ndryshime në traditat dhe kulturën e kësaj treve, me ç'rast që ndërlidhem edhe me dukuritë e reja kriminale. Paraprijëse në këtë drejtim del të jenë politikat zhvillimore dhe sociale që u diktuan nga rrethanat e reja të organizimit shoqëror, të përkrahura dhe mbështetura nga faktori ndërkombëtar që diktonte drejtimin e ri. E gjitha kjo vjen nga disa arsyet:

- ❖ Diktimi i rrethanave gjatë periudhës së luftës, ku pjesa e madhe e popullsisë së kësaj treve ishte e detyruar të shpërngulej nga vendi i tyre, brenda e jashtë Kosovës, ku si rezultat erdhi edhe njohja me tradita e kultura të tjera
- ❖ Ardhja e faktorit ndërkombëtar për instalimin e institucioneve vendore, prapa të cilëve vinte kultura dhe tradita nga vendi pasues
- ❖ Angazhimi i shumë organizatave të huaja për qëllime humanitare, ku secila shfrytëzonat traditat dhe kulturën e vet
- ❖ Avancimi mediatik, qasja në teknologjinë moderne dhe njohja me kulturat dhe zhvillimet e ndryshme botërore, ndër të cilat edhe trendët e kriminalitetit
- ❖ Gjendja ekonomike e sociale, të cilat mundësuan dhe diktuan kapjen e shumë gjëra të huaja, duke dalë tërësisht nga vjetvetja

Kjo nuk kurseu as kapjen e trendit në sferën e kriminalitetit. Kështu, “shumë dukuri të reja janë jashtë traditës shqiptare, po disa kanë qenë, sidomos ato me kanun, po që sot edhe këto kanë ndryshuar, p.sh. vrasja sot është jo sipas kanunit, por tejkalon normat kanunore, pastaj grabitja që tejkalon normat njerëzore” (D-L-M-2)<sup>33</sup>.

Janë të shumta mendimet se trendët e fundit të kriminalitetit *pak* dhe *aspak* nuk i takojnë kulturës dhe traditës së kësaj shoqërie. Në mbështetje të kësaj e kemi edhe komentin vijues:

---

<sup>33</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

Rrethanat e reja kriminale janë të rrezikshme për shoqërinë dhe tejkalojnë traditat e rrethit të Gjakovës. Menjëherë pas luftës në Kosovë erdhën njerëz e misione të ndryshme që sollën edhe gjëra që për ne nuk kanë qenë të njohura. P.sh. lejuan hapjen e lokaleve të natës në të cilat punonin femrat, që për ne nuk kanë ekzistuar, pastaj erdhën drogat, lojërat e fatit etj. Nuk ka qenë traditë e jona të merremi me të tilla gjëra, sepse nuk ka lejuar familja e rrethi. Vendimet e tyre kanë qenë më të forta se ligji, vetëm për të mos u bërë me ‘shenjë’ (D-D-2)<sup>34</sup>

Duke qenë se shoqëria e kësaj ane njihej për mbrojtjen e moralit dhe të traditave, ndryshimet e kohës sot kanë bërë të tyren, andaj edhe pse:

Kemi qenë popull i moralshëm, tani ka humbur krejt morali. Përpala është respektuar tradita dhe ajo është dashur të respektohet, sepse e ke pasur më të vështirë të merresh me rrethin se sa me ligjin. Edhe pse kanë mundur të kryhen, nuk janë lejuar nga ana morale. E sot këto thuajse janë bërë e bëhen si me krenari. Pra, si me qenë një botë tjeter (D-P-2)<sup>35</sup>

Se disa nga aktivitetet kriminale janë të reja dhe se nuk hyjnë në traditën dhe kulturën e kësaj treve e shpjegon edhe kjo shprehje: “Këto aktivitete kriminale, që edhe vet merrem, dhe shumë tjera bien ndesh me traditat dhe kulturën e Gjakovës me rrethinë. Ato kanë qenë shumë më të mira dhe më pozitive për shoqërinë dhe e kanë ruajtur atë” (D-P-2)<sup>36</sup>. Këto ndryshime po i përqafon edhe gjinia femërore, ku në disa raste ajo bëhet nxitëse e problemeve, qoftë brenda familjes, qoftë mes shoqërisë apo edhe futet vet në kriminalitet. Këtë e dëshmon edhe ky vlerësim: “Nuk është e drejtë që një femër e re apo grua, të del në orët e vona të natës nëpër lokale deri në orët e hershme të mëngjesit. Kjo nuk lejohet në traditën tonë dhe për këtë shumë herë po ndodhin probleme familjare e që disa herë po i shtyjnë edhe në krim” (D-L-F-1)<sup>37</sup>.

Në anën tjetër, në shoqërinë e sotme kemi paraqitjen e disa dukurive sociale, që njëkohësisht janë dukuri të reja në vete dhe po ashtu janë pjesë e aktiviteteve kriminale (shih diagr. 43).


<sup>34</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

<sup>35</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 22.06.2014.

<sup>36</sup> Po aty.

<sup>37</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 25.09.2014.

Diagrami 43. Ndërlidhja e aktiviteteve kriminale në raport me traditën dhe kulturën e rajonit



Këto janë prezente që nga fillimi i riorganizimit të ri shoqëror dhe vazhdojnë deri në ditët e sotme. Shumë prej tyre kanë kaluar në përmasa shqetësuese. Disa nga këto janë:

#### *Vetëvrasjet*

Paraqesin një dukuri të theksuar, pasi që në të kaluarën kanë qenë shumë të pakta rastet e tillë, ndërsa gjatë kësaj periudhe dita ditës vazhdojnë të jenë në rritje. Ajo që e karakterizon këtë dukuri është se viktimë e saj janë pa dallim moshe as gjinie, religioni apo gjendje ekonomike, zone rurale apo urbane, statusi familjar apo social (shih tab. 7).

Tabela 7. Statistikat e vetëvrasjeve në vite

Vepra	Viti													
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Vetëvrasje	7	1	7	3	4	4	5	2	6	2	8	6	4	7
Tentim vetëvrasje	/	/	/	1	15	16	30	37	23	30	16	17	19	7

Duke iu referuar ngjarjeve të tillë dhe dosjeve të organeve të rendit del se viktimi e kësaj dukurie janë që nga nxënësit e shkollave fillore e deri te moshat e shtyra. Në disa raste janë lënë me shkrim, në mesazh të telefonit apo letër të shkruar, ‘arsyet’, që te moshat e reja zakonisht kishin të bënин me dashuritë rimore, ndërsa te ato më të vjetrat disa borxhe, ku ka prej tyre që kanë humbur pasurinë në lojëra të fatit. Nuk përjashtohen edhe rastet e imitimeve të ‘idolëve’ nga mediat. Mjetet që kanë përdorur për kryerjen e akteve të tillë janë të ndryshme, si: përdorimi i medikamenteve të ndryshme kimike, përdorimi i tabletave mjekësore, litarët apo gjësendet e përafërtë me litarin, hedhje nga lartësitë, hedhje në ujë, përdorim të mjetave të mprehta e deri te armët e zjarrit. Karakteristikë janë edhe moshat e shtyra, shumë prej të cilëve kishin të gjitha kushtet e jetesës, deri te ato shumë të mira. Dukuria e tillë, përveç humbjes së anëtarit të familjes, ajo shumë herë ka krijuar kushte shumë të rënda për familjarët e tjerë. Kësaj dukurie i shtohet edhe numri i madh i atyre që kanë tentuar të vetëvriten, por që kanë përfunduar me pasoja të rënda shëndetësore.

Të gjitha këto karakteristika të vetëvrasjeve duket se ndërlidhen me dy dukuri: së pari pasojat e luftës dhe streset e përjetuara dhe së dyti mos pranimi i gjeneratave lidhur me zhvillimet shoqërore që po përjeton shoqëria e kësaj treve.

#### *Përdorimi i narkotikëve*

Vjen si dukuri menjëherë pas luftës, duke pasur një zhvillim drastik. Këtë e potencion edhe shprehja se “në të kaluarën droga apo mjetet narkotike kanë qenë të panjohura për popullin dhe ne as që kemi ditur se çfarë janë ato; sot është bërë një fenomen i përditshmërisë dhe një numër i konsiderueshëm i të rinjve është zhytur në këto

fenomene” (Q-M-3)<sup>38</sup>. Edhe pse rezultojnë të jenë të ndaluara për shkak të dëmeve dhe rrezikut që shkaktojnë dhe se përndiqen nga organet e rendit, ato konsumohen, shiten dhe shpërndahen pavarësisht pasojave që këto sjellin për një shoqëri. Për numrin në rritje të këtyre përdoruesve është shprehur edhe një nga ekspertët e kësaj dukurie, sipas të cilit “nga dukuritë e reja shqetësuese në periudhën e pasluftës, është dukuria e përdorimit të substancave narkotike, ku në përgjithësi kemi një numër të madh të përdoruesve” (Q-I-5)<sup>39</sup>. Sipas të njëjtës, narkotikët më të përdorshëm në Gjakovë janë heroina dhe marihuana e shumë më pak kokaina, mirëpo ai shprehet se “kohëve të fundit ka dalë një lloj droge që po përdoret në masë të madhe, e quajtur GHB (acidi hidroksibutirik), që ndikon në rritjen e aktivitetit seksual te femrat”.

*Tabela 8. Statistikat e rasteve me narkotikë*

Vepra	Viti													
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Droga&substanca psikotrope	/	2	5	30	23	14	32	36	14	29	31	27	33	17

Edhe një ekspert tjetër shprehet se “kjo dukuri është dukuria më e shëmtuar në shoqërinë tonë”, pasi që në vete paraqet një problematikë të veçantë, ngase “individë të caktuar, për qëllimet e tyre personale përfituese po i infektojnë të rinjtë” (Q-S-6)<sup>40</sup>. Duke marrë parasysh se është një substancë joshëse, sidomos për moshat e reja, mundësia e nxitjes dhe infektimit është e madhe, pasi që kjo u shpërblehet me përfitime

<sup>38</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>39</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>40</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 31.07.2014.

të mëdha trafikantëve të tillë. Kjo paraqet një shqetësim jo vetëm për familjen e shoqërinë, por edhe më gjerë.

Përdorimi i narkotikëve, veçanërisht në mesin e gjeneratave të reja, kohëve të fundit ka fituar një vëmendje akoma më të madhe. Të rinjtë, ndonjëherë nga kureshtja, e ndonjëherë të nxitur nga rrathi shoqëror i tyre, priren t'i përdorin narkotikët sa për t'i provuar, pa menduar për pasojat e mëtutjeshme. Shumica bien pre e këtyre ‘provave’ dhe pastaj vijnë deri tek krijimi i varshmërisë ndaj tyre. Në fillim kënaqësitë që përjetohen, i shtyjnë ata që të krijojnë iluzione mbi realitetin, duke e shtrembëruar atë për ta bërë të duket më i bukur. Me kalimin e kohës organizmi kërkon këto substanca në sasi më të mëdha, gjë që për ta tashmë është vështirë të sigurohen, kryesisht për shkaqe financiare. Këtu fillojnë edhe problemet kryesore. Në mungesë të parave për të blerë dozën e nevojshme, ata janë të prirë të ushtrojnë dhunë në familje, të kryejnë vepra kriminale, si: grabitje, dëmtim të pronës private, shkaktim të lëndimeve trupore, vjedhje të rënda e madje edhe plagosje me armë zjarri deri në vrasje, me të vetmin qëllim që të shuajnë nevojën e organizmit për drogë.

Për shoqërinë e kësaj ane, përdorimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike, është një risi tejet negative, e cila çdo ditë e më shumë po lëshon rrënjen, sidomos në mesin e gjeneratave të reja, dhe do të duhet një vullnet i fortë dhe koordinim i madh mes të gjithë akterëve shoqëror, për vetëdijesimin mbi pasojat e substancave psikotrope.

Prezenca e saj dëshmohet nga disa prej përdoruesve të këtyre lëndëve. Ata përmes rrëfimeve të tyre, dhënë gjatë intervistave, kanë dhënë shumë informata për veten e tyre dhe për shoqërinë e tyre. Një nga to është edhe ky rrëfim:

**P:** A ke ti shoqëri që përdorin drogën?

**X:** Po, kam

**P:** A keni pasur rast të dëgjoni që ata që kanë konsumuar drogën kanë përfunduar edhe me vdekje?

**X:** Po, kam pasur raste. Shumë vdekje në komunën tonë po shkaktohen nga mbidoza e përdorimit të drogës

**P:** Cila nga drogat po përdoret më tepër në këtë rajon?

**X:** Marihuana, por njerëzit nga marihuana po kalojnë edhe tek llojet e tjera

**P:** Cilat mosha e përdorin më tepër drogën?

**X:** Adoleshentët janë përdorues të mëdhenj të drogës, por edhe më të mëdhenj, moshat 20-30 vjeç.

**P:** Si keni arritur deri tek sigurimi i drogës?

**X:** Unë kam punuar kamerier dhe jam detyruar të bëj gjëra që s'duhet, por edhe duke kërkuar borxh, e më përparr kur kam qenë pa punë jam detyruar madje edhe të vjedhi e të përfundoj burgjeve për arsyet e drogës, vetëm për t'i siguruar të hollat për ta marrë dozën time që më është dashur. Kjo iu ndodh edhe të gjithë atyre që konsumojnë drogën. Pastaj kemi raste kur shokë të mijë kanë kryer edhe grabitje të ndryshme vetëm për të gjetur para për të blerë drogë. Por, edhe mua vëtë më ka ndodhur të grabis çanta nga krahët e femrave, për të cilën jam pishman, dhe i lutem Zotit të ma falë këtë. Ka ndodhë që kemi grabitur edhe pije alkoolike nëpër markete, për arsyet se ato shiten pak më shtrenjtë.

**P:** Në Gjakovë a kultivohet apo lëviz droga?

**X:** Te ne nuk kultivohet, por lëviz. Lëviz edhe tranzit dhe një sasi ndalet në Gjakovë, se këta dilerët e drogës e dinë përafërsisht se çfarë sasie duhet lënë këtu. Edhe i kanë njerëzit e vet ku e lënë dhe ata e shesin për ta

**B:** Cila është droga më e shtrenjtë që konsumohet këtu në Gjakovë?

**X:** Më e shtrenjta është kokaina, por ajo konsumohet shumë pak. Përparrë është përdorur shumë heroina, por pasi është vdekjeprurëse, sot mund t'i numërosh njerëzit që e përdorin atë. Unë vet personalisht e kam përdorur heroinën. Por, ka qenë e vështirë të sigurohet dhe shpesh kam pritur me ditë të tëra. Gjatë kësaj kohe jam ndier shumë keq. Gjatë pritjes kam kryer vjedhje, grabitje e shumë të tjera

**P:** A ke dëgjuar apo të ka rastisë të hysh nëpër shtëpitë e të tjerëve për të kryer grabitje?

**X:** Po

**P:** Sa të ka zgjatë efekti i drogës dhe çka ndjen njeriu?

**X:** Më së shumti zgjatë tri deri në katër orë. Ndjen njëfarë fllesh lumturie, nuk brengoset për problemet, për asgjë. Pin, qetësohesh, hajt se ka zgjidhje. Gjithçka e ke rrafsh. Pasi të lëshon dhe fillon të të kapë kriza, ke mërtzi, etj... Por prapë e pin, se gjen prehje vetëm aty (D-1)<sup>41</sup>

Vlerësim thuajse të njëjtë kemi edhe nga dy përdorues të tjerë të narkotikëve, ku mes tjerash shprehë:

<sup>41</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 01.08.2014.

**I:** Unë po iu them të gjithëve të largohen, por këta prapë vazhdojnë. Po pinë *bari*, e kjo drogë është më e fëlliqtë, e këta e marrin se kushton më lirë. Nuk kanë para se i marrin edhe ato të mëdhatë, kokainën, por ajo kushton 1 gram - 80 EURO, o burrë. Atëherë kur s'po kanë para, dalin e vjedhin, plaçkisin, marrin telefonat, bile edhe vrasin të tjerët

**P:** Në këto fenomene, a ka edhe të gjinisë femërore?

**I:** Po, ka edhe femra, shumë... të gjithë i njoh (D-2)<sup>42</sup>

**P:** A ke dëgjuar ndonjëherë për dikë që është dënuar në botën perëndimore dhe kur është kthyer në Kosovë prapë ka vazhduar me kryerjen e veprave të tillë penale?

**Z:** Unë jam vetë një ndër ta (D-7)<sup>43</sup>

### *Kërkimi i lëmoshës*

Bazuar në praktikat e pasluftës del të jetë një dukuri e re. Kështu mendon edhe një nga ekspertët, që thotë se “kjo është një dukuri tipike sociologjike dhe që nuk ka ekzistuar më parë; në të kaluarën njeriu ka kërkuar lëmoshë për njeriu në rast fatkeqësie të tij dhe atë në baza humane e njerëzore” (Q-S-6)<sup>44</sup>. Pra, kjo është një praktikë e huazuar nga vende të tjera, e shfrytëzuar nga individë e grupe që për qëllime të përfitimeve personale i shtyjnë fëmijët që në mosha shumë të reja, pastaj femra e grupe të tjera, për të shtrirë dorën e deri te disa që thirren në emër të rasteve humane përmes OJQ-ve të ndryshme.

Në ditët e sotme, fëmijë nga të gjitha moshat dhe persona të tjerë i gjen kudo duke shtrirë dorën, qoftë nëpër rrugë, lokale e markete, udhëkryqe e deri nëpër dyer baneshash e shtëpish në tërë rajonin e Gjakovës. Kjo dukuri ka shtuar numrin e personave të tillë, sa që vijnë edhe nga vendet tjera, sidomos nga Shqipëria. Lidhur me këtë, bazuar në të dhënrat e organeve të rendit, shihet se ka pasur disa planifikime dhe veprime operacionale për largimin e tyre nga kudo dhe procedimi në organet e drejtësisë, pasi që kjo veprimtari është e ndaluar me ligj.

<sup>42</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 24.06.2014.

<sup>43</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 27.06.2014.

<sup>44</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 31.07.2014

Duke marrë për bazë disa të dhëna, si nga organet e rendit, ashtu edhe nga qytetarët, duket se prapa këtyre ‘lëmoshë-kërkuesve’ qëndrojnë individë dhe grupe kriminale të organizuara, të cilët i sjellin fëmijët me makina nga vende të ndryshme dhe i shpërndajnë nëpër pika strategjike, ku ata zgjatin duart në kërkim të lëmoshës dhe në fund të ditës, të hollat e mbledhura i dorëzojnë tek ‘shefat’. Këta të fundit në disa raste kur të nënshtruarit e tyre nuk sjellin të holla të mjaftueshme, i keqtrajtojnë duke ushtruar dhunë fizike dhe psikike mbi ta, pastaj edhe duke i dënuar me mosdhënien e racionit ditor.

Në anën tjetër, edhe mediat po punojnë me anë të programeve vetëdijesuese dhe hulumtuese, por po hasin në sfida. Nga kjo shihet se situata në këtë rast është tejet shqetësuese dhe sfidat me të cilat po përballen akterët që luftojnë krimin e organizuar, i cili qëndron prapa kërkuesve të lëmoshës, krijojnë bariera të mëdha në reduktimin deri në eliminim të kësaj dukurie negative.

#### *Lokalet e natës dhe të lojërave të fatit*

Që në vitet e para të riorganizimit shoqëror në rajonin e Gjakovës u paraqit edhe dukuria e lokaleve ku shërbenin femra të sjellura nga jashtë Kosovës, sidomos nga vendet e lindjes. Si dukuri e re për këtë anë ishte hapja e lokaleve të ‘natës’ dhe punësimi i femrave për shërbime, kinse si kamariere, mirëmbajtëse, por që pas kësaj fshiheshin edhe shërbimet intime me pagesë. Duke u bazuar në gjendjen jo të mirë ekonomike të shumë vendeve dhe familjeve, sidomos të atyre në tranzicion, shumë individë dhe grupe kanë shfrytëzuar prirjet dhe lidhjet e tyre për kriminalitet, sidomos duke shfrytëzuar situatën jostabile të institucioneve shtetërore dhe të vetë shoqërisë për qëllim të përfitimeve personale. Këtë e shpreh edhe njëri prej të pronarëve të dënuarit të

një lokal, i cili thotë se “femrat i kemi sjellur nga Moldavia, Rusia e shtetet tjera, të cilat shteti i ka lejuar të qëndrojnë, bile edhe të punojnë me leje pune në lokale të tilla, vet kam pasur femra që kanë pasur leje dhe dokumente përcjellëse për të punuar në lokalin tim” (D-D-1)<sup>45</sup>. Se kanë ekzistuar këto lokale dhe se ishin të regjistruala është e pranuar edhe nga zyrtarët komunal të Gjakovës<sup>46</sup>. Pra, këtu shihet se kjo veprimtari ishte e lejuar nga shteti, pasi që edhe ato që vinin nga jashtë posedonin dokumentacion qëndrimi të përkohshëm dhe leje për punë dhe se ishte veprimtari e regjistruar.

Ky aktivitet pune vlerësohet të jetë shumë fitimprurës në ‘zingjirë’, pra nga shefi e deri te i fundit. Kjo ka “shtyr që këtij biznesi t’i qasen edhe femrat kosovare, madje që nga moshat e reja, duke përfshirë këtu edhe ato nga nën 16 vjeç, qoftë me vet dëshirë apo edhe përmes mashtrimeve që iu kanë bërë” (D-D-1)<sup>47</sup>. Duke vlerësuar se deri pasluftës, lokale të tilla kishte shumë pak dhe se nuk punonin femrat shqiptare, tanë kjo del si dukuri e re sociale. Mirëpo, krahas këtij ‘biznesi’ këto ambiente pune shumë herë janë sfiduar edhe me probleme dhe incidente të ndryshme. Kështu “lokalet e natës kanë sjellur shumë probleme në shumë sfera, duke nisur nga problemet fizike mes individëve, grupeve e deri te përdorimi i armëve, por edhe në humbje të mjeteve materiale e deri te problemet familjare, ku shumë martesa kanë përfunduar me ndarje”<sup>48</sup>, gjë që “në të kaluarën nuk është dëgjuar për të tilla raste, por ardhja e të ‘huajve’ ka sjellur këto gjëra dhe atë qoftë nga kulturat e tyre e deri te interesat e veta”<sup>49</sup>. Kjo dukuri ka dëshmuar edhe për problemet e tjera me pasoja shumë të rënda dhe që nuk kanë ndodhur në traditën dhe kulturën jo vetëm të kësaj treve, por as në atë shqiptare në përgjithësi. Një

<sup>45</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014

<sup>46</sup> Aprovimi përmes emailit nga zyrtari komunal - Gjakovë

<sup>47</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

<sup>48</sup> Po aty.

<sup>49</sup> Po aty.

nga këto është edhe ndarja nga familja dhe martesa me femrat ‘prostituta’, për të cilën gjë njëri thotë: “derisa kam qenë pronar i një lokalitë tillë, e di sa ka persona që janë martuar dhe kanë krijuar familje të reja me to, apo që bashkëjetojnë, duke u ndarë nga familja” (D-D-1)<sup>50</sup>. Sipas tij, puna me lokale të tilla sjellë fitime të mëdha: “këto më kanë sjellur përfitime, edhe pse duke u ndarë përgjysmë, prapë kam pasur leverdi”, shprehet ai.

Një vlerësim të njëjtë lidhur me lokalet e natës e jep edhe një nga të intervistuarat e gjinisë femërore, sipas së cilës kemi këtë mendim:

Licencimi i lokaleve të natës dhe të lojërave të fatit kanë sjellur shumë dukuri kriminale, pra janë shkaktarë të dukurive të tilla. Lokalet e natës kanë sjellur femra të ndryshme nga e gjithë bota dhe ato janë shkaktar të divorceve, sepse meshkujt shkojnë me to e shpenzojnë, ka raste që janë martuar dhe kanë lindur fëmijë me to, duke lënë gruan dhe fëmijët e vet. Bile tani edhe femrat kosovare po punojnë në lokale të tilla (D-L-F-1)<sup>51</sup>

Lidhur me personat që kanë frekuentuar këto lokale dhe pasojat del edhe dhuna në familje. “Dhuna në familje është a pashmangshme, ka raste kur e ka dërguar gruan buzë vetëvrasjes, pasi një kohë ka bashkëjetuar me një femër të tillë” (Q-N-10)<sup>52</sup>, shprehet një nga zyrtaret e një OJQ -je.

#### *Lojërat e fatit*

Si dukuri, është një risi në shoqërinë kosovare dhe këtë gjakovare në veçanti. Lokalet e tilla gjenden kudo nëpër qytetin e Gjakovës e deri edhe nëpër fshatra. Sipas të intervistuarve, lojërat e fatit hapen vend e pavend, si afër shkollave, afër objekteve fetare, në qendra dhe nëpër kthina. Një pjesë e tyre kanë leje pune, por ka shumë që veprojnë edhe pa leje. Kështu që ato “veprojnë në mënyrë ‘legale’, duke u marrë shuma

<sup>50</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektyues dhe numri, 23.09.2014.

<sup>51</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektyues dhe numri, 25.09.2014.

<sup>52</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

të mëdha njerëzve dhe duke u shkatërruar familjet dhe jetën”, pasi që “shteti nuk ka shikuar anën morale e sociale, por vetëm atë tatinore” (Q-R-7)<sup>53</sup>.

Duke iu referuar të gjeturave nga terreni del se këto lokale përveç që janë vende ku individët humbin pasurinë, janë burim i shumë faktorëve kriminal. Ato të ‘shtyjnë’ në vepra e dukuri kriminale, dhe një shtytje në veprimet e tillë të paraqitet nga “hapja e lokaleve të natës dhe e lojërave të fatit 10% të rinisë gjakovare i ka shty të merret me droga, prostitucion dhe kur nuk na kanë mjaftuar të hollat, jemi marrë me vjedhje e grabitje” (D-P-2)<sup>54</sup>. Mendime dhe vlerësimë të tillë vijnë edhe nga persona të tjera që kanë kryer vepra kriminale. Po ashtu të njëjta janë edhe ato vlerësimë që janë marrë thuajse nga të gjitha mostrat tjera. Ata tregojnë se shumë raste janë rrezikuar nga veprime të tillë.

Lokalet e tillë shumë herë kanë pasur incidente mes vete edhe për arsyet e konkurrencës, ku kanë sulmuar njëri tjetrin, duke ia dëmtuar aparaturat e deri te grabitjet mes vete. Pastaj, ato lokale kanë qenë edhe vet shënjestër e grabitjeve nga personat që i kanë humbur të hollat. Për këtë nuk kanë munguar as edhe raportimet në organet e rendit të këtij rajoni. Kështu që, “lokalet e tillë mbeten bartëse apo infektuese të traditës dhe kulturës kësaj shoqërie; ato që ndodhin aty janë të papranueshme për shoqërinë; fatin e atyre vajzave ‘mysafire’ do ta ndjekin edhe vajzat e motrat tonë duke i parë ato” (Q-E-1)<sup>55</sup>.

Analizat nga puna e këtyre lokaleve rezultojnë të kenë edhe një numër të madh të aktiviteteve kriminale, duke filluar me mundësimin indirekt të trafikimit dhe të prostitucionit, pastaj numrin e incidenteve të shumta kriminale dhe atë deri të vrasjet;

<sup>53</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 20.06.2014.

<sup>54</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektyues dhe numri, 22.09.2014.

<sup>55</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 24.06.2014

largimin e vajzave të reja në moshë pa dijeninë e familjes dhe punësimi në ato lokale e raportimi i tyre si persona të zhdukur; kemi në rritje të numrit të divorceve, që sipas të dhënave si faktorë kryesor ishte pikërisht aktiviteti i këtyre lokaleve. Të gjitha këto dëshmohen edhe nga numri i rasteve të rapportuara në policinë që mbulonte këtë zonë dhe që çdo vit ishte në rritje, si dhe nga vet të intervistuarit që tregojnë raste konkrete se shkaktar i divorceve ishin vizitat që bëheshin në to. Kjo pranohet edhe nga vet pronarët që posedonin lokale të tillë.

Nuk janë të rralla rastet kur pronarët e këtyre lojërave kanë probleme me rivalët e vet, dhe se nuk kanë munguar as edhe aktivitetet kriminale, ku ata i kanë shkaktuar dëme të qëllimshme njëri-tjetrit deri te rastet e grabitjeve apo edhe lëndimeve të rënda trupore ndaj punëtorëve, sepse në këtë mënyrë ata kanë realizuar egot e tyre të hakmarrjes dhe inateve të lidhura me bizneset e tyre.

Përfundimisht, hapje e lokaleve të lojërave të fatit mbetet një risi për qytetarët e kësaj treve. Edhe pse disa janë lokale që janë të legalizuara nga institucionet shtetërore, ato nuk respektojnë procedurat dhe ligjet. Shumë nga ato janë edhe pa leje pune. Vendi se ku ato janë vendosur përzgjidhet në interesin e individit dhe jo të procedurave ligjore, sepse është me rëndësi të jetë në zonën më të frekuentuar dhe ku bie në sy më shumë. Sipas statistikave të nxjerra nga pyetësori, këto lokale janë nxitëse të shumë dukurive kriminale. Po ashtu edhe intervistat e zhvilluara vlerësojnë se pikërisht lejimi i hapjes së lokaleve të tillë në qendër të qytetit, afér shkollave dhe institucioneve tjera, ka mundësuar paraqitjen e shumë aktiviteteve kriminale m'u në ato zona. Disa tregojnë raste kur shumë nga qytetarët apo edhe familjarët e tyre kanë humbur pasuri të tëra, derisa edhe shtëpinë e familjes e ka lënë peng. Kanë shkaktuar probleme mes anëtarëve të familjes, duke nxitur dhunën në familje e deri te divorcet. Në anën tjetër, shumë të

rinj shkojnë dhe luajnë, kur humbin paratë, ata dalin e vjedhin kudo gjejnë mundësi, sidomos objektet që nuk janë të banuara apo që e shfrytëzojnë kohën derisa nuk gjendet dikush aty. Janë të shumta raste kur ata vendosin maskat në kokë dhe grabitin këdo që kalon andejpari apo edhe hyjnë edhe nëpër shtëpi të banuara. Kjo ka shtuar edhe numrin e këtyre veprave kriminale.

Kjo dukuri na paraqet një realitet të vështirë për t'u gëlltitur, sepse vet shoqëria i është përshtatur në mënyrë absorbuese. Në anën tjetër, edhe shteti ka dhënë dozën e vet, duke krijuar mundësi ligjore për veprimtarinë e tyre të pakontrollueshme. Ndonëse ekzistojnë organet përkatëse të inspektimit, gjetjet e tyre të mundshme bëhen pluhur brenda pak kohësh, për të mos thënë që nuk bëhen asnjëherë gjetje, ngase personat e inkriminuar në këtë veprimtari, janë të korruptuar deri në përmasa dhe nivele shqetësuese.

Pikërisht njerëzit, duke i frekuentuar lokalet e tillë, janë ata që mundësojnë ekzistencën e kësaj veprimtarie të dëmshme. Pasojat po rriten dita ditës dhe populli e ka gjithnjë e më të vështirë t'i kuptojë shkatërrimet që po i bën vvetes, ngase këto janë gjëra që futen thellë në gjak, dhe jo vetëm.

### *Uzurpimi i pronave*

Populli i kësaj ane ishte i njohur për ruajtjen e pronave publike dhe atyre të përbashkëta. Nuk bëhej fjalë për prona që kishin pronar. Mirëpo, gjatë kësaj periudhe kjo traditë nuk qëndron. Kemi dukurinë e uzurpimeve të të gjitha pronave. Pra, jo vetëm të atyre publike, por edhe të atyre që dihet të kujt kanë qenë apo e kujt është ende. Thua jse përmes këtyre është matur edhe fuqia se kush më tepër po uzuron. Nuk kanë munguar edhe rastet që këto kanë përfunduar edhe me incidente tjera kriminale, nga prishjet e

rendi e deri te vrasjet. Një gjendje reale e paraqet edhe vet ngushtimi i hapësirave që dikur kanë shërbyer për tërë lagjen, tani është bërë biznes i një individi (shih tab. 9).

*Tabela 9. Statistikat e usurpimit të pronave*

Vepra	Viti													
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Uzurpimi pronës	/	/	/	8	1	/	7	13	3	7	3	11	9	15

Edhe pse njerëzit gjithmonë kanë qenë lakmitar për pasuri e gjëra të ndryshme, këto në shumë vende i ka ndaluar ligji, mirëpo në shoqërinë tonë kjo më tepër është respektuar nga tradita dhe edukata, duke i konsideruar si të shenja, “ato askush nuk ka guxuar t’i prekë se ishte konsideruar si mallkim” (Q-M-3)<sup>56</sup>. Ndryshimet shoqërore të kohës kanë sjellur një frysë të re ‘kulture’ edhe në këtë drejtim, ku “sot laktmia është shtuar shumë në raport me mundësitë”<sup>57</sup>. Pra, “kjo është një dukuri e pahijshme, e paligjshme dhe antimorale, sepse prona dhe familja konsiderohen të shenja... kjo nuk ka ekzistuar dhe kurdo që ka qenë ndonjë kontest, ai është zgjidhur me marrëveshje” (Q-S-6)<sup>58</sup>.

Bazuar në mendimet e të intervistuarve vlerësohet si një dukuri e ‘shëmtuar’ që po bëhet në këtë drejtim dhe atë vetëm për qëllime të përfitimeve personale të individëve apo grupeve.

Kështu, edhe usurpimi i pronave zë vend në listën e dukurive sociale negative që kanë gjetur hapësirën për të depërtuar në shoqërinë e kësaj ane. Ndoshta ngaqë lidhjet

<sup>56</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>57</sup> Po aty.

<sup>58</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 31.07.2014

farefisnore po zbehen dita ditës dhe shoqëria po kalon nga një sistem i familjes së gjerë dhe me shumë anëtarë, në një sistem të familjes së ngushtë dhe me pak anëtarë, edhe raportet mes njerëzve të gjakut po ftohen çdo herë e më shumë. Si rezultat i kësaj ka humbur edhe interesimi që të ruhet rendi në shoqëri, por edhe në rastet kur dikush nga shoqëria merr iniciativën për të dënuar usurpimin e paligjshëm të pronës së huaj, është shteti ai që e ndalon ta bëjë një gjë të tillë, por prapë është shteti ai që nuk ndërhyt asnjëherë në raste të tilla, deri atëherë kur pronarët legitim bëjnë kërkesa e ankesa të panumërtë, duke zhvilluar procedura të gjata ligjore deri në kthimin e pronësisë dhe mbrojtjen e pronës së tyre private. Por, deri atëherë, prona private po pëson dëmtime të shumta, deri në demolim të tërësishëm.

Veçanërisht rol të madh në këtë drejtim ka luajtur paqartësia e pronësisë së tokave dhe objekteve të banimit, të cilat dikur u përkisnin serbëve të shpërngulur nga rajonet e Serbisë gjatë ‘reformave’ bujqësore dhe ‘projekteve’ të rregullimit demografik të krahinës së asokohshme të Kosovës, ku toka të shumta të shqiptarëve iu dhanë atyre për t’i punuar dhe për të jetuar në to, me të vetmin qëllim shpërnguljen e banorëve shqiptarë nga këto zona. Kjo gjë kishte ndikim tejet negativ në ruajtjen e dokumentacionit valid të pronësisë dhe edhe sot e kësaj dite pronarët e ligjshëm të pronave të tyre, hasin në vështirësi në vërtetimin dhe kthimin e pronësisë në emrin e tyre.

#### *RiorGANIZIMI SHOQËROR DEMOKRATIK*


‘Prurjet’ e reja demokratike sollën ndryshime dhe avancime në shoqërinë e kësaj ane. Sidomos kontakti me kulturat e huaja nga personat që kishin ardhur për instalimin e institucioneve, duke sjellur edhe pjesë të kulturave nga vendet që vinin. Me qëllim të krijimit të kushteve të përafërtë, u modifikuan edhe ambiente të përafërtë me kulturat

perëndimore. Në anën tjetër, kjo hapje dhe zhvillimet që ndodhën shumë shpejt, si dhe niveli i teknologjisë moderne mundësoi qasje thuajse në të gjitha vendet e botës. Kështu, patjetër që këto reflektuan në përpjekjet për ‘kopje’ dhe ‘imitime’ të tilla mbarëshoqërore.

Këto rrethana u shfrytëzuan nga individë dhe grupe të ndryshme që të përfitojnë nga të ‘rejat’. Ata nuk kursyen mënyra dhe forma për të përfituar nga rrethanat e kohës dhe për të ardhur deri te përfitimet personale në dëm të shoqërisë. Kështu që këto sollën edhe praktika të reja ‘demokratike kriminale’ në shoqëri. Disa nga praktikat e tillë nuk ishin pjesë e normave të mëhershme. Pikërisht kjo ka paraqitur nevojën edhe për normime të reja në sferën e juridiksonit në shoqëri. Brenda kësaj periudhe janë bërë tri herë ndryshime të shumta në ligje, duke mos lënë anash edhe nxjerrjen e shumë akteve dhe rregulloreve tjera në plotësim të tyre.

Andaj, vlerësohet se këto ‘prurje’ demokratike sollën edhe shumë dukuri të kriminale duke modifikuar disa nga ato që kanë ekzistuar e deri te reflektimi i krimeve ‘moderne’. Vlerësimi i avancimeve të tillë e paraqet edhe diagrami i mëposhtëm.

*Diagrami 44. Avancimet e kriminalitetit*



Sipas të dhënave nga terreni, disa prej dukurive të reja kriminale rezulton të jenë: edhe grabitja dhe vjedhja grabitqare, vrasjet enigmatike dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm me vendosjen e eksplozivëve dhe mjeteve tjera shpërthyese si dhe teknologjia e avancuar.

#### *Grabitjet*

Bazuar në praktikat e kësaj treve, vjedhjet grabitqare dhe grabitjet thuajse nuk ishin prezente këndejpari, sidomos dekadave të fundit. Nga e kaluara e largët dukuri të tilla kanë ndodhur nga grupe ‘kaçake’, që për shkak të rrethanave të kohës kanë jetuar nëpër male, me ç’rast kanë dal dhe kanë plaçkitur personat që kalonin andejpari, por jo edhe duke hyrë brenda në familje të maskuar dhe të armatosur, duke i maltretuar të gjithë anëtarët pa mëshirë, pra edhe fëmijët e gratë shtatëzëna, derisa kanë marrë prenë e tyre dhe kanë ikur. Madje edhe atëherë kanë respektuar moshat e vjetra, femrat dhe fëmijët. Ndërsa sot, kjo dukuri është jashtëzakonisht e lartë. Personat që kryejnë këto vepra nuk zgjedhin viktimat dhe as vendin. Përveç që veprojnë në rrugë, në lokale, në natyrë, ata nuk janë kursyer të veprojnë edhe brenda në shtëpi ku kishte edhe fëmijë pleq, gra dhe gra shtatëzëna. Vet mënyra e kryerjes është shumë e frikshme, sepse ata përdorin maska dhe armë të ndryshme dhe veprojnë në grupe. Shqetësuese janë edhe grabitjet individuale, kur individë të caktuar veprojnë ndaj femrave dhe moshave të vjetra. Ata ua marrin nga krahu çantat apo bizhuteritë e arit nga qafa apo veshët, duke i shtyr e rrëzuar për tokë. Këtë e bëjnë nëpër vende të errëta të pjesëve të rrugëve apo edhe nëpër hyrje të banimeve kolektive. Raste të tilla janë publikuar edhe nëpërmjet mediave. Po ashtu, tregojnë edhe të dhënët nga statistikat e rasteve të raportuara në organet e sigurisë dhe të rendit (shih tab. 10).

*Tabela 10. Statistikat e grabitjeve*

Vepra	Viti													
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Grabitje& Tentim grabitje	/	22	24	46	24	23	29	24	23	20	29	30	41	32

Dukuritë e grabitjeve dhe ndjenjat që krijojen gjatë mënyrës së kryerjes rezultojnë të jenë të rrezikshme dhe të frikshme. Autorët e këtyre veprave gjijnë vendet e përshtatshme për ta kryer, që pastaj të mund të ikin më lehtë. “Është e frikshme, ... nuk po njeh moshë, as gjini, as fe, kjo mund të bie ‘hise’ kurdo e kujdo, ... kur flitet për ato brenda në familje, që vijnë deri te vrasjet, atëherë kësaj i frikësohen të gjithë” (Q-E-1)<sup>59</sup>.

Rrezikshmëria e kësaj dukurie kriminale për shoqërinë nuk është vetëm vlerësim i qytetarëve, po këtë e tregon edhe ky citim i njërit prej personave që vet ka kryer grabitje:

Shumë herë kemi pasur maska dhe armë me vete. Kemi pasur raste kur jemi konfrontuar me personat që i kemi vjedhur dhe grabitur. Janë ndjenja të veçanta për t'u shpjeguar, thaujse rritet andrenalina dhe në rrethana të caktuara 80% të rasteve jemi të gatshëm të vrasim, vetëm për të ikur, sepse në ato momente nuk e ke veten në kontrollë. Të gjitha ato pare i shpenzojmë në lojëra të fatit, në lokale nate dhe në droga. Shumë herë hulumtojmë ditën se ku mund të ketë pare, ari, armë, e pastaj veprojmë natën. Mjetet e vjedhura dhe të grabitura i shesim, që paraprakisht e dimë se ku duhet t'i dërgojmë. Kemi raste që me vete kemi edhe femra dhe bashkarisht kryejmë veprën. Është interesantë se paret e fituara në këtë mënyrë na shpenzohen shumë shpejtë, pa ditë as vet (D-P-2)<sup>60</sup>

Edhe më shqetësuese rezultojnë rastet e grabitjeve të ‘natës’, kur persona të maskuar e të armatosur bllokojnë rrugët dhe ndalojnë këdo që lëviz andej pari duke iu grabitur çdo gjë më vlerë, pa marrë parasysh se kush mund të jetë ‘gjahu’. Ata që kanë kundërshtuar

<sup>59</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 24.06.2014.

<sup>60</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektaus dhe numri, 22.09.2014.

apo nuk i kanë përfillur ‘urdhrat’ e tyre, janë qëlluar edhe me armë. Me qëllim të shmhanges në raste të tilla, qytetarët kanë reduktuar lëvizjet e tyre, sidomos natën dhe nëpër zona të frekuentuara pak, madje “ka pasur periudha kur jemi detyruar të mbyllemi në shtëpi për t'u vetëmbrojtur” (Q-E-1)<sup>61</sup>. Në raste të tilla, rreziku del të jetë i dy anshëm, pra edhe për ‘gjahun’ e tyre dhe po ashtu edhe për vet kryesit. Megjithatë, sipas kryesve, ata janë gjithmonë të përgatitur për veprim dhe me masa të vetëmbrojtjes për rastet që mund të hasin, “thuajse në të gjitha rastet marrim mjete të përshtatshme për kryerjen e veprës e deri te ndonjë mjet tjeter për vetëmbrojtje, që nuk përjashtohen edhe ato të rrezikshmet” (D-L-M-1)<sup>62</sup>.

Kjo dukuri ishte shumë dhe vazhdon të mbetet mjaft aktive në këtë trevë, e praktikuar sidomos nga moshat e reja. Nga kjo janë goditur shumë individë, familje, institucione, organizata, vendor dhe të huaj, edhe fëmijë, gra e pleq. Ka ndodh në çdo kohë, nga mëngjesi e deri në orët e vona të natës.

#### *Vrasjet dhe mënyrat e vrasjeve*

Dukuri shqetësuese janë edhe format dhe mënyrat e vrasjeve. Sipas tyre, nëse marrim veprën kriminale të vrasjes, dihet se edhe në të kaluarën kanë qenë prezente raste të tilla dhe nga ato më të lehtat e deri te më të rëndat. Edhe pse kanë ekzistuar raste që nuk kanë mundur të ndriçohen asnjëherë, këto të sotmet janë shumë më të frikshme dhe se tejkalojnë traditën shqiptare, ku “90% nuk janë në traditën tonë” (Q-G-9)<sup>63</sup>. Kjo del si një dukuri e moderuar dhe duket si një ‘evolucion’ shumë i avancuar. Tanimë ka pak raste, për të mos thënë fare, që janë të përafërtë sipas traditave e zakoneve të kësaj treve. Edhe ato që kanë të bëjnë me hakmarrjet, kanë ndryshuar mënyrën e ‘nxjerrjes’ së

<sup>61</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 24.06.2014.

<sup>62</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

<sup>63</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 19.06.2014.

gjakut. Pikërisht se “vrasjet në të kaluarën janë rregulluar më shumë me kanun se sa me ligj, sepse më shumë ia kanë pasur frikën kanunit” (Q-P-8)<sup>64</sup>, ndërsa në ditët e sotme ato kryhen në rrithana tjera. Së pari mendohet që t’iu shmangen ‘normave kanunore’ edhe pse po shkohet në zbehjen e tyre dhe së dyti, për t’i ikur ligjit. Pra, nuk qëndron më ajo ‘krenaria’ dhe ‘burreria’ nga kryesi, por po shkohet në fshehjen e kryesve.

Sot shoqëria e kësaj treve ballafaqohet me vrasjet e shumta enigmatike, nga me maska e deri te vrasjet që bëhen në prezencë të fëmijës, gruas apo edhe në vende publike. Pra, “edhe mënyrat dhe format vrasjeve janë praktikë e re, po vriten për ‘biznese’ e për femra e jo për nder e marifet” (D-4)<sup>65</sup>. Sipas të dhënave nga terreni, arsyet e shumta janë për çështje të bizneseve të ndyta apo edhe bindjeve të tjera. Kjo ka shtuar edhe numrin e veprave të tilla. Bazuar në të dhënat statistikore të organeve të rendit shihet se ka rritje (shih tab. 11).

*Tabela 11. Statistikat e vrasjeve 1999-2012*

Vepra	Viti													
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Vrasje	8	13	10	5	5	1	1	1	6	2	5	6	3	3

Përveç kësaj, shqetësuese mbetet mënyra e kryerjes, e cila është shumë e rrezikshme për këdo që gjendet atypari. Duke u bazuar në informatat nga terreni, vlerësohet se menjëherë pas luftës është filluar me vrasjet politike, duke vazhduar me vrasje që janë kryer për shkak të bizneseve të ndryshme e deri te ato motivet e të cilave mbeten mister

<sup>64</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 28.06.2014.

<sup>65</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014

edhe sot e kësaj dite. Ka nga ata që vlerësojnë se edhe hakmarrjet më nuk dihen. Pjesa më e madhe e veprave të tillë pretendojnë të kryhen në rrrethana enigmatike dhe të mbeten anonime. Nuk janë përjashtuar edhe vrasjet me pagesa, “ka pasur raste kur dikush është paguar për vrasje dhe pasi ka dalur nga burgu ka bërë prapë një gjë të tillë” (D-5)<sup>66</sup>. Kjo faktohet edhe me numrin e madh të rasteve të pazbuluara deri me tanë.

#### *Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm*

Duke iu referuar të dhënave nga terreni, një ndër dukuritë e reja shqetësuese dhe shumë të rrezikshme dalin të jenë edhe rastet e vrasjeve dhe shkaktimit të dëmeve përmes mjeteve eksplozive dhe mjeteve shpërthyese tjera. Kjo dukuri nuk ka kursyer as këtë trevë. Janë të shumta rastet kur individëve iu është vendosur sasi e eksplozivit në automjete apo edhe në objekte të banimit. Po ashtu të shumta janë rastet kur mjete shpërthyese u janë hedhur në objekte të banimit dhe në oborre dhe nga shpërthimet ka pasur edhe viktima në njerëz dhe dëme të mëdha materiale, apo kur mjete të tillë iu janë vendosur të kurdisura nëpër dyer të oborreve e në automjete. Këto raste janë evidentuar edhe nga organet e rendit, dhe bazuar në statistikat e tyre, kjo dukuri vazhdon të jetë në trend (shih tab. 12).

*Tabela 12. Rastet e shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm*

Vepra	Viti													
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Sh.Rr. P		27	15	56	29	14	54	46	20	88	12	43	55	40

<sup>66</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014

Duke u bazuar në natyrën dhe specifikat e tyre, këto vlerësohen të jenë shumë të rrezikshme dhe shkaktimi i rrezikut merr një perimetër të gjerë. Këtë e potencojnë edhe disa nga ekspertët e sigurisë. Në anën tjetër, për mënjanimin e këtij rreziku, atëherë kur ato nuk kanë shpërthyer, kërkohen ekspert të veçantë. Kështu që rreziku ekziston deri në mënjanimin e plotë të tyre. Pasojat psikologjike dhe shqetësimet e familjarëve janë të shumta, qoftë nga ekspozimi i rrezikut ndaj shpërthimit, pastaj evakuimi i tyre e deri te shpërthimet e kontrolluara nga ekspertët, pasi ka raste kur ato nuk mund të tërhiqen nga vendi i ngjarjes dhe aty duhet të asgjësohen, me ç'rast nuk mungon as ndotja ekologjike.

Nuk kanë munguar as rastet kur në vende publike individë të armatosur kanë shtënë me armë zjarri apo edhe me mjete shpërthyese duke shkaktuar viktima dhe dëme materiale dhe atë thjesht vetëm pas një mosmarrëveshje mes vete. Mirëpo, ka raste edhe kur përmes këtyre mjeteve janë kërcënuar dhe shantazhuar edhe pronarë të bizneseve apo personalitete tjera, duke mos përashtuar edhe mosmarrëveshje të ndryshme rreth pronave dhe gjërave tjera që kanë pasur qytetarët e kësaj treve.

#### *Teknologja e avancuar*

Zhvillimi i teknologjisë ka ndikuar dhe ndikon shumë, ku përmes rrjeteve sociale individët dhe grupet po krijojnë mundësi bashkëpunimi e organizimi dhe takime për përfshirje në kriminalitet. Këto kontrollohen dhe ndalohen me vështirësi nga institucionet e shtetit. Pasojat e përdorimit të internetit i gjemë të shprehura edhe përmes këtij mendimi:

Përdorimi i internetit po ka në shumë raste efekte negative, sepse fëmijët, madje edhe të moshave shumë të reja, nuk po kanë asnjë kontrollë nga ana e prindërve, e le më ndonjë kufizim. Kështu vjen deri tek keqpërdorimi i qasjes në internet, tek incizimet apo edhe biseda me rezultate negative për familjet e vajzave dhe djemve. Por, më e keqja është se

këto familje nuk i kanë trajtuar këto raste, por i kanë rezultuar ato. Madje kemi raste të tilla kur një vajzë e re ka shkuan edhe deri tek vetëvrasja (Q-N-10)<sup>67</sup>

Andaj, shihet se teknologjia ka bërë të veten, si emisionet e ndryshme të pakontrolluara, filmat me kultura e zakone nga më të ndryshme, pastaj, “telefonat dhe rrjetet sociale, na mundësojnë të krijojmë miqësi me të tjerë dhe të organizojmë aktivitete kriminale, që edhe organet e rendit e kanë vështirë për t'i kontrolluar” (D-L-M-1)<sup>68</sup>. Së paku as “televizionin s'je në gjendje ta përcjellësh me familjen tënde, gjithfarë idiotësish” ku kjo tregon se “pas kësaj lufte humbi morali, humbi nderi” (D-4)<sup>69</sup>.

Shoqëria e këtij rajoni është hapur në veçanti ndaj ndryshimeve teknologjike, sidomos moshat e reja. Në të njëjtën kohë kjo ka mundësuar që përdoruesit e teknologjisë të fitojnë njohuri të reja mbi kulturat dhe shoqëritë e huaja, funksionalizimin, mënyrën e jetesës, peripecitë dhe të arriturat e tyre. Por, në vend që përmes teknologjisë, programeve televizive, përdorimit të rrjeteve sociale e webfaqeve informuese, përdoruesit e tyre të thithin gjërat pozitive, karakteristikat me vlera, janë pikërisht anët negative ato të cilat po bëhen pjesë e mendësisë së të rinjve në veçanti. Kështu, kemi raste kur grupmosha të ndryshme kanë krijuar varshmëri edhe ndaj serive televizive, të cilat paraqesin madje përbajtje të papërshtatshme për ta, duke shfrytëzuar paqëndrueshmërinë e mendësisë për ta ndryshuar atë sipas ‘parimeve’ kulturore të huaja, me ç'rast kanë sjellë edhe sjellje devijante në mesin e anëtarëve të familjes. Në anën tjetër, kur përmendim internetin, mund të themi se nuk janë të rinjtë ata që po e përdorin, por është interneti ai që po i përdorë të rinjtë.

<sup>67</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.


<sup>68</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektyues dhe numri, 30.09.2014.

<sup>69</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014.

Pastaj, teknologja po konsiderohet si një nga mënyrat më të mira dhe më të avancuara për t'u përdorur si mjet për organizimin e aktiviteteve kriminale, por jo vetëm kaq. Përmes rrjeteve sociale, individë dhe grupe të caktuara kriminale, po zhvillojnë fushata propaganduese, duke ndikuar në krijimin e bindjeve në mesin e kategorive të caktuara, të cilat iu përshtaten atyre dhe qëllimeve të tyre kriminale. Në këtë mënyrë krijohet një linjë e re e bashkëpunimit edhe mes rrjeteve të ndryshme kriminale, të cilat në mënyrë mjaft aktive i shfrytëzojnë mundësitë që ofron teknologja informative dhe mungesën e edukimit dhe arsimimit të duhur të gjeneratave të reja, të cilat janë pre e lehtë për ‘gjahtarët’ e bandave kriminale.

Mungesa e institucioneve stabile dhe periudha e tranzicionit vlerësohet të jetë një ndër faktorët kryesor në paraqitjen e dukurive të reja kriminale në këto treva. Këtë e tregojnë të dhënat e marra nga terreni përmes pyetësorëve. Po ashtu, vlerësime të tillë janë dhënë edhe nga intervistat e pranuara, sipas të cilave janë shumë arsy që pikërisht kjo periudhë është shfrytëzuar për paraqitjen e dukurive të shumta kriminale, të cilat janë të rrezikshme për shoqërinë (shih diagr. 45).

*Diagrami 45. Ndikimi i mungesës së institucioneve stabile gjatë periudhës së tranzicionit si faktor në shfaqjen e dukurive të reja kriminale*



Menjëherë pas luftës në Kosovë erdhën njerëz e misione të ndryshme që sollën edhe gjëra krejtësisht të reja, sidomos ekonomike e sociale. Kështu, përmes tyre u lejuan hapjet e lokaleve të natës në të cilat punonin femrat, që për ne nuk kanë ekzistuar, pastaj erdhën lojërat e fatit e deri te drogat.

Me formimin e strukturave shtetërore, gjatë kohës së të ashtuquajturit transformim shoqëror, sidomos gjatë periudhës tranzitore, u krijuan mundësitë për formimin e strukturave të tjera. Duke qenë një shoqëri tradicionale dhe me kulturë, ‘prodhim’ i vet kësaj shoqërie, gjatë rrëthanave të reja të riorganizimit, kjo periudhë domosdo që u pasua me ndryshime në të gjitha fushat. Kjo periudhë paraqiti rast të mirë që individë dhe grupe të ndryshme të rrëshqasin nga normat shoqërore tradicionale dhe morale, madje edhe duke shfrytëzuar reformat e atyre ligjore.

Gjatë hulumtimit është vlerësuar se organet ‘shtetërore’ gjatë kohës së tranzpcionit nuk ishin sa duhet të qëndrueshme dhe se shumë prej tyre funksiononin pjesërisht. “Ndoshta janë krijuar në mënyrë sipërfaqësore, por në fakt nuk e kanë luajtur rolin e tyre” (Q-N-10)<sup>70</sup>, tregon se reflektimi i tyre nuk ishte në nivelin e duhur. Ato në të shumtën e rasteve udhëhiqeshin nga ndërkombëtarët e ardhur nga vende të ndryshme, madje edhe nga të pazhvilluara, duke punuar në atë profesion për herë të parë. Një nga të anketuarit thotë: “Kam pasur një administratore, na ka qaros kur e ka kuptuar se në fshatin tonë (e saj, cit. i autorit) ka ardhur rrryma” (Q-G-9)<sup>71</sup>. Pastaj, edhe stafi vendor i angazhuar, kishte mungesë të përvojës profesionale. Në disa raste kishin angazhuan staf në rrëthana urgjente. Kjo ka ndodhur edhe në shumë institucione të tjera. Pikërisht, kjo ka ndikuar që ato të mos jenë sa duhet stabile. Sipas të anketuarve, mes tjerash, vlerësohet se në

<sup>70</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>71</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 19.06.2014.

shumë raste në institucionet kryesore kishte të angazhuar persona jo kompetent apo edhe të padëshiruar për mjedisin. Kështu që, pikërisht “mos puna e duhur e institucioneve dhe mungesa e rolit të familjes i shtynë individët e caktuar të merren me vepër kriminale” (Q-S-6)<sup>72</sup>.

Në anën tjetër, shumë prej institucioneve ndërkombëtare kishin ndërtuar një sistem menaxhimi që nuk ishte në hap me zhvillimin dhe realitetin shoqëror të këtyre trevave. Ata në disa raste kishin sjellur praktika nga vendet e tyre, të cilat përkëndeshin shoqëri ishin jashtë traditave e zakoneve të saj. Këtë e përforcon edhe ky vlerësim:

Unë krejt fajet i lë te faktori i huaj, çdo tjetësim që ka ndodh në Kosovë është pasojë e tyre, nuk mundemi ne që për një kohë kaq të shkurtër pasi fituan lirinë të krahasohemi me anglezë e francezë, po faleminderit prej të huajve që po bëjnë eksperimente me neve” (Q-P-8)<sup>73</sup>.

Në një vlerësim i tjetër të përafërt thuhet: “ardhja e të huajve menjëherë pas luftës dhe qëndrimi i tyre kanë sjellë shumë dukuri të dëmshme për shoqërinë tonë, edhe vet kultura e tyre është në një nivel që shoqërisë tonë i duhet kohë ta zë, sepse në rrithanat e tanishme po keqpërdoret” (D-L-F-1) <sup>74</sup>, gjë që dëshmon se kjo shoqëri ishte e papërgatitur në aspektin moral dhe social të përballet me këtë nivel organizimi.

Është mungesa e përvojës së institucioneve dhe koha e gjatë e tranzicionit të kësaj shoqërie, të cilat “ndikuan që grupet kriminale ta shfrytëzojnë këtë vakum institucional” (Q-R-7)<sup>75</sup>. Pikërisht rrithanat e tillë ishin shfrytëzuar edhe nga individët dhe grupe të ndryshme, të cilët i zhvilluan edhe aktivitetet kriminale. Shumë prej aktiviteteve kriminale rezultojnë të jenë dukuri të reja për këto treva. Akterët e këtyre dukurive

<sup>72</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 31.07.2014

<sup>73</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 27.06.2014

<sup>74</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektyues dhe numri, 25.09.2014.

<sup>75</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 20.06.2014.

arritën të ndërlidhen mes vete përmes formave të ndryshme, duke rekrutuar individë vendor dhe nga jashtë. Prandaj, gjendja e tillë institucionale fajësohet për rrethanat e reja kriminale dhe gjendjen e sigurisë, që nga shprehja e mëposhtme është vlerësuar kështu:

Pa asnjë dyshim se organizimet e institucioneve tona, kanë ndihmuar tërë shoqërinë që të ketë krim me bollék në mesin tonë dhe populli të vuani dhe të qëndron në pabesi ndaj strukturave institucionale. Pse mendoj këtë aspekt kështu? Sepse përgjedhja e individëve të partive politike pa verifikimin e kredibilitetit ka shkaktuar kaos të paparë në vend. Pra, në vend vënie së njerëzve të aftë e profesional në ballë detyra, janë vënë njerëzit që nuk kanë njojur obligimet e tyre. Si të tillë kanë ndihmuar krimin e jo luftuar atë (Q-T-2)<sup>76</sup>

Nga të dhënat e mbledhura, rezulton se sjellja e disa prej kulturave nga vende tjera për shoqërinë e kësaj treve ishte shkaktar i përhapjes së shumë dukurive kriminale. Thua jse nga të gjithë potencohen rastet e lejimit të hapjes së disa lokaleve të natës, kur shërbimin femra nga shtetet e Evropës lindore e vende tjera, të gjitha të pajisura me dokumente të institucioneve shtetërore qendrore dhe lokale. Pikërisht, këto lokale janë shfrytëzuar edhe për shumë aktivitete të jashtëligjshme, ku pasojat i kanë ndier nga individi e familja e deri te vet shteti. Kështu që institucionet “jo vetëm që nuk i kanë parandaluar, por i kanë stimuluar haptas këto dukuri” (Q-M-3)<sup>77</sup>.

Rrethanat e tillë nuk ndryshojnë në këtë drejtim edhe pas zhvillimeve e ndryshimeve në sferën politike, as pas shpalljes së shtetit të Kosovës. Madje, as me ndryshimet e ligjeve që shërbimin për luftimin e dukurive të tillë. Pra, del të jetë se nuk u veprua asgjë në interes të shoqërisë në këtë drejtim, madje edhe duke drejtuar gishtin në adresë të vet shtetit: “institucionet tona, që janë institucione politike të lidhura me rrjete mafioze, që

<sup>76</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 10.10.2014.

<sup>77</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

janë të zhytura në realizimin e qëllimeve të tyre antiligjore, i kanë lënë anash problemet shoqërore...” (Q-M-3)<sup>78</sup>.

Ndër këto aktivitete kriminale, kemi edhe trafikimin e qenieve njerëzore dhe keqpërdorimin e tyre për shërbime seksuale me pagesë. Vet mundësimi i punësimit në lokale të tilla, kinse për shërbime tjera, si kamariere, mirëmbajtëse, shankiste, etj., ishte rast që u shfrytëzua edhe për prostitucion. Ky mundësim ‘indirekt’ institucional ka ndikuar edhe më shumë në disa paraqitje të dukurive të reja, si: paraqitja e personave të zhdukur, ku në shumë raste ishin moshat e reja që largoheshin nga shtëpia pa iu treguar familjarëve dhe shkonin e punonin pikërisht në lokale të tilla; dhunë në familje, si rezultat i ftohjes së raporteve burrë - grua apo edhe shpenzimeve e borxheve ku hynin ata; divorcet në rritje etj. (shih tab. 13).

*Tabela 13. Personat e zhdukur*

Vepra	Viti													
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Personat e zhdukur		19	17	21	12	17	6	17	15	10	10	11	22	13

Këtyre rrethanave të reja kriminale u ka kontribuuar edhe koha e gjatë e periudhës së tranzicionit. Këtë e shprehin disa nga të intervistuarit, të cilët vlerësojnë se “sa më shumë që zgjatë tranzicioni, aq më shumë prodhohen efekte negative, aq më shumë rritet kriminaliteti e pasiguria” (Q-S-6)<sup>79</sup> dhe se “stërvizatja e tranzacionit dhe gjendja pa organe të veprimit të shtetit, jo që ka krijuar destabilitet shoqëror, por ka ushqye

<sup>78</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>79</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 31.07.2014.

kryekëput lulëzimin e krimit në vendin tonë, ku anarkia e pushtetit, burokracia, mospërgjegjësia janë ushqim i parë për lulëzimin e krimit në një vend në tranzicion” (Q-T-2)<sup>80</sup>. Pikërisht kjo ka krijuar mundësi bashkërendimi të akterëve nga brenda Kosovës dhe atyre nga vende të tjera të Evropës dhe të botës. Këta më së miri arritën të përfitojnë në kohë me ‘bizneset’ e tyre, madje duke u bazuar në përvojat e shkathtësisë e tyre kriminale, duke sjellur edhe shumë aktivitete kriminale këndejpari.

Ndër të tjera, duhet theksuar rastet e narkotikëve dhe numrin e madh të të përfshirëve në këtë dukuri, sidomos të të rinxve. Në të kaluarën nuk kishte thuajse fare të tilla raste, e tani është dukuri shumë e përhapur dhe mjaft shqetësuese. Këtë e paraqesin jo vetëm të dhënat e raportuara nga organet e rendit të kësaj zone, por edhe nga institucioni pë trajtimin dhe shërimin e këtyre kategorive, ku thuhet se “është shtuar shumë numri i përdoruesve të substancave narkotike në këtë rajon, ku mosha që i përdorë këto më së shpeshti i takon asaj nga 15 deri në 25, por edhe mbi 30 – 35 vjeç” (Q-I-5)<sup>81</sup>. I njëjti potencon se gjatë trajtimeve të tyre kishte ndëgjuar se kishte nga ata që për të siguaruar mjetet për blerjen e narkotikëve, kishin përdorur maska e armë zjarri me të cilat kishin kryer vjedhje dhe grabitje. Ka raste kur kjo kategori shkon edhe më larg. “Kemi pasur raste kur gruaja është detyruar të paguajë borxhet e burrit edhe në mënyrën më çnjerëzore, gjë që paraqet një dukuri që kurrë nuk ishte prezente në shoqërinë tonë” (Q-N-10)<sup>82</sup>.

Si dukuri shqetësuese dhe shumë e shprehur në shoqërinë e kësaj treve, por edhe më gjërë, del të jetë edhe ajo e fajdeve. Ekzistimin e kësaj në shoqëri e tregojnë edhe të dhënat nga terreni dhe po ashtu edhe statistikat nga organet e rendit.

<sup>80</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 10.10.2014.

<sup>81</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>82</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

Ndonëse me ligj është e ndaluar si veprimtari, prapë se prapë është shumë aktive dhe e pranishme në mesin e banorëve të kësaj treve. Edhe në të kaluarën ka ekzistuar, por në masë tejet të vogël dhe në formë krejtësisht tjetër, ku personat që kanë marrë hua të hollat nga dikush tjetër, të njëjtat i kanë kthyer në sasinë e huazuar dhe jo më shumë, pra praktikisht nuk ka qenë fajde, por huazim i parasë. Kurse sot, njerëzit që ushtrojnë këtë veprimtari, po i shfrytëzojnë edhe rrethanat që u krijuan menjëherë paslufte, ku njerëzit kishin nevojë për huazime dhe atyre iu imponua të huazonin paranë me kthim me interes të shtuar.

Për pjesën më të madhe kjo dukuri del të jetë e re, edhe pse nuk i përjashtojnë rastet. Këtë na thotë edhe shënim i marrë nga një prej të anketuarve, sipas të cilit “në të kaluarën nuk ka qenë aq praktike, por nga periudha e pasluftës, gjatë tranzicionit e tutje kjo dukuri ka pasur një rritje të dukshme dhe akoma po vazhdon të ketë” (Q-S-6)<sup>83</sup>. Ndarja e popullsisë në dy shtresa, të varfër dhe të pasur, ku gjendja e dobët ekonomike si dhe pasoja nga dëmet e luftës kanë imponuar që individët, duke menduar të gjejnë një zgjidhje për ekzistencë, janë detyruar të ‘huazojnë’ para të gatshme. Këtë gjendje të tyre e kanë shfrytëzuar pjesa që kishin dhe duke qenë shumë ‘humanitar’, i kanë ‘ndihmuar’ ata, me ç’rast u kanë shkaktuar edhe më shumë probleme sociale. Një kontribut në këtë dukuri e kanë dhënë edhe kamata e larta të bankave dhe shkalla e lartë e papunësisë.

Riorganizimi shoqëror demokratik dhe transformimi nga sistemi tradicional në atë modern solli edhe ‘hapjen’ e shoqërisë. Kjo ndikoi edhe në praktikat tradicionale brenda në familje, ku dominimi i gjinisë mashkulllore ndaj asaj femërore duhej të ndërronte. Ndryshimet e reja mundësuan që gjinia femërore të ketë të drejtat e saj të plota, jo vetëm në familje, por edhe në shoqëri. Praktikat e tillë i dhanë të drejtë secilës femër që

---

<sup>83</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 31.07.2014.

të raportojë në organet e rendit nëse do t'i imponohej diçka që ajo nuk ishte e gatshme ta bënte. Një gjë e tillë u sanksionua, fillimisht përmes disa rregulloreve të pushtetit të instaluar e qeverisur nga faktori ndërkombëtar në Kosovë, që veprimet e tilla i quante dhunë në familje. Kjo më vonë u kodifikua edhe në legjislativin e shtetit të Kosovës. “Ndoshta mund të gabojmë, por në të kaluarën nuk ka pasur të dhëna apo nuk kemi pasur informata që dhuna në familje ka ndodh” (Q-G-9)<sup>84</sup> vjen një vlerësim i bazuar në praktikat tradicionale.

Duke qenë se zbejha e traditave të tilla kërkonte kohë, nuk munguan as raportimet në këtë drejtim. Në aspektin social kjo reflektonte një papajtueshmëri gjeneratash. Kështu, “kjo dukuri është në rritje dhe mendoj se janë probleme serioze” (Q-G-9)<sup>85</sup>. Pasojat e tyre janë jo vetëm për familjen por edhe për tërë shoqërinë. Janë të shumtë faktorët që ndikojnë në paraqitjen e kësaj dukurie, por edhe më të shumta vlerësohet të jenë pasojat. Dukuria e tillë duket të jetë prezente edhe në shoqërinë gjakovare. Përveç të dhënavë nga organet e rendit, këtë e dokumentojnë edhe të dhënat nga terreni dhe atë nga vëtytetarët si dhe nga OJQ-ja që trajton këtë problem në këtë zonë (shih tab. 14).

*Tabela 14. Dhuna në familje*

Vepra	Viti													
	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Dhunë familjare	/	/	23	28	37	27	67	70	71	34	47	49	54	51

<sup>84</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 19.06.2014

<sup>85</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 19.06.2014.

Këto të dhëna janë vetëm ato që janë raportuar, por vlerësohet se ka edhe shumë të tilla që kanë ndodhë e ndodhin por që nuk raportohen për shkak të disa rrëthanave. Andaj, ‘kjo tregon se duhet të kalojë edhe një periudhë e mirë derisa njerëzit të hapen ndaj këtyre çështjeve” (Q-N-10)<sup>86</sup>.

Thuajse kjo është bërë një dukuri e pashmangshme e kësaj shoqërie e thotë edhe ky mendim: “dhuna në familje është e pashmangshme në këto raste e rrëthana, sidomos kur ka dhunë ndaj gruas, por edhe më keq kur dhuna ushtrohet ndaj fëmijëve” (Q-N-10)<sup>87</sup>. Përmes kësaj del të ketë shumë rrëthana e faktorë që në njëfarë mënyre imponojnë të ketë mosmarrëveshje familjare e që përfundojnë me një gjë të tillë. Pra, në kohën moderne “nuk ka mundësi të jetojmë me një njeri të dhunshëm” (Q-N-10)<sup>88</sup>, ishte mendimi i disa prej atyre që kishin përjetuar dhunën e tillë, dhe vjen si rezultat “se ka shumë faktorë që sjellin këto raste”<sup>89</sup>.

Nuk janë të pakta rastet që pas kësaj përfundojnë me ndarje mes bashkëshortëve. Kështu, “rastet ekstreme kanë qenë kur gratë kanë vendosur të shkëpusin lidhjen martesore, përkundër pamundësisë ekonomike”<sup>90</sup>. Megjithatë ka raste që edhe përkundër dhunës së vazhdueshme “gratë kanë vendosur ta vazhdojnë jetën e tillë”<sup>91</sup>.

*Tabela 15. Divorce<sup>92</sup>*

Viti:	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Shkurorëzime	152	157	146	161	187	184	188	166

<sup>86</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>87</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>88</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014

<sup>89</sup> Po aty.

<sup>90</sup> Po aty.

<sup>91</sup> Po aty.

<sup>92</sup> Të dhënat nga qendra për punë sociale në K.K. Gjakovë

Ndër të tjera, në aspektin social kjo përbën problemin më madhor, ngase institucionet shtetërore nuk kanë mundësi të merren me lehtësimin e pasojave. Ndonjëherë viktimë e këtyre rasteve kanë rënë fëmijët, ngase ata kanë ngelur pa përkujdesjen prindërore dhe pa mjetet e nevojshme pë jetesë. Këtë e dëshmon fakti se me rastet e dhunës në familje, në tërë rajonin që mbulon rajoni i Gjakovës gjendet vetëm një strehimore përfemrat dhe fëmijët që janë viktimë e rasteve të tilla, në të cilën ato qëndrojnë përkohësisht.

### 5.3 Faktorët nxitës

Duke iu referuar të dhënave nga terreni shihet se në kuadër të këtyre zhvillimeve dhe organizimit të ri shoqëror, shumë prej tyre shërbejnë të jenë edhe shtytje në aktivitete kriminale.

#### 5.3.1 Hapja e lokaleve të lojërave të fatit, lokaleve të ‘natës’, kazinove

Lejimi i punës së këtyre lokaleve dhe atë në të shumtën e rasteve me leje të institucioneve shtetërore, sjellë mendime dhe vlerësimë të shumta. Pjesa më e madhe vlerësojnë se ato janë njëri prej faktorëve shtytës në kriminalitet si dhe në paraqitjen e dukurive të reja kriminale dhe shumë të rrezikshme për shoqërinë. Këto janë joshëse dhe të ardhura nga vende të tjera, pra që “në kohën kur kanë depërtuar agjentura nga më të ndryshmet, edhe joshja e njerëzve, sidomos e të rinjve, për të ardhur më lehtë te paraja, e për këta nuk është vështirë të shfrytëzojnë këto lokale” (Q-M-3)<sup>93</sup>. Një vlerësim tjetër i tillë del të jetë edhe ky: “këto vërtet janë dukuri të këqija dhe si thotë populli, këto janë pjellë e dikujt tjetër, nuk kanë qenë në kulturën tonë” (Q-S-6)<sup>94</sup>.

Dukurinë e këtij ‘biznesi’ e shfrytëzuan grupe të caktuara, ku “grupet mafioze kanë bërë që të hapen lloj-lloj biznese të natyrave të ndryshme, sepse këto sjellin të ardhura të


<sup>93</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>94</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 31.07.2014.

gatshme, të menjëhershme dhe nga këto e kanë pjesën e tyre të fitimit edhe njerëzit e mafisë, por edhe nga ta të pushtetit” (Q-M-3)<sup>95</sup>. Në të kaluarën nuk kishte lokale të tilla që mund t’i frekuentonte cilido. Kjo ka shtyr në garë se cila ‘kompani’ të hapë sa më shumë lokale të tilla, me fokus në vendet më të frekuentuara, pa zgjedhur vendet se ku ndalohen, ngase përfitimet e tyre janë të shumta. M’u për këtë ka raste që edhe “kanë plaçkitë njëri tjetrin” (D-4)<sup>96</sup>.

Natyrat e punës së tyre krijojnë joshje për përfitime, por në anën tjetër këto janë edhe faktorë nxitës për aktivitetet kriminale. Andaj, “me vetë lejimin e këtyre po nxitet krimi, sepse njerëzit përmes tyre veç mendojnë si të vijnë deri te paratë, ata vazhdojnë të luajnë derisa të humbin të gjitha paratë, shtëpinë e edhe jetën me fajde. Ka raste kur janë vra për shkak të borxheve (Q-G-9)<sup>97</sup>. Se janë faktorë nxitës e dëshmojnë edhe të dhënat e paraqitura në diagramin e mëposhtëm.

*Diagrami 46. Lokalet e natës, lojërat e fatit, kazinotë – faktor shytës kriminal*



Lidhur me vlerësimin e këtyre dukurive kemi edhe mendimet e atyre që kanë pasur rastin të merren personalisht me këtë punë. Njëri nga ata shprehet se, “shtytes janë kazinotë, lojërat e fatit, lokalet e natës, që kanë vërvshuar Gjakovën dhe pjesa e atyre që i

<sup>95</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>96</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014.

<sup>97</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 19.06.2014.

frekuentojnë domosdo që iu imponohet me u marrë me gjëra të tilla, arsyeva është përfitimi më i lehtë dhe më i shpejtë (D-P-1)<sup>98</sup>.

Kjo bënë që kur këta nuk kanë para t'iu qasen aktiviteteve kriminale, ‘atëherë kryejnë grabitje’ e vjedhje. Në shumë raste veprojnë në grupe të organizuara, e cila gjë argumentohet edhe nga kjo shprehje: “I organizojmë krejt përmes telefonit. Pimë më së pari drogë, atëherë hyjmë edhe të vjedhin e grabitim. Shkojmë nëpër kazino. Edhe nëpër bastore luajmë, kur humbim, iu kërkojnë para. Kur nuk kanë, vejmë maskat, marrim armët edhe shkojmë t'i grabitim” (D-2)<sup>99</sup>.

Ndërsa, sipas një tjetri kemi mendimin se “skamja ka sjell dukuri të tillë, si kërkimi i lëmoshës, hapja e disa lokaleve të natës, lojërat e fatit e kazinotë bëjnë që të shtyjnë në vepra e dukuri që janë jashtë traditave të rrëthinës së Gjakovës”, dhe vlerëson “se ato duhet me qenë të kontrolluara e disa edhe të ndaluara, që t'mos jepet mundësia me shkua ata” (D-P-3)<sup>100</sup>.

Në anën tjetër, duke qenë se këto lokale nuk mbikëqyren fare nga inspektorët, frekuentohen nga persona që u takojnë moshat fëmijërore e deri te ato më të vjetrave. Për punëtorët aty me rëndësi të kenë klientë, pavarësisht moshës dhe gjendjes ekonomike. Bile, disa dëshmojnë se ata u mundësojnë të luajnë edhe kur ata nuk kanë të holla, duke iu pranuar si hipotekë gjësendet me vlerë që i posedojnë me vete e deri te veturat apo edhe shtëpitë. Ato vizitohen me dhjetëra herë nga persona të njëjtë. “Institucionet shtetërore kanë krijuar vende që moshave t'iu mundësohet të merren me kriminalitet, si bastoret, lokalet e natës etj. Kur humbet paratë, ato duhet kompensuar

<sup>98</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrekues dhe numri, 22.09.2014.

<sup>99</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 24.06.2014.

<sup>100</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrekues dhe numri, 22.09.2014.

dhe këtë e bëjmë duke shkelur ligjin” (D-L-M-1)<sup>101</sup>, është shprehur një nga të miturit. Kështu që mungon një mbikëqyrje që e kërkon edhe ligji.

Bazuar në analizat e bëra nga të dhënat e nxjerra nga organet e rendit si dhe deklarimet e të anketuarve, del se në zonat ku punojnë këto lokale, kishte shumë incidente kriminale nga më të ndryshmet, si: vjedhje, lëndime trupore e deri te grabitjet e armatosura e të maskuara dhe vrasjet. Nuk janë kursyer as edhe dëmtimet kriminale që ia kanë shkaktuar njëra-tjetrës kompanitë përmes personave të tyre në shenjë hakmarrjeje për biznese. Një nga vlerësimet e shumta ishte se dukuria e grabitjeve rrjedh si rezultat i humbjeve të pronës dhe me qëllim që të vazhdojnë të luajnë edhe më tutje, që sipas analizës, del të jetë e pranuar edhe nga vet të dënuarit. Pastaj, prezencia e këtyre lokaleve kishte bërë që zonat përreth tyre të ishin ndër më të sfidurat nga kriminaliteti.

Andaj, lokalet e lojërave të fatit, lokalet e natës dhe kazinotë janë disa biznese që ndihmuant në shfaqjen e kriminalitetit. Njëri nga të anketuarit është shprehur kështu: “faktorët shtytës janë lojérat e fatit, që pas humbjes së të hollave detyrohem të grabisim për të ardhur deri te mjetet materiale dhe për të vazhduar me luajt prapë” (D-D-3)<sup>102</sup>, e që njëjtë thuajse kemi edhe atë se “ka shumë faktorë që i nxitin, sidomos moshat e reja, në aktivitetet kriminale, p.sh. lojérat e fatit, lokalet e natës etj. (D-L-M-3)<sup>103</sup>. Kështu, hapja e lokaleve të natës, lojérat e fatit e kazinotë bëjnë që të shtyjnë në veprat kriminale.

---

<sup>101</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

<sup>102</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

<sup>103</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

### **5.3.2 Legjislativi**

Të gjitha shoqëritë rregullimin e brendshëm e bëjnë përmes normave ligjore, pra “nuk ka shtet që formohet pa ligje, mirépo, zbatimi i ligjeve në raport me shoqërinë është problem i madh, ... duhet ditur mentalitetin që e karakterizon shoqërinë” (Q-E-1)<sup>104</sup>. Gjatë periudhës 1999 - 2012 shoqëria kosovare dhe ajo gjakovare u përcollën edhe me ndryshime në aspektin ligjor. Me fillimin e organizimit demokratik, në aspektin e legjislativit u fillua me ish-ligjet që kishin qenë ekzistuese deri në mars 1989, duke përashtuar çështjet politike, për të vazhduar me ndryshimet rrënjosore në vitin 2004 e deri të ndryshimet e fundit gjatë vitit 2012, që hynë në fuqi në janar 2013. Kjo periudhë u përcoll edhe me shumë irregullore dhe akte të tjera nënligjore. Të gjitha këto ndryshime kishin për qëllim avancimin demokratik të shoqërisë kosovare. Ky legjislativ mbulonte tërë rajonet e Kosovës, pra edhe Gjakovën. Lidhur me avancimin dhe implementimin e legjislativit janë të shumta mendimet dhe vlerësimet nga mostra në terren.

Fillimisht normat e tillë shoqërore që kanë sanksionuar shkeljet ligjore vlerësoheshin se nuk ndërlidheshin me rrëthanat e kohës dhe realitetin shoqëror. Këto vinin si rezultat se një shoqëri e apo dalur nga lufta dhe që vinte nga një sistem i izoluar ende nuk ishte e përgatitur për të kuptuar drejt këto normime demokratike. Në të shumtën e rasteve edhe ishin keqpërdorur. Edhe gjyqtarët e huaj nuk ishin në hap me kapjen e realitetit, bazuar në traditat dhe kulturën e kësaj shoqërie. Kështu, “shoqëria jonë nuk ka qenë e gatshme për ta përballuar implementimin e ligjeve të reja, edhe pse njerëzit i donë ligjet, i

---


<sup>104</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 24.06.2014.

respektejnjë, por shpesh herë binë ndesh me praktikimin e tyre për shkak të pamundësisë për t'iu përshtatur menjëherë një risie të tillë” (Q-N-F-10)<sup>105</sup>.

Kështu që shumë raste kriminale nuk kanë mundur të trajtohen si duhet dhe se dënimet nuk arrinin efektin e duhur. Kjo te qytetarët kishte sjellur edhe pasiguri të madhe. Shumë nga ata edhe pse ishin dëshmitar, tërhiqeshin nga frika për të dëshmuar. Edhe ato pak arrestime që bëheshin, ata liroheshin, në mos menjëherë, shumë shpejt. Ishin këto që dëshmonin mosbatimin e ligjeve dhe se një mosbatim i tillë ishte faktor për nxitje të aktiviteteve kriminale. Në disa raste, zhvillimet e shpejta që përfjetonte kjo shoqëri në përqafimin e demokracisë, sillnin edhe tejkalime në aspektin tradicional dhe kulturor, por që nuk mund të sanksionoheshin deri sa ligji nuk i parashihte si shkelje. Andaj, shumë persona të dyshuar dhe të akuzuar për veprimtari kriminale nuk kanë mundur të dënohen, dhe

këta janë shembujt më të këqinj për shoqërinë, sepse personi që ka kryer krim e nuk është dënuar apo ka marrë dënim minimal, atëherë kjo nxitë të tjerët të kryejnë kryejnë krimë, ku mentaliteti jonë u mundëson këtyre njerëzve t'i përsëritin veprat e tyre duke u bërë problem për familjen, shoqërinë dhe shtetin (Q-N-F-10)<sup>106</sup>

*Diagrami 47. Harmonizimi i normave ligjore në Kosovën e pas luftës ishte real me rrethanat e kohës*



<sup>105</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>106</sup> Po aty.

Duke iu referuar përgjigjeve në fig. 37, nga vlerësimet e mostrës del se rreth 70% e normave ligjore nuk ishin në kornizat reale të kohës. Këtë e vërteton edhe ky mendim: “Gjykatat aspak s’ë kanë luajtur rolin e tyre. Ligjet e reja në Kosovë aspak nuk kanë qenë dhe nuk janë në hap me realitetin” (Q-P-8)<sup>107</sup>. Njëjtë kemi edhe këtë mendim, i shprehur nga një i dënuar, që thotë: “Kam pasur rastin në burg, kur njëri për vrasje ka dalur nga burgu pas disa muajve, pra e kanë liruar për krejt, ndërsa tjetri për vepra më të vogla ka mbajtur dënim shumë herë më të madh. Ligji nuk përkon me realitetin” (D-4)<sup>108</sup>.

Është e kuptueshme se asnjë shoqëri dhe asnjë institucion nuk mund të jetë i përkryer, sidomos kur bëhet fjalë për transformimet shoqërore. Kështu që një pjesë e madhe e shfrytëzojnë vakumin shoqëror dhe atë ligjor duke përfituar në kundërshtim me normat e kohës. Një dukuri e tillë është pranuar edhe nga vet personat që janë marrë me aktivitete kriminale, sidomos me dukuritë e reja, për të cilat edhe janë dënuar. Kështu, “ligjet moderne kanë sjellë shumë të drejta dhe se këto shumë herë po keqpërdoren nga individët dhe grupet” (D-D-3)<sup>109</sup>. Pikërisht këto hapësira dhe mos përshtatje me realitetin janë edhe faktori kryesor që personat i kanë joshur në kriminalitet. Andaj, duhet që “shteti me ligje më serioze dhe njëjtë për të gjithë” të vepron “sepse disa raste mos vuajtja e dënimeve po bënë që të vazhdojnë me krime të tjera (D-D-3)<sup>110</sup>.

Të gjitha këto tregojnë se sistemi ligjor nuk i ishte përshtatur realitetit jetësor duke u shndërruar në faktor nxitës për shkelësit e ligjit që të vazhdojnë në këtë drejtim me shkelje të reja. Përveç këtyre, ndihmesë edhe më të madhe në këtë drejtim ka treguar

<sup>107</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 27.06.2014.

<sup>108</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014.

<sup>109</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektyes dhe numri, 23.09.2014.

<sup>110</sup> Po aty.

edhe dhënia e dënimive si dhe koha e kaluar nëpër burgje. Janë disa arsyet që kanë ndikuar këtu. Mes tjerash, kemi edhe mendimin e njërit prej të anketuarve që shprehet kështu:

Mendoj se gjykata është pika më e dobët e shtetit tonë, ku duhet intervenuar që këta njerëz (gjyqtarët, sqarim i autorit) të janë të mbrojtur dhe të mos ndikohen nga presionet politike apo shoqërore. Një njëfarë forme, në mënyrë indirekte, kriminelët janë të favorizuar në këtë rast, qoftë me vetëdije apo edhe pa të. P.sh.: vjedh apo grabit 20.000€, dënohet me kusht dhe ato para nuk i kthen kurrë. Kjo edhe ka shtyrë ata dhe shumë të tjera të merren me këso veprimtarie (Q-G-9)<sup>111</sup>

Mirëpo, mendime të njëjta kemi edhe nga kategoria e të anketuarve që kanë qenë të dënuar m'u për aktivitete kriminale. Edhe ata mendojnë se dënimet nuk përputheshin me realitetin dhe se vuajtja e tyre shumë herë ofronte kushte të përshtatshme për miqësi të reja dhe ‘profesionalizim’. Pra, “mos dënimet e merituara shumë herë bëjnë që të vazhdohet me kriminalitet, bile ndodh që personat e dënuar më parë për vepra të ndryshme, gjatë shoqërimit këtu, kur kanë dal kanë kryer vepra kriminale bashkë dhe janë dënuar për të njëjtën vepër dhe kanë ardhur prapë këtu” (D-L-M-2)<sup>112</sup>.

Se disa nga personat e tillë janë të privilegjuar nga gjykata dhe gjatë kohës që kalojnë në burg, edhe pse ato janë të ndaluar me ligj, e thotë edhe kjo shprehje: “Gjykatat nuk e kanë luajtur rolin e tyre. Ligjet e reja në Kosovë nuk kanë qenë dhe nuk janë në hap me realitetin. E sa për burgjet shkurt po tregoj: Më thirri njëri nga burgu, ... u çudita, .... Po ti o vëlla a je në burg a ku je? Me qenë në Australi thotë njeri. Në burg i jasin telefon” (Q-P-8)<sup>113</sup>.

Kjo situatë e tillë e krijuar nëpër qendrat ku kryhet vuajtja e dënimive nga personat e dënuar për veprat më të lehta penale e deri te ato më të rëndat, shumë herë ka krijuar

<sup>111</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 19.06.2014.

<sup>112</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

<sup>113</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 27.06.2014.

incidente edhe brenda këtyre hapësirave. Nuk janë të pakta rastet kur disa të burgosur kanë pësuar nga njëri tjetri. Ngjarje të tillë tregohen edhe nga vet të burgosurit dhe ka të regjistruara edhe në organet e rendit. Nuk kanë munguar rastet e prishjes së rendit, të lëndimeve trupore deri te ato me lëndime të rënda, vetëvrasjet, posedimi i narkotikëve, armëve, dhunimet, etj, ku “shumë herë ka përzierje të moshave dhe të veprave penale ku personat gjenden në të njëjtën dhomë të burgut, ku edhe kanë pasur probleme mes vete” (D-D-1)<sup>114</sup>, gjë që në të shumtën e rasteve edhe ishte shkas e këtyre incidenteve.

Kështu që, mangësitë ligjore dhe dënimet e gjykatave janë ndër faktorët shtytës, pasi që “edhe paraja luan rol të madh këtu, ai që ka dalë nga burgu pas pak kohe, e tjetri që nuk ka mbetet deri në fund” (D-5)<sup>115</sup>. Këto i dëshmon edhe kjo, ku “ka asi që shkojnë në burg për të dytën apo tretën herë, por ka edhe deri në trembëdhjetë herë që kanë qenë” (D-6)<sup>116</sup>.

### 5.3.3 Institucionet e shtetit

Gjatë intervistave rezulton të kemi shumë mendime dhe vlerësime rreth ‘kontribuuesve’ në kriminalitet, ku njëri nga këta kontribuues vlerësohet të jetë vet shteti përmes institucioneve të veta. Një vlerësim i tillë është se: “Nxitës në shumë raste të kriminalitetit është vet shteti, sepse ka lejuar e lejon gjëra që i detyrojnë të rinjtë të futen në kriminalitet. Duhet të lëvizet diçka që të ndalohen disa nga veprimtaritë që i ka leju shteti të punojnë” (D-D-2)<sup>117</sup>. Pra, përmes këtij vlerësimi, është e nevojshme që institucionet shtetërore paraprakisht t’i analizojnë të gjitha përfitimet që vijnë nga bizneset e tilla, sidomos nga aspekti social dhe ato të mbahen nën kontroll.

<sup>114</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

<sup>115</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014.

<sup>116</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014.

<sup>117</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

Prejardhjen e këtyre dukurive disa e ndërlidhin me ardhjen ndërkombëtarëve në Kosovë dhe menaxhimin e organizimit të shoqërisë dhe të institucioneve. Se ky vlerësim qëndron, e tregon edhe ky mendim i shprehur:

Si faktor nxitës janë që nga ardhja e misioneve të ndryshme në Kosovë, ku persona të ndryshëm kanë sjellur edhe kultura e gjëra tjera, deri të aktivitetet kriminale forma që nuk kanë ekzistuar. Ato nuk janë kontrolluar sa duhet. Disa i kanë legalizuar, si lokalet e natës, ku kanë dhënë leje pune shumë femrave nga shtete tjera, që për shoqërinë tonë kanë sjellur dëme, deri te ndarjet në familje dhe shpenzime të mëdha ekonomike. Pastaj, lojërat e fatit, kazinotë, që sjellin veç shpenzimeve edhe vepra kriminale, si grabitjet, vjedhjet e rënda e deri te vetëvrasjet (D-D-4)<sup>118</sup>

### 5.3.4 Teknologjia

Një nga burimet në shtytje të kriminalitetit është vlerësua edhe zhvillimi i teknologjisë. Kjo teknologji e avancuar është shfrytëzuar nga disa aspekte. Pra, teknologjia e ka bërë të veten, p.sh. filmat e emisionet, domosdo që kanë ndikimin e tyre, pastaj telefonat, rrjetet sociale, etj, janë të favorshme për aktivitete kriminale e të disfavorshme për shoqërinë, sepse po keqpërdoren. Kështu, “zhvillimet e teknologjisë kanë sjellur gjëra të mira, por që shumë herë po keqpërdoren për gjëra të ndryshme e deri në kriminalitet. Kjo po zhvillon krimin duke sjell forma të reja dhe duke krijuar shoqëri mes kriminelëve” (D-L-F-1)<sup>119</sup>.

Për rolin dhe ndikim e teknologjisë thuhet ndër tjera se:

Ka ndikuar, sepse shumë herë ka raste që dëgjoj nga shokët këtu që ata kanë emituar gjëra që i kanë parë në TV apo internet dhe vet i kanë provuar. Sidomos te moshat e reja ndodh që disa emisione në TV dhe përmes internetit të krijojnë interesim për t'u bërë kopje e ndonjë personazhi kryesor negativ dhe sjelljet i tillë i bën në realitet (D-L-M-1)<sup>120</sup>

<sup>118</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

<sup>119</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 25.09.2014.

<sup>120</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

Kështu që ata shumë herë në shoqëri luajnë rolin e shembujve, idhujve dhe idoleve të ngjarjeve dhe dukurive që ata i krijojnë me rastin e ‘miqësimit’ me ta përmes teknologjisë dhe emisioneve të TV-së.

### 5.3.5 Risocializimi

Duke ditur se dhënia e dënameve ka për qëllim risocializimin e individëve të tillë, bazuar në rrëthanat reale kjo vihet në pyetje. Janë të pakta vendet që shërbejnë për këto qëllime. Thuajse të gjitha realizohen vetëm përmes institucionit të shërbimit korrektues, pra nëpër burgje. Këtë e thotë edhe njëri nga të dënuarit, sipas të cilit:

Ka mungesë të institacioneve për risocializim, kështu që vetëm burjet janë aktuale. Jam i dënuar dhe që nëntë vite jam në burg. Në burg ka individë me karaktere të ndryshme, ka raste kur shumë individë bien në depresion dhe përfundojnë keq, po ka raste që përfitojnë përvuja kriminale nga të tjerët dhe krijojnë lidhje. Pra, burgu nuk është aq vend risocializues. Kemi shumë të dënuar që janë recidivistë (D-D-3)<sup>121</sup>

Se burgu nuk është vend risocializimi e mbështet edhe fakti se aty ka individë, të cilët shkojnë si recidivistë dhe atë edhe me dhjetëra e qindra herë. Sipas të dhënave nga organet e rendit në Gjakovë, shihet si disa persona janë të dyshuar edhe për mbi 160 raste, gjë që e vërtetojnë edhe disa nga të anketuarit e dënuar, duke thënë: “kemi mungesë të institacioneve sociale, sepse burgu nuk po kryen rolin risocializues, pasi që shumë herë të njëjtë persona vijnë për vepra të njëjta apo edhe për tjera” (D-L-F-1)<sup>122</sup>. Për mosefektin e risocializimit gjatë qëndrimit në vuajtjen e dënimit nëpër burgje kemi këto shprehje nga ata që i kanë përjetuar:

Gjatë kohës në burg takohemi me të tjerë dhe i këmbejmë përvojat mes vete dhe këto janë nxitëse për të ardhmen. Shumë herë mësojmë forma për vepra penale tjera. Bile jemi bërë shokë dhe pas lirimt kemi kryer bashkë aktivitetet tjera kriminale (D-L-M-2)<sup>123</sup>

<sup>121</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

<sup>122</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 25.09.2014.

<sup>123</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

Kam takuar individë që kanë kryer grabitje, vrasje me pagesë, dhunime, me droga, bile disa nga ata ishin për të dytën herë e deri për të trembëdhjetën herë. Gjatë vuajtjes së dënimit në burg, rreth 70% të kohës e kam kaluar me hajdutë profesionalista. Njeriu merr njëfarë shkolle prej tyre. Ata dalin edhe më profesionistë dhe shumë më të fortë, sa as me kryer kriminalistikën më shumë nuk profesionalizohen. Në burg i fusin bashkë në një thes si të mirin (kundërvajtje trafiku, shënim i autorit) si të keqin (kryes të veprave të rënda penale, shënim i autorit). Aty hyjnë armët, celularët, droga dhe kështu vijnë incidentet me pasoja edhe brenda në burg (D-6)<sup>124</sup>

Mungesa e këtyre institucioneve reflekton pasiguri për shoqërinë, ngase personat ‘problematik’ shumë herë janë edhe agresiv në rrethana të caktuara. Së pari, një kategori prej tyre, kur kanë nevojë për ‘furnizim’ duhet t’i sigurojnë mjetet materiale dhe gjatë kësaj kohe ata mund të viktimidizojnë këdo dhe në çfarëdo mënyre derisa t’i sigurojnë ato dhe së dyti, disa duhet të jenë të ‘izoluar’ në periudha të gjata nga shoqëria, sidomos ata me probleme mendore. Bazuar në pohimin se “momentalisht nuk ka asnjë institucion që merret me këto raste, përveç neuropsikiatrisë dhe ndonjë psikologu” (Q-N-10)<sup>125</sup>, shihet e nevojshme që sa më parë të ndërmerren masat për krijimin e tyre.

Edhe pse janë jetike për një shoqëri demokratike, mungesa e tyre është evidente në këtë shoqëri. Njëjtë qëndron edhe Gjakova, veç një reparti në spitalin rajonal të qytetit, nuk ka asnjë vend tjetër. Sipas njërit prej mjekëve, kjo ka trajtuar dhe trajton shumë persona të tillë dhe te disa ka pasur sukses (Q-I-5)<sup>126</sup>. Këtë e pohon edhe një prej të trajtuarve, sipas së cilis ka pasur sukses dhe është i kënaqur me trajtimin (D-1)<sup>127</sup>, mirëpo vetëm kjo, me kushtet aktuale, nuk i plotëson as për së afërmri nevojat dhe kërkesat që vijnë nga personat e tillë.

Andaj, mungesa e institucioneve për rehabilitim si, në disa raste dhuna në familje, kushtet ekonomike dhe mos trajtimi social i institucioneve shtetërore është faktor.

<sup>124</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014.

<sup>125</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>126</sup> Intervistë me qytetarin: emri konvencional dhe numri, 01.08.2014.

<sup>127</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 01.08.2014.

Mirëpo në shumicën e herëve femrat i shtyjnë interesat personale për t'u marrë me krim. Këtë e bëjnë për të bërë emër dhe nganjëherë për përfitime personale (D-L-F-1)<sup>128</sup>. Tek disa individë arrihet qëllimi i risocializimit, sepse janë kushtet e mira. Por tek disa ndodhë e kundërtë. Ka raste kur vijnë për të tretën apo të më shumë herë, bile kanë krijuar shoqëri dhe kryejnë aktivitete kriminale bashkë (D-L-M-3)<sup>129</sup>

Kështu që, vuajtja e dënimive pa kategorizim të veprave, ndodh që gjatë vuajtjes së dënimit personat të profesionalizohen për krime, ajo që nuk respektohet është ndarja e kategorive të të burgosurve, p.sh. për aksident trafiku apo kundërvajtje rrinë bashkë me të dënuarit për krime të rënda. Mendoj se depresioni i madh te disa individ që përjetojnë në burg dhe problemet familjare po sjellin vetëvrasjet brenda në burg. Duhet të bëhet një kategorizim i mirëfilltë i personave. Ngjan që brenda në burg të përdoret edhe droga dhe veprime kriminale të tjera (D-D-4)<sup>130</sup>:

#### **5.4 Motivi shtytës në dukuritë kriminale**

Andaj, bazuar në rrethanat reale, rezulton se në njëren anë ndryshimi nga mënyra e organizimit si shoqëri demokratike dhe prurjet e reja kulturore, dhe në anën tjeter gjendja e dobët ekonomike në raport me të kaluarën, ishin mundësi potenciale për paraqitjen e dukurive të reja. Dukuritë e tillë në disa rrethana u ‘shfrytëzuan’ edhe për aktivitete kriminale dhe në disa tjera ishin faktorë nxitës të kriminalitetit.

Disa nga autorët e veprave kriminale tregojnë se shkaktar nganjëherë dinë të jenë edhe arsyet e tjera, si: kureshtja, dominimi mbi rrëthin, paraqitjet si heronj, etj. Ekzistimin e këtyre arsyeve e tregojnë disa nga mendimet dhe përjetimet konkrete të shprehura kështu:

<sup>128</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 25.09.2014.

<sup>129</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

<sup>130</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

Ndër tjera është edhe kureshtja. Pra, shumë të rinj, thjesht nga kureshtja thonë ‘hajt ta përdorim edhe ne këtë lloj droge’ (D-2)<sup>131</sup>


Thjesht kureshtja për ta provuar. Edhe shoqëria mund të ndikojë, është një hap më tepër, por mua më ka shtyrë kureshtja (D-1)<sup>132</sup>

Në pjesën më të madhe këto vijnë për shkak të asaj që me qenë në qendër të vëmendjes dhe për të dominuar mbi rrithin.

Janë shumë rrethana, po në shumë raste duke pretendua me qenë mbi shokun dhe të tjerrët, të rinjtë përmes aktiviteteve kriminale mundohen të paraqesin veten si heronj (D-L-M-1)<sup>133</sup>

Bazuar në të dhënat nga terreni, pjesa e madhe e dukurive nxitëse kriminale pranohen nga dyja tipat e mostrave. Duke u bazuar në gjendjen e dobët ekonomiko-sociale, te pjesa më e madhe e kësaj treve, trendi i kriminalitetit del të mos jetë varfëria. Këtu motivi kryesor i kriminalitetit ka të bëjë përfitime personale dhe pjesërisht për nevoja sociale.

*Diagrami 48. Motivi shtytës i shkeljes së ligjit*



Të dhënat në fjalë janë nxjerrë nga analiza e pyetësorëve, por këto edhe më tej i sqarojnë gjatë interviewave. Kështu, sipas tyre, thuajse të gjitha aktivitetet kriminale rezultojnë të kryhen përfitime personale dhe argëtimin e tyre, gjë që e dëshmon edhe

<sup>131</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 24.06.2014.

<sup>132</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 01.08.2014.

<sup>133</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014.

kjo shprehje: “për përfitim personal, të gjithë i kryejnë për interesa të veta e jo për familje. P.sh. grabitim e pastaj shkojmë dhe i shesim dhe me to marrim droga e bëjmë punë të pista” (D-L-M-2)<sup>134</sup>. Kjo tregohet edhe nga ky vlerësim: “Kam qenë i arrestuar dhe i dënuar për aktivitete kriminale. Arsyja ka qenë për përfitime personale. Unë dhe shokët kemi dashur të vijmë sa më shpejtë te fitimi” (D-7)<sup>135</sup>. Kjo shkon edhe më larg, pra “ka pasur raste që dikush është paguar për vrasje dhe pasi është liruar, ka bërë prapë një gjë të tillë vetëm për përfitime” (D-5)<sup>136</sup>.

## 5.5 Parandalimi

Që këto dukuri të reja kriminale të mund të parandalohen, është e nevojshme që të angazhohet në tërësi shoqëria, duke filluar nga familja, shkolla, mjedisi e deri te institucionet shtetërore dhe organizatat e ndryshme qeveritare e joqeveritare.

Bazuar në hulumtimin në terren rreth parandalimit të dukurive kriminale, që janë risi për shoqërinë e kësaj treve, rezulton se një prej faktorëve kyç është roli i familjes, i cili, krahasuar me traditën e së kaluarës, tani është zbehur dhe nuk është në nivel. Familja shqiptare e kësaj treve shquhej për traditat dhe përmes kësaj i kontribuonte një rendi e rregulli shoqëror. Nga fëmija më i vogël e deri të kryefamiljari dinin detyrat dhe obligimet e veta. I ngjante një ‘mini shteti’, ku secili i kryente me përgjegjësi të madhe detyrat e veta. Rregulli familjar respektohej dhe për cilatdo rrethana dihej kush merrte vendimin. Gjithmonë ekzistonte ‘droja’ që të mos turpëroheshin para tjereve, frikë më të madhe se sa nga vet ligjet. Mirëpo, në rrethanat aktuale të zhvillimit modern, familja e ka humbur këtë ‘fuqi’. Këto rrethana kanë ndryshuar rendin, duke bërë që secili nga anëtarët e familjes sot të jetë i pavarur dhe të vendosë sipas të ‘drejtave’ e tekeve të

<sup>134</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 30.09.2014

<sup>135</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 27.06.2014

<sup>136</sup> Intervistë me të dënuar, numri, realizuar në qytet, 28.06.2014.

veta. Shumë herë këto të drejta i kanë dërguar në rrugët e gabuara të jetës. Andaj, “rrethanat e reja, të sjella nga jashtë e kanë krijuar një rrethanë të re, ku nuk është ai bashkimi familjar dhe se këtu mungojnë shumë herë edhe mësimet për të rinjtë rreth traditës shqiptare” (D-D-4)<sup>137</sup>.

Mungesat e tillë edukuese dhe avancimet e kohës kanë sjellë shumë avantazhe te individët, që shumë herë edhe tejkalojnë rrethanat reale dhe cilësitë civilizuese. Këto vlerësohen jo mirë edhe nga shumë anketues, ndër të cilat thuhet se “nuk është e drejtë që një femër e re apo grua, të dalë në orët e vona të natës nëpër lokale deri në orët e hershme të mëngjesit” (D-L-F-1)<sup>138</sup>.

Transformimi i tillë i familjes shqiptare të kësaj treve dhe pasojat e sjelljeve devijante, veç familjes, ndikojnë edhe në shoqëri. Edhe pse vërtetë duhet përcjellë trendin e zhvillimeve të shoqërisë, është shumë e rëndësishme që kjo të bëhet konform rrethanave reale. Për të pasur një transformim të mirëfilltë dhe në hap me rrethanat e kohës është e rëndësishme edhe normimi i rregullave shoqërore dhe funksionimi i institucioneve shtetërore. Përmes këtyre mund të bëhet edhe organizimi i shoqërisë duke minimizuar sjelljet devijante dhe shfaqjen e dukurive kriminale. Pra, parandalimi duhet të reflektojë edhe nga institucionet shtetërore dhe organizatat e ndryshme që veprojnë. Sipas të dhënave nga terreni dhe vet ekspertët, rezulton se në Gjakovë me rrëthimin nuk ka institucione të mjaftueshme për trajtimin dhe rehabilitimin e personave devijant. Pjesës më të madhe të personave të përfshirë në dukuritë kriminale u mbetet që të rehabilitohen nga institucioni i ndëshkimeve, pra nga burgu.


---

<sup>137</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 23.09.2014.

<sup>138</sup> Intervistë me të dënuar: emri konvencional i institucionit korrektues dhe numri, 25.09.2014.

Një situatë e tillë, në raport me numrin e madh të nevojave që dalin nga gjendja reale, as për së afërmë nuk mund t’iu përgjigjet kërkesave reale. Andaj, kjo sjellë edhe shqetësimin tjetër, sepse personat që nuk iu nënshtrohen trajtimeve të nevojshme janë rrrezik potencial për sigurinë e tjerëve dhe si model për moshat e reja (shih diagr. 48).

*Diagrami 49. Kush duhet të merret me parandalimin dhe luftimin e dukurive kriminal*



Vlerësimet dëshmojnë se për parandalimin dhe tejkalimin e dukurive kriminale, sidomos këtyre që nuk janë në traditën dhe kulturën e kësaj treve, është domosdoshmëri që të veprojnë shoqëria dhe institucionet shtetërore. Bazuar në këto, del se për t'u bërë një parandalim i këtyre dukurive të tilla kriminale, është i pashmangshëm një bashkëpunim mes familjes, shoqërisë dhe institacioneve shtetërore. Kur kjo të funksionojë, me siguri se efekti do të sjellë edhe rezultatin e duhur dhe më se të nevojshëm. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt edhe në krijimin e stabilitetit të shoqërisë në fushën e sigurisë.

Mungesa e një koordinimi të mirëfilltë mes shoqërisë dhe institacioneve shtetërore, kur dihet se janë pikërisht dy faktorët që po mundësojnë krijimin e hapësirave, ashtu që

dukuritë kriminale po zënë vend, do të sjellë një vetëdijesim mbi rëndësinë që ka eliminimi i këtyre dukurive dhe ruajtja e vlerave shoqërore, kaq të lakmueshme dhe të lartëngritura nga të huajt, të cilët mahnitën me karakteristikat e popullit shqiptar, në veçanti ato të rajonit të Gjakovës. Pikërisht për këtë arsyе nevojitet një punë e madhe në ç'rrënjosjen e këtyre dukurive përmes bashkëpunimit të të gjithë të përfshirëve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, sepse vetëm kështu do të ruhen vlerat dhe parimet që shoqërinë e kësaj ane e bëjnë të jetë kaq e veçantë.

## **KAPITULLI VI: PËRFUNDIME, VLERËSIME DHE REKOMANDIME**

### **6.1 Implikimet teorike dhe rekomandime për studime të ardhshme në këtë fushë**

Shoqëria kosovare, me theks të veçantë ajo gjakovare, gjatë periudhës 1999-2012 është përballur me një evoluim të madh zhvillimor, që vlerësohet një prej zhvillimeve revolucionare brenda kësaj shoqërie. Dalja nga një sistem i mbyllur e vet izolues dhe përqafimi i sistemit të hapur demokratik për këtë shoqëri përbën hapin më të rëndësishëm në drejtim shoqërive më të zhvilluara demokratike. Kjo hapje, ndër tjera, mundësoj transformimin nga sistemi patriarkal tradicional në atë modern.

*Periudha transformuese* dhe rrugëtimi drejt *modernizimit* domosdo që u përballë me shumë sfida dhe atë nga më të ndryshmet. Ky udhëtim shoqërinë e kësaj treve e preku në të gjitha sferat e saj, si në atë politike, ekonomike, sociale dhe teknologjike, duke sjellë shumë ndryshime. Rrethanat nëpër të cilat iu imponua të kalojë drejt modernizimit dhe reformat e njëpasnjëshme në këtë drejtim shumë herë sollën edhe dukuri të reja, sidomos në aspektin social. Modeli demokratik i dha hapësirë dhe liri individit, duke përmbysur konceptet tradicionale. Në disa raste ky reformim krijoj edhe hapësira sociale, pasi që trendi i zhvillimit disa herë tejkalonte mundësitë reale të kësaj shoqërie.

Gjatë kësaj faze tranzitore të *modernizimit*, sidomos liria individuale dhe hapësirat sociale dhe specifikat tjera në ndërtimin e institucioneve vendore shtetërore, të udhëhequra nga faktori ndërkombëtar, u përballuan edhe me probleme, që ndërlidheshin me këtë proces të komplikuar. Avancimet në disa fusha, si politike, ekonomike dhe teknologjike nuk përshtateshin me ato sociale apo edhe me parimet morale të kësaj treve. Pikërisht kjo bëri që shoqëria të përballet me sfida të shumta dhe atë deri në

rrezikim të *identitetit*, të cilin e kishte ruajtur me fanatizëm shkuj me radhë, që nga Lashtësia.

Rrethanat e tillë gjatë kësaj periudhe mundësuan asgjësimin e bindjes moniste politike, duke sjellë lirinë e shprehjes dhe të veprimit, por që në anën tjetër sollën edhe paraqitjen e dukurive të reja sociale dhe atyre në fushën e *kriminalitetit* të panjohura më parë. Individë dhe grupe të ndryshme shfrytëzuan disa zbrazëti dhe panjohuri të institucioneve në themelim e sipër dhe të vet shoqërisë, duke sjellur risi të reja, kinse kultura e civilizim nga vendet e zhvilluara, dhe atë përmes veprimitarive ekonomike e të biznesit. Në njëren anë ata shfrytëzuan gjendjen e dobët ekonomike të kësaj treve dhe në tjetrën, mungesën institucionale e normative, duke qenë të përkrahur nga ndërkombëtarët. Kjo krijoj një jetë tërësisht më ndryshe, sidomos nga aspekti moral dhe social. Janë këto që mundësuan edhe shfaqjen edhe të dukurive të reja kriminale.

Kësisoj del se periudha e *tranzicionit* dhe *transformimit* social-kulturor kishte sjellë mjaft dukuri të reja sociale dhe kulturore në shoqërinë gjakovare, madje dukuri që nuk kishin reflektuar asnjëherë më parë. Ndër prurjet e reja sociale dalin të jenë “bizneset” nga puna me lokalet e natës, lojërave të fatit, kërkimi i lëmoshës, bashkëjetesa, trendi i divorceve, stili i veshmbathjes etj.

Janë të shumta dukuritë e reja sociale dhe ato kriminale që përballet kjo trevë. Kështu, në emër të rritjes së ekonomisë dhe bizneseve janë hapur shumë lokale ‘nate’; pastaj të lojërave të fatit; grabitjet me maska e armë nëpër rrugë dhe brenda në familje; vjedhjet grabitqare tek femrat dhe moshat e vjetra, të cilat kanë sjellë pasoja të mëdha shoqërore, në aspektin moral, ekonomik dhe atë social. Kjo vjen si rezultat i lirisë së individit, duke lënë anash konceptet e përbashkëta tradicionale, por që i kontribuojnë dukurive

negative. Në anën tjetër, këto janë faktorë shumë i rëndësishëm në mundësimin e paraqitjes së aktiviteteve kriminale dhe atë si dukuri që më parë nuk kanë ekzistuar brenda kësaj shoqërie. Janë këto që pushtuan shoqërinë e kësaj treve, e që edhe në periudhat e rrethanat më të vështira politike e ekonomike përmes moralit dhe solidaritetit i kishin sfiduar.

Andaj, prurjet e reja social-kulturore kanë shërbyer edhe si shkas i paraqitjes së dukurive të reja edhe në fushën e kriminalitetit, madje duke qenë shumë shqetësuese për qytetarët dhe duke krijuar një pasiguri për jetën dhe pronën e tyre.

Bazuar në dukuritë e reja social-kulturore dhe në ato kriminale, rezulton se këto janë reflektimi tërësisht të reja dhe që dallojnë në raport me traditat dhe kulturën e këtij rajoni. Derisa përmes traditave organizohejjeta nga kolektiviteti, respekti, sidomos ndaj anës morale dhe humanitare, ishte i domosdoshëm, ngase ‘dënimet’ nga vet rrathi konsideroheshin më të rënda se nga normat ligjore, të rejat sjellin risi që në aspektin social dalin të jenë më të dëmshme dhe më të rrezikshme për individin dhe për vet shoqërinë. Kjo prurje, veç problemeve sociale, shumë herë ndërton edhe elementet e veprës penale dhe krijon kriminalitet. Domosdo që kjo ka ndikuar edhe në destabilitetin shoqëror dhe atë në të gjitha aspektet e jetës, por me theks të veçantë në atë social dhe të sigurisë.

Duke iu referuar të dhënavë të gjatë punës kërkimore, bazuar mbi hipotezën e ngritur, rezulton se gjatë riorganizimit të shoqërisë gjakovare, prurjet e reja në aspektin social-kulturor kanë sjellë po ashtu dukuri të reja kriminale që nuk i përkasin traditave të kësaj treve, me të cilën gjë e vërteton hipotezën e ngritur.

Përfundimisht, rrethanat e reja të diktuara nga riorganizimi i proceseve të përshpejtuara dhe jo në hap me realitetin kanë mundësuar ekspozimin e kësaj shoqërie ndaj rreziqeve të botës moderne, duke bërë që kjo tronditet nën përjetimin e shumë dukurive sociale, të cilat thuajse po bëjnë ndërrimin e personalitetit dhe të shoqërisë pikërisht me përqafimet e kulturave tjera duke shpërbë tërësisht kulturën tradicionale. Andaj, kjo është edhe arsyaja se sot ndër lajmet e para dalin problemet shoqërore të atakuara me dukuritë kriminale, si: grabitje, dhunë në familje, divorce, kërkim lëmoshe, tradhti bashkëshortore, shpërthime nga mjete eksplozive, fëmijë të braktisur, persona të zhdukur etj.

Pra, është shumë e rëndësishme që vlerat e sistemit modern të reflektojnë në hap me realitetin shoqëror dhe periudha e tranzicionit të jetë më e shkurtër, që t'iu shkurtohet jeta dukurive dhe aktiviteteve të shumta kriminale. Kjo ndikon edhe në stabilitetin e shoqërisë dhe të shtetit.

## 6.2 Vlerësime

Duke iu referuar këtij transformimi dhe periudhës tranzitore që e ka përcjellë shoqërinë e Gjakovës me rrithinë, del se kjo është përballur dhe vazhdon edhe më tej të sfidohet me shumë nga dukuritë e reja sociale dhe ato kriminale. Dukuritë e reja janë si rezultat i ndryshimit të politikave, qoftë riorganizuese, e po ashtu edhe të atyre ekonomike e sociale.

Ndryshimet në fjalë kanë ndikuar edhe në situatën e sigurisë së vet shoqërisë, e cila vlerësohet të jetë shumë shqetësuese për ta. Shqetësimi vjen për arsyet e aktiviteteve të ndryshme kriminale që janë prezente gjatë kësaj periudhe. Shumë prej këtyre rezultojnë të janë të reja, por edhe disa nga të ‘kaluarat’ janë më ndryshe tanë dhe njëkohësisht më

të frikshme. Kështu, edhe vrasjet e kësaj kohe janë shumë më të frikshme, kryhen në vende publike, madje pa përzgjedhur saktë ‘prenë’, pastaj në prezencë të anëtarëve të familjes, me maska dhe të paguara. Edhe grabitjet e pronës paraqesin shqetësim dhe rrezik për shoqërinë, ngase nuk kursejnë as moshë e as gjini. Janë evidente thuajse në çdo kohë, natën dhe ditën, kryhen me maska e me armë, madje jo vetëm ne vende publike e private, por edhe brenda në familje dhe atë në prezencë të të gjithë anëtarëve. Ky shqetësim dhe pasiguri ka shtyrë që qytetarët t’i drejtohen edhe policës me kërkesa për prezencë më të shtuar në terren.

Natyrën e rrezikshme të këtyre aktivitetave e potencjojnë edhe vet autorët e disa prej këtyre veprave kriminale, që del të jetë rrezik edhe për ata, por njëkohësisht edhe për shoqërinë. Për ata rreziku vjen nga vet natyra e veprës dhe nga i dëmtuari, ndërsa për shoqërinë ka të bëjë se autorët janë të gatshëm të dëmtojnë këdo që u del përpara për t’i penguar.

Prirja e aktivitetave kriminale gjatë kësaj periudhe është risi e re, që nuk përket aspak me traditën dhe kulturën e shoqërisë së kësaj treve. Kjo vjen si rezultat i politikave zhvillimore dhe sociale të diktuara dhe mbështetura edhe nga faktori ndërkombëtar si dhe nga reflektimi institucional vendor. Duke iu referuar këtyre kemi paraqitjen e këtyre dukurive sociale: hapja e lokaleve të natës, hapjen e lojërave të fatit, bastore e kazino, kërkimin e lëmoshës, vetëvrasjet, dhe usurpimi i pronave.

Këto dukuri të reja apo të modifikuara, përveç që në vetvete përmbanin aktivitete kriminale, ato shërbyen dhe ishin indikatorët kyç edhe në paraqitjen e aktivitetave tjera kriminale. Kështu, duke iu referuar këtyre dhe analizave të të dhënavë, dukuritë e reja kriminale janë rrjedhojë me sa vijon:

*Lokalet e ‘natës’ - fillimisht janë një risi për ekonominë dhe biznesin në këtë trevë, që bie ndesh me normat morale të traditës, dhe në anën tjetër mundësuan trafikimin e qenieve njerëzore dhe të prostitucionit, fillimisht me femrat e trafikuara nga vendet e huaja. Kjo solli edhe dukurinë e re, ku në këto lokale filluan të punojnë edhe femra nga kjo shoqëri, qoftë duke u keqpërdorur apo edhe për biznese të tyre. Puna e këtyre lokaleve ishte shkaktar edhe i shumë aktiviteteve tjera kriminale, si: dhunës në familje, divorceve, personave të zhdukur, pasojat sociale të së cilave janë të mëdha. Kulmi i të gjitha këtyre paraqitet kur me femrat e tillë lidhen martesat dhe krijojnë familje, duke u ndarë nga bashkëshorti/bashkëshortja dhe fëmijët, apo edhe duke e shfrytëzuar gruan apo të dashurën për qëllime të tillë.*

*Lojërat e fatit – të modifikuara dhe të pakontrolluara nga shteti, ku si rezultat i tyre paraqiten disa aktivitetet kriminale, si: grabitjet, dëmet materiale, dhuna në familje, divorcet, fajdetë, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm apo sulme me mjete shpërthyese dhe eksplozive, humbjen e pasurisë, substancat narkotike dhe vetëvrasjet. Disa nga aktivitetet kriminale ndërlidhen mes vete, duke u nxitur nga njëra-tjera. Kështu, për të ardhur deri te lojërat e tillë apo përdorimi i narkotikëve kërkohen edhe mjete materiale, ku në mungesë të tyre, autorët kryejnë vepra kriminale tjera, si: vjedhje të rënda, grabitje, pastaj kemi persona të vdekur nga mbidozat etj. Pjesa e madhe e këtyre aktiviteteve nuk i përkisnin traditave të kësaj treve dhe se paraqitja e tyre përbën rrezik të madh për shoqërinë dhe me shumë dëme materiale. Nuk kanë munguar as problemet mes kompanive të këtyre lokaleve, ku në shenjë hakmarrje iu kanë kundërvënë njëri tjetrit në forma kriminale.*

*Kërkimi i lëmoshës – një dukuri që nuk ka qenë prezente, ngase ky popull ishte i njohur për solidaritet. Mirëpo, kjo tanë del të kryhet me qëllime tjera, kryesisht përfitime*

kriminale, ku në pjesën më të madhe të ‘shtrirësve të dorës’ qëndrojnë individë dhe grupe të caktuara kriminale. Nuk mungojnë rastet kur kërkohen ndihma në emër të personave të sëmurë apo për ndihma solidare, por që prapa këtyre qëndrojnë mashtruesit, që ato mjete i përvetësojnë dhe ‘zhduken’ më pastaj. Në aspektin social kjo më së shumti vjen si rezultat i zbehjes së funksionit të familjes.

*Vetëvrasjet* – paraqesin një dukuri shqetësuese dhe në rritje në këtë shoqëri. Nuk kursejnë moshat dhe gjininë, të pasurit e as të varfëritë. Nuk mohohen rastet kur janë të shtyrë nga gjendja e krijuar gjatë marrjes me aktivitete kriminale, por edhe nga mospajtimi i gjeneratave lidhur me rrëthanat e reja të krijuara. Po ashtu, ato reflektojnë edhe rastet stresuese të fituara nga periudha e luftës, kjo te moshat që kanë ndier peshën e saj, si dhe të stresit për t'u përballur me sfidat e reja të jetës. Të pranishme duket se janë vendimmarjet e të rinxve për një gjë të tillë dhe atë vetëm pse nuk mund të realizojnë dëshira të një adoleshenti. Rrëthanat e tillë të krijuara në të shumtën e herëve janë shkaktari kryesor që dërgojnë në vetëvrasje.

*Uzurpimi i pronave* – dukuri sociale dhe kriminale e re në këtë trevë. Derisa në të kaluarën shquhej për tolerancën ndaj pronave të huaja, sot del të jetë mjaft aktiv, ku nuk kursehen pronat shoqërore dhe as ato private, edhe pse dihet kujt i takojnë. Si rezultat i kësaj dukurie, kemi paraqitje të aktiviteteve kriminale, si: dëmtimet e pronave të huaja, sulme me mjete shpërthyese e eksplozive e deri te vrasjet.

Këtyre dukurive kriminale ndihmesë të madhe iu kanë dhënë edhe reflektimi institucional shtetëror dhe të arriturat teknologjike.

*Institucionet shtetërore* – mungesat e institacioneve të tillë gjatë periudhës së transformimit dhe fazës së tranzicionit u shfrytëzuan nga individë dhe grupe të

ndryshme kriminale. Kjo mungesë mundësoj prurjet e reja sociale dhe kriminale. Prania e shumë misioneve ndërkombe tëtare dhe individëve që drejtonin institucionet e përkohshme shtetërore, ndër tjera, mundësuan hapjen e lokaleve të natës. Kështu, lejimi i hapjes së lokaleve të natës dhe lejet e lëshuara për femrat e huaja, kinse për të shërbyer në ato lokale, ndihmoj ‘legalizimin’ e prostitucionit dhe të trafikimit, të cilat edhe ishin të ndaluara me ligj. Pastaj, hapja e lojërave të fatit pa respektuar ligjin dhe pa kontrollim nga institucionet, është faktorë nxitës i shumë aktiviteteve kriminale. Disa nga këto lokale vazhdojnë aktivitetin apo edhe fillojnë punën edhe pas instalimit të institucioneve dhe kodifikimit të normave ligjore, që i ndalojnë në parim. Pra, sistemi i menaxhimit të filluar nga ndërkombe tarët e që nuk ishte në hap me realitetin e kësaj shoqërie, vazhdoj edhe me ndërtimin e institacioneve vendore.

Në anën tjetër, kthimi i personave nga shtetet e ndryshme, të cilët vinin me një të kaluar kriminale, organet e rendit asnjëherë nuk janë njoftuar me dosjet e tyre për të pasur një kontrollë ndaj tyre. Shumë nga ata kanë vazhduar të njëjtat aktivitete dhe atë dukë krijuar rreth të gjërë e duke shpërndarë përvojën tek te tjerët.

*Mangësitë ligjore* - transformimi shoqëror dhe prurjet e reja sollën dukuri të papranuara për shoqërinë, por mos normimi i tyre bënte që ato të jenë prezente në shoqëri. Për këtë qëllim pati disa herë ndryshime në legjislativin e Kosovës. Mirëpo, shumë herë edhe ato norma që ishin të sanksionuara me ligjet e aplikuara në Kosovë, mosfunkcionimi i ligjit si duhet dhe barabartë për të gjithë bëri që ai të mbetët vetëm në letër, dhe duke mos ndikuar në parandalim. Madje, nga disa vlerësohet se ligjet e deritanishme asnjëherë nuk kanë qenë në hap me realitetin e rrëthanave shoqërore, por kanë qenë në interes të autorëve që kanë shkelur ato. Kësaj i shtohet edhe dënim i dhënë nga gjykatat, për të cilat del se nuk janë të kënaqur qytetarët. Edhe pse janë të pakta rastet e dënimive në

raport me veprimtaritë kriminale, shumë prej tyre nuk mbahen deri në fund. Ajo që është edhe më nxitëse, mjete e fituara nga veprat kriminale nuk iu kanë kthyer të dëmtuarve, por u kanë mbetur kryesve, pra ata vetëm janë dënuar për veprën.

Pra, përpjekjet e vazhdueshme për identifikimin e natyrës së prejardhjes së dukurive kriminale dhe natyrës së personalitetit të aktorit të veprave të tilla penale janë të shumta dhe në vazhdimësi; lufta kundër tyre po bëhet gjithnjë e më tepër atraktiv dhe më i përsosur: thuajse çdo ditë përgjohen, hetohen dhe arrestohen subjekte të tillë dhe kjo synon të ndikojë në arritjen e efekteve të duhura. Megjithatë, ligjet e zbatueshme në Kosovë, që nuk pasqyrojnë realitetin ekzistues, si dhe mungesat e disa ligjeve dhe moszbatimi në kohë i sanksioneve penale ndikojnë ndjeshëm në inkurajimin e mëtejshëm të shumë aktiviteteve kriminale

*Mungesa e institucioneve rehabilituese* - është një faktorë që ndikon në dukuritë e aktiviteteve kriminale. Në Kosovë, posaçërisht në Gjakovë, ka mungesë të institucioneve të tilla. Kështu, thuajse të gjithë të dënuarit rehabilitimin dhe risocializimin e kryejnë vetëm nëpër institucionet e shërbimit korrektues, pra nëpër burgje. Për pjesën më të madhe, vuajtja e dënimit jo vetëm që nuk ndikon në risocializim, por shumë herë aty fitohen përvoja të reja. Këtë e dëshmon edhe ajo se ka individë të shumtë që me qindra herë kryejnë krime dhe me dhjetëra herë shkojnë nëpër burgje. Këtë ‘profesionalizim’ e zhvillojnë politikat e shërbimeve korrektuese, që nuk bëjnë analiza konkrete për rolin dhe ndikimin e tyre te të dënuarit. Ndaj, edhe nuk janë të pakta edhe incidentet brenda vet këtij institucioni. Në rajonin e Gjakovës ekziston vetëm një repart në spitalin rajonal që merret me trajtimin e narkomanëve, që në raport me numrin nuk i plotëson nevojat as përsë afërmi. Po ashtu gjendet edhe një ‘shtëpi e

sigurtë’ që merret me viktimat e dhunës në familje, e që menaxhohet nga një organizatë joqeveritare.

*Zhvillimi i teknologjisë* – është një nga burimet nxitëse në aktivitetet kriminale dhe atë në shumë mënyra. Arritjet teknologjike nga një pjesë e madhe e individëve dhe grupeve keqpërdoren. Ato fillojnë me mundësimin në qasje në emisione dhe programe degjeneruese, pastaj telefonat dhe rrjetet sociale që shfrytëzohen për aktivitete kriminale dhe bashkëpunim mes grupeve dhe atë shumë herë duke iu shmangur edhe ndjekjeve nga organet e rendit. Po ashtu, përmes këtyre shumë individë, sidomos mosha të reja, kanë krijuar idol nga programet e ndryshme dhe veprimet e tillë i imitojnë në praktikë apo edhe përfitimi i ‘mjeshtërise’ kriminale përmes emisioneve të tillë.

*Motivi shtytës* - marrje me dukuritë e reja sociale dhe ato kriminale është si rezultat i përfitimeve personale dhe shumë pak nga gjendje e dobët sociale. Në anën tjetër, aktivitetet e tillë iu kanë qasur nga kureshtja, me qëllim dominimi ndaj tjerëve dhe paraqitja si heronj apo edhe nga imitimet dhe idolët e ‘fituar’ nga programe të ndryshme.

Shoqëria njerëzore, që nga lindja e saj, është përballur dhe vazhdon të sfidohet nga aktivitetet kriminale. Sot, siguria nuk është vetëm përgjegjësi e organeve dhe shërbimeve zyrtare, por problemet e sigurisë duhet të jenë në qendër të interesimit të një serë shoqatash të pavarura dhe të vetë qytetarëve. Është e kuptueshme se kundërvënia *kriminalitetit*, sidomos ajo preventive, duhet të ketë në themel të konceptit programor faktin se kriminaliteti nuk mund të vështrohet vetëm si problem që ka të bëjë me sjelljen e individit apo të grüpuit kriminal, por si problem që ka të bëjë me shoqërinë globale. Pra, trajtimi i problemit duhet të jetë jo vetëm juridik por edhe shoqëror.

## **6.3 Rekomandimet për institucionet shtetërore, të sigurisë dhe organizatave shoqërore**

- ❖ Parandalimi i aktiviteteve kriminale dhe dukurive negative sociale të fillojë nga familja dhe mjediseti dhe jo të pritet vetëm nga organet e rendit dhe institucionet e tjera. Duke ditur se këto dy institucione janë të parat që përballen me sjelljet devijante të individëve dhe me vendet që i joshin ato aktivitete, të ndërmarrin masat që u takojnë atyre dhe në pamundësi të evitimit, të kërkojnë mbështetje nga institucionet tjera
- ❖ Institucionet shtetërore të hartojnë politika zhvillimore për shambahien e dukurive joshëse dhe nxitëse në aktivitete kriminale. Të veprojnë në bazë të interesave shoqëror dhe jo të atyre individual. Shërbimet qytetare të janë të kontrolluara dhe të mbikëqyrura në çdo kohë dhe të marrin masat rigorozë për cilëndo shkelje. Secili ‘biznes’ të plotësojë standartet e duhura, sidomos në aspektin e sigurisë
- ❖ Institucionet shtetërore të organizojnë emisione edukative e familjare përmes ekspertëve të lëmive të ndryshme në identifikimin e sjelljeve të para devijante që shpijnë në aktivitete kriminale dhe dukuri të tjera sociale me pasoja shoqërore
- ❖ Ndërtimi i një legjislativi të mirëfilltë dhe funksional në raport real me rrethanat shoqërore. Implementimi i tij të jetë me standarde të njëjtë për të gjithë shkelësit e ligjit. Po ashtu, përvèç shqiptimeve të dënimit për veprën e kryer, të veprohet edhe për kthimin e pasurisë së fituar në mënyrë të kundërligjshme
- ❖ Institucionet shtetërore të ndërtojnë institucione rehabilituese e risocializuese nëpër të gjitha qendrat. Të koordinojë punën me organizata të ndryshme

qeveritare dhe joqeveritare për ngritjen e disa qendrave që do të mund të menaxhohen nga ato

- ❖ Shërbimi Korrektues i Kosovës të hartojë politika lidhur me risocializimin e të burgosurve. Të ndajë të dënuarit për vepra kundërvajtëse dhe të lehta nga ata me dënlime larta. T’iu kushtojë trajtim të veçantë recidivistëve. Kërkohet të angazhohen më shumë zyrtarët e qendrave sociale, sidomos me moshat e reja dhe me personat e dënuar për të parën herë. Të krijojnë dosjet e secilit nga aspekti social. Të shtohet niveli i sigurisë brenda burgut dhe të shmangen hyrjet e gjëra të ndaluara. Po ashtu, të shtohet kontrolli ndaj zyrtarëve dhe t’iu pamundësohet shërbimi i ‘klientëve’
- ❖ Institucionet lokale dhe shoqëria civile të ndalojë aktivitetet e bizneseve që janë në kundërshtim me ligjin dhe që janë nxitës të aktiviteteve kriminale
- ❖ Familja, mjedisi, shoqëria dhe institucionet të veprojnë në ndërtimin e familjeve të shëndosha dhe të qëndrueshme, që ato të mund të luajnë rolin e tyre edukues
- ❖ Institucionet shtetërore të kontrollojnë zhvillimet teknologjike dhe të gjitha programet që mund të jenë nxitës në sjellje devijante apo aktivitete kriminale. Ndaj programeve të tillë të ndërmerren masat të menjëhershme ligjore
- ❖ Institucionet e sigurisë të shtojnë luftimin e dukurive kriminale, sidomos ndaj narkotikëve, trafikimit dhe prostitucionit, grabitjeve, kërkimit të lëmoshës, etj.

## SHËNIME

### Komente të pyetësorëve

Më vjen mirë për vizitën tuaj, sepse vërtet paskemi nevojë për biseda të tilla ngase secili nga ne ka stres dhe ndjeve një lehtësim gjatë një bisede të tillë, pavarësisht temës, së paku që t'i bie ndërmend dikujt për ne, sepse secili mund të gabon dhe të bie në burg.

Jeta brenda, edhe përkundër kushteve të mira, është shumë e keqe, je i mbyllur tërë kohën, ke kontakt me të dënuar të tjerë për raste nga më të ndryshme etj.

Unë si i dënuar nuk jam i kënaqur me ligjin e Kosovës, pasi që bëhen shumë shkelje.

Këtu në drejtësinë tonë nuk ka drejtësi të mirëfilltë, po ende përdoret edhe kanuni po nuk mirret parasysh se qysh ka ndodhur rasti, a kush ka qenë iniciator, por neve na shkilen të drejtat njerëzore. P.sh. mua më ka ndodhur rasti i vrasjes në vend të punës dhe jam dënuar me 13 vite burg edhe pse jam fajtor për këtë vepër, por për mua ky është dënim i tepërt se nuk funksionon drejtësia të mënyrë të drejt edhe pse institucionet tona janë shumë të korruptuara.

Në disa raste më është imponuar nga shoqëria të bie ndesh me ligjin, në disa raste tjera nuk kam ditur se kam shkelur ligjin

Jam penduar se e kam përdorur drogën

Kisha komentuar pak sa i përketë veprave të cilat shpesh herë jemi të detyruar që për shkaqe familjare edhe përkundër dëshirës sonë jemi të detyruar t'i kryejmë; andaj kisha pasur dëshirë që shteti ynë të hap vende të reja punësimi dhe që rinia e Kosovës të mos jetë prapa grilave por të punojë dhe të ketë kushte për jetesë

Veq vazhdoni se vyen punë shumë për t/i zhdukur këto dukuri negative

Iu bëj apel të gjitha grave ‘mos e shkelni ligjin’

Nuk pajtohem me veprat që po ndodhin në shoqërinë tonë vitet e fundit te femrat shqitare sepse kjo është një dukuri negative dhe shkatërruese për shoqërine tonë

The problem is not the place, ore the persons. The problem is our not existen shure finance banking system, .... one I was coming to Kosovo ëhen ëe have monney, ëe can open the doors for study, children and old peopel to get in a good place of futher

Mendoj se familja duhet ta luan rolin e vet në socializimin e anëtarëve të vet, pastaj ligjet të janë më efikase me qëllim që të ndikon te individi dhe tek të tjerët.

Shoqëria nuk po luan rolin e vet, sepse duke i përkrahue individët e tillë dhe duke mohuar rastet kriminale edhe indirekt apo direkt.

Shteti dhe vet shoqëria duhet të angazhohen në parandalimin e këtyre gjërave dhe atë përmes ligjeve më funksionale si dhe përmirësimëve në aspektin social

Shoqëria të vetëdijesohet, se nuk shkon duke i përkrahur, por të ndikon te ata që t'mos vazhdojnë. Disa tradita e zakone që këmi pasur do t'ëishin më të mira e më të sigurta për shoqërinë.

### Transkriptë e një interviste (narkoman)

**X:** Rinia tani e kanë harruar shkollën dhe e kanë prioritet drogën, e cila po iu duket diçka interesante. Në fillim e provojnë për kureshtje, por është shumë vështirë t'i ndahesh më pas.

**P:** A ke ti shoqëri që përdorin drogën?

**X:** Po, kam

**P:** Çfarë të shtyri të merresh me drogë?

**X:** Thjesht kureshtja për ta provuar. Edhe shoqëria mund të ndikojë, është një hap më tepër, por mua më ka shtyrë kureshtja.

**P:** Çfarë ke ndjerë kur e ke përdorë dhe çfarë apelon?

**X:** Ndjenjat që t'i jep droga nuk mund të përshkruhen me fjalë, por tash jam pishman që e kam përdorë. Apeloj tek të gjithë përdoruesit e drogës që t'i largohen, veçanërisht heroinës, se ajo është shkatërruese personale së pari, pastaj shkatërruese e familjes, e shoqërisë dhe është ndër drogat më vdekjeprurëse

**P:** A keni pasë rast të dëgjoni që ata që kanë konsumuar drogën kanë përfunduar edhe me vdekje?

**X:** Po, kam pasë raste. Shumë vdekje në komunën tonë po shkaktohen nga mbidoza e përdorimit të drogës

**P:** Cila nga drogat po përdoret më tepër në këtë rajon?

**X:** Marihuana, por njerëzit nga marihuana po kalojnë edhe tek llojet e tjera

**P:** Cilat mosha e përdorin më tepër drogën?

**X:** Adoleshentët janë përdorues të mëdhenj të drogës, por edhe më të mëdhenj, moshat 20-30 vjeç.

**P:** Si keni arritur deri tek sigurimi i drogës?

**X:** Unë kam punuar kamerier dhe jam detyruar të bëj gjëra që s'duhet, por edhe duke kërkuar borxh, e më përpala kur kam qenë pa punë jam detyruar madje edhe të vjedhi e të përfundoj burgjeve për arsyet e drogës, vetëm për t'i siguruar të hollat për ta marrë dozën time që më është dashur. Kjo iu ndodh edhe të gjithë atyre që konsumojnë drogën. Pastaj kemi raste kur shokë të mijë kanë kryer edhe grabitje të ndryshme vetëm për të gjetur para për të blerë drogë. Por, edhe mua vetë më ka ndodhur të grabis çanta nga krahët e femrave, për të cilën jam pishman, dhe i lutem Zotit të ma falë këtë. Ka ndodhë që kemi grabitur edhe pije alkoolike nëpër markete, për arsyet se ato shiten pak më shtrenjtë.

**P:** Si e keni marrë/ble dhe a ka qenë e vështirë të vini deri të droga?

**X:** Thjesht e ke ble, ke paguar dhe të ka ardhë materiali. Jo, nuk është e vështirë. Për punë të këqija është shumë lehtë të arrish. E për me dalë prej punëve të këqija është vështirë, por njeriu duhet të mundohet me mish e me shpirt për të dalë nga droga

**P:** Në Gjakovë a kultivohet apo lëviz droga?

**X:** Te ne nuk kultivohet, por lëviz. Lëviz edhe tranzit dhe një sasi ndalet në Gjakovë, se këta dilerët e drogës e dijnë përafërsisht se çfarë sasie duhet lënë këtu. Edhe i kanë njerëzit e vet ku e lënë dhe ata e shesin për ta

**P:** Po prej nga vjen?

**X:** Të gjitha llojet e drogës vijnë nga Shqipëria.

**B:** Cila është droga më e shtrenjtë që konsumohet këtu në Gjakovë?

**X:** Më e shtrenjta është kokaina, por ajo konsumohet shumë pak. Përpara është përdorur shumë heroina, por pasi është vdekjeprurëse, sot mund t'i numrosh njerëzit që e përdorin atë. Unë vet personalisht e kam përodrur heroinën. Por, ka qenë e vështirë të sigurohet dhe shpesh kam pritur me ditë të tëra. Gjatë kësaj kohe jam ndier shumë keq. Gjatë pritjes kam kryer vjedhje, grabitje e shumë të tjera

**P:** A ke dëgjuar apo të ka rastisë të hysh nëpër shtëpitë e të tjerëve për të kryer grabitje?

**X:** Po; **P:** Sa luftohet kjo nga institucionet tona? **X:** Mendoj se luftohet 60-65%.

**P:** A ka mundësi të luftohet më tepër dhe kush duhet më tepër?

**X:** Po, ka mundësi të luftohet më tepër. Këtë duhet ta bëjë policia. Pastaj edhe shoqëria në bashkëpunim me policinë

**P:** Familja juaj, kur e ka ditë që ju jeni përdorues?

**X:** E kanë marrë vesh gati pas dy vitesh, por ata kanë bërë shumë për mua. Ata më kanë sjellë këtu. Ata më kanë larguar nga droga më shumë se një herë. Pastaj është edhe shpenzim ekonomik shumë i madh edhe për familjen. Për ty s'është problem a ka dikush për të ngrënë apo jo, vetëm droga ka rëndësi

**P:** A ka mjaft konsumues në rajonin tonë?

**X:** Në përgjithësi ka

**P:** Sa të ka zgjatë efekti i drogës dhe çka ndjen njeriu?

**X:** Më së shumti zgjatë tri deri në katër orë. Ndjen njëfarë fllesh lumturie, nuk brengoset për problemet, për asgjë. Pin, qetësohesh, hajt se ka zgjidhje. Gjithçka e ke rrash. Pasi të lëshon dhe fillon të të kapë kriza, ke mërzzi, etj... Por prapë e pin, se gjen prehje vetëm aty.

**P:** Ç'mesazh do të përcillni tek të tjerët duke marrë shembull pjesë nga përvoja juaj?

**X:** Përpara shoqëria nuk ka qenë si sot. Sot, ndoshta edhe nëse nuk të nxisin në përdorimin e drogës, vetë duke ndejtur me ta, lakkia, kureshtja të shtyjnë ta provosh. Do t'iu thosha të gjithë atyre që po përdorin drogën, që ta lënë atë, sepse është send i keq. Edhe unë për vete jam pishman që e kam përdor. Ajo është e vështirë për ta lënë (D-1:01.08.2014)

**I:** Unë po iu them të gjithëve të largohen, por këta prapë vazhdojnë. Po pijnë *bari*, e kjo drogë është më e fëlliqtë, e këta e marrin se kushton më lirë. Nuk kanë para se i marrin edhe ato të mëdhatë, kokainën, por ajo kushton 1 gram - 80 EURO, o burrë. Atëherë kur s'po kanë para, dalin e vjedhin, plaqkisin, marrin telefonat, bile edhe vrasin të tjerët

**P:** Në këto fenomene, a ka edhe të gjinisë femërore?

**I:** Po, ka edhe femra, shumë... të gjithë i njoh (D-2)

**P:** Me çfarë aktiviteti je marrë konkretisht?

**Z:** Me droga. Kemi përdorë vetëm *barin*

**P:** A kanë përdorë shoqëria jote ndonjëherë maska ose armë?

**Z:** Për armë e di që kanë pasë

**P:** A ke dëgjuar ndonjëherë për dikë që është dënuar në botën perëndimore dhe kur është kthyer në Kosovë prapë ka vazhduar me kryerjen e veprave të tilla penale?

**Z:** Unë jam vetë një ndër ta (D-7)

## SHTOJCA

### Shtoje 1. Pyetësori me qytetarë, faqja parë



**Universiteti  
European i  
Tiranës**

Tema e hulumtimit:

*"Vështrim antropologjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës" (1999-2012)*

I/E nderuar,

Realizimi i këtij pyetësori ka për qëllim të nxjerrë të dhënat lidhur me rrëthanat dhe fenomenet e reja kriminale në rajonin e Gjakovës në raport me traditën dhe kulturën shqiptare të këtij rajoni. Që analiza të dal reale, kërkohet që të jeni të singertë dhe presim që me seriozitet e korrektësi t'iu përgjigjeni pyetjeve, nigung me këtë ju do të kontribuoni për një shoqëri sociale stabile. Rezultatet dhe komentet tuaja do të mbeten anonime.

#### UDHËZIME SE SI DUHET TË PLOTËSOHET PYETËSORI

- Pyetësori plotësohet në mënyrë anonime
- Ju e kenë një kohë të mjaftueshme për ta plotësuar pyetësorin
- Çdo pyetje e ka përgjigjen adekuante
- Ju duhet ta zgjidhní vetëm një përgjigje
- Zgjedhja e përgjigjes bëhet duke përdorur simbolet **X** ose **✓**

*Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe lu falenderoj për bashkëpunimin dhe kontributin e dhëne*

*Me respekt,  
Bekim Avdaj - PhD Candidate*

## Shtojea 1. Pyetësori me qytetarë, faqja e dytë

<b>PYETËSORI</b>				
1.	Mosha juaj ?	25-34 <input type="checkbox"/>	35 -44 <input type="checkbox"/>	45 - 60 <input type="checkbox"/>
				Mbi 60 <input type="checkbox"/>
2.	Gjinia:	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>	
3.	Niveli i shkollimit:	Fillor <input type="checkbox"/>	I mesëm <input type="checkbox"/>	I lartë <input type="checkbox"/>
				Superior <input type="checkbox"/>
4.	Statusi martesor:	I pamartuar <input type="checkbox"/>	I martuar <input type="checkbox"/>	
5.	Statusi familjar:			
	Jeton me prindër <input type="checkbox"/>	Me fëmijë <input type="checkbox"/>	I vetëm <input type="checkbox"/>	Me prindër e fëmije <input type="checkbox"/>
6.	Jetoni në:	Oqjet <input type="checkbox"/>	Fshat <input type="checkbox"/>	
7.	Punësimi:	I punësuar <input type="checkbox"/>	I papunësuar <input type="checkbox"/>	
8.	Gjendja ekonomike:	Dobët <input type="checkbox"/>	E mesme <input type="checkbox"/>	E mirë <input type="checkbox"/>
				Shumë e mirë <input type="checkbox"/>
9.	A keni qenë ndonjëherë:			
	Viktimi e ndonjë vepre penale:	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	Dëshmitar në ndonjë vepër penale:	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
	Ankues për ndonjë vepër penale:	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>	
10.	Bazuar me rrethanat me të cilat u përballën qytetarët e Gjakovës me rrithinë në fushën e aktiviteteve kriminale gjatë periudhës 1999-2012, vlerësojmë se kishim një situatë:			
	Shqetësuese <input type="checkbox"/>	Të qetë <input type="checkbox"/>		
11.	Periudha e vitesve 1999-2012, në fushën e sigurisë së brendshme u përballë me shumë ngjarje dhe incidente kriminale nga më të ndryshmet. Krasa me periudhën e paralajmës, mënyra dhe illoji i disa prej këtyre incidenteve kriminale janë:			
	Të njëjtë <input type="checkbox"/>	Të ndryshme <input type="checkbox"/>		

## Shtojea 1. Pjetësori me qytetarë, faqja e tretë

12. Ky rajon duke qenë i njobur për traditën dhe kulturën e pastër shqiptare, trendet e fundit të kriminalitetit janë brenda traditave kulturore të kësaj ase.

Plotësisht  Pak  Aspak

13. Krahas ndryshimeve të shumta me rastin e kalimit në sistemin demokratik të shoqërisë së sonë, a kemi edhe avancime në paraqitjen e fenomeneve të reja kriminale, që më parë nuk janë hasur në traditën dhe kulturën e këtij rajoni?

Shumë  Pak  Pjesërisht

14. Sa ka ndikuar mungesa e institucioneve stabile shtetërore në periudhën e tranzicionit në Kosovë në shfaqjen e dukurive kriminale?

Shumë  Pak  Aspak

15. Hapja e lokaleve të lojërave të fatit, lokalet e natës e tjera, sa mund të janë si faktorë shytës në prurjet e fenomeneve të reja kriminale në rajonin e Gjakovës?

Shumë  Pak  Aspak

16. Sa ishin në harmoni normat ligjore për organizimin e jetës në Kosovën e paslufisë në rapport me rrethanat reale?

Shumë  Pak  Aspak

17. Kush duhet t'i u qasë këtyre fenomeneve të reja kriminale dhe të rrezikshme për shoqërinë me qëllim të parandalimit dhe tkurrjes së tyre

Institucionet shtetërore  Shoqëria  Të dyja

Ndonjë koment shtesë:

---

---

---

## Shtojca 2. Pyetësori me të dënuar, faqja e parë



**Universiteti  
European i  
Tiranës**

Tema e hulumtimit:

*"Vështrim antropologjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës" (1999-2012)*

I/E nderuar,

Realizimi i këtij pyetësori ka përgjillim të nxjerrë të dhënat lidhur me rrithanat dhe fenomenet e reja kriminale në rajonin e Gjakovës në raport me traditën dhe kulturën shqiptare të këtij rajoni.

Që analiza të dal reale, kërkohet që të jeni të sinqertë dhe presim që me seriozitet e korrektësi t'iu përgjigjeni pyetjeve, ngase me këtë ju do të kontribuoni për një shoqëri sociale stabile

Rezultatet dhe komentet tuaja do të mbeten anoneime.

### UDHËZIME SE SI DUHET TË PLOTËSOHET PYETËSORI

- Pyetësori plotësohet në mënyrë anonime
- Ju e keni një kohë të mjaftueshme për ta plotësuar pyetësorin
- Cdo pyetje e ka përgjigjen adekuate
- Ju duhet ta zgjidhní vetëm një përgjigje
- Zgjedhja e përgjigjes bëhet duke përdorur simboleit **X** ose **✓**

*Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe lu falënderoj për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë*

*Më respekt,  
Bekim Avdiaj - PhD Candidate*

## Shtojca 2. Pjetësori me të dënuar, faqja e dytë

<b>PYETËSORI</b>					
1.	Mosha juaj?	Nën 18 <input type="checkbox"/>	18- 25 <input type="checkbox"/>	26 - 40 <input type="checkbox"/>	Mbi 40 <input type="checkbox"/>
2.	Gjinia:	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>		
3.	Niveli i shkollimit:	Filler <input type="checkbox"/>	I mesëm <input type="checkbox"/>	I lartë <input type="checkbox"/>	Superior <input type="checkbox"/>
4.	Statusi martesor:	I parnartuar <input type="checkbox"/>	I martuar <input type="checkbox"/>	I ndarë <input type="checkbox"/>	
5.	Statusi familjar:				
	Jeton me prindër <input type="checkbox"/>	Me fëmijë <input type="checkbox"/>	I vetëm <input type="checkbox"/>	Me prindër e fëmijë <input type="checkbox"/>	
6.	Jetomi në:	Qytet <input type="checkbox"/>	Fshat <input type="checkbox"/>		
7.	Punësimi:	I punësuar <input type="checkbox"/>	I papunësuar <input type="checkbox"/>		
8.	Gjendja ekonomike:				
	Dobët <input type="checkbox"/>	E mesme <input type="checkbox"/>	E mirë <input type="checkbox"/>	Shumë e mirë <input type="checkbox"/>	
9.	Keni jetuar jashtë Kosovës:	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>		
10.	Keni ra ndesh me ligjin ndonjëherë:	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>		
11.	I arrestuar ndonjëherë (jo politikisht):	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>		
	II. Nëse po, sa herë dhe kur:	Një herë <input type="checkbox"/>	Dy herë <input type="checkbox"/>	Disa herë <input type="checkbox"/>	
	III. Para luftës 1998-1999 <input type="checkbox"/>	Pas luftës 1998-1999 <input type="checkbox"/>	Në të dy periudhat <input type="checkbox"/>		
12.	Keni qenë i dënuar:	Po <input type="checkbox"/>	Jo <input type="checkbox"/>		

## Shtojea 2. Pyetësori me të dënuar, faqja e tretë

II. Nëse po, sa herë është kur: Një herë  Dy herë  Disa herë

III. Para luftës 1998-1999  Pas luftës 1998-1999  Në të dy periudhat

13. Ndonjë anëtar i familjes i arrestuar ndonjëherë (jo politikisht): Po  Jo

14. Ndonjë anëtar i familjes i dënuar ndonjëherë: Po  Jo

15. Veprat për të cilat jeni arrestuar apo edhe dënuar:

Kanë ekzistuar edhe paralufte  Vetëm pas luftës  Nuk di

16. A keni ndonjë shok që ka qenë i arrestuar apo edhe dënuar? Po  Jo

17. Cili është motivi shtytës për shkelje të normave të ligjit?

Për argëtim dhe përfitim personal  Për nevoja të familjes

18. Disa nga shkeljet ligjore sa korrespondojnë me traditën dhe kulturën shqiptare të këuji rajoni?

Pak  Aspak  Pjesërisht

Ndonjë koment shtesë:

---

---

---

### Shtojca 3. Intervista me qytetarë, faqja e parë



**Universiteti  
Europian i  
Tiranës**

Tema e hulumtimit:

*"Vështrim antropollogjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës" (1999-2012)*

I/E. nderuar,

Realizimi i kësaj interviste ka për qëllim të nxjerrë të dhënat lidhur me trethanat dhe fenomenet e reja kriminale në rajonin e Gjakovës në raport me traditën dhe kulturën shqiptare të këtij rajoni.

Që analiza të dal reale, kërkohet që të jeni të sinqtë dhe presim që me seriozitet e korrektesi t'lu përgjigjeni pyetjeve, ngase me këtë ju do të kontribuoni për një shoqëri sociale stabile.

Komentet tuaja do të mbeten anonime.

*Shpresojmë në mirekuptimin tuaj dhe iu falenderoj për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë*

*Me respekt,  
Bekim Avdaj - PhD Candidate*

### Shtojca 3. Intervista me qytetarë, faqja e dytë

<b>Interistë</b>					
1.	Mosha juaj	? 30- 40 <input type="checkbox"/>	41- 50 <input type="checkbox"/>	51-60 <input type="checkbox"/>	Mbi 60 <input type="checkbox"/>
2.	Gjinia:	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>		
3.	Niveli i shkollimit:	Fillor <input type="checkbox"/>	I mesem <input type="checkbox"/>	I lartë <input type="checkbox"/>	Superior <input type="checkbox"/>
<p>Periudha e fillimit të historisë së re në shoqërinë kosovare, pra nga qershor 1999 e tuije, u përballë me shumë ndryshime, ndër to edhe Gjakova me rrëthinë. Këto diktuan edhe në fushën e sigurisë. Bazuar në rrëthanat e krijuara gjatë kësaj periudhe në këtë drejtim nuk kishte të kursyer as në incidente kriminale. Cili është vlerësimi i juaj rrëth gjendjes së sigurisë dhe sjelljeve kriminale ?</p> <p>Rrëthanat e reja të organizimit të shoqërisë, me rastin e prurjeve të reja demokratike, sollën edhe risi në aktivitetet kriminale, nga ato të rëndomat e deri te fenomenet më të reja kriminale. Ku është ndryshimi i disa nga aktet kriminale nga e kaluara me të sotmet dhe cilat janë disa nga fenomenet e reja kriminale që sot e shqetësojnë rajonin e Gjakovës ?</p> <p>Sa korrespondojnë sot këto aktivitete të reja kriminale me realitetin e traditës dhe kulturës së qytetarëve të këtij rajoni nga e kaluara ?</p> <p>Disa nga veprat kriminale të tanishme, a kanë mundur të kryhen edhe në të kaluarën, nëse po kush ka ndikuar të mos kryben së paku nga ana morale ?</p> <p>Sa ka mundur të ndikon periudha e stërvizgjatur e tranzicionit dhe organjet jostabile të qeverisjes së shoqërisë në paraqitjen e këtyre fenomeneve të reja kriminale ?</p> <p>A mendoni se vet institucionet, duke sjellur risi në organizimin shoqëror, në disa raste ishin nxitës dhe shitytës për shtimën e aktiviteteve kriminale dhe nëse po çka do të mund të veçoni ?</p> <p>Kush mendoni se duhet angazhuar në luftimin e aktiviteteve kriminale, sidomos të atyre që janë risi për kulturën dhe traditën e deri te ato që janë në trend të zhvillimeve të kohës ?</p> <p>Ndonjë koment shtesë :</p>					

#### Shtojca 4. Intervista me të dënuar, faqja e parë



**Universiteti  
Europian i  
Tiranës**

Tema e hulumtimit:

*"Vështrim antropollogjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës" (1999-2012)*

I/E nderuar,

Realizimi i kësaj interviste ka për qëllim të nxjerrë të dhënat lidhur me rrethanat dhe fenomenet e reja kriminale në rrethin e Gjakovës në raport me traditën dhe kulturën shqiptare të këtij rajoni.

Që analiza të dal reale, kërkohet që të jeni të sinqtë dhe presim që me seriozitet e korrektesi t'i u përgjigjeni pyetjeve, ngase me këtë ju do të kontribuoni për një shoqëri sociale stabile.

Komentet tuaja do të mbeten anonime.

*Shpresojmë në mirëkuptimin tuaj dhe iu falenderoj për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë*

*Me respekt,  
Bekim Avdiaj - PhD Candidate*

#### Shtojca 4. Intervista me të dënuar, faqja e dytë

<b>Interistë</b>				
1. Moshë juaj ?	Nën 18 <input type="checkbox"/>	18- 25 <input type="checkbox"/>	26 - 40 <input type="checkbox"/>	Mbi 40 <input type="checkbox"/>
2. Gjinia:	M <input type="checkbox"/>	F <input type="checkbox"/>		
3. Niveli i shkollimit: Fillor <input type="checkbox"/>	I mesem <input type="checkbox"/>	I lartë <input type="checkbox"/>	Superior <input type="checkbox"/>	
Rrethanat e reja të organizimit të shoqërisë në Kosovë ndikuan edhe në paraqitjen e aktiviteteve kriminale. Si mund t'i vlerësoni këto ndryshime të disa vepra kriminale që kanë ekzistuar edhe në të kaluarën dhe të fenomenet e reja kriminale ?				
Disa nga veprat kriminale të tanishme, a kanë mundur të kryhen edhe në të kaluarën, nëse po kush ka ndikuar të mos kryhen së paku nga ana morale ?				
Sipas juve, disa lloje të aktiviteteve kriminale, në përgjithësi a bien ndesh me traditat dhe kulturën shqiptare të rajonit të Gjakovës ?				
Për kryerjen e disa aktiviteteve kriminale ndonjëherë janë shkaktarë edhe disa faktorë shtytës. Ngjuaqës së shqipërisë sonë, institucionet shtetërore sa kanë krijuar hapësitë për paraqitjen e faktorëve shtytës dhe si ?				
Për të risocializuar individet e përfshire në disa aktivitete kriminale, kush mendoni se duhet përfshirë, duke filluar nga individi e deri te institucionet ?				
Ndonjë koment shtesë:				

### Shtojca 5. Statistikat me qytetarët

#### Statistics

N	Valid	530
	Missing	20
	Mean	2.08
	Median	2.00
	Std. Deviation	.969
	Range	3
	Minimum	1
	Maximum	4

**Mosha:**  
**25-34= 1    35-44= 2    45-60= 3    Mbi 60= 4**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	187	34.0	35.3	35.3
	2	153	27.8	28.9	64.2
	3	149	27.1	28.1	92.3
	4	41	7.5	7.7	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Gjinia:**  
**M= 1 Meshkuj    F= 2 Femra**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	259	47.1	48.9	48.9
	2	271	49.3	51.1	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
	Missing	System	20	3.6	
	Total	550	100.0		

**Niveli i shkollimit:**  
**A= 1 Fillor B= 2 I mesëm C= 3 I lartë D= 4 Superior**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	52	9.5	9.8	9.8
	2	116	21.1	21.9	31.7
	3	217	39.5	40.9	72.6
	4	145	26.4	27.4	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Statusi martesor:**  
**A= 1 I pamartuar B= 2 I martuar**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	141	25.6	26.6	26.6
	2	388	70.5	73.2	99.8
	4	1	.2	.2	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
	Missing	System	20	3.6	
	Total	550	100.0		

**Statusi familjar:**  
**A= 1 Jeton me prindër B= 2 Me fëmijë**

**C= 3 I vetëm                      D= 4 Bashkërisht**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	140	25.5	26.4	26.4
	2	244	44.4	46.0	72.5
	3	27	4.9	5.1	77.5
	4	119	21.6	22.5	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Jeton në:**  
**A= 1 Qytet    B= 2 Fshat**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	358	65.1	67.5	67.5
	2	172	31.3	32.5	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Statusi i punës:**  
**A= 1 I punësuar    B= 2 I papunësuar    C= 3 Pensionist**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	377	68.5	71.1	71.1
	2	148	26.9	27.9	99.1
	3	5	.9	.9	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Gjendja e ekonomike:**  
**A= 1 Dobët    B= 2 E mesme    C= 3 E mirë    D= 4 Shumë e mirë**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	43	7.8	8.1	8.1
	2	288	52.4	54.3	62.5
	3	179	32.5	33.8	96.2
	4	20	3.6	3.8	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Viktimë e ndonjë vepër penale:**  
**A= 1 Po      B= 1 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	52	9.5	9.8	9.8
	2	478	86.9	90.2	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Dëshmitar në ndonjë vepër penale:**  
**A= 1 Po      B= 1 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	73	13.3	13.8	13.8
	2	457	83.1	86.2	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Ankues për ndonjë vepër penale:**  
**A= 1 Po      B= 1 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	62	11.3	11.7	11.7
	2	468	85.1	88.3	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Bazuar në rrethanat me të cilat u përballen qytetarët e Gjakovës me rrethinë në fushën e aktiviteteve kriminale gjatë periudhës 1999-2012, vlerësoni se kishim një situatë:**

A= 1 Shqetësuese B= 2 Tëqetë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	423	76.9	79.8	79.8
	2	107	19.5	20.2	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Periudha e viteve 1999-2012, në fushën e sigurisë së brendshme u përball me shumë ngjarje dhe incidente kriminale nga më të ndryshmet. Krahasuar me periudhën e paraluftës, mënyra dhe lloji i disa prej këtyre incidenteve kriminale janë:**

A= 1 Të njëjta B= 2 Të ndryshme

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	75	13.6	14.2	14.2
	2	455	82.7	85.8	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Ky rajon duke qenë i njojur për traditën dhe kulturën e pastër shqiptare, trendët e fundit të kriminalitetit janë brenda traditave kulturore të kësa jane:**

A= 1 Plotësishët B= 2 Pak C= 3 Aspak

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	52	9.5	9.8	9.8
	2	219	39.8	41.3	51.1
	3	259	47.1	48.9	100.0
Missing	Total	530	96.4	100.0	
	System	20	3.6		
Total		550	100.0		

**Krahas ndryshimeve të shumta me rastin e kalimit në sistemin demokratik të shoqërisë sonë, a kemi edhe avancime në paraqitjen e dukurive të reja kriminale, që më parë nuk janë hasur në traditën dhe kulturën e këtij rajoni?**

**A= 1 Shumë B= 2 Pak C= 3 Pjesërisht**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	201	36.5	37.9	37.9
	2	184	33.5	34.7	72.6
	3	145	26.4	27.4	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing System	20	3.6			
	Total	550	100.0		

**Sa kandikuar mungesa e institucioneve stabile shtetërore në periudhën e tranzicionit në Kosovë në shfaqjen e dukurive kriminale?**

**A= 1 Shumë B= 2 Pak C= 3 Aspak**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	393	71.5	74.2	74.2
	2	117	21.3	22.1	96.2
	3	20	3.6	3.8	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing System	20	3.6			
	Total	550	100.0		

**Hapja e lokaleve të lojërave të fatit, lokalet e natës e tjera, sa mund të jenë si faktor shtytës në prurjet e dukurive të reja kriminale në rajonin e Gjakovës?**

**A= 1 Shumë B= 2 Pak C= 3 Aspak**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	448	81.5	84.5	84.5
	2	78	14.2	14.7	99.2
	3	4	.7	.8	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing System	20	3.6			
	Total	550	100.0		

**Sa ishin në harmoni normat ligjore për organizimin e jetës në Kosovën e pasluftës në raport me rrethanat reale?**

**A= 1 Shumë B= 2 Pak C= 3 Aspak**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	55	10.0	10.4	10.4
	2	355	64.5	67.0	77.4
	3	120	21.8	22.6	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Kush duhet t'iua qaset këtyre dukurive të reja kriminale dhe të rrezikshme për shoqërinë me qëllim të parandalimit dhe tkurrjes së tyre?**

**A= 1 Institucionet shtetërore B= 2 Shoqëria C= 3 Tëdyja**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	143	26.0	27.0	27.0
	2	23	4.2	4.3	31.3
	3	364	66.2	68.7	100.0
	Total	530	96.4	100.0	
Missing	System	20	3.6		
	Total	550	100.0		

**Shtojca 6. Statistikat me personat e dënuar**

**Mosha:**

Nën 18= 1    18-25= 2    26-40= 3    Mbi 40= 4

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	2	2.5	2.7	2.7
	2	32	40.0	42.7	45.3
	3	23	28.8	30.7	76.0
	4	18	22.5	24.0	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**Gjinia:    M= 1 Meshkuj    F= 2 Femra**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	57	71.3	76.0	76.0
	2	18	22.5	24.0	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**Niveli i shkollimit:**

**A= 1 Fillor    B= 2 I mesëm    C= 3 I lartë    D= 4 Superior  
 E= 5 Pa shkollim    F= 6 Profesional**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	36	45.0	48.0	48.0
	2	30	37.5	40.0	88.0
	3	3	3.8	4.0	92.0
	4	1	1.3	1.3	93.3
	5	4	5.0	5.3	98.7
	6	1	1.3	1.3	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**Statusi martesor:**

**A= 1 I pamartuar    B= 2 I martuar    C= 3 I ndarë    D= 4 I ve**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	40	50.0	53.3	53.3
	2	26	32.5	34.7	88.0
	3	7	8.8	9.3	97.3
	4	2	2.5	2.7	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**Statusi familjar:**

**A= 1 Jeton me prindër    B= 2 Me fëmijë    C= 3 I vetëm  
D= 4 Bashkë me fëmijë dhe prind**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	40	50.0	53.3	53.3
	2	21	26.3	28.0	81.3
	3	3	3.8	4.0	85.3
	4	11	13.8	14.7	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**Jeton në:**

**A= 1 Qytet    B= 2 Fshat**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	44	55.0	58.7	58.7
	2	31	38.8	41.3	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**Statusi i punës:**

**A= 1 I punësuar    B= 2 I papunësuar    C= 3 Pensionist**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	15	18.8	20.0	20.0
	2	59	73.8	78.7	98.7
	3	1	1.3	1.3	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**Gjendja e ekonomike:**

**A= 1 Dobët    B= 2 E mesme    C= 3 E mirë    D= 4 Shumë e mirë**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	39	48.8	52.0	52.0
	2	24	30.0	32.0	84.0
	3	11	13.8	14.7	98.7
	4	1	1.3	1.3	100.0
Total		75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**Keni jetuar jashtë Kosovës?**

**A= 1 Po    B= 2 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	27	33.8	36.0	36.0
	2	48	60.0	64.0	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**Keni rindesh me ligjin?**

**A= 1 Po    B= 1 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	72	90.0	96.0	96.0
	2	3	3.8	4.0	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**I arrestuar ndonjëherë (jo politikisht)?**

**A= 1 Po    B= 1 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	71	88.8	94.7	94.7
	2	4	5.0	5.3	100.0
	Total	75	93.8	100.0	

Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**Nëse po, sa herë?**

**A= 1 Një herë    B= 2 Dy herë    C= 3 Disa herë  
D= 4 Nuk kam qenë i arrestuar**

		Frequenc y	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	47	58.8	62.7	62.7
	2	9	11.3	12.0	74.7
	3	17	21.3	22.7	97.3
	4	2	2.5	2.7	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**A= 1 Para luftës 1998-1999    B= 2 Pas luftës 1998-1999  
C= 3 Në të dy periudhat    D= 4 Nuk kam qenë i arrestuar**

		Frequenc y	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	2	2.5	2.7	2.7
	2	69	86.3	92.0	94.7
	3	2	2.5	2.7	97.3
	4	2	2.5	2.7	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**Keni qenë i dënuar?**

**A= 1 Po B= 2 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	72	90.0	96.0	96.0
	2	3	3.8	4.0	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**Nëse po, sa herë?**

**A= 1 Një herë      B= 2 Dy herë  
C= 3 Disa herë      D= 4 Nuk kam qenë i dënuar**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	55	68.8	73.3	73.3
	2	7	8.8	9.3	82.7
	3	10	12.5	13.3	96.0
	4	3	3.8	4.0	100.0
Missing	Total	75	93.8	100.0	
	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**A= 1 Para luftës 1998-1999 B= 2 Pas luftës 1998-1999**  
**C= 3 Në të dy periudhat D= 4 Nuk kam qenë i dënuar**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	1	1.3	1.3	1.3
	2	68	85.0	90.7	92.0
	3	3	3.8	4.0	96.0
	4	3	3.8	4.0	100.0
Total		75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**Ndonjë anëtar i familjes i arrestuar ndonjëherë (jo politikisht)?**  
**A= 1 Po B= 2 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	24	30.0	32.0	32.0
	2	51	63.8	68.0	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
	Missing	System	5	6.3	
Total		80	100.0		

**Ndonjë anëtar i familjes i dënuar ndonjëherë?**

**A= 1 Po                    B= 2 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	19	23.8	25.3	25.3
	2	56	70.0	74.7	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**Veprat për të cilat jeni arrestuar apo edhe dënuar:**

**A= 1 Kanë ekzistuar edhe paralufte      B= 2 Vetëm pas lufte  
C= 3 Nuk e di**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	20	25.0	26.7	26.7
	2	48	60.0	64.0	90.7
	3	7	8.8	9.3	100.0
Missing	Total	75	93.8	100.0	
	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

**A keni ndonjë shok/shoqe që ka qenë i arrestuar apo edhe i dënuar?**

**A= 1 Po              B= 2 Jo**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	37	46.3	49.3	49.3
	2	38	47.5	50.7	100.0
	Total	75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**Cili është motivi shtytës për shkelje të normave të ligjit?**

**A= 1 Për argëtim dhe përfitim personal    B= 2 Për nevoja sociale  
C= 3 Nga frika    D= 4 Nga rastësia**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	49	61.3	65.3	65.3
	2	24	30.0	32.0	97.3
	3	1	1.3	1.3	98.7
	4	1	1.3	1.3	100.0
Total		75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
	Total	80	100.0		

**Shkeljet ligjore që keni kryer sa përkojnë me traditën dhe  
kulturën shqiptare të këtij rajoni?**

**A= 1 Pak    B= 2 Aspak    C= 3 Pjesërisht**

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	1	15	18.8	20.0	20.0
	2	42	52.5	56.0	76.0
	3	18	22.5	24.0	100.0
Total		75	93.8	100.0	
Missing	System	5	6.3		
Total		80	100.0		

## Shtojca 7. Korrespondenca me institucionet

**Bekim Avdaj**

---

**From:** Xhevati Ibraj  
**Sent:** May 21, 2014 12:25  
**To:** Bekim Avdaj  
**Cc:** Shaban Shala; Baki Kelani; Gani Hajdaraj; Nedzad Gutiq; Teki Syla; Sami Mahmutaj  
**Subject:** FW: Kérkesë- sigurimi i të dhënave kriminale

Inderuar Avdaj , -

Bashkangjitur do të gjeni **miratamin e kérkesës** nga ZIMP DPP ,për fazën e kompletimit të hulumtimit doktoral me temën "Studim antropologjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës 1999-2012" pranë " UET " Tiranë - Republika e Shqipërisë, andaj ju bëjmë me dije se të njëjtat nuk mund të përdoren për qëllime tjera , por vetëm për qëllimin e kërkuar.

Me respekt,

 Xhevati IBRA  
Zëdhënës - Zyra për informimi dhe mardhënie me publikun  
Drejtoria Rajonale e Policiës se Kosovës- Pejë  
Tel. celular / fiks: +387 45 285 367  
Ext: 5048/ ext.zyre 038 50 80 5048  
xhevati.ibraj@kosovopolice.com  
zreinformimite@kosovopolice.com

---

**From:** Baki Kelani  
**Sent:** May 20, 2014 2:30 PM  
**To:** Xhevati Ibraj  
**Cc:** Granit Fetahu  
**Subject:** RE: Kérkesë- sigurimi i të dhënave kriminale

Inderuar,

Kérkesën e poshtëshënuar e kemi shqyrtuar dhe njehërit parimisht e kemi miratuar për dhënien e statistikave te kërkuaara për periudhën e caktuar kohore. Te njëjtën e kemi bazuar ne Ligjin e PK-se, saktësisht nenin 31, pika, 8, ku mund te jepen statistika numerike për qëllime studimore, akadameke.

Ju lutem qe nga kollegu (pala kerkuese) te definohen statistikat e kerkuara ne baze te kodit penal dhe te njjetat ti adresohen per rajonin e caktuar dhe nga pala kerkuese te perdoren vetem per qellimin e kerkuar dhe asgje tjetere.

Me respekt,

**Major Baki Kelani**

Shef i Zyras per Infomim dhe Marrëdhënie me Publikun

Drejtoria e Përgjithësme e Policisë -Prishtinë

Tel: +381 38 50 80-1243

Cel: +377 44 506 308

Mail: [baki.kelani@kosovopolice.com](mailto:baki.kelani@kosovopolice.com)  
[zimp@kosovpolice.com](mailto:zimp@kosovpolice.com)

**From:** Xhevat Ibraj

**Sent:** May 19, 2014 4:08 PM

**To:** Baki Kelani

**Cc:** Shaban Shala; Gani Hajdaraj; Bekim Avdaj; Teki Syla

**Subject:** FW: Kërkesë- sigurimi i të dhënave kriminale

Inderuar Major Kelani,-

Zimp DRP Pejë më date 19 Maj 2014 ka pranuar Kërkesën e shenuar më poshtë nga Majori politor , Shef i sektorit të Hetimeve Rajonale DRP Pejë  
z. Bekim AVDIAJ.

Të njëjtën Kërkesë ua dërgojmë në kompetencën Tuaj , nga se kérkon t'i ndihmohet në fazen e kompletimit të hulumtimit doktoral me temën "**Studim antropologjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës 1999-2012**" pranë " UET " Tiranë - Republika e Shqipërisë.

Ju lutem , që Kërkesën ta shqyrtoni për APROVIM.

Email: [bekim.avdaj@kosovopolice.com](mailto:bekim.avdaj@kosovopolice.com) // telefoni kontaktues 044 179 369 ( i parashtuesit të kërkesës),ku mund të kontaktoni drejtpërdrejtë për ndonjë sqarim.

Me respekt,



Xhevat IBRA

Zëdhënës - Zyrë për informim dhe marrëdhënie me publikun

Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës- Pejë

Tel. celular: (+381) 45 285 367

Ext: 5048; ext.2.yre: 038 50 80 5048

[xhevat.ibraj@kosovopolice.com](mailto:xhevat.ibraj@kosovopolice.com)

[zimp@kosovpolice.com](mailto:zimp@kosovpolice.com)

**From:** Bekim Avdaj  
**Sent:** May 19, 2014 11:00 AM  
**To:** Xhevati Ibraj  
**Subject:** Kërkësë- sigurimi i të dhënave kriminale

Inderuar,

Jam në fazën e kompletimit të hulumtimit doktoral me temën "Studim antropologjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës 1999-2012", pranë "UET" Tiranë. Me qëllim të kompletimit të hulumtimit kam nevojë për të shfrytëzuar statistikat e aktiviteteve penale dhe lokacionet që kanë ndodhur në zonën e stacionit policor në Gjakovë dhe atë nga viti 1999 deri në fund të vitit 2012. Kryesisht kam të bëj me fenomenet e reja kriminale që janë paraqitur pas luftës dhe që për traditën e kësaj zone janë një prurje e re në aspektin kriminal. Këto statistika do të shfrytëzohen vetëm për të konfirmuar rastet e ndodhura që janë raportuar në polici.

**Shtesë:** Këto prurje të reja kriminale do të studiohen në aspektin e antropologjisë kulturore dhe kriminologjisë, pra duke shfrytëzuar pyetësor dhe intervista edhe nga qytetarët, edhe nga viktimet si dhe nga personat e dyshuar.

Qëllimi i studimit është hulumtimi në aspektin social, duke pretenduar që të identifikohen faktorët kriminal në bazën sociale dha që vet shoqëria të ndikon në parandalim.

Andaj, kërkoj që këto evidenca t'më mundësohen t'i marr nga të dhënat e stacionit policor Gjakovë apo data baza rajonale për periudhën në fjalë, pra nga viti 1999 deri me 2013.  
Duke iu falënderuar për mirëkuptimin, iu përvendos.

Sinqerisht,  
Bekim Avdaj

PËR:

**z. Shemsi Hajrizi**  
U.D. Drejtor i Përgjithshëm i SHKK

Data: 09.09.2014

PREJ:

Bekim Avdaj  
PhD Candidate, UET Tiranë

LËNDA:

**Kërkesë**  
-Interviewimi dhe pyetësorët-

I nderuar drejtor,

Jam në fazën e kompletimit të hulumtimit doktoral me temën "**Studim antropologjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës 1999-2012**", pranë "UET" Tiranë. Më qëllim të kompletimit të hulumtimit kam nevojë për të bërë intervista dhe të realizoj disa pyetësor me personat që janë dënuar për veprat penale (apo që edhe më parë kanë qenë të dënuar, kuptohet vetëm për rastet nga paslufta e vitit 1998/99).

Të dhënat do të studiohen në aspektin e antropologjisë kulturore dhe kriminologjisë. Qëllimi i studimit është hulumtimi në aspektin social, duke pretenduar që të identifikohen faktorët kriminal në bazën sociale dhe që vet shoqëria të ndikon në parandalim.

Në kuadër të hulumtimit, ndër tjera kam paraparë edhe realizimin e pyetësorit nga 100 personat që janë në vuajtje të dënimit dhe realizimin e 20 intervistave me personat në fjalë. Të dy këto do janë anonime. Për realizimin e këtyre kam menduar që këto t'i kryej me disa nga personat që janë në burgun e Dubravës dhe në atë të Lipjanit, si dhe në qendrën e paraburgimit në Pejë. Arsyeja është se në kuadër të këtij realizimi më duhet të përfshijë mosha të ndryshme dhe nga të dy gjinjtë, më qëllim që hulumtimi të dal sa më i kompletuar.

Kështu që iu drejtohem me kërkesën për t'më mundësuar të kam qasje në lokacionet në fjalë për realizimin e pyetësorit dhe të intervistave me disa nga personat që janë në vuajtje të dënimive, dhe atë ashtu siç e parashihni ju.

Edhe një herë iu siguroj se asgjë nuk do të ndërlidhet nga puna policore dhe as për ndonjë rast konkret, por në përgjithësi nga aspekti social.

Realizimi i këtyre intervistave dhe pyetësorëve në afatin sa më të shkurtë do të ishte i rëndësishëm përmes.

Duke iu falënderuar për mirëkuptimin, iu përshtendes.

Miqësisht,  
Bekim Avdaj  
Tel. 044 179 369  
Email: bekimi4324@hotmail.com

1

	 <b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosova-Republic of Kosovo</b> <b>Qeveria -Vlada-Government</b>															
<i>Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice</i>																
<i>Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Služba Kosova/Kosovo Korrekctional Service</i> <i>Drejtoria Qendrore-Prishtinë</i>																
<table border="1" style="width: 100%; border-collapse: collapse;"> <tr> <td style="padding: 2px;">DATE/A:</td> <td style="padding: 2px;">10/09/2014</td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">REFERENC-Ë:</td> <td style="padding: 2px;"></td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">PËR/ZA/TO:</td> <td style="padding: 2px;">Bekim Avdaj PhD Candidate,UET Tirane</td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">CC:</td> <td style="padding: 2px;"></td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">PËRMES/PREKO/THROUGH:</td> <td style="padding: 2px;"></td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">NGA/OD/FROM:</td> <td style="padding: 2px;">Shemsi Hajrizi, U.D. Drejtori i Përgjithshëm, Shërbimi Korrektues I Kosovës/Ministria e Drejtësisë</td> </tr> <tr> <td style="padding: 2px;">TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</td> <td style="padding: 2px;">Njoftim</td> </tr> </table>			DATE/A:	10/09/2014	REFERENC-Ë:		PËR/ZA/TO:	Bekim Avdaj PhD Candidate,UET Tirane	CC:		PËRMES/PREKO/THROUGH:		NGA/OD/FROM:	Shemsi Hajrizi, U.D. Drejtori i Përgjithshëm, Shërbimi Korrektues I Kosovës/Ministria e Drejtësisë	TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim
DATE/A:	10/09/2014															
REFERENC-Ë:																
PËR/ZA/TO:	Bekim Avdaj PhD Candidate,UET Tirane															
CC:																
PËRMES/PREKO/THROUGH:																
NGA/OD/FROM:	Shemsi Hajrizi, U.D. Drejtori i Përgjithshëm, Shërbimi Korrektues I Kosovës/Ministria e Drejtësisë															
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Njoftim															
<p>I nderuar z.Bekim Avdaj  E kam pranuar kërkesën tuaj me datë 09/09/2014, me të cilën kërkon leje për të vizituar Qendrën Korrektuese Dubrav,Lipjan dhe Qendrën e Paraburgimit Pejë me qëllim të kompletimit të hulumtimit doktoral me temën: <b>Studimi antropologjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale ne rajonin e Gjakovës 1999-2012.</b>  Shërbimi Korrektues i Kosovës është transparent dhe misionin e saj e realizon duke bashkëpunuar ngushtë edhe më institucionet tjera për të lejuar qasje në realizimin e qëllimeve të përbashkëta.  Pas shqyrtimit të kërkesës tuaj ju njoftoj se e njëjtë është <b>aprovuar</b> dhe ju mund ti vizitoni Qendrat e lartpërmendura.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Pyetësorin të cilin e përgatiteni për personat e dënuar paraprakisht ta sillni ne Drejtoren Qendrore të SHKK-së me qëllim të njoftimit me përbajtjen e pyetjeve.</li> <li>- Për intervistimin e personave të dënuar vendos drejtori i institucionit në bazë të vullnetit të personave të dënuar.</li> </ul> <p>Drejtoret e Institucioneve janë të njoftuar me aprovin e kërkesës tuaj.  Gjatë vizitës jeni të obliguar tu përbaheni ligjeve dhe rregullave të brendshme të Shërbimit Korrektuese të Kosovës.  Për kohën dhe datën e vizitës konsultohuni me Drejtoret e Institucioneve.</p> <p>Me respekt;</p>																

PËR: Vaton Derguti  
Kryetar i gjykatës themelore Gjakovë

Data: 25.08.2014

PREJ: Bekim Avdaj  
PhD Canditate, UET Tiranë

LËNDA: Statistikat për disa vepra të proceduara

I nderuar kryetar,

Jam në fazën e kompletimit të hulumtimit doktoral me temën "Studim antropologjik dhe kriminologjik i aktiviteteve kriminale në rajonin e Gjakovës 1999-2012", pranë "UET" Tiranë. Me qëllim të kompletimit të hulumtimit dhe të argumentimit kam nevojë për disa konfirmime të disa rasteve që kanë kaluar nëpër institucionin tuaj.

Të dhënat do të studiohen në aspektin e antropologjisë kulturore dhe kriminologjisë. Qëllimi i studimit është hulumtimi në aspektin social, duke pretenduar që të identifikohen faktorët kriminal në bazën sociale dhe që vet shoqëria të ndikon në parandalim.

Për të realizuar këto, është e nevojshme që t'më mundësohet statistika për rastet nga fundi i viti 1999 deri në vitin 2012 (pra, komplet edhe viti 2012) dhe ajo për këto raste:

Vrasje, grabitje, vjedhje grabitqare, vetëvrasje, tentim vetëvrasje, dhunë në familje, shkaktim të rezikut të përgjithshëm (kryesisht me mijete eksplozive dhe zjarr vënie), shantazh, trafikim i qenieve njerëzore, posedim i mijeteve psikotropedrogave, kërkim i lëmoshës, lojëra të fatit, fajde, reketim, kontrabandim me imigrantë, krim të organizuar, hyrje në sistemet kompjuterike, usurpim i paligjshëm i pronave, rrëmbim/kidnapim, persona të zhdukur.

Me interes do të ishte edhe sigurimi i të dhënavë ku janë përfshirë edhe nën moshën 18 vjeçare, si dhe nga gjinia femërore. Pastaj, rastet e marrjes së të drejtës prindërore. Nëse keni statistika të shkurorëzimeve/divorceve. Apo edhe ndonjë të dhëne që ju e vlerësoni me interes për aspektin studimor në fjalë

Edhe një here iu siguroj se asgjë nuk do të ndërlidhet nga puna policore dhe as për ndonjë rast konkret, por në përgjithësi nga aspekti social.

Sigurimi i këtyre të dhënavë në afatin sa më të shkurtë do të ishte i rëndësishëm përmua.

Duke iu falënderuar për mirëkuptimin, iu përshëndes.

Miqësisht.

1

## LITERATURA

### Literatura parësore

- Bajraktari, Jusuf (1998). *Gjakova me rrethinë (1878-1912)*. Prishtinë: Instituti i historisë
- Bardhoshi, Nebih (2011). *Gurtë e kufinit – Kanuni, pronësia, strukturimi social*. Tiranë: UET press
- Barnes, Harry E., Teeters, Negley K. (1959): *New Horizons in criminology*. 3rd edition. Englewood Cliffs: Prentice Hall
- Beqja, Hamit (1987). *Evolucioni i edukatës familjare dhe tipat e saj të sotëm kryesorë*. Te: Kultura Popullore viti VIII (15), nr. 1. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH-Instituti i kulturës populllore
- Biberaj, Elez (2011). *Shqipëria në tranzicion- rruga e vështirë drejt demokracisë 1990-2010*. Tiranë: AIIS.
- Bickman, Leonard (2008). *The handbook of applied social research methods*. 2nd edition. Thousand Oaks, California: Sage Publications
- Bobi, Gani (1986). *Paradoks kulturor*. Prishtinë: Rilindja.
- Buda, Aleks (2006). *Studime historike - tekste të zgjedhura*. Akademi e shkencave dhe e arteve e Kosovës. Botime të veçanta LXXII seksioni i shkencave shoqërore. Libri 22. Prishtinë: Adnan R. Co
- Bullaç, Ali (2003). *Historia, shoqëria dhe tradita*. Shkup: Logos-A.
- Burkart, Roland (1998). *Kommunikationswissenschaft. Grundlagen und Problemfelder. Umrisse einer interdisziplinären Sozialwissenschaft*. 3. überarbeitete und aktualisierte Auflage. Wien, Köln: Verlag Böhlau.
- Canhasi, Shevqet (2004), *Haxhi Zekë Byberi- në lëvizjen kombëtare Shqiptare*. Pejë: Besa
- Canolli, Arsim (2009). *Kultura K*. Prishtinë: AIKD

- Coser, Lewis & Ridener, Larry (2005). *Teoritë sociologjike – nga fillimet deri në ditët tona*. Tiranë: Plejad
- Creswell, John W. (2008). *Research Design: Qualitative, Quantitative and Mixed Methods approaches*, 3rd edition. California, US: Sage Publications
- Demiraj, Bardhyl (2014). *Shqiptar dhe shqa – histori popujsh përmes dy emrave etnikë*. Tiranë: Naimi.
- Dragoti, Edmond (1999). *Psikologja sociale*. Tiranë: Libri Universitar
- Dhima, Aleksandër (1985). *Gjurmime antropologjike mbi shqiptarët-Monografi*.
- Dhima, Aleksandër (2010). *Hyrje në antropologji*. Tiranë: botimet ideart
- Dhima, Aleksandër (2013). *Antropologji e komunikimit - Qasje në realitetin shqiptar*. Tiranë: Kumi.
- Falaski, Vlora Nermin (2002). *Pellazgët- ilirët – etruskët- shqiptarët*. Prishtinë: Faik Konica
- Giddens, Anthony (2004). *Sociologja*. Tiranë: Çabej.
- Gjokutaj, Çapajev (1987). *Kultura popullore në mendësinë e rilindësve*. Te: Kultura Popullore, viti VIII (15), nr. 2. Tiranë: Akademia e Shkencave e RPSSH- Instituti i kulturës popullore
- Hahn Georg Johan [1854]. *Studime shqiptare*. Bota shqiptare 10. Tiranë: Kumi
- Hajdari, Azem (2004). *Kriminaliteti i të miturve në Kosovë gjatë periudhës 2001-2003*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës
- Halili, Ragip (1995). *Kriminologja me penologji*. Prishtinë
- Halili, Ragip (2002). *Kriminologja*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës/ Fak. Juridik
- Halili, Ragip (2008). *Kriminologja*. Prishtinë: Universiteti “Fama”
- Halili, Ragip (2009). *Penologja*. Prishtinë: Kolegji “Fama”

Hysi, Vasilika (2000). *Hyrje në kriminologji dhe penologji*. Tiranë: Universiteti i Tiranës/ Fakulteti i Drejtësisë.

Hysi, Vasilika (2005). *Kriminologja*. Tiranë: Universiteti i Tiranës/ Fakulteti i Drejtësisë.

Islami, Hivzi (1981). *Popullsia e Kosovës, studim demografik*. Prishtinë: Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës

Jacques, Edwin (1995). *Shqiptarët – histori e popullit shqiptar nga lashtësia deri në ditët e sotme*. Tiranë: Kartë e Pendë

Keesing, Roger, & Strathern, Andrew (2007). *Antropologja kulturore - një perspektivë bashkëkohore*. Tiranë: UFO Pres.

Krasniqi, Mark (1990). *Disa ndryshime bashkëkohore në traditën fshatare në Kosovë nën ndikimin e faktorëve ekonomikë*. Te: Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare. Prishtinë: Instituti albanologjik i Prishtinës

Krasniqi, Mark (2002). *Rrënje tona etnike*. Prishtinë: Dukagjini.

Latifi, Vesel (2008). *Politika kriminale*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës/ Fakulteti Juridik.

Lleshi, Qazim (1987). *Normalja e Gjakovës, themelimi dhe brezi i saj i parë 1946-1948*. Prishtinë: Rilindja

Martin, N. Judith, & Nakayama, K. Thomas (2010). *Hyrje në komunikimin ndërkulturor*. Tiranë: UET Pres.

Maxwell, Joseph A. (2005). *Qualitative research design: an interactive approach*, 2nd edition. Thousand Oak, California, US: Sage Publications

Memushi, Luan (2000). *Antropologja*. Tiranë: Shtëpia botuese e Librit Universitar.

Miles, Matthew B., Huberman, Michael A. (1994). *Qualitative data analysis: an expanded sourcebook*, 2nd edition. Thousand Oaks, California: Sage Publications

- Milutinovic, Milan (1982). *Kriminologja*. Prishtinë: ETMMK
- Myers David G. (2003). *Socialpsikologja*. Tiranë: UEGEN
- Nopça, Franc (2013). *Fiset e Malësisë së Shqipërisë veriore dhe e drejta zakonore e tyre*. Tiranë: Eneas
- Olson Mancur (2001). *Ngritja dhe rënia e kombeve*. Tiranë: Toena
- Osmani, Jusuf (2010). *Vendbanimet e Kosovës – Gjakova 14*. Prishtinë: Karnime
- Pinatel, Jean (1979). *La criminologie*. Paris: Buchbeschreibung Editions ouvrières
- Pipa, Arshi (2007). *Stalinizmi shqiptar – aspekte ideo-politike*. Tiranë: IKK&Princi
- Pirraku, Muhamet (1989). *Kultura kombëtare shqiptare deri në lidhjen e Prizrenit*. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës
- Pula, Selami (1972). Krahinat e Sanxhakut të të Dukagjinit gjatë shek. XVI. Studime historike nr. 3 – 4; ID 1984. Popullsia shqiptare e Kosovës në shek. XV – XVI: Studime dhe dokumente. Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë
- Rago, Paolo. (2011). *Tradita, nacionalizmi dhe komunizmi në Shqipërinë bashkëkohore*. Tiranë: Dudaj.
- Raimi, Sunaj (2009). *Sociologja*. Tetovë: Universiteti Shtetëror i Tetovës
- Rizvanolli, Masar (2009). *Çarshia e madhe e Gjakovës*. Gjakovë: Shoqata e intelektualëve “Jakova”
- Rizvanolli, Masar (2009). *Zhvillimi i arsimit shqip në Gjakovë deri më 1918*, K.D.U.37 (496.51) (092). Kosova 31/32. Prishtinë: Institut i historisë K.D.U.94 (=18)
- Sayer, Andrew (1992). *Methods in social science: a realist approach*, 2nd edition. London: Routledge
- Schmitt, J. Oliver (2012). *Shqiptarët – një histori midis Lindjes dhe Perëndimit*. Guttenberg, Tiranë

Šeparovic, Zvonimir (1982). *Kriminologija i socijalna patologija*. Zagreb: Pravni fakultet u Zagrebu

Singer, Mladen (1996). *Kriminologija*. Zagreb: Globus

Statovci, Drita (1990). *Ndryshimet bashkëkohore në kulturën populllore shqiptare dhe rezultatet dhe detyrat e etnografisë ndaj problemit të ndryshimeve*. Te: Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën populllore shqiptare. Instituti Albanologjik i Prishtinës: Prishtinë: Rilindja.

Shukriu, Edi (2002). *Trashëgimia arkeologjike në kontekst të ndryshimeve të toponomive*. Te: Toponimia e Gjakovës me rrëthinë, Kuvendi i Komunës Gjakovë. Gjakovë: Blini-BK

Tarifa, Fatos (2014). *Dinamika e modernitetit pluralizues*. Tiranë: Minerva

Tërnava, Muhamet (1995). *Popullsia e Kosovës gjatë shekujve XIV-XVI*. Instituti Albanologjik i Prishtinës. Prishtinë: Grafoprint

Tirta, Mark (1981). *Besime të ndryshme në kulturën populllore shqiptare, procesi i zhdukjes së tyre mbas çlirimt*. Te: Etnografia shqiptare 11. Akademia e shkencave e RPSSH, Instituti i kulturës populllore. Tiranë

Tirta, Mark (2003). *Etnologjia e shqiptarëve*. Tiranë: Geer

Tushi, Gëzim (2006). *Probleme dhe dilema sociale*. Tiranë: Dudaj

Tylor, Edward (1871). *Origins of Culture*. New York: Harper & Row

Uçi, Alfred (1997). *Për një rivlerësim kritik të përvojës së zhvillimit të kulturës populllore*. Te: Kultura popullore 1, 2. Viti XVIII (35, 36). Tiranë: Shkenca

Uka, Sabit (2002). *Përkime onomastike të regjionit të Prokuples dhe të atij të Gjakovës dhe disa veçori të Gjakovës me rrëthinë*. Te: Toponimia e Gjakovës me rrëthinë. Gjakovë. Kuvendi i komunës Gjakovë

Vold, George B., Bernard, Thomas J., Snippes, Jeffrey B. (1998). *Theoretical criminology*. New York: Oxford University Press

- Weber, Max (2004). *Studime sociologjike*. Tiranë: Plejad
- Xhakolli, Agron (1997). *Arritje dhe probleme të folkloristikës dhe të etnografisë shqiptare*. Te: Kultura popullore 1, 2. Viti XVIII (35, 36). Tiranë: Shkenca
- Yin, K.Robert (2009). *Case study research: Design and Methods*, 4th edition. Thousand Oaks California: Sage Publications
- Zimel, Georg (1969). *Teorije o drushtvu*. Beograd: VukKaraxhiq.
- Zuma-Deva, Afërdita &bp. (2009). *Partneriteti shkollë-familje-komunitet*. Prishtinë: Libri shkollor.

#### **Literatura dytësore:**

- Agani, Fehmi (2002). *Mbi shoqërinë civile*. Pejë: Dukagjini
- Begeja, Skënder (2001). *Kriminalistika*. Tiranë: Erik
- Braunstein, François-Jean & Phan Bernard (2008). *Manual i Kulturës së përgjithshme*. Tiranë: Liria
- Cana, Zekeria (1996). *Gjenocidi i Malit të Zi mbi popullin shqiptar 1912 - 1913*, dokumente. Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës
- Demiraj, Bardhyl (2006). *Gjon P. Nikollë Kazaz*. Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Prishtinë: Grafoprint
- Foucault, Michel (2010). *Disiplinë dhe ndëshkim*. Tiranë: Odeon
- Gashi, Bejtush & Avdaj, Bekim (2012). *Roli dhe përgjegjësitë e policisë në sistemin e sigurisë së brendshme*. Pejë: Kolegji Evropian Dukagjini
- Gjata, Fatos (2003). *Krimi dhe droga – këndvështrim juridiko-social*. Tiranë: Afërdita
- Gjika, Preng (1999). *Gjurmime etnologjike në trevat veriore shqiptare*. Tiranë, Mirëdita
- Gjonbalaj, Hasan I. (2012). *Rite e zakone*. Pejë: Biblioteka Malësori

- Hadri, Ali (1979). *Gjakova me rrethinë në LNÇ-e*, Prishtinë
- Hajdari, Azem (2006). *Kriminaliteti i organizuar*. Prishtinë: TWINS
- Haxhibeqiri, Fuad (2011). *Monografi e kimeve të luftës në Gjakovë 1998-1999*. Gjakovë: Erpo-print
- Haxhosaj, Halil (2012). *Khubi letrar "Gjon N. Kazazi" – Monografi*. Gjakovë: Klubi letrar "Gjaon N. Kazazi"
- Hecquard, Hyacinthe (2008). *Historia dhe përshkrimi i Shqipërisë së Epërme ose i Gegërisë*. Tiranë: Plejad
- Historia e shtetit dhe e së drejtës në Shqipëri (2005). Tiranë: Luarasi
- Ismaili, Osman (2007). *Fillet e së drejtës*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës – Fakulteti juridik
- Këpuska, Avni (2004). *Qenësia e territorit dhe kufive etnikë autoktonë të Kosovës*. Prishtinë: Rilindja
- Korajlic, Nedzhat & Muharremi, Driton (2009). *Kriminalistika*. Prishtinë: Riinvest
- Korkuti, Muzafer (2003). *Parailirët, ilirët, arbërit – histori e shkurtër*. Tiranë: Toena
- Krasniqi, Mark (2007). *Toleranca në traditën shqiptare*. Prishtinë: Akademia e shkencave dhe e arteve e Kosovës
- Kuliqi, Halim (2003). *Viktimat e delikteve të gjakut në Kosovë*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik.
- Lajçi, Bashkim (2007). *Gjurmë etnologjike*. Pejë: Dukagjini.
- Latifi, Vesel (2001). *Taktika kriminalistike*. Universiteti i Prishtinës, fakulteti Juridik. Prishtinë
- Latifi, Vesel (2006). *Kriminalistika*. Universiteti i Prishtinës, fakulteti Juridik. Prishtinë
- Latifi, Vesel (2009). *Kriminalistika*. Prishtinë: Universiteti i Prishtinës

Masllesha, Ramo (2006). *Strategjia kriminalistike*. Sarajevë/Prishtinë: Universiteti AAB

Nushi, Pajazit (2011). *Vetëdija kulturore dhe politike e shqiptarëve në kohën e lidhjes së Prizrenit*. Lidhja shqiptare e Prizreni 1878-1881. Prishtinë: Instituti i Historisë - Prishtinë

Pango, Ylli (2003). *Psikologji Sociale*. Tiranë: Albin

Rexhepagiq, Jashar (2008). *Çështje fondamentale në pedagogjinë ndërkombëtare*. Prishtinë.

Sahiti, Ejup (1996). *Të provuarit në procedurën penale - mundësitë dhe vështirësitë*. Prishtinë: E drejta, nr 3.

Salihu Ismet (1985). *Vrasjet në KSAK*. Prishtinë

Serbia e shqiptarët- pasqyrë e politikës së Serbisë ndaj shqiptarëve prej vitit 1878 deri në vitin 1914. Libri i parë. Instituti i Historisë Prishtinë; Prishtinë

Sokoli, Lekë (2000). *Themeluesit e sociologjisë*. Tiranë: Rinia 2000

Stavileci, Esat (2000). *Kosova nën administrimin ndërkombëtar*. Gjakovë: Forumi për Iniciativë Demokratike

Subhani Imtiaz Muhammad & Osman Amber, (2011). *Human mindis a Tabula Rasa*. Interdisciplinary Journal Of Contemporary Research in Business, Vol. 3, No. 3, np. 1173 – 1176 July 2011

Shabani, Alisabri (2006). *Tema të zgjedhura nga patologjia sociale*. Sarajevë/ Prishtinë: FSK/13/06

Titra, Mark (2001). *Etnologjia e përgjithshme*. Tiranë: Geer

Uljini, Kahreman (1991). *Bajraku në organizimin e vjetër shoqëror*. Akademia e shkencave e RPS e Shqipërisë. Tiranë.

Uljini, Kahreman (2003). *Struktura e shoqërisë tradicionale shqiptare*. Shkodër: Idromeno

Vula, Veton (2013). *Kriminaliteti i organizuar*. Pejë: Kolegji Evropian Dukagjini

Yvejsi, Mexhid (2013). *101 Personalitete*. Prishtinë: Instituti për shkencat humane “Ibni Sina”, Prishtinë,

Zajmi, Shkelzen & Blerim (2010). *Familja Zajmi - mbi 250 vjet çerdhe e pendës, pushkës dhe atdherdashurisë*. Gjakovë: Shoqata e Intelektualëve “Jakova”

**Burime tjera:**

Aleanca Gjinore për Zhvillim (2008). *Ndarja e jetës private dhe publike në familjet shqiptare*. Tiranë: Mediaprint.

Ekonomitë shtëpiake sipas vendbanimeve në KSA të Kosovës. Prishtinë: Qershori 1984, buletini 37

Enti i Statistikave të Kosovës, Prishtinë, Prill 2014

Guidë turistike (2010). *Gjakova dhe Valbona*. Gjakovë: Erpo print

Instituti i Kosovës për mbrojtjen e monumenteve të kulturës (2004). *Monumentet e Kosovës*. Prishtinë

Intervista - Rrëfime personale

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2005). *Trashëgimia e evidentuar e Kosovës*. Prishtinë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (2007). *Xhamia e Hadumit & Çarshia e Gjakovës*. Prishtinë: Instituti i Mbrojtjes së Monumenteve të Kosovës

Monografi, Historiku i shkrimit shqip në Gjakovë

OSBE (2008). *Praktika të mira për ndërtimin e partneritetit Polici-Publik*. Vjenë

Popullsia sipas kombësisë dhe vendbanimeve në KSA të Kosovës - regjistrimi i popullsisë, ekonomive shtëpiake dhe i banesave më 1981 (1984). Prishtinë: Enti krahinor i statistikës, buletini 33:

Qendra Aleanca gjinore për zhvillim (qershor 2008), Gaia. Revistë për tremuajshe, nr. 6

Qendra për punë sociale, K.K Gjakovë

Raportet Vjetore të Policisë së Gjakovës nga 2000-2011

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës kundër Krimtit të Organizuar, 2009-2012

Studimi etnografik i ndryshimeve bashkëkohore në kulturën popullore shqiptare,  
Instituti Albanologjik i Prishtinës

*Toponimia e Gjakovës me rrëthinë* (2002), Gjakovë: Kuvendi i Komunës - Gjakovë